

Bordi Editorial

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

FATOS TARIFA PH.D., *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ERLETA MATO, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. ENIS SULSTAROVA, *Universiteti i Tiranës*

BLENDI KAJSIU, DOKT., *Essex University, Britani e Madhe*

STEPHANIE SCHWANDNER-SIEVERS, *University of Roehampton, Britani e Madhe*

PROF. ASOC. ÇAPAJEV GJOKUTAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. NATHANIEL COPSEY, *Aston University, Britani e Madhe*

Kryeredaktore

ODETA BARBULLUSHI, PH.D.

Redaktorë shkencorë

PROF. ASOC. DR. TONIN GJURAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. PËRPARIM FUGA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ALEKSANDËR DHIMA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

VALBONA NATHANAILI, DREJTORE UET PRESS

Redaktorë

BASHKIM GJERGJI

BESA VILA

Arti grafik

BESNIK FRASHNI

Dialogu dhe kritika e lirë si emancipim shoqëror: ç'mësojmë nga Popper dhe Habermas? Ph.D. Fatos TARIFA & Prof. Asoc. Dr. Tonin GJURAJ.....	5
Globalizimi kulturor dhe komunikimi global Prof. Dr. Aleksandër DHIMA.....	15
Vështirësitë në procesin e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme Dokt. Roland LAMI.....	29
Përjashtimi social në lagjet e pafavorizuara për qytetin e Kukësit Dokt. Rifat DEMALIJA.....	39
Qasjet politikëbërëse për grupet e skajuar: kufijtë e ligjërimit në hapësirën publike për “fëmijët në situatë rruge” Dokt. Blerjana BINO.....	53
Ndërtimi i identiteteve nëpërmjet arkitekturës Dr. Vera BUSHATI & MA. Bisej KAPO.....	69
Udhëtimi i teorive neoliberales në fushën e zhvillimit urban në vendet postsocialiste. Rasti shqiptar Ph.D. Marcela MELE & Entela SHEHU.....	79
Dëshira e "Tjetrit" si indikator për të lexuar vuajtjen psikike ose mutacionet bashkëkohore në lidhjet sociale Dokt. Klodiana TURHANI	97
Poshtë korrupsioni! Rroftë Neoliberalizmi! Politika e fushatës ndërkombëtare antikorruption në Shqipëri, 1998 - 2005 Ph.D. Blendi KAJSIU	111
Niveli i kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë: efektet e drejtimit të zyrtarëve të lartë dhe besimit në institucione Ph.D. Marsela DAUTI	135

Botime të kolanës “REVISTA SHKENCORE”.

© 2013 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve.
Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në shkrimet e tyre.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

odeta.barbullushi@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Revista është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
“UET Press” është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, verë 2013.

Media sociale, audienca dhe politika. Çfarë audience synojnë politikanët nëpërmjet internetit? MA. Erald KAPRI	153
RECENSA	163
Recensë e monografisë së dr. Nebi Bardhoshit: "Gurtë e kufinit" Tiranë: UET Press, 2011 Prof. Dr. Aleksandër DHIMA	163
Recensë e librit të Shkëlzen Maliqit: "Shembja e Jugosllavisë, Kosova dhe rrëfime të tjera". Tiranë: UET Press, 2011 PhD. Odeta BARBULLUSHI	169
Recensë e librit të Michel Foucault (1976): "Historia e Seksualitetit, Vullneti për Dije", përkthyer nga Orges Hazizi, Tiranë: UET Press, 2011 Dokt. Klodiana TURHANI	173
ABSTRACTS	181

Dialogu dhe kritika e lirë si emancipim shoqëror: ç'mësojmë nga Popper dhe Habermas?

Ph.D. Fatos TARIFA¹

Prof. Asoc. Dr. Tonin GJURAJ²

Abstrakt. Edhe pse filozofitë e Popper-it dhe të Habermas-it konsiderohen shpesh si të papajtueshme, kryesisht për sa i përket metodologjisë së shkencave sociale dhe ideologjisë politike, në to ka elemente që flasin jo vetëm për shqetësime të përbashkëta, por edhe për një sërë vlerash dhe supozimesh të njëjta si, për shembull, vlera e lirisë së fjalës dhe të komunikimit, e cila ka një rëndësi qendrore tek të dy. Për Popper-in, një kërkesë esenciale për shoqërinë e hapur është liria për të kritikuar autoritetet politike dhe intelektuale, ndërsa Habermas i kushton rëndësi komunikimit të hapur dhe të qartë. Konvergjenca kryesore në mendimin e tyre shihet sidomos në idenë e Popper-it rreth "shoqërisë së hapur" dhe në konceptin e Habermas-it mbi "situatën ideale të fjalës". Si njëri dhe tjetri flasin për rëndësinë e sferës publike dhe për rolin e dialogut e të kritikës së lirë në kontekstin e shoqërisë demokratike, edhe pse ata përdorin mënyra të ndryshme për ta argumentuar këtë. Ky artikull synon të argumentojë rëndësinë që kanë idetë e Popper-it dhe të Habermas-it rreth rolit që debati i lirë dhe i vërtetë mund të luajë për emancipimin e shoqërisë shqiptare, kaq shumë të polarizuar intelektualisht.

Hyrje

Jetës intelektuale në Shqipëri i mungojnë kryesisht dy gjëra: (1) krijimi i njëmendët teorik në fushën e shkencave dhe (2) debati i gjallë në çdo fushë të krijimtarisë intelektuale. Në këtë artikull, ne dëshirojmë të trajtojmë disa

¹ Fatos Tarifa, PhD është Drejtor i Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave në Universitetin Europian të Tiranës dhe anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave.

² Prof. Asoc. Dr. Tonin Gjuraraj është Rektor i Universitetit Europian të Tiranës.

çështje që kanë të bëjnë me të dytën, duke u nisur nga idetë që kanë shtjelluar dy prej filozofëve më të shquar të shekullit të 20-të: Karl Popper dhe Jürgen Habermas. Popper dhe Habermas kanë qenë të angazhuar fuqimisht në “debatin pozitivist” (*Positivismusstreit*) të viteve '60. Edhe pse filozofitë e tyre konsiderohen shpesh si të papajtueshme, kryesisht për sa i përket metodologjisë së shkencave sociale dhe ideologjisë politike, në to ka elemente që flasin jo vetëm për shqetësime të përbashkëta, por edhe për një sërë vlerash dhe supozimesh të njëjta si, për shembull, vlera e lirisë së fjalës dhe komunikimit, e cila ka një rëndësi qendrore tek të dy. Për Popper-in, një kërkesë esenciale për shoqërinë e hapur është liria për të kritikuar autoritetet politike dhe intelektuale, ndërsa Habermas i kushton rëndësi komunikimit të hapur dhe të qartë. Konvergjenca kryesore në mendimin e tyre shihet sidomos në idenë e Popper-it rreth “shoqërisë së hapur” dhe në konceptin e Habermas-it rreth “situatës ideale të fjalës” (*ideal speech situation*). Si njëri dhe tjetri flasin për rëndësinë e sferës publike dhe për rolin e dialogut e të kritikës së lirë në kontekstin e shoqërisë demokratike, edhe pse ata përdorin mënyra të ndryshme për ta argumentuar këtë. Ky artikull synon të argumentojë rëndësinë që kanë idetë e Popper-it dhe të Habermas-it mbi rolin që debati i lirë dhe i vërtetë mund të luajë në emancipimin e shoqërisë shqiptare intelektualisht të polarizuar.

Një shoqëri postkomuniste si kjo e jona, e cila doli nga periudha komuniste jo vetëm më e varfër sesa çdo shoqëri tjetër europianolindore, por edhe me një traumë të rëndë shpirtërore dhe intelektuale, është karakterizuar, në këto njëzet e ca vitet e fundit, nga një polarizim ekstrem politik dhe intelektual. Të duket sikur jo vetëm aktorët politikë kryesorë, por edhe njerëzit krijues në fushën e ideve, të shkencës, të letrave dhe të arteve nuk gjejnë dot një gjuhë të përbashkët për të komunikuar, ose “komunikojnë” në një gjuhë, e cila, duke qenë shqip për këdo, është megjithatë semantikisht e ndryshme për të gjithë. Eksperiencat jetësore dhe fatet e ndryshme të intelektualëve shqiptarë në periudhat para dhe pas rënies së komunizmit duket se kanë krijuar një mjedis të tillë social dhe intelektual, në të cilin komunikimi dhe, aq më pak debati i mirëfilltë intelektual, janë bërë shumë të vështirë, në mos të pamundur. Shumë intelektualë, të cilët përpiqen të sjellin në vëmendjen e publikut një shqetësim real, ose të sugjerojnë ndonjë ide, vihen në shënjestër nga intelektualë të tjerë, shumë herë më pak të aftë, ose të cilët vijnë nga fusha që s’kanë të bëjnë aspak me idetë e shprehura. Në më të shumtën e rasteve, ata sulmohen dhe, herë-herë, stigmatizohen me një fjalor banal, jo për shkak të ideve që ata shprehin, por për shkak të emrit që kanë dhe të punëve që kanë realizuar. Faqet e shtypit shqiptar janë të mbushura thuajse çdo ditë me shembuj të tillë. Po, a është ky një realitet fatal?

Karl Popper, një ndër filozofët më origjinalë dhe më të shquar të shekullit të 20-të, vinte në dukje se komunikimi midis individëve, të cilët nuk kanë një “prejardhje kulturore” ose një “gjuhë kulturore” të përbashkët, si edhe komunikimi intelektual mes atyre që janë kundërshtarë ideologjikë, nuk është krejt i pamundur. Ai mund të

jetë shumë i vështirë, por nëse arrin të komunikosh me një kundërshtar intelektual, kjo është diçka shumë e frytshme për të dyja palët. Vetë Popper demonstroi se, duke argumentuar një pikëpamje të caktuar dhe duke debatuar lidhur me të, ne të gjithë, si individë, mund të përmirësojmë si idetë tona, ashtu edhe njohuritë kolektive të shoqërisë në të cilën jetojmë.

Aftësia për të qenë kritikë—dhe sidomos autokritikë—demonstrohet më mirë se kudo në procesin e komunikimit dhe të debatit publik. Por, siç sugjerojnë vështirësitë dhe problemet e përditshme në komunikimet tona në *hapësirën publike*, nëse eksperiencat tona jetësore dhe *background*-i ynë kulturor nuk përpunohen me ato të individëve të tjerë, me të cilët ne komunikojmë, mundësia e një dialogu ose e një komunikimi të vërtetë është e vogël.

Idea se të gjitha problemet njerëzore shkaktohen, në fund të fundit, nga “forca sociale”, është zhvilluar për herë të parë nga Hegeli. Koncepti i tij *Zeitgeist* (idetë sunduese në një kohë dhe në një vend të caktuar) (Hegel 1975), u bë, si të thuash, shkopi magjik për shkencën dhe filozofinë, për moralin dhe fenë, për politikën dhe estetikën e shekullit të 19-të, sepse impersonaliteti i këtij koncepti filozofik u duk se, me kalimin e kohës, i transcendente dallimet kulturore midis individëve. Sidoqoftë, problemi me “forcat sociale”, si një *idée fixe* që sot është bërë dije konvencionale, qëndron në vetë konceptin hegelian të ndryshimit, i cili, te Hegeli, ka për subjekt të njohjes jo mendimin individual të njeriut me pavarësinë e tij krijuese, por “Frymën” e përgjithshme, e cila materializohet në sistemet shoqërore dhe në institucionet e tyre, që zhvillohen historikisht. Me këtë transformim, zgjidhjet specifike që u jepen problemeve të veçanta bëhen më pak të rëndësishme sesa “Fryma” e kohës, ose sesa eksperiencia kolektive historike dhe sociale që kjo “Frymë” gjeneron, duke zgjidhur në mënyrë impersonale problemet tona si individë të veçantë. Marksi, nga ana e tij, besonte se çdo klasë shoqërore ka ideologjinë e vet dhe se klasat që kanë “interesa ekonomike antagoniste” nuk mund të pajtohen kurrë, por janë vazhdimisht në luftë me njëra-tjetrën (Marx & Engels [1846] 1998; shih, gjithashtu, Lukács [1923] 1972).

Relativizmi i dijes dhe kriteri i së vërtetës

Në ditët tona, shumë autorë postmodernistë janë të mendimit se ideologjitë e ndryshme mund të bashkekzistojnë në mënyrë paqësore me njëra-tjetrën, jo duke konkurruar për të provuar secila vërtetësinë a epërsinë e saj, por duke pranuar diversitetin e tyre. Nga ky pozicion relativist, askush nuk ka të drejtë ta konsiderojë Tjetrin si “të paarsyeshëm” vetëm e vetëm për shkak se pikëpamjet e tij ndryshojnë nga pikëpamjet tona, edhe pse të dyja palët mund të mos bien kurrë dakord për asgjë, pasi nuk kanë të përbashkët asgjë që të shërbente si një standard (ose kriter) i vetëm kulturor. Fizikani dhe filozofi i shquar i shkencës, Philipp Frank, ka

argumentuar se “relativizmi” është një metodë, e cila ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përparimin e dijes njerëzore (Frank 1951: 20). Ai shkruante: ‘Atje ku është bërë beteja e vërtetë për progresin e njohjes...kjo beteje është zhvilluar dhe drejtuar pikërisht nga doktrina e së vërtetës relative’ (ibid).

Nuk ka dyshim se mënyra më e lehtë dhe të cilën e ndeshim më shpesh në përcaktimin e së vërtetës është ajo që nisët nga standardet tona *individuale* rreth të vërtetës—e vërtetë është ajo që mendoj unë. Këtë dukuri e ndeshim rëndom në faqet e shtypit dhe në debate të ndryshme televizive në Shqipëri, të cilat më shumë dominohen prej narcisizmit dhe solipsizmit të të njëjtëve “intelektuale” të kudogjendur, sesa karakterizohen nga një debat i mirëfilltë intelektual. Në fakt, narcisizmi, solipsizmi dhe besimi i verbër në të vërtetën “tënde” nuk bëjnë tjetër veçse inkurajojnë intolrancën dhe izolimin intelektual.

Kushdo nga ne e krahason standardin e vet mbi të vërtetën me standardet e individëve të tjerë dhe, nëse jemi intelektualisht të ndershëm dhe kurajozë, çdonjëri nga ne mund të kuptojë—dhe të pranojë—se, shumë herë, standardi i së vërtetës nuk është domosdoshmërisht ai që aplikojmë ne vetë. Madje, duke i gjykuar pikëpamjet tona sipas standardeve që s’janë tonat, ne mundet edhe t’i ndryshojmë këto pikëpamje dhe të pranojmë si të vërtetë atë që sugjeron dikush tjetër, i cili është më i informuar sesa ne dhe gjykon më saktë se ne. Në një shoqëri demokratike, ashtu si në shkencë, ajo që ndonjëherë është më e nevojshme—dhe më e dobishme—janë opinionet e ndryshme ose të kundërta nga dija konvencionale. Astrofizikani i shquar amerikan, Karl Sagan, vinte në dukje se:

Në shkencë ndodh shpesh që shkencëtarët të thonë: ‘E di çfarë? Argumenti juaj është vërtetë bindës, ndërsa qëndrimi im është i gabuar’ dhe, pas kësaj, ata ndryshojnë qëndrim dhe s’i dëgjon më të përsërisin të njëjtën pikëpamje të vjetër (Sagan 1987: 39).

Sa ndodh kjo në shkencat shqiptare dhe, përgjithësisht, në debatet intelektuale që zhvillohen në vendin tonë? Shkenca dhe, përgjithësisht, shoqëria njerëzore, ekzistojnë dhe zhvillohen si një *proces vetëkorrigjues*. Që të pranohen gjerësisht, idetë e reja duhet t’u qëndrojnë standardeve më rigorozë të mbledhjes dhe të ekzaminimit të fakteve.

Habermas: diskursi komunikativ dhe format patologjike të përdorimit të gjuhës

Meqenëse kriteri i së vërtetës nuk përkon me atë që gjykojmë ne vetë, kur angazhohemi në një debat publik kërkohet që në morinë e gjykimeve që shprehen për një çështje të caktuar të vlerësojmë dhe të zgjedhim atë gjykim, i cili mbështetet

mbi fakte të verifikueshme dhe që është i argumentuar më mirë. Kjo nuk duhet kuptuar si dobësi intelektuale, por si një virtut dhe ndershmëri intelektuale. Sidoqoftë, një gjë e tillë bëhet praktikisht e mundur vetëm nëse *kolektivisht* përpigemi të ndërveprojmë me njëri-tjetrin në një diskurs komunikativ të civilizuar. Ndryshe nga Michel Foucault (1972), i cili i shihte gjuhën dhe komunikimin si një çështje dominimi, Jürgen Habermas, argumenton se komunikimi midis njerëzve nënkupton që, si ata që flasin, ashtu edhe ata që dëgjojnë, janë *a priori* të interesuar që ta kuptojnë njëri-tjetrin në lidhje me “interesimet e tyre të përbashkëta”, duke bërë të mundur mirëkuptimin mes tyre (Habermas 1971: 314). Supozimi nga nisët Habermas është se, në procesin komunikativ, çdo pjesëmarrës reflekton mbi pozicionin dhe pikëpamjet e tij, çka nënkupton që struktura e gjuhës është esencialisht *hermeneutike* (interpretative) dhe, si e tillë, ajo bën të nevojshme që pjesëmarrësit në diskutim të angazhohen në interpretime në të gjitha nivelet, duke e rritur kështu shkallën e të vetkuptuarit tek çdo individ, çka mundësohet nga vetë ndërveprimi me të tjerët (Gjuraj & Tarifa 2011). Ky, sipas Habermasit, është pikërisht vetë *telos*-i i gjuhës. Gjuha, sipas tij, demonstroi sociabilitetin tonë më esencial. Habermas e konsideron gjuhën si një “meta-institucion”, nga i cili varen të gjitha llojet e institucioneve shoqërore (Tarifa 1997). Çdo veprim shoqëror, sipas tij, është i mundur vetëm përmes komunikimit të zakonshëm ndërmjet “subjekteve që flasin dhe veprojnë” (Habermas 1984: 99). Edhe pse gjuha nuk është një medium transparent, ajo mundëson që komunikimi midis individëve—ose midis grupe individësh—të realizohet. Sa herë që ky komunikim dështon, kjo, sipas tij, do të thotë se kemi të bëjmë me një “formë patologjike të përdorimit të gjuhës” (Habermas 1971: 314).

Habermas synon ta kapërcejë trajtimin pesimist të arsyes nga Horkheimer dhe Adorno në *Dialektikën a arsyes* (1972) duke shprehur një vlerësim më të madh për rolin relativisht të pavarur të ideve, të paraqitjes simbolike, të “mimesisit” dhe të gjuhës në përpjekjet për emancipim shoqëror (shih Calhoun 1995). Sipas tij, emancipimi është baza e vërtetë e jetës shoqërore. Habermas beson se nëpërmjet diskursit racional njerëzit mund të zgjidhin—të paktën në parim—të gjitha mosmarrëveshjet. “Gjuha”, shkruan ai, “është një mjet komunikimi që i shërben mirëkuptimit”. Për këtë arsye, diskutimet racionale shërbejnë që individë dhe grupe të caktuara të negociojnë dhe të vijnë në një kuptim të përbashkët për çdo situatë të dhënë, duke synuar arritjen e një konsensusi për çështje të ndryshme të së vërtetës e të veprimtarisë praktike, duke rënë në marrëveshje dhe duke përmirësuar kështu marrëdhëniet mes njëri-tjetrit. Ajo çfarë nevojitet më së pari, sipas Habermas, është përdorimi i plotë i potencialit që përmban “komunikimi gjuhësor”, pasi në çdo situatë komunikimi, “fjalë jonë e parë shpreh pa asnjë ekuivok qëllimin e një konsensusi të përgjithshëm dhe të pakufizuar” (Habermas 1971: 314).

Kjo, sipas tij, mund të arrihet në një “situatë ideale të fjalës” (*ideal speech communication*), e cila bën të mundur arritjen e një konsensusi për të gjitha ato

çështje, të cilat, për nga vetë natyra e tyre, janë përgjithësisht të debatueshme. Natyrisht, jo të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me bindjet personale të njerëzve, fjala vjen, për një jetë më të mirë, janë çështje të debatueshme, por në një shoqëri pluraliste, njerëzit nuk mund të bëjnë dot nëse nuk ndajnë mes tyre një pikëpamje të përbashkët mbi atë se çfarë duhet kuptuar me “jetë e mirë”. Kjo pikëpamje e përbashkët nuk mund të arrihet nëse padituria, paragjykimet dhe ideologjitë tona e kufizojnë ose e bëjnë të pamundur diskursin e lirë. Vetëm nëse arrijmë që, përmes forcës së argumentit më të mirë, ta përjashtojmë sistematikisht komunikimin e deformuar në marrëdhëniet mes njëri-tjetrit (Habermas 1984: 177), atëherë mund të krijojmë një situatë “ideale” për arritjen e një konsensusi të përbashkët.

Habermas dallon katër kushte për krijimin e kësaj “situatë ideale të fjalës”: (1) Të gjithë ata që janë potencialisht pjesëmarrës në një diskurs, duhet të kenë *të drejta të barabarta* të flasin në një mënyrë të tillë që diskursi të jetë vazhdimisht i hapur si ndaj argumenteve të të tjerëve, ashtu edhe ndaj kundërgjykimëve, si për pyetje, ashtu edhe për përgjigje; (2) Të gjithë pjesëmarrësit në një diskurs duhet të kenë *mundësi të barabarta* për të parashtruar hipotezat dhe interpretimet e tyre, për të bërë pohime, për të dhënë shpjegime dhe për të bërë korrigjime, si edhe mundësi të barabarta për të problematizuar ose sfiduar vlefshmërinë e këtyre interpretimeve përmes argumenteve pro dhe kundër tyre. Në këtë mënyrë bëhen të qarta të gjithë kritikrat e mundshme dhe nuk mbeten më paragjykime. Këto dy kushte bëjnë të mundur diskutimin e lirë dhe veprimin komunikativ, në të cilin (3) pjesëmarrësit në diskurs *shprehin në mënyrë të barabartë* qëndrimet, ndjenjat dhe dëshirat e tyre, duke qenë të ndershëm dhe transparentë me njëri-tjetrin; (4) Pjesëmarrësit në diskurs kanë mundësi të barabarta për të dhënë urdhra dhe për t’u rezistuar urdhrave, për të premtuar dhe për të refuzuar, për të dhënë llogari për sjelljet e tyre dhe për të kërkuar llogari për sjelljet e të tjerëve. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet reciprociteti mes veprimit dhe pritshmërisë (*Reziprozität der Verhaltenserwartungen*) (Habermas 1984: 177-178; shih gjithashtu Benhabib 1986: 285).

Sipas Habermas-it, në mënyrë që diskursi të jetë *përgjithësisht i mundur* është e domosdoshme përmbushja e kushteve 1 dhe 4. Kushtet 2 dhe 3, të marra së bashku, bëjnë të mundur forcën e motivimit racional (argumenti më i mirë fiton). Habermas mendon se “situata ideale e fjalës” nuk është thjesht një *konstruktion teorik*, ngaqë pjesëmarrësit në çdo *situatë empirike* diskursi priren vullnetarisht të përmbushin kushtet e një situatë ideale diskursi. Edhe pse asnjë hulumtim empirik ose studim nuk do të mund të zbulonte dot faktin e një situatë ideale, një situatë e tillë, sipas Habermas-it, përsëri ekziston (Habermas 1984: 180). Madje, situata ideale e fjalës është një “standard i rëndësishëm me anën e të cilit një konsensus realisht i arritur mund të vihet në dyshim ose të legjitimohet” (*ibid.*).

Popper: argumenti vis-à-vis i identitetit dhe algoritmi i komunikimit njerëzor

Por le t’i kthehem përsëri çështjes sesi mundet të marrim në konsideratë pikëpamjet e Tjetrit dhe larminë e pikëpamjeve që shprehen, kur të tjerët janë kaq të ndryshëm nga ne. Karl Popper ka një përgjigje për këtë çështje: *krabasoni argumentet tuaja, jo identitetet tuaja* (Popper 1996: 53). Nëse nuk veprojmë kështu, ne s’do të jemi kurrë në gjendje të komunikojmë duke treguar respektin e duhur për ata me të cilët komunikojmë (Stokes 1998). Zëvendësimi i diskutimit mbi *argumentet* e njëri-tjetrit me “analiza” mbi njëri-tjetrin, sipas Popper-it, s’është veçse “metoda shkencore” që zhvilluan dhe përdorën në analizat e tyre marksistët, frojdistët dhe adleristët. Sipas tij:

Çdo argument kundër kornizës së mendimit të tyre interpretohej nga vetë ata në një mënyrë të tillë që t’u përshtatej pikëpamjes së tyre. Dhe, nëse kjo ishte e vështirë, atëherë ishte gjithmonë e mundur ta psikoanalizoje, ose ta socioanalizoje kundërshtarin tënd: kritikrat ndaj ideve *marksiste* kishin gjoja për bazë paragjykimin klasor; kritikrat ndaj ideve *frojdiste* ‘shpjegoheshin’ me represionin, ndërsa kritikrat e ideve *adleriste* buronin nga pasioni për të provuar superioritetin tënd, pasion që, në të vërtetë, shpjegohet me përpjekjen për të kompensuar inferioritetin tënd (*ibid.*).

Të tria këto epistemologji “sociologjike”—marksizmi, frojdzizmi dhe adlerizmi—të cilat Popper i ka kritikuar, janë në mënyrë inherente relativiste. Ndërsa pajtohej me pikëpamjen se askush s’është i përsosur dhe se të gjithë njerëzit mund të gabojnë, Popper theksonte se, pikërisht ky fakt përbën atë *standard absolut*, mbi bazën e të cilit duhen gjykuar të gjitha opinionet tona.

Për çdonjërin nga ne, natyrisht, është e vështirë që të njohim dhe të pranojmë gabimet tona. Sidoqoftë, të tjerët mund të na ndihmojnë në këtë drejtim. T’i lëmë ata të na kritikojnë; kjo ndoshta mund të na shpëtojë nga rënia në gabime ose nga përsëritja e tyre. Po kështu, është veçse e logjikshme që ne t’ua shpërblejmë të tjerëve këtë ndihmë në të njëjtën mënyrë, duke u vënë në dukje gabimet e tyre. Kështu bëhet i mundur një komunikim normal në sferën publike. Vetë Popperi e konsideronte një ekzagjerim të rrezikshëm të thuash se një diskutim i frytshëm është i *pamundur* nëse diskutantët nuk kanë një vizion të përbashkët. Megjithatë, ai pranonte se mungesa e një vizioni të ngjashëm e bën shumë të *vështirë* komunikimin mes njerëzve (*ibid.*, f. 35).

Është me interes të vëmë në dukje se, për të kapërcyer këtë vështirësi, Popper propozon një *algoritëm të komunikimit njerëzor*, duke identifikuar pesë hapa në procesin e komunikimit, të cilat mund t’i bëjnë më të hapur ndaj njëri-tjetrit si individët, ashtu edhe kulturat e ndryshme.

(1) Nëse ti përgatitesh vërtet për një diskutim të hapur, atëherë edhe konfrontimi

total midis dy pikëpamjeve të papajtueshme, pa ndonjë shenjë kompromisi ose mirëkuptimi minimal, mund të mos jetë krejt i pafrytshëm, pasi secila palë mund të mësojë diçka të re nga pala tjetër (*ibid.*, f. 36).

(2) [Sidoqoftë] është më mirë kur “përplasja e opinioneve bën që pjesëmarrësit në komunikim të arrijnë në argumente të reja dhe interesante, edhe pse ato mund të mos jenë përfundimtare. Me përjashtim të çështjeve të vogla dhe të parëndësishme, përfundimet në mbështetje të një argumenti janë shumë të rralla, edhe pse argumentet kundër një teorie, ose kundër një pikëpamjeje të caktuar mund të jenë shumë të forta” (*ibid.*, f. 37).

(3) Qëllimi i një debati nuk duhet të jetë kurrë që të fitosh; *qëllimi i vërtetë i një diskutimi duhet të jetë progresi intelektual, jo afirmimi social*. Afirmimi social duhet të jetë rrjedhojë e suksesit intelektual. Përveç kësaj, kriteri i fitores s’duhet të jetë kurrë i jashtëm (social, ekonomik, politik); ai duhet të jetë thjesht intelektual. Në këtë mënyrë, edhe nëse ti përpiqesh të mbrosh interesat e tua personale, ose ato të komunitetit ku bën pjesë, ti duhet të përdorësh vetëm argumente të vlefshme intelektualisht. Popper theksonte se:

Fitorja në një debat s’është asgjë, ndërsa sqarimi sado i vogël qoftë edhe i një problemi të vetëm, madje edhe kontributi më i vogël për një kuptim më të qartë të pikëpamjes tënde, ose të pikëpamjes së kundërshtarit, është një sukses i madh. Një diskutim, të cilin ti e fiton, por i cili nuk arrin të ndryshojë, ose të sqarojë sadopak mendimin tënd, mund të konsiderohet si humbje (*ibid.*, f. 44).

(4) Në dallim nga postmodernistët, të cilët nuk shohin mënyra racionale drejt lirisë, Popper e konsideron debatin si mjetin më të efektshëm për çlirimin gjuhësor, social dhe kulturor. Sipas tij:

Partnerët në një përplasje [kulturore] mund të çlirohen nga paragjykimet për të cilat ata nuk janë të ndërgjegjshëm...Sidoqoftë, ky rezultat është më pak i mundshëm nëse njerëzit nuk e dëshirojnë një diskutim të hapur (*ibid.*, f. 51).

Në qoftë se nuk jemi seriozë dhe të sinqertë në përpjekjen tonë intelektuale për të kërkuar të vërtetën, por vetëm bëjmë *debat për hir të debatit* dhe kryqëzojmë heshtat mbi njëri-tjetrin, atëherë diskutimi që bëjmë humbet rolin e tij epistemologjik dhe nuk i shërben thellimit të njohjes sonë apo verifikimit të gjykimeve tona.

(5) Progresi intelektual konsiston pikërisht në krijimin e urave midis kornizave konceptuale dhe paradigmave të ndryshme. Sado ngushtësisht të lidhur të jemi me pikëpamjet tona të preferuara, idetë më të plota dhe më të argumentuara ushtrojnë një presion të fortë intelektual mbi çdonjërin nga ne për t’i pranuar ato si një shpjegim më i mirë i realitetit në të cilin jetojmë (*ibid.*, f. 54).

Debati si mjet emancipimi dhe progresi intelektual

Në përfundim dëshiroj të theksoj se qëllimi kryesor i një debati intelektual duhet të jetë mirëqenia dhe prosperiteti intelektual i përbashkët. Ashtu sikurse në plan global lufta në fushën e ideve synon të gjejë zgjidhje për të parandaluar konfliktet dhe luftërat e përgjakshme, po kështu, debatet intelektuale duhet t’i shërbejnë pikërisht evitimit të përplasjeve politike, sociale dhe emocionale. Edhe pse emocionet janë një pjesë e pandarë e gjendjes sonë jetësore, ne mund t’i përmbajmë ato që të mos zëvendësojmë me emocionet tona idetë që shprehim dhe mbrojmë. Siç vë në dukje Anthony Giddens, “Progresi në fushën e mendimit vjen nga dialogu i vazhdueshëm, jo nga paragjykime që i ndajnë dhe i armiqësojnë palët me njëra-tjetrën” (Giddens 2013: 17).

Ndërsa Hegel-i dhe Marx-i iniciuan traditën e “filozofisë sociologjike” (*idealizmi historik* dhe *materializmi historik*, përkatësisht), traditë e cila vazhdon në ditët tona me kredon postmoderniste se njohja është gjithnjë relative ndaj një kulture ose ndaj një komuniteti, Popperi u kthye te Kanti, i cili besonte se vetëdija ka një vlerë të pavarur, njëlloj si edhe vlerat e moralit, të fesë dhe të estetikës, të cilat plotësojnë, por kurrë nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën. Për më tepër, siç vinte në dukje Popper, për Kantin dija është një instrument i politikës dhe, për këtë arsye, ai besonte në “emancipimin përmes dijes” (1784: 169). Për Popperin, *vetëm progresi intelektual mund të sigurojë progres shoqëror të qëndrueshëm, pasi politikat realiste dhe moralisht të justifikueshme kanë nevojë për një vizion të qartë dhe të ndërgjegjshëm, të bazuar në arsyen dhe në dijen*.

Referencat

- Benhabib, Seyla. 1986. *Critique, Norm and Utopia: A Study of the Foundations of Critical Theory*. Neë York: Columbia University Press.
- Calhoun, Craig. 1995. *Critical Social Theory: Culture, History and the Challenge of Difference*. Oxford: Blackëell.
- Foucault, Michel. 1972. *Archeology of Knowledge*. Neë York: Pantheon Books.
- Frank, Philipp. 1951. *Relativity—A Richer Truth*. London: Jonathan Cape.
- Giddens, Anthony. 2013. “Parathënie”, ff. 15-18 në Fatos Tarifa et al., *Shkencat e shoqërisë: Sociologjia si disiplinë integruese për studimin e jetës shoqërore*. Tiranë: Onufri.
- Gjuraj, Tonin & Fatos Tarifa. 2011. “The Habermasian (De)Reconstruction of Marx’s Paradigm”, *The International Journal of the Humanities* 9, 3: 285-293.
- Habermas, Jürgen. 1971. *Knowledge and Human Interests*. Boston: Beacon Press.
- Habermas, Jürgen. 1984. *The Theory of Communication Action*. Volumes 1, 2. Boston: Beacon Press.

- Hegel, Georg Wilhelm Friedrich. 1975. *Lectures on the Philosophy of World History: Introduction, Reason in History*. New York: Cambridge University Press.
- Horkheimer, Max & Theodor W. Adorno. 1972. *Dialectic of Enlightenment*. New York: Herder & Herder.
- Kant, Immanuel. 1784. "What is Enlightenment?" (burimi on-line: <http://www.columbia.edu/acis/ets/CCREAD/etscc/kant.html>).
- Lukács, György. [1923] 1972. *History and Class Consciousness: Studies in Marxist Dialectics*. Cambridge MA: MIT Press.
- Marx, Karl & Friedrich Engels. [1846] 1998. *The German Ideology*. Amherst, NY: Prometheus Books.
- Popper, Karl R. 1996. *The Myth of the Framework: In Defence of Science and Rationality*. New York: Routledge.
- Sagan, Carl. 1987. "The Burden of Skepticism", *Skeptical Inquirer* 12, 1: 38-46.
- Stokes, Geoffrey. 1998. *Popper: Philosophy, Politics and Scientific Method*. Cambridge, MA: Polity.
- Tarifa, Fatos. 1997. "The Language Paradigm in Contemporary Social Theory: Marx, Habermas, and Bourdieu in Comparative Perspective", *Journal of Social Sciences* 1, 4: 245-253.

Globalizimi kulturor dhe komunikimi global

Prof. Dr. Aleksandër DHIMA¹

Abstrakt. Në artikull shqyrtohen sfidat aktuale të globalizimit kulturor: kultura ideologjike e konsumit, shkëmbimi kulturor transnacional dhe relativizimi i identiteteve etno-kulturor në bashkëlidhje me komunikimin global, të cilat rrjedhin nga zbatimet bashkëkohore të teknologjisë së informacionit dhe nga pluralizmi i "mallit mediatik" si pjesë elektronike e jetës social-kulturore. Në vazhdim, jepen fakte në lidhje me ndikimin e përfytyrimeve globaliste në mjedisin mediatik shqiptar dhe diskutohen sfidat që lidhen me vektorët përmbajtjesorë të kumtit globalistik, të cilat realizohen përmes medias vendase.

Hyrje

Globalizimi lidhet pikësisht me proceset dhe me veprimet ndërgjegjësuese njerëzore për një "botë të tërësishme". Ai përfshin, ndër të tjera, pranueshmërinë dhe mirëkuptimin e kulturave të "tjetrit", si shtesa të rëndësishme për vektorët socialë, politikë, ekonomikë dhe mjedisorë të erës postmoderne; kultura shërben, qoftë edhe në formë "delikate", për të mbështetur sistemin mbarëbotëror në rritje (Robertson, 2000: 15). Nga ana tjetër, nocioni i dikurshëm i "ngjeshjes" së informacionit duket se ia ka lënë vendin një këndvështrimi të hapur globalistik mbi sistemet e transportit ndërkombëtar të komunikimit, me qëllim përshpejtimin e përhapjes së ideve, të të mirave materiale dhe shpirtërore si dhe të lëvizjes së kapitalit njerëzor (Held & McGrew, 2003 [2000]: 6). Në këtë kuptim, kufijtë mes çështjeve lokale dhe atyre globale të zhvillimit bëhen gjithnjë e më të dukshme dhe të artikuluar.

Në sfondin teorik të bashkëlidhjes së globalizimit kulturor me komunikimin global, studimi synon të evidentojë disa nga mangësitë me të cilat përballet media e sotme shqiptare në këtë fushë.

¹ Pedagog i Antropologjisë së Komunikimit në Universitetin Europian të Tiranës.

Kuptimi antropologjik i konsumit

Si pjesë e përvojës njerëzore, *konsumi* është përfshirë në sferën e ekonomisë dhe në atë të politikës e të mediave dhe është rrënjësuar përfundimisht në jetën sociale dhe kulturore. Ky ka qenë gjithmonë modeli i shoqërive njerëzore, qysh nga fazat më të hershme të historisë së tyre; por, *industrializimi* dhe *globalizimi* i ka tjetërsuar këto lidhje në mënyra të ndryshme, sidomos në vendet në zhvillim (Weiss, 2002). Në krahasim me dy valët/ brezat e globalizimeve të parë (politik dhe ekonomik) që realizuan hapjen, *globalizimi i tretë* lidhet me ndërgjegjësimin njerëzor për lidhjet e qenësishme midis kulturës dhe komunikimit dhe, nga ana tjetër, me nevojën e organizimit të bashkëjetesës kulturore në rrafsh botëror (Wolton, 2009: 118).

Parapëlqimet dhe stilet e konsumatorëve, gjegjësisht të grupeve të ndryshme sociale, janë formësuar nga jeta shoqërore; ato synojnë të na mbushin mendjen për atë çka ne jemi ose pretendojmë të jemi lidhur me *statusin social*. Nga ana tjetër, cilësitë tona morale lidhen me besime dhe prirje kulturore që i ndajmë me të tjerët. Tërheqja e njerëzve në këtë grupim “vlerash të përbashkëta” na aftëson të komunikojmë, t’i japim më shumë kuptim botës që na rrethon dhe të shprehim identitetet që ndajmë midis nesh. Kjo “urë” cilësore e shkallës së ndërgjegjes shoqërore paralelizon me llojshmërinë e mallrave, sidomos të “mallit mediatik” që përcaktohet tashmë si “pjesa elektronike” e jetës sociale dhe kulturore (Boyd & Ellison, 2007: 210).

Por, mallrat, të çfarëdolloj natyre qofshin, veprojnë njëherësh edhe si mjet “programimi” të jetës së përditshme, ndërkohë që kanë edhe kuptim simbolik. Në shoqëritë paramoderne, *besimi* dhe *zakonet* përbënin burimet përgjegjëse të kuptimit për mallrat. Shumë artikuj ceremonialë si, sendet e vjera, shtëpitë dhe orenditë brenda familjes dhe bashkësisë, të siguruar përmes trashëgimisë dhe pronës së ndarë, kanë shërbyer si “shënjes” të përkatësive shoqërore dhe të ndryshimeve të rëndësishme në lidhje me kohën, vendin e origjinës, gjininë etj. (Scupin, 2011: 33-55). Kështu p.sh., vizitorët e huaj në New York, i mbiquajtur “epiqendër e botës kapitaliste”, mund të preken fare lehtë dhe papritur nga “dominanca multikulturore”: pothuaj çdo lloj kuzhine, muzike, arti, stili, gjuhe, forme biznesi, kishe etj. mban “vulën” e bashkësisë, së cilës i përket në origjinë. Kompanitë reklamuese të kohës sonë i “mbushin” mallrat shpesh herë me kuptime joshëse, të huazuara pikërisht nga këta “rezervuarë kulturorë” botërorë: nga besimet antike, zakonet ose identitetet etnike, pa lidhje të drejtpërdrejtë me realitetin konkret. Megjithatë *konsumi* i praktikuar në kohët e sotme është i ndryshëm nga format e së kaluarës, mesazhet e mbartura prej medias (kryesisht nëpërmjet reklamës) nuk janë të rastësishme, sepse ato kanë lidhje me kode, simbole, marrëdhënie shoqërore ose me ideologji të shkuara (Bartes, 1970: 9; Alexander & Jacobs, 1998: 28; Smith, 2009: 23).

Dimensione kulturore të globalizimit

Kjo temë ngërthen në vetvete, së pari, rolin e “kulturës ideologjike të konsumit”, e cila është evidentuar në shumë vende të pasura, por që rreket të kapë veçanërisht njerëzit që jetojnë në vendet në zhvillim. Adaptimi i kësaj ideologjie, nga një masë gjithnjë më e madhe njerëzish, i ka detyruar disa vëzhgues të druhen nga fakti se “të bërit perëndimor” të botës nëpërmjet reklamave e massmediave dhe veçanërisht zotërimi i industrive mediatike botërore nga ana e SHBA-së po kultivojnë një lloj imperializmi të mbështetur jo thjesht politikisht, por në formën e *kontrollit kulturor* (White, 2001: 94; Hamm & Smaynch, 2005: 18). Ky proces çon dhe në krijimin e një bote gjithnjë e më homogjene, ku jeta e “stilit perëndimor” priret të zbehë kulturat lokale unikale. Prirja në fjalë ndodh sepse, në kushtet e *globalizimit* në rritje, individët mund të çlirohen më lehtë nga disa korniza shoqërore dhe kulturore vetjake ose kolektive.

Në lëmin e kulturës, *globalizimi* shkakton, gjithashtu, qarkullimin tërësor të stileve jetësore, vlerave, simboleve, përfytyrimeve, qëndrimeve, besimeve, dokeve etj. Ndryshimet tradicionale kulturore dobësohen ose “hapen” shpejt dhe bashkëpunojnë në *shkëmbimin kulturor* përmes *pranimit* dhe *dhënies* ku shfaqen diversitetet e reja dhe fragmentimi i identiteteve, siç ndodh me shoqëritë multikulturore. Në raste të tilla, *globalizimi* nuk sjell unifikim kulturor, por e shpejton zhvillimin e identiteteve *hibride* paralele që përhapen globalisht, siç janë ato klasore, gjinore, moshore, etnike, nacionale, politike, morale, religjioze etj. Për këtë arsye, *globalizmi* vështrohet sot si një *proces homogjenizimi* e njëkohësisht *heterogjenizimi kulturor*, i përbërë nga 5 dimensione: etnike, mediatike, teknologjike, financiare dhe ideore (Appadurai, 1996: 32-33).

Në këndvështrimin e *globalizimit* si proces homogjenizimi ka ndikuar edhe *postmodernizmi* në sferat e artit dhe kulturës së jetës së përditshme (Lash, 1990: 172). Me këto sfera, fusha e kulturës do të zgjerohej në “fushë të shoqërisë masive”, domethënë kultura nuk do të kuptohej më si një “kulturë e lartë elitare” apo si “art elitar”, por si një “kulturë e popullarizuar” (Bratič, 2002: 83). Qysh nga vitet '90- të shek. XX, shumë gjëra janë zhvendosur në kahen që mund të përmbledhet me një fjali të vetme: “*ikje nga elitarizmi drejt ofertave më zbavitëse*”, domethënë që “populli të dëfrehet me bukë dhe me lodra” (Russ-Mohl, 2010: 223).

Tematika e gjerë e ndërvarësisë kulturore të *globalizimit* lidhet ngushtë edhe me impaktin e *identiteteve etno-kulturore* në rrethana të caktuara të *sekularizmit*, sepse këta përqendrohen te pjesa shpirtërore (e brendshme) e bashkësisë, ku lëvizjet janë më të ngadalshme dhe dinamika afatshkurtër është më e dobët sesa ajo në vazhdimësi. Dukuri të tilla për njeriun, si qenie sociale, antropologët i shpjegojnë me nocionin e “nevojave të pazëvendësueshme”, të cilat mund “t’i kënaqë” *identiteti etno-nacional* (Kriegsberg, 2003: 3-5). Ky tipar, nën një perspektivë historike dhe mitologji të caktuar të *prejardhjes*, e dallon një bashkësi nga fqinjët e saj (Conversi, 2002: 55; Smith,

2009: 23-25). Mirëpo, në praktikë është treguar se “kufijtë në ndërlidhje” paraqiten njëkohësisht si “kufij të pavarësimit”; përfshirja, me ose pa dashje, në korniza të gjera ndërkombëtare e relativizon varësinë brenda sistemit dhe rrit mundësitë për përzgjedhjen e alternativave, duke siguruar në këtë mënyrë *autonominë individuale*. Shembuj konkretë mund të sillen nga realiteti i kombeve të ndryshme europiane: *identiteti kulturor* nuk është diçka që mund të manipulohet lehtë, qoftë edhe duke aktivizuar massmedian; ai mbijeton, madje lulëzon, në shumë forma, pa zvogëluar dukshëm *unikalitetin* e përvojave kulturore në rajone të ndryshme (McQuail, 2000: 237).

Megjithatë, përparësia “nënkulturore” e *identiteteve etno-kulturore* qëndron në faktin se *identiteti*, por jo “sasia” e tij, ka rëndësi të veçantë për vazhdimësinë e shoqërisë në fjalë. Nën shembullin e grekëve të lashtë, është treguar tashmë sesi *identiteti* mund të mbijetojë përkundërt “plasaritjeve” të shumta demografike, territoriale, politike dhe historike (A.D. Smith, 2001: 193). Nëse ekziston besimi në vazhdimësinë e bashkësisë, *identiteti* i saj forcohet varësisht nga dinamika e *globalizimit kulturor*. Është e vërtetë se *identiteti* nuk është gjithmonë zotërues dhe nuk ka patjetër domethënien e një kulture homogjene, por ai mund të aktualizohet në rrethana të *globalizimit*.

Spektri i larmishëm i *dominimit botëror të kulturës* përmes shpërndarjes së konsumit perëndimor ka shqetësuar shumë vëzhgues. “Frika e të bërit perëndimor” ndihet qartë sot dhe po bëhet gjithnjë e më e prekshme. Qëllimi i vërtetë i gjithë kësaj trysnie është krijimi i kanaleve dhe i agjencive sponsorizuese të reklamës në radiot kombëtare, në programet televizive dhe në rubrikat e gazetave, të cilat më pas do t’u krijojnë një hapësirë të gjerë prodhimeve globaliste për konsumatorët vendës. Kështu, përmes audiencës komerciale, media bën që sistemet maksimalizuese të ndërtojnë më shumë se diçka rreth inkurajimit të modeleve të “konsumit të lartë” dhe të lehtësojnë përfshirjen e kompanive shumëkombëshe në botën e ekonomisë. Ndryshe nga Europa, Kanadaja dhe ShBA-ja janë shtete të formuara nga përbërës kulturorë të “importuar” nga shumë vende, por grupet me prejardhje anglo-saksone kanë bërë përpjekje të vendosura – së paku nga fillimi i shek. XX e këtej – për të “amerikanizuar” masat e ardhura nga Europa Perëndimore, Kina, Japonia dhe nga shumë vende të tjera të Azisë, Amerikës Latine dhe Europës Lindore, veçanërisht përmes sistemit të shkollimit (Olneck, 2009: 379). Megjithatë, bërthamat dalluese etnike kanë rezistuar në shumë qytete të atij shteti të madh federal; shumica e tyre vazhdojnë të ruajnë gjuhën, besimet dhe trashëgiminë kulturore përmes *kulinarisë* dhe lidhjeve martesore brenda bashkësive përkatëse ose me ato shtesa popullsie që kanë ardhur nga burime shteguese të njëjta.

Komunikimi global

Kjo formë e re komunikimi përbën një proces transformues që lidhet me mekanizma lehtësues të marrjes së informacionit në shkallë botërore. Popujt, edhe në të kaluarën,

e kanë pasur prirjen për një komunikim që do t’i kalonte hapësirat e rrokura normalisht prej tyre; por, për shkak të izolimit të natyrave të ndryshme (kulturore, etnike, sociale etj.), të distancës gjeografike dhe barrierave gjuhësore, ata nuk mund ta realizonin lehtë këtë ëndërr të kahershme. Me evolucionin e teknologjisë, ky lloj komunikimi filloi të marrë jetë gradualisht, duke u bërë më i lehtë, më i shpejtë, më i qartë dhe, sidomos, më efektiv. Interneti, qysh nga koha e shpikjes së tij, po ndërhyr fuqishëm në krijimin e modeleve të reja të *ndërveprimit social*, duke konvergjuar me produktet e tjera dhe duke sjellë ndryshime thelbësore në karakterin e shoqërisë së sotme. Në vitet '60-'70-të të shek. XX, televizioni filloi të zëvendësojë gazetatat, sidomos për lajmet; në vitet '90-të, televizioni kabllor u bë përfundimisht më popullor sesa televizioni analog; në fillimet e shek. XXI, interneti u shndërrua në një burim madhor komunikimi, për shkak të përditësimit dhe shumëllojshmërisë së informacionit të ofruar. Në dekadën e fundit, kompanitë e fuqishme, që veprojnë në fushën e kompjuterëve, duke përfshirë telekomunikacionet, filmin, botimet elektronike dhe TV digjital, kanë fituar një status global.

Por, interneti ka edhe një impakt të ndjeshëm negativ në fushën e *komunikimit ndërrajonal*. Ndikimi anglishtfolës i këtij mjeti të fuqishëm mediatik, në formë dhe përmbajtje, mund të interpretohet në terma të *homogjenizimit kulturor*. Ai mund të vështrohet, gjithashtu, si një mjet efikas për marketimin e ideve dhe vlerave që burojnë (e kanë prejardhjen) nga një pjesë specifike e botës, si Amerika e Veriut. Tiparet e tanishme të shpërndarjes dhe prodhimit të përmbajtjes pasqyrojnë dhe përforcojnë, në fakt, natyrën e theksuar asimetrike të strukturave të *komunikimit global* dhe të “mediave të reja” (Hannerz, 1992: 30; Featherstone, 2002: 2; Flew, 2008: 412). *Software*-t e përkthimit synojnë, në një farë mase, ta “mjekojnë” situatën, duke ndërmjetësuar përdorimin e një shumice gjuhësh. Por, nga ana tjetër, s’duhet harruar se anglishtja shërben edhe në funksion të të qenit *lingua franca globale*, e cila u lejon njerëzve, me prejardhje kulturore të ndryshme, të komunikojnë lirshëm njëri me tjetrin. Në qoftë se interneti do të jetë një *medium multikulturor* i vërtetë, njerëzit e Botës së Dytë dhe të Botës së Tretë mund të inkurajohen për ta përdorur atë në mënyrë aktive dhe për t’u shprehur nëpërmjet tij, jo vetëm në gjuhën e vet, por edhe në kornizën globale të referencës. Fakti që vetëm 5-10% e përmbajtjeve të internetit ka prejardhje nga Azia (Rao, 2003), ndërkohë që ky kontinent përfshin gati gjysmën e popullsisë së botës, tregon sesa larg është interneti nga të qenët vërtetë “kulturalisht i ndryshëm”.

Aspektet social-kulturore të internetit nuk kufizohen vetëm në sferën e gjuhës dhe në sferën e përmbajtjes. Interneti simbolizon një mënyrë specifike të komunikimit që ndikohet nga një numër variablesh; disa prej tyre (ndoshta më të rëndësishmit) lidhen me prejardhjen amerikano-veriore të tij, duke pasqyruar këndvështrimin “amerikan” rreth botës dhe stilet “amerikane” të *ndërveprimit social*. Zhvillimi i mëtejshëm i internetit është ndikuar gjithashtu edhe nga vizioni i pionierëve të tij, shumica e të cilëve e shihnin atë si një mjet të fuqishëm që do të lejonte forma më demokratike të shpërndarjes së informacionit dhe do të stimulonte struktura

institucionale më të decentralizuara. Në këtë aspekt, është rasti të përmendim edhe ndikimin *on-line* të nënkulturave, çka sendërtohet te entuziastët e rinj dhe *hacker*-at e kompjuterit, të cilët kanë zhvilluar etikën dhe udhërrëfyesit e tyre personale për *ndërveprimin social on-line*. Sot mund të flitet gjithashtu për të ashtuquajturat “kultura *cyber*”, të cilat përfaqësojnë përzierje të ndikimeve të ndryshme kulturore, qoftë brenda ose jashtë sistemit të internetit (Escobar, 1994: 211; Turkle, 1996: 21; Angleman, 2000: pj. 5). Elementet e kulturave të përfshira në këtë proces janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë dhe ndryshojnë me kalimin e kohës, duke pasqyruar më tepër tipare, ide dhe vlera të ndryshme, në krahasim me strukturat e ngurtësuara të së kaluarës. Ndikimi i tyre është tashmë lehtësisht i prekshëm në disa nga karakteristikat e hapësirës “*cyber*”, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje.

Rruga, ose më mirë të themi rrugët e komunikimit përmes internetit janë, së paku në dy aspekte, të ndryshme nga ato që kanë ndjekur mjetet tradicionale në kuadër të *ndërveprimit*, si në botën e zhvilluar, ashtu edhe në vendet më pak të zhvilluara, ndonëse kontrasti është ndoshta më i mprehtë në këto të fundit. Së pari, interneti ofron zakonisht një mjet tepër të individualizuar komunikimi që “u bën hije” formave kolektive (p.sh., banorët e një fshati tradicional do të lëviznin shumë ngadalë drejt praktikave komunikuese që reklamohen në rrjetet elektronike të komunikimit). Së dyti, *ndërveprimi* në rastin e internetit mbështetet te kompjuteri që ndërmjetëson ballafaqimin “ballë për ballë” nëpërmjet mjeteve teknike. Pra, mjete të tilla si *PC*-të janë, në shumë pikëpamje, me efekt mjaft të kufizuar, në krahasim me morinë e mënyrave që përfshin ndërveprimi “ballë për ballë”, megjithëse ato mund ta shpien njeriun drejt formave të reja krijuese të *ndërveprimit*. Është kjo arsyeja pse shumë studiues i bëjnë thirrje njerëzimit të mënjanojë rrezikun e përdorimit të kudondodhshëm të internetit për të zëvendësuar kontaktin njerëzor natyror “të gjallë”, çka mund të çojë në tjetërsimin social të tij.

Për shumë njerëz në botë, ky tip i *ndërveprimit kompjuterik* do të perceptohej jo vetëm i çuditshëm, i largët ose në rastin më të mirë – plotësues, por ndoshta edhe mjaft i padëshirueshëm, sidomos po të kihet parasysh se miliona njerëz s’kanë përdorur kurrë as telefonin. Në shumë pikëpamje, *ndërveprimi social* përmes internetit është shumë i papërcaktuar, më tepër virtual sesa real. Nëse ai është “shpikur” për t’u përvetësuar nga shumica e popujve të botës, atëherë për plotësimin e këtij qëllimi fisnik do të duhej të zhvilloheshin më tepër procedura hyrëse miqësore, shoqërore dhe familjare ndaj përdoruesit, sesa të adaptohen për këtë qëllim praktika komunikuese tradicionale.

Globalizimi i mediave

Ndër faktorët më të rëndësishëm, që përcaktojnë botën e sotme globale, janë *media* dhe *migrimi i popullsisë*. Që të dy këta faktorë krijojnë “parregullsi” specifike,

por media elektronike (sidomos televizioni) ndikojnë më tepër në modifikimin e hapësirave kulturore, sepse ato i kanë dhënë mjedisit social një pamje të re, në kuadër të së cilës “modernia” dhe “globalja” shfaqen shpesh si anë të kundërta të së njëjtës medalje (Appadurai, 1996: 44). Aftësia e medias elektronike për të transformuar ndjesinë e distancës midis shikuesit dhe ngjarjeve e ka tjetërsuar edhe diskursin e jetës së përditshme; për pasojë, kjo “medie e re” e riformaton shoqërinë, madje tipa të ndryshëm të saj dhe të popujve që e përbëjnë.

Mjedisi mediatik në ditët e sotme është prekur gjerësisht nga *globalizimi* dhe mediet lokale e kanë të vështirë të “mbijetojnë” në kushtet e “etjes” për t’u informuar më tepër me lajme sensacionale nga bota sesa nga vendi ku ato gjallojnë. Kjo gjendje pasqyrohet, qoftë edhe tërthorazi, në zhvillimin e mëtejshëm të kulturave kombëtare, të cilat po fitojnë gjithnjë e më tepër tipare të huazuara nga kultura të “jashtme”, shpesh shumë të largëta; elementet e tyre “shkrihen” natyrshëm me elementet kulturore vendase derisa nuk është çudi që t’i asimilojnë ata. Spektatori apo lexuesi i sotëm e ka shumë më të lehtë sesa më parë të mësojë se çfarë ndodh në pjesët e tjera të globit, por ky realitet i përditësuar mbart me vete edhe “grimca” kulturore që shumohen çdo ditë, derisa shndërrohen në pjesë integrale të realitetit kulturor vendas.

Nga ana tjetër, vendet e ndryshme po synojnë gjithnjë e më tepër të ruajnë *identitetet etno-kulturore* të tyre nëpërmjet kufizimit të efekteve të *globalizimit* në sferën ekonomike. Mediet, si pasqyrë e këtyre *identiteteve*, kanë për detyrë të bëjnë diferencimin/ fragmentarizmin e lajmit, për t’ia përshtatur atë kontekstit social dhe semiotik ku lëvrohen. Lumani, në librin e tij “Dashuria si Pasion” shkruan se “*diferencimi bëhet kusht i ekzistencës së komunikimit që prodhon gjithashtu vazhdimësi të jetesës dhe strukturës sociale*” (Luhmann, 1982: 247). Prej këtej, del e nevojshme që mediet lokale të ndërgjegjësohen më tej për rolin e tyre të pazëvendësueshëm në transmetimin korrekt, të vërtetë dhe sa më të shpejtë të lajmeve që emetojnë nga vendi i tyre, sidomos të atyre lajmeve që përbëjnë ngjarje me interes ndërkombëtar, sepse vetëm në këtë mënyrë ato do të zënë vendin e merituar në mjedisin global mediatik. Pra, ajo që legjitimon vlerat e mediave lokale është mënyra dhe forma sesi e transmetojnë lajmin për botën mediatike. Me sa duket, ka pak rëndësi fakti nëse jemi bërë pjesë, me ose pa dashje, dhe i jemi nënshtruar (në një farë mënyre dhe në shumë plane) dukurisë së *globalizimit mediatik*; pothuajse të gjithë ne kemi një koncept të ndryshëm për *globalizmin*. Ky proces nuk sjell vetëm pasojën e përhapjes masive të “mediatizimit perëndimor” në kontekst global, por ndikon edhe në drejtimin që medie të fuqishme lokale, si *Al Jazeera*, të ndërmarrin veprime globaliste duke sfiduar agjenci të fuqishme ndërkombëtare si *CNN*-i me lajmet e tyre, duke çuar kështu në një farë “globalizimi të fragmentarizuar” dhe jo vetëm në një drejtim të caktuar, p.sh. në shpërndarjen e lajmit nga Perëndimi në Lindje, por edhe anasjelltas, duke përhapur vlera të ndryshme lokale në një botë globale.

Shumë njerëz e kanë të lehtë të mendojnë se gjinia njerëzore është në fillimet e

një “ere të re” të *komunikimit*, të ashtuquajtur “iluministe”. Tashmë ekzistojnë mjaft vizione lidhur me depërtimin në teknologjinë digjitale për të ndryshuar mënyrën e jetesës, të të bërit biznes e politikë si dhe në sferën e *ndërvëprimit* (Toffler, 1984: 22; Negroponte, 1995; Revenaugh, 2000: 38; Meyrowitz, 1999: 423; 2003: 96; Lievrouw & Farb, 2003: 499). Sot besohet se e ashtuquajtura “epoka e informacionit global” ka sjellë ndryshime dhe përmirësime radikale, sepse të gjitha vendet po preokupohen thellësisht në ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, “autostradave të informacionit”, për të përballuar sfidat e shoqërisë së informacionit të shek. XXI. Por, ndonëse inovacionet në teknologjinë digjitale janë impresionuese, ne s’duhet të harrojmë se teknologjia në vetvete nuk është faktor përcaktues i ndryshimit, por veçse një lehtësues i tij; është *konteksti social* ai që dikton përfshirjen e teknologjive të reja dhe sidomos implementimin dhe impaktin e tyre.

Njerëzimi i sotëm është përfshirë në një valë ndryshimesh historike. Revolucioni informativ ka të bëjë sot shumë më pak me *byte* kompjuterike sesa me realitete dhe aspirata të njerëzve të thjeshtë. Kjo gjendje na detyron të përcaktojmë se çfarë tipi ndryshimesh do të ndodhin në të ardhmen e afërt dhe kë do të prekin ato më tepër (Stoll, 1995; Schiller, 1996: 35). A jemi duke ndërtuar një *shoqëri globale informimi* gjithëpërfshirëse apo një botë të shtresëzuar informacioni “të pasur” dhe “të varfër”? Kush do të ketë më tepër akses në shoqërinë e ardhme të informacionit dhe kush do të mbetet pas saj? Po qe se do të kualifikoheshin si anëtarë të kësaj “shoqërie të re” vetëm përfuturit e rinj në moshë, të shkolluar dhe përdorues të rregullt të kompjuterit, atëherë pjesa më e madhe e popullsisë së botës do të mbetet jashtë.

Si do t’i drejtohej teknologjia e informacionit botës së sotme, të karakterizuar nga thellimi i hendekut midis të pasurve dhe të varfërve, nga pabarazia, luftërat dhe shpërthimet sociale? Këto janë disa dilema që duhet të kapërcehen me konsensus, nëse njerëzimi do të ecë përpara në “erën e re” të teknologjisë së informacionit. Interneti është duke luajtur vërtet një rol shumë të rëndësishëm në evolucionin e *teknologjisë digjitale*, por- megjithëse ka njohur rritje të shënueshme në dhjetëvjeçarin e fundit- shpërndarja e tij në shkallë botërore mbetet mjaft asimetrike. Sot është e vështirë të gjendet numri i saktë i përdoruesve, por ky numër vlerësohet me përafërsi në 600 milionë persona në 130 vende; me këtë vërtetohet parashikimi i Bill Gates, i bërë në Forumin Ekonomik Botëror në Davos (Zvicër) në shkurt të 1997-ës, sipas të cilit “*interneti do të kishte mbi 500 milionë përdorues në 10 vjetët e ardhshëm*”. Kjo rritje eksponenciale mund të tingëllojë impresionuese, por vlera e saj zbehet po të mendosh se bota banohet sot nga 7 miliardë njerëz! Nëse në “botën e zhvilluar” (me të ardhura të larta) vlerësohet se interneti përdoret rregullisht nga rreth 31% e popullsisë, kjo shifër ulet në mënyrë drastike (deri në 2%) në vendet e varfra dhe në ato në zhvillim, të marra së bashku.

Mungesa e teknologjisë së lartë dhe e ekipeve për instalimin dhe funksionimin e saj përbëjnë pengesa thelbësore për aksesin e internetit në vendet më pak të pasura.

Për këtë arsye, sot vërehet një prirje e re për të hequr dorë nga ideja e lidhjeve individuale, si qëllim jorealist në vetvete, por për gjetjen e rrugëve alternative për sigurimin e lidhjeve grupore (në rrafsh lokal ose kombëtar), natyrisht jo për të fuqizuar një grup elitar për të pasur informacion të përditësuar. Në fakt, në Europë është duke u vendosur akses i publik i internetit nëpërmjet qendrave komunitare si dhe në universitete, biblioteka dhe në libraritë e mëdha publike; përpjekje të ngjashme vërehen edhe në Shqipëri, përmes zyrave lokale të postës ose në *cyberkafenetë*. Në disa vende të tjera, mesazhet me e-mail printohen dhe u shpërndahen marrësve; në këtë mënyrë, interneti arrin të njerëzitet që s’kanë parë kurrë kompjuter me sy.

Për shkak të lehtësisë me të cilën përçohet informacioni përmes rrjeteve elektronike, interneti ka shkurtuar ndjeshëm procedurat e komunikimit në shumë vende. Por, politikat komunikuese janë të lidhura me disa prej kontradiktave të rendit botëror bashkëkohor si lëvizjet dhe shkëmbimi transnacional i njerëzve, mallrave dhe informacionit, në kontrast me administrimin publik brenda kufijve shtetërorë (Giddens, 1991: 187-201). Interneti mund të shërbejë si një medium i fuqishëm për arritjen dhe sigurimin e *identifikimit social*, një aspekt i rëndësishëm ky për çdo shoqëri. Në fakt, në të kaluarën kanë qenë të pranishme forma sociale më komplekse, të cilat duket se janë kapërcyer me kalimin e kohës edhe falë përdorimit të mjeteve komunikuese të sofistikuara. Ndërkohë që mediet moderne, mund të përdoren sot për të promovuar *unitetin nacional*, mjete të tilla janë përdorur edhe për të nxitur *përçarjen sociale* për qëllime kundërvënëse ndaj rrjedhës normale të zhvillimit shoqëror, si shfaqjet e ksenofobisë dhe propaganda raciste. Nelson Mandela ka theksuar në fjalën hyrëse të Konferencës së *Telecom-it* në Gjenevë (3 tetor 1995): “Në qoftë se *ne nuk mund të garantojmë që revolucioni global të krijojë një shoqëri të informacionit të shtrirë në të gjithë botën, në të cilën çdonjëri të mund të piketojë dhe të luajë pjesën e tij, atëherë ky s’do të ishte një revolucion i vërtetë*”.

Diskutimi, tashmë i vjetër, mbi *imperializmin kulturor* mbetet aktual edhe në ditët e sotme (Kunczik, 1992: 43-48; Kunczik, 1993: 269-274; Kunczik & Zipfel, 1997: 159-163; White, 2001). Përballë mbizotërimit të industrisë mediatike amerikane (kinemasë, televizionit, muzikës pop etj.), mund të merret me mend prania e “rrezikut” që e gjithë bota të adoptojë në të ardhmen jo të largët *një kulturë të vetme mediatike*, në kuadrin e së cilës të gjithë njerëzit do të duhej të ndiqnin të njëjtat programe, të përdornin të njëjtat shprehje në komunikim me të tjerët, të prireshin për të lexuar të njëjtën kategori lajmesh, etj. Ky model ka prirje për t’u përhapur kudo dhe s’ka pse të mos jetë i pranishëm në çdo kulturë nëpër botë, por çështja e perceptimit antropologjik *globalist* qëndron te shkalla e përhapjes (Katz & Liebes, 1987: 419; Liebes & Katz, 1993: 82). Në erën e zhvillimeve të reja teknologjike, si p.sh. me digjitalizimin e programeve televizive, koncertet mediatike po përpiqen të sigurojnë dhe të zgjerojnë, jo pa sukses, tregjet e tyre në të gjithë botën. Sipas komentit të P. Rawley të firmës këshilluese “*Internet Control*

Message” (ICM), “*Hollivudi do të ketë nevojë në të ardhmen jo vetëm për Europën, por edhe për Kinën dhe Indinë, për Azinë Juglindore dhe Amerikën Latine...; dimensione të tilla mund të përballojë vetëm një koncern i gjithanshëm mediatik, me burimet dhe talentet përkatëse*” (cituar ne Forouzan, 2007: 630).

Megjithatë, disa breza kulturore vendase duket se i janë shmangur ekspozimit ndaj “konsumizmit intensiv” në qytetet e pasura të botës, ndërkohë që *fast food*-et në rrugët e Tiranës ose krijimi i mundësive për të parë Rihanën në fshatrat e Egjiptit kanë qenë në gjendje të shkatërrojnë pjesë të tëra të traditës kulturore; disa banorë të Lagosit në Nigeri ose ata të Kuala Lumpur-it në Malajzi vërtet mund të pinë *Coca-Cola*, të veshin xhinse *Levis 501* dhe të dëgjojnë Madonën, por kjo s’do të thotë që ata- pikërisht për shkak të këtyre risive në konsum- duhet të braktisin patjetër zakonet, detyrimet familjare e shoqërore apo identitetet kombëtare.

E ardhmja e komunikimit mediatik në Shqipëri

Impakti i përfytyrimeve globaliste në mjedisin mediatik shqiptar është një çështje me theks aktual. Handikapi më i madh në këtë drejtim qëndron në faktin se këto përfytyrime, të cilat kanë kaluar një periudhë maturimi në vende të tjera, në Shqipëri depërtuan me një shpejtësi shumë të madhe dhe u bënë pjesë e beftë e një realiteti “të huaj” vetëm mbas viteve '90-të. E gjithë jeta shoqërore e së shkuarës, e shtrënguar në “morsat” e politikës, pati përjetuar një stanjacion të dukshëm, kur, në të njëjtën kohë, shtetet fqinje përjetonin një realitet me dinamikë zhvillimi dhe me rregulla loje krejt të tjera. Katër dekadat paraardhëse, për nga dinamikat dhe shpejtësia e ndryshimeve, kanë qenë pothuajse të padobishme; këtu i referohem kryesisht ndryshimeve në shkencë dhe në teknologji, që e patën prekur tangjent Shqipërinë, ndërkohë që në vendet e tjera ato kanë qenë pjesë organike e gjithë jetës shoqërore. Pra vetëkuptohet që në kanalet e sotme shqiptare të komunikimit, tashmë të pacensuruara, do të kalojnë sa vjen e më shumë dhe më shpejt mesazhe të perceptuara dhe të vlerësuara në mënyra nga më të ndryshmet, për shkak të larmisë së sotme të audiencës dhe të hapjes së plotë ndaj botës.

Në kushte të tilla, a mund të pohojmë se *komunikimi global* është i pranishëm në botën mediatike shqiptare dhe si i përgjigjet audiencia vendase sfidave të këtij realiteti të ri perspektiv? Në të gjitha pjesët e botës shqiptare vihet re një “uri” e madhe për të përvetësuar sa më shpejt risitë e teknologjisë së informacionit dhe modelet e reja të pasqyrimit mediatik. Shqipëria është vendi i parë në rajon që zbatoi platformën digjitale dhe rrjeti kabllor mbulon tashmë pjesën më të madhe të vendit; ka nisur procesi i licencimit për sistemet e reja 3D; rrjeti kompjuterik është shtrirë gjerësisht në institucionet e administratës shtetërore dhe në sistemin arsimor. Edhe në fushën e medias së shkruar dhe asaj elektronike ka arritje të ndjeshme: çdo vit shtohet numri i gazetave dhe i revistave me prirje novatore në

format dhe në përmbajtje si dhe është rritur ndjeshëm frekuentimi i *website*-ve të tyre; *facebook*-u, *blog*-et dhe *twitter*-i po shërbejnë gjithnjë e më tepër jo vetëm si rrjete sociale argëtuese për bashkëbisedim ndërpersonal, por ato kanë tashmë akses edhe në komunikimin politik me publikun. Pra, teknologjia e zbatuar, prania e kompanive të mëdha mediatike dhe larmia e emisioneve janë tre nga tiparet e reja të medias shqiptare, të cilat synojnë të ndjekin linjën e zhvillimit të medias në plan botëror (Gjergji, 2009: 28).

Me gjithë këto arritje, mbetet shumë për të bërë, jo aq në drejtim të “përballjes” me mjetet dhe me mekanizmat që sigurojnë përfshirjen në botën globale të informacionit sesa në drejtim të përmbajtjes së kumtit globalistik që realizojnë mediet vendase. *Së pari*, shoqëria shqiptare duhet të ndërgjegjësohet për t’i menaxhuar sa më mirë mediet pluraliste, në mënyrë që të gjithë aktorët shoqërorë të shprehin mendimin e tyre. Procesi i komunikimit po njihet vërtet një intensitet shumëdimensional, por audiencia shqiptare mund të konsiderohet më shumë si një “masë” e bombarduar me frymën e luftës së ashpër politike sesa një pjesëmarrëse aktive në këtë proces, çka ka çuar- në mjaft raste- në rënien graduale të besueshmërisë ndaj përmbajtjes mediatike (Gjergji, *art. cit.*: 24-25). *Së dyti*, për t’i miradministruar mediet në kuadrin e *diversitetit* të sotëm duhet të krijohen mundësi brenda vendit për vjeljen e informacionit nga burime të ndryshme. Në kushtet e një medieje vendase, që nuk heq dorë lehtë nga format stereotipe të dhënies së lajmit dhe të performancës, opinioni publik rreket të ballafaqohet symbyllazi me operatorë të huaj të fuqishëm mediatikë, duke çuar kështu në dobësimin gradual dhe pa kthim të rëndesës së faktorit kulturor vendas. Kjo rrethanë i shndërron shqiptarët në konsumues pasivë të informacionit dhe i detyron t’i binden pa ndonjë rezistencë përzgjedhëse “erës globale” të komunikimit.

Konkluzione

Në bazë të analizës së gjendjes aktuale dhe sfidave të *globalizimit kulturor* në rrafsh kombëtar, unë mund të pohoj se shoqëria shqiptare është ende larg perceptimit bashkëkohor të “globales” në komunikim, me gjithë zbatimet e lavdërueshme teknologjike dhe kushtet e reja të krijuara nga pluralizmi i “mallit mediatik”. Kjo gjendje i detyrohet, *në radhë të parë*, aksesit të diferencuar dhe shpesh herë të mangët të aktorëve të jetës shoqërore në përcjelljen shumëngjyrëshe të mesazhit, me gjasme për ruajtjen e *identitetit etno-kulturor* dhe, *së dyti*, prirjeve politike të ditës, që denatyrojnë dëshirën për krijimin e një klime dashamirëse ndaj kumtit mediatik, që vjen “nga jashtë”. Prandaj nuk është për t’u çuditur që realiteti mediatik shqiptar ndodhet ende në një fazë të brishtë dhe atij do t’i duhet kohë për të instaluar vlera të reja kulturore me sfond globalist.

Bibliografi

- Alexander, Jeffroy C. & Ronald N. Jacobs "Mass Communication, Ritual, and Civil Society" in: Tamar Liebes; James Currain; Elihu Katz (eds.) "Media, Ritual, and Identity; Communication and Society" New York: Routledge, 1998: 23-41.
- Angleman, Sharon A. "What does it mean to dwell in Cyberspace and why do we go there?" Jonesboro-AR: Arkansas State University, 2000.
- Appadurai, Arjun "Modernity at Large; Cultural Dimensions of Globalization" Minneapolis- MN: University of Minnesota Press, 1996.
- Barthes, Roland "Mythologies" Paris: Le Seuil, 1970 (originali: 1957); botimi anglisht: "Myths" New York: Hill and Wang, 1972.
- Boyd, Danah & Nicole B. Ellison "Social Network Sites; Definition, History, and Scholarship" in: "Journal of Computer-Mediated Communication" vol. 13 (2007) No. 1: 210-230.
- Bratič, Vladimir, "Media in Transition 2; Globalization and Convergence" Cambridge-MA: MIT Press, 2002.
- Conversi, Daniele (ed.) "Ethnonationalism in the Contemporary World; Walker Connor and the Study of Nationalism" London: Routledge, 2002.
- Devereux, Eon "Understanding the Media" London-New York: Sage Publ., 2003.
- Escobar, Arturo "Welcome to Cyberia; Notes on the Anthropology of Cyberculture" in: "Current Anthropology" vol. 35 (1994) No. 3: 211-231.
- Featherstone, Mike (ed.) "Global Culture; Nationalism, Globalization and Modernity" London: Sage Publ., 2002 (9th ed).
- Flew, Terry "New Media; An Introduction" South Melbourne: Oxford University Press, 2008.
- Forouzan, Behrouz A. "Data Communications and Networking" Boston: McGraw-Hill, 2007.
- Giddens, Anthony "Modernity and Self-Identity; Self and Society in the Late Modern Age" Cambridge: Polity Press, 1991; Stanford-CA: Stanford University Press, 1991.
- Gjergji, Bashkim "Komunikimi global dhe ndikimi i tij mbi shqiptarët" në: "Komunikimi bashkëkohor midis shqiptarëve" Tiranë: Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë, vol. 1 (2009): 20-32.
- Hannerz, Ulf "Cultural Complexity; Studies in the Social Organization of Meaning" New York: Columbia University Press, 1992; id. "Transnational Connections; Culture, People, Places" London: Routledge, 1996.
- Hamm, Bernd & Russell Charles Smandych "Cultural Imperialism; Essays on the political economy of cultural domination" Toronto: University of Toronto Press, 2005.
- Held, David & Anthony McGrew (eds.) "The Global Transformations Reader" Cambridge (UK): Polity Press, 2003 (2nd ed.) (originali: Malden-MA, Wiley, 2000).
- Katz, Elihu & Tamar Liebes "Decoding Dallas; Notes from a Cross-Cultural study" in: H. Newcomb (ed.) "Television; The Critical View" New York: Oxford University Press, 1987: 419-432.
- Kriegsberg, Louis "Identity Issues" in: Guy & Heidi Burgess (eds.) "Beyond Intractability" Boulder-CO: Conflict Research Consortium, 2003.
- Kunczik, Michael "Development and Communication" Bonn: Friedrich-Ebert-Stiftung, 1992; id. "Communication and Social Change" Bonn: Friedrich-Ebert-Stiftung, 1993 (4th ed).
- Kunczik, Michael & Astrid Zipfel "Hyrje në shkencën e komunikimit dhe të publicistikës" Tiranë: Fondacioni Friedrich Ebert, 1997 (originali: "Einleitung in die Kommunikations-und Publizistikwissenschaft" Wiesbaden: Westdeutscher Verlag, 2003).
- Lash, Scott, "Sociology of Postmodernism" London: Routledge, 1994 (4th ed).
- Liebes, Tamar; James Currain; Elihu Katz (eds.) "Media, Ritual, and Identity" New York: Routledge, 1998.
- Liebes, Tamar & Elihu Katz "The Export of Meaning; Cross-Cultural Reading of 'Dallas'" New York: Blackwell Publ. 1993.
- Lievrouw, Leah A. & Sharon E. Farb "Information and Equity" in: "Annual Review of Information Science and Technology" vol. 37 (2003): 499-540.
- Luhmann, Niklas "Liebe als Passion; Zur Codierung von Intimität" Frankfurt/M: Suhrkamp, 1982; id. "Beobachtung der Moderne" Opladen: Westdeutscher Verlag, 1992.
- McQuail, D. "McQuail's mass communication theory" London-Thousand Oaks (CA)-New Delhi: Sage Publ. 2000.
- Meyrowitz, Joshua "Global Permeabilities" in: Enrique Rodriguez Laretta (ed.) "Media and Social Perception" Rio de Janeiro: UNESCO, 1999: 423-441; id. "Global Nomads in the Digital Veldt" in: Kristóf Nyíri (ed.) "Mobile Democracy; Essays on Society, Self and Politics" Wien: Passagen Verlag, 2003: 91-102.
- Negroponte, Nicholas "Being Digital" New York: Vintage Books, 1995.
- Olneck, Michael R. "Historical and Contemporary Perspectives on Immigrants, Languages, and American Schooling" in: "American Journal of Education" vo. 115 (2009): 379-406.
- Rao, Madanmohan "News Media and New Media; The Asia-Pacific Internet Handbook, Episode V" Singapore: Eastern Universities Press, 2003.
- Revenaugh, M. "Beyond the Digital Divide; Pathways to Equity" in: "Technology and Learning" vol. 20 (2000) No. 10: 38-50.
- Robertson, Roland "Globalization; Social Theory and Global Culture" London: Sage Publ. 2000 (6th ed.).
- Russ-Mohl, Stephan "Journalismus; Hand-und Lehrbuch" Frankfurt/M: Suhrkamp,

- 2003; përkthimi shqip: "Gazetaria" Tiranë: Natyra, 2010.
- Sachs, Jeffrey & Andrew Warner "Fundamental Sources of Long-Run Growth" in: "American Economic Review/ Papers and Proceedings" vol. 87 (1997): 184-188.
- Schiller, Herbert "Information Inequality; Making Information Haves and Have Nots" New York- London: Routledge, 1996.
- Scupin, Raymond "Cultural Anthropology; A Global Perspective" Englewood-NJ: Prentice- Hall Inc. 2011 (8th ed.) (origjinali: 1992).
- Smith, Anthony D. "National Identity" Reno-NV: University of Nevada Press, 2001 (origjinali: London, Penguin, 1991); id. "Ethno-symbolism and Nationalism; A cultural approach" London-New York: Routledge, 2009.
- Stoll, Clifford "Silicon Valley Snake Oil; Second Thoughts on Highway Information" Austin- TX: Doubleday Books, 1995.
- Toffler, Alvin "Future Shock" New York: Random House, 1984.
- Turkle, Sherry "Life on the Screen; Identity in the Age of Internet" New York: Simon and Schuster Inc., 1995; London: Weidenfeld and Nicholson, 1996.
- Weiss, John "Industrialization and Globalisation; Theory and Evidence from Developing Countries" London-New York: Routledge, 2002 (2nd ed).
- White, Livingston A. "Reconsidering cultural imperialism theory" in: "Transnational Broadcasting Studies" vol. 6 (2001).
- Wolton, Dominique "Të shpëtojmë komunikimin" Tiranë: Papirus, 2009 (origjinali: "Sauver la communication" Paris: Flammarion, 2005).

Vështirësitë në procesin e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme

Dokt. Roland LAMI¹

Abstrakt. Në dy dekadat e fundit jemi përballur me një eksod rural dhe përqendrim demografik të konsiderueshëm në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Sigurisht, ky mobilitet social mundëson krijimin e një realiteti multikultural në këto qytete, por krijon dhe terrenin për konflikt midis individëve apo grupeve që i përkasin nënkulturave të ndryshme. Në këto hapësira sociale, identitetet kulturore jo vetëm që nuk zbehet, por përkundrazi, zhvillohen tashmë në një shoqëri bashkëveprimi, dallimesh dhe komunikimi. Ata shfaqin dëshirën për t'u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t'i përkitur të njëjtit grup, njëkohësisht, u lind nevoja për t'u diferencuar, diskriminuar dhe përjashtuar. Pikërisht, nisur nga kjo perspektivë, në punim analizohen disa variabla që pengojnë zhvillimin normal të proceseve ndërvepruese ndërmjet grupeve me identitet të ndryshëm kulturor.

Fjalët kyçe: Semiotika, kodifikimi, nënkultura, identiteti, migrimi, komunikimi, devijanca

Hyrje: lëvizjet migratore në zonat suburbane

Në këndvështrimin sociologjik të botës në përgjithësi dhe të njeriut në veçanti, një vend qendror zë analiza e grupeve shoqërore. Këndvështrimi weberian mbron tezën se ekzistojnë lidhje të dyfishta dhe të ndërsjella midis individit dhe grupit shoqëror si dhe raporte të caktuara ndërmjet identitetit grupor dhe formave të mendësive dhe të ndërgjegjes shoqërore (Collins, 1986).

¹ Roland Lami është doktorant për sociologji në Fakultetin e Shkencave Sociale Tiranë. Ai zotëron një B.A dhe M.A në Sociologji nga Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë, një M.A në Studime Europiane të Fakultetit Filologji – Histori Tiranë. Aktualisht, është pedagog pranë Universitetit European të Tiranës.

Gjithashtu, argumentohet se subjektiviteti kolektiv i jep identitet çdo grupi shoqëror dhe, njëkohësisht, natyra e një grupi shoqëror i jep specifikat e veta të veçanta mendësisë së individëve të veçantë. I njëjti grup shoqëror, por i shfaqur në kohë dhe në vende të ndryshme të hapësirës shoqërore, përmes historisë dhe eksperiencave të veçanta, e formon identitetin e vet shoqëror në mënyra të ndryshme dhe duke iu përmbajtur disa parimeve specifike. Por ne nuk jemi vetëm qenie shoqërore, jemi edhe individë. Çdo person, si një individ i papërsëritshëm, është i vetëdijshëm për veten (mënyra e veçantë dhe vetjake me anë të së cilës ndërvepron me të tjerët.) Kjo bën të mundur që ne, si individë, të reflektojmë në marrëdhëniet dhe ndërveprimet tona me të tjerët dhe të tregojmë historitë tona mbështetur në këndvështrimin vetjak për realitetin shoqëror, ashtu siç e perceptojmë. Komunikimi është pikërisht instrumenti që i pasqyron të gjitha këto aspekte shoqërore.

Nga kjo perspektivë, vlen të studiohen tipologjitë e grupeve shoqërore dhe shkalla e ndërveprimit në një kontekst shqiptar, me qëllim kuptimin e situatës dhe evidentimin e rolit të komunikimit në zhvillimin normal të proceseve ndërvepruese ndërmjet këtyre grupeve shoqërore. Një analizë e këtij dimension merr një vlerë të veçantë, për vetë faktin se në dy dekadat e fundit jemi përballur me një eksod rural të gjerë dhe masiv si dhe me një përqendrim demografik të konsiderueshëm në disa prej qyteteve kryesore të vendit.

Shoqëria postkomuniste shqiptare është përballur me një dallgë migracioni, në dukje kaotike dhe spontane, por që reflekton deri diku kundërveprimin e natyrshëm dhe praktik të shqiptarëve drejt gjeografisë së re të mundësive. Lëvizjet e brendshme migratore ndryshuan brenda një periudhe të shkurtër raportin midis popullsisë rurale dhe asaj urbane. Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë, gjatë viteve 1991 – 1999 popullsia urbane pëson një rritje 11.2 % duke arritur 47.1% (INSTAT,2000:8), dhe ky trend vazhdon edhe në dhjetëvjeçarin e fundit duke kapur shifrat 53.7% në 2011 (INSTAT,2011:16) Rajonet qendrore (prefekturat e Tiranës dhe Durrësit) dhe rajonet bregdetare (prefekturat e Vlorës, Fierit dhe Lezhës) janë bërë destinacionet kryesore të këtij migrimi, ndërsa rajonet verilindore dhe juglindore janë prekur shumë pak nga lëvizjet e brendshme të popullsisë. Sigurisht, Tirana duke qenë një qytet me mundësi më të mëdha punësimi, edukimi dhe argëtimi, lakmohej më shumë në krahasim me Durrësin. Sipas regjistrimit të popullsisë në Bashkinë e Tiranës kemi një rritje dramatike të popullsisë nga 238,057 banorë në 1989 në 343,078 në 2001. I njëjti intensitet vërehet gjatë periudhës 2001- 2009, ku këtij qyteti i shtohen 148,000 duke arritur në 2012 numrin 702,380 banorë.²

Në përgjithësi, origjina e banorëve të ardhur nga zonat e ndryshme të Shqipërisë drejt kryeqytetit sipas të dhënave zyrtare, rezulton të jetë 39% nga zonat e veriut

dhe 38% nga zonat e jugut (Karagumi & Dumani, 2005). Pjesa më e madhe e tyre janë vendosur në zonat periferike të Tiranës dhe më konkretisht në njësitë 4 (zona rreth Alliasit), 6 (zona rreth Kombinat-it), 11 (zona rreth Laprakës). Mirëpo, duhet theksuar se në këto zona gjatë këtyre dy dekadave nuk kemi vetëm lëvizje migratore që vijnë nga zonat të ndryshme të Shqipërisë drejt kryeqytetit, por edhe lëvizje brenda përbrenda rrethit të Tiranës. Viti 2005 demonstroi më mirë se çdo vit tjetër këtë dinamikë demografike. Sipas të dhënave zyrtare lëvizjet brenda rrethit nga një vend në një tjetër arrin 49, 470 persona si dhe dalja me banim jashtë tij shkon në 7,226 persona.³ Përzgjedhëm vitin 2005, jo se ky vit shënon lëvizjen më të madhe migruese pasi lëvizje të tilla me intensitet akoma më të lartë kanë ndodhur midis viteve 1993 – 2000, por nisur nga fakti se ky vit konsiderohet nga specialistët e INSTAT si një nga vitet më të plota nga pikëpamja e dokumentimit të fenomenin në fjalë.

Këto njësi periferike të Tiranës, vlerësohen nga pikëpamja zhvillimore si më të varfrat e rrethit të Tiranës. Një vlerësim i tillë lidhet me një sërë faktorësh si: niveli i ulët i konsumit mesatar për banor, koeficienti i lartë i varfërisë së përgjithshme, niveli i lartë i papunësisë si dhe niveli i ulët i shkollimit (Karagumi & Dumani, 2009). Kjo ka bërë të mundur që fqinjët nga pikëpamja territoriale të jenë aq të ngjashëm sa janë në tërësinë e zhvillimeve ekonomiko- sociale. Jo vetëm kaq, por një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë ngritur bashkësi të cilat pasqyrojnë bashkësitë e vendndodhjeve të tyre të mëparshme. Shumë prej tyre jetojnë pranë të afërmeve ose bashkëfshatarëve të tyre duke formuar grupe sociale me identitete kulturore të ngjashme. Nuk mungojnë rastet ku një pjesë e tyre jetojnë brenda subkulturës së krahinës nga kanë ardhur duke manifestuar një “larmi të spikatur veshjesh, mënyrën e sjelljes, raportet shoqërore, dialekte, kulturë materiale, etj” (Dervishi, 2001:38). E gjitha kjo, ka kontribuar në përforcimin e identiteteve që mbartnin këto banorë nga e kaluara dhe ka vështirësuar në të njëjtën kohë, integrimin e tyre me shoqërinë urbane në tërësi.

Pikërisht, ky realitet i pasur nga pikëpamja multikulturore prodhon disa probleme të natyrës psikosociale ku komunikimi bëhet mbartës dhe pengesë njëkohësisht. Në këto hapësira sociale, identitetet kulturore jo vetëm që nuk zbehen, por përkundrazi, zhvillohen tashmë në një shoqëri bashkëveprimi, dallimesh dhe komunikimi. Perspektiva teorike të disa autorëve të njohur në fushën e sociologjisë së komunikimit do të na ndihmojnë për të shpjeguar fenomenin në fjalë.

Prezantimi i identiteteve nëpërmjet komunikimit

Shumë grupe shoqërore të cilat në kohën e regjimit totalitar ishin të detyruara të jetonin në zona jo të zhvilluara, në rrethanat e reja iu krijua mundësia të lëvizin

² Open Data (2011) “ Popullsia në Tiranë 2001-2009”.

³ Shih. INSTAT (2006), Popullsia e Shqipërisë, Tiranë: INSTAT.

drejt *zonave fizike të preferuara*. Në fakt, ndryshimi i regjimit u shoqërua më lëvizje të mëdha migratore si brenda dhe jashtë vendit. Kjo fazë, për një pjesë nuk ishte e lehtë, pasi iu lindte nevoja të përshtateshin me realitete të reja social-kulturore dhe njëkohësisht të rivlerësonin *vlerat*, normat dhe traditat e përfituara nga e kaluara. Kjo dilemë, i vendoste ata, siç e përshkruan me shumë realizëm Fuga, “në një pikë të ndërmjetme, midis fshatit dhe qytetit, midis jetës rurale dhe asaj urbane, midis të shkuarës dhe të sotmes, midis mbijetesës dhe mjerimit, midis personifikimit të vetvetes dhe kalimit në identitetin e një grupi tjetër” (2000:212).

Një situatë e tillë ka bërë të mundur që kriteret morale dhe vlerore të stabilizuara përgjatë një procesi të gjatë socializmi të përfshiheshin nga një proces i shpejtë ç’ekulibrimi dhe shpërbërjeje. Por, njëkohësisht, nuk përjashtoheshin rastet e konsolidimit të kriterëve ekzistues për shkak të pasigurisë që shkaktonte braktisja e tyre. Po të shprehemi me gjuhën e sociologut Ferdinand Toennies (1963), mund të themi se ata po kalonin nga një komunitet shoqëror me solidaritet të fortë në një mjedis të ri shoqëror me solidaritet të dobët, si rrjedhojë e shumëllojshmërisë subkulturore që ata mbartnin. Banorë të tillë shpesh reflektonin një gjendje të dyzuar dhe të paqartë me veten dhe tjetrin.

Meunier & Peraya (2009) e shikojnë këtë dualitet brenda një logjike normale të funksionimit të çdo individi apo grupi shoqëror, i cili e ndërton kohezionin e brendshëm me anë të përjashtimit të grupeve të tjera të konsideruara “të huaja” për të. Këto grupe të huaja, shfaqin dëshirën për t’u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t’i përkitur të njëjtit grup, njëkohësisht, u lind nevoja për t’u diferencuar, diskriminuar dhe përjashtuar. Përjashtimi në këtë rast shfaqet në nivele të ndryshme që varion nga dhuna fizike (përjashtimi fizik i tjetrit) deri te nuancat e holla – të sjelljes, gjuhës (paragjykimet, stigmatizimit, etiketimet, diskriminimet etj.), ndërsa kohezionin si mënyrë e të bërit njësh e unit të tij me atë të grupit. Për aspektin e fundit, Meunier & Peraya shprehin: “Njeriu si individ kërkon që të bëjë njësh unin e tij me vetveten – ky është narcizizmi, unin e tij me tjetrin në çift – ky është narcizizmi i çiftit, unin e tij me të tjerët në grup – ky është narcizizmi i grupit. Në këtë dinamizëm, stofi shoqëror fragmentarizohet në komunitete të kundërta” (2009:274).

Në këtë linjë, Edgar Morin (1977) mbron tezën se çdo sistem është një *unitas multiplex* në të njëjtën kohë, një raport mes njëjësit dhe shumësit, tërësisë dhe llojeve, sipas kulturave dhe momenteve historike. Ky raport, nëse do të huazonim shprehjen e filozofit postmodern Jacques Derrida “në shumë raste shërben për krijimin e identitetit të gjithkujt” (Morin, 1977:54). I gjithë procesi, prezantohet dhe stimulohet nëpërmjet komunikimit.

Një aspekt i rëndësishëm i prezantimit dhe njëkohësisht i krijimit të identiteteve është komunikimi. Martin & Nakayama (2010:108) argumentojnë se këto identitete shfaqen në momentin kur mesazhet e komunikimit, shkëmbehen midis personave, dhe ata me vullnet të lirë zgjedhin të negociojnë, bashkëkrijojnë,

përforcojnë ose sfidohen përmes komunikimit. I të njëjtit mendim është edhe specialisti i komunikimit, Stefano Zecchimi, i cili thotë: “Komunikimi është gjithnjë zanafilla e identitetit të një shoqërie, është shprehje e një dallimi. Të kuptuarit e këtij komunikimi bën të mundur njohjen e veçorive të shoqërisë që e përdor atë” (2006:9).

Pikërisht, për rëndësinë që merr analiza e procesit të komunikimit C.Wright Mills nënvizon: “midis ndërgjegjes dhe ekzistencës qëndron komunikimi që ndikon në mënyrën me të cilën njerëzit ndërgjegjësohen në lidhje me ekzistencën e tyre” (1969: 96). Analiza e procesit të komunikimit merr një rëndësi parësore. Dhe në këtë kontekst, natyra e raporteve të vendosura midis “dhënësit” dhe “marrësit” bëhen përcaktues për suksesin ose jo të deshifrimit të mesazhit dhe të komunikimit në tërësi.

Nevoja për t’u përshtatur me veçoritë e secilit gjatë përcjelljes së mesazheve dhe në të njëjtën kohë interesi për t’u diferencuar për shkak të ruajtjes së identitetit, shndërrohen në procese normale të komunikimit. Mirëpo, nuk mungojnë rastet e mungesës së dëshirës për ta vendosur veten në pozicionin e të tjerëve, me qëllim kuptimin e pikëpamjeve të tyre në fazën finale të formulimit të mesazhit, duke gjykuar se kjo nuk është e nevojshme. Për Jean Piaget, në rastet kur mungon ky vullnet, fillojnë të shfaqen probleme me kuptimin e mesazhit dhe nuk parandalohen dot prirjet përjashtuese dhe marginalizuese ndaj të tjerëve. Ky paralajmërim i Piaget-it mbështetet edhe nga arsyetimet e bëra të David Morley-t dhe më vonë Stuart Hall-it. Sipas tyre, vështirësitë në komunikim, lidhen kryesisht me vetë kuptimin e mesazhit, i cili nuk varet vetëm nga përmbajtja në vetvete e mesazhit, por më shumë nga shkalla e interpretimit dhe kjo e fundit kushtëzohet nga tradita që qëndron pas personit që përpiket ta bëjë këtë gjë. Mosnjohja e kësaj tradite krijon në shumë raste keqkuptimesh në fazën e deshifrimit të mesazhit, pasi shumica e fjalëve – simbol nuk kanë lidhje ngjashmërie me objektin që ata përfaqësojnë.

Ekzistenca e kësaj bote ndërsubjektive, për shumë sociologë supozon një marrëdhënie komunikimi në trajtën e simboleve të përbashkëta (për shembull, shenjave të gjuhës). Këto simbole përbëjnë një rrjet interpretimesh që secili e trashëgon nga shoqëria dhe nga grupi social të cilit i përket. Për shembull, “kur shohim një person që përshëndet një tjetër, vetëm fakti i cilësimit si “përshëndetje” të këtij veprimi nënkupton se tanimë e kemi interpretuar. Fjalët dhe shprehjet e gjuhës janë një rezervuar kontekstesh interpretimi për tipa të ndryshëm veprimesh, dëshmitarë të të cilave jemi gjatë rrjedhës së jetës sonë të përditshme” (Mead, 2001:235).

Pikërisht, nisur nga kjo perspektivë, bëhet e qartë se të komunikosh nuk do të thotë vetëm të prodhosh informacion dhe ta shpërndash atë, por nënkupton gjithashtu të jesh i vëmendshëm ndaj kushteve në të cilat mesazhmarrësi e merr, e pranon e kundërshton, e rimodelon në funksion të horizontit të vet kulturor, politik, filozofik, mesazhin dhe njëkohësisht, i përgjigjet nga ana e tij. Jo në pak

raste, urat e komunikimit konsolidohen brenda anëtarëve që ndajnë të njëjtat kode komunikimi dhe përjashtohen të tjerët e ndryshëm nga ata.

Në përgjithësi, anëtarët e grupi “saldojnë” unitetin e tyre duke krijuar një entitet në të cilin çdo anëtar njihet dhe me të cilin identifikohet, në të njëjtën kohë dobëson ndjeshëm lidhjet me anëtarët e tjerë të ndryshëm nga ata. Janë pikërisht, konvencionet e përbashkëta që lejojnë bashkimet dhe ndarjet ndërmjet individëve ose grupeve të ndryshme shoqërore. Jo pa arsye, Paolo Alto (1951) e konsideron komunikimin “matrica e të gjitha veprimtarive njerëzore” dhe ku gjuha si një nga elementet përbërëse të tij, merr një rëndësi parësore. Fal tij, njerëzit arrijnë t’u transmetojnë kuptime të caktuara personave të përfshirë në komunikim, ndërsa këta të fundit kanë mundësi ta interpretojnë atë dhe të orientojnë përgjigjen e tyre, bazuar mbi këto interpretime. Jo vetëm kaq, por nisur nga rëndësia e kuptimit të mesazhit përcaktohet edhe roli që merr aktori social në një marrëdhënie ndërpersonale. Kuptimet dhe simbolet sipas George Ritzer i japin karakteristika të dallueshme veprimit shoqëror (i cili përmban një aktor të vetëm) dhe ndërveprimit shoqërorë (i cili përmban dy ose më shumë aktorë të përfshirë në veprime reciproke sociale)” (Ritzer 2009:371). Në këtë mënyre, realiteti social ndërtohet prej interpretimesh të kryera nga aktorët socialë që janë të angazhuar. Jo vetëm kaq, por që ndajnë kuptimet të njëjta interpretative për simbolikën e shprehur gjatë procesit të ndërveprimit.

Kjo qasje semiotike, mund të shërbejë fare mirë në kontekstin shqiptar, për të kuptuar vështirësitë në procesin e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme. Shumë nënkultura, që dikur zhvilloheshin në krahina dhe në zona relativisht të ndara dhe të veçuara, tani, si pasojë e migrimit të brendshëm janë vendosur në të njëjtat hapësira urbane. Mirëpo, vlen të saktësohet se hapësira e përbashkët fizike nuk nënkupton njësimin e zakoneve, traditave, besimeve, mënyrave të sjelljesh që ata mbartin nga e shkuara e tyre. Ardhja nga zona të mbyllura shoqërore, me norma morale ose kode të fiksuara mirë, shpeshherë u minimizon aftësinë këtyre banorëve për të perceptuar një botë tjetër, të ndryshme nga ajo që kanë parë më parë. Dalja jashtë këtij realiteti dhe ballafaqimi me situata të panjohura, për arsye nga më të ndryshme, i detyron këto banorë të mbyllën brenda vetes dhe të humbasin lidhjet me realitetin e jashtëm duke jetuar me të shkuarën. Sigurisht, nuk përjashtohen mundësitë që të konfirmohen kuptime dhe linja të reja kuptimi, por kjo kërkon, në rastin më të mirë, kohë. Pikërisht, të tilla sjellje, shpjegohen me problematikat që shfaqen nga komunikimi gjatë proceseve socializuese. Është komunikimi që kushtëzon aftësinë e përshtatjes në proceset ndërvepruese dhe më specifikisht, keqkuptimi ose mungesa e kodeve të duhura. Shpesh ata nuk i kuptojnë kodet me anë të cilave transmetohen mesazhet ose nuk zotërojnë kodet e përshtatshme për të dhënë mesazhet e tyre tek individë ose te grupe që i përkasin nënkulturave të ndryshme nga ajo e tyre. Mendimi, në këto raste nuk arrin të formulohet qartë pasi i mungojnë fjalët autentike shprehëse. Studiuesi

Fuga, situata të tilla i përshkruan në këtë formë: “... ai/ajo përpiket të gjejë atë që i duhet, mërmërit, por mbetet i paplotë me të meta dhe zbrazëti gjuhësore, sepse gjetja e fjalës që i korrespondon nuk është diçka e lehtë. Mesazhi nuk arrin të shprehet i plotë, pasi “burimi”, sikurse “marrësit” e tij, nuk zotërojnë atë sistem të kodifikuar shenjash që do të lejonte përmbajtjen semantike të tij të shprehur lirshëm dhe në mënyrë të shpenguar”(2010:158). E gjitha kjo, influencohet nga ajo që me të drejtë nënvizohet nga Pierre Bourdieu si trashëgimi kulturore. “Është *habitat*-i i tyre që i ka pajisur ato me një seri skemash të brendësuar, të cilat ndikojnë në shkallën e perceptimit, kuptimit, dhe vlerësimit të botës shoqërore të përcjell nëpërmjet komunikimit. Në shumicën e rasteve ato janë viktimat të këtyre skemave” (2008:82).

Në këto kushte, “individit ose grupe të caktuara rrezikojnë të kthehen në njësi të mbyllura brenda vetes, pa komunikim real e të vërtetë me të tjerët. Pra, të shndërrohen në njësi të izoluara që janë në kontakt vetëm me veten, brenda botës së tyre ose me të ngjashmit e tyre” (Fuga, 2010:276). Nuk bëhen përpjekje që veten ta njoh nëpërmjet tjetrit siç na sugjerojnë përfaqësuesit e ndërveprimit simbolik (Cooley, 1902. Mead, 1934, Blumer, 1969), por e bëjnë këtë gjë nëpërmjet vetes. Në këtë mënyrë, njeriu, duke dashur të njohë veten pa asnjë ndërmjetës tjetër, krijon një përfytyrim shumë të idealizuar për personalitetin e tij pasi vendos veten në qendër të botës. Nuk përjashtohen rastet që një psikozë e tillë të manifestohet edhe në nivel grupi.

Në kontekstin shqiptar, banorët e sapoardhur në Tiranë, pavarësisht dëshirës ose nevojës për t’u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t’i përkthyer të njëjtit grup, në jo pak raste detyrohen të diferencohen, diskriminohen dhe përjashtohen për shkak të komunikimit. Ata vazhdojnë të mendojnë e të sillen sipas mënyrës tradicionale të subkulturës së vendbanimeve të mëparshme duke humbur kontaktin me realitetin e ri në të cilin janë vendosur fizikisht. Kjo manifestohet në mënyrën e organizimit të jetesës, raporteve shoqërore brenda dhe jashtë familjes, përdorimit të dialektit etj. Kjo situatë, në jo pak raste i shtyn ata të konsolidojnë raportet me të ngjashmit e tyre, por njëkohësisht mund të shërbejë edhe si shtysë për të reflektuar rreth “tjetrit” dhe “vetes”. Në këtë proces nuk përjashtohen rastet e modifikimit dhe të tëhuajzimit, por që të ndodhë kjo e fundit, kërkohet intensifikim kontaktesh me “tjetrin”.

Nga raporti i Bankës Botërore (2007: 92), del në pah shkalla e ulët e integritetit të këtyre banorëve në tregun e punës. Niveli i ulët arsimor, kufizimet në aftësitë profesionale, njohja e kufizuar e tregut, i orienton këto banorë drejt profesioneve të rëndomta në sektor si: ndërtimi, fasoni, përpunimi ushqimor etj. Vende të tilla pune për shkak të kushteve të punës, statusit dhe pagës së ulët nuk lakmohen në përgjithësi nga banorë që jetojnë prej vitesh në kryeqytet. Orientimi në masë i banorëve të sapoardhur, drejt këtyre sektorëve, në shumë raste bëhet shkak për izolimin e tyre nga grupe të tjera sociale dhe në krahun tjetër iu rrit shanset për një

intensifikim marrëdhëniesh mes njëri -tjetrit. Nga vëzhgime sporadike në terren, konstatohet që shpesh punonjësit e punësuar në këto sektorë vijnë nga vende me origjinë të ngjashme dhe me nivel social ekonomik të përafërt.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që ndikon në izolimin e një pjese të banorëve të sapoardhur nga mjedisi social është fakti se një pjesë e tyre i sigurojnë të ardhurat nga remitancat e dërguara nga të afërmit e tyre. Në studimin e realizuar nga IOM (2008:39) evidentohet ky fakt. Në këto kushte, shumë prej tyre nuk shikojnë ndonjë nxitje për t'u orientuar drejt tregut të punës. Aq më shumë që personat që i dërgojnë këto remitanca janë në përgjithësi kryetarët e familjes ose personat e aftë për punë të seksit mashkull.

Konkluzion

Në punim u ndalëm për të analizuar realitetin multikultural që është krijuar në kryeqytetin e Shqipërisë si pasojë e lëvizjeve demografike të ndodhura gjatë këtyre viteve postranzicion. Njëkohësisht, shpjeguar mundësinë e konflikteve midis individëve ose grupeve që i përkasin nënkulturave të ndryshme si pasojë e moskomunikimit. Pavarësisht se banorët e sapoardhur shfaqin dëshirën për t'u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t'i përkthyer të njëjtit grup, por në të njëjtën kohë, u lind nevoja për t'u diferencuar, diskriminuar dhe përjashtuar. Komunikimi i mbart dhe i prodhon njëkohësisht të gjitha këto aspekte. Falë këtij komunikimi, njerëzit arrijnë t'u transmetojnë kuptime të caktuara personave të përfshirë në komunikim, njëkohësisht, interpretojnë dhe orientojnë përgjigjen e tyre, bazuar mbi këto interpretime.

Problemi qëndron te rrethanat kur grupe të ndryshme sociale nuk zotërojnë kodet e përshtatshme për të dhënë mesazhet e tyre tek individë ose te grupe që i përkasin nënkulturave të ndryshme nga ajo e tyre, pasi tradita që mbartin i kushtëzon në këtë drejtim. Jo vetëm kaq, por shpesh këto grupe manifestojnë mungesë dëshire për ta vendosur veten në pozicionin e të tjerëve, me qëllim kuptimin e pikëpamjeve të tyre në fazën finale të formulimit të mesazhit, me mendimin se nuk është e nevojshme një gjë e tillë ose duke besuar se referenca te vetja, mjafton për të kuptuar tjetrin. Mirëpo harrohet fakti se “vlerat apo kriteret me të cilat njerëzit përpiqen ta njohin veten, ta shohin veten si në pasqyrë, përpara se të jenë norma botëkuptimi, janë fjalë të një gjuhe të caktuar dhe kanë kuptim vetëm në kuadrin e përmbajtjes së tyre gjuhësore. Këto fjalë, përmbajtjen e tyre kuptimore si dhe mënyrat e përdorimit të tyre nuk i përcakton asnjë individ i marrë në veçanti dhe në vetminë e tij intime. Ato janë produkte shoqërore të krijuara gjatë një procesi të gjatë socializimi që kërkon kohë të ndryshojë” (Fuga, 2010). Aq më shumë që në kushtet kur shkalla e integrimit në tregun e punës, në jetën sociale dhe kulturore është shumë e pakët.

Shumë studiues mbrojnë pikëpamjen se marrëdhëniet e reduktuara ndërmjet grupeve që i përkasin nënkulturave të ndryshme ul ndjeshëm probabilitetin e njohjes së njeri - tjetrit dhe ajo që është më e rëndësishmja e aftësisë për të deshifruar kuptimin e mesazhit që ata dëshirojnë t'i përcjellin njëri - tjetrit. Për sa kohë që rrethanat ekonomike, sociale, politike nuk kontribuojnë sa duhet për të ndryshuar situatën, izolimi social kthehet në nevojë qoftë për të ruajtur identitetin, qoftë për t'u diferencuar nga tjetri i ndryshëm dhe shpeshherë i perceptuar si kërcënues i vlerave dhe i traditës me të cilën identifikohen grupe të ndryshme sociale. Kjo mund të konsiderohet një vlerë për sa i përket mozaikut kulturor që krijohet për shoqërinë në tërësi, por në krahun tjetër nuk shmangen dot problemet psikosociale që sjell një realitet i tillë.

Bibliografia

- Banka Botërore (2007) *Vlerësim i sektorit urban në Shqipëri*, Raport Nr. 37277-AL.
Banka Botërore (2003) *Shqipëria : Një vlerësim i varfërisë*, Raport Nr. 26231
Bourdieu, P. (2008) “Mbi televizionin” (Përkth. Budina, Belina.) *Polis*. Nr.8, Tiranë: UET Press.
Dervishi, Z. (2001) “Politika dhe Shoqëria”, ISPS, Vell.4, Nr.1. (8)
Collins R. (1986), *Weberian Sociological Theory*, Cambridge: Cambridge University Press.
Open Data, (2011) Popullsia në Tiranë 2001-2009, marrë nga <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/262/Popullsia-ne-Tirane-ne-vitet-2001-2009> (parë për herë të fundit me 20 prill 2013).
Fuga, A. (2000) *Shoqëria periferike*. Tiranë: ORA.
Fuga, A. (2010) *Monolog*, Tiranë: DUDAJ.
Hall, S. (1996) *Critical Dialogues in Cultural Studies*, London: Routledge.
James, W. C. (1992) *Communication as Culture: Essay on Media and Society*, London: Routledge.
Karaguni, M & Dumani, B. (2005) “Tirana, Relievi Demo – ekonomik e Social”, *Revista Demografike*, Tiranë:ILAR.
Karaguni, M & Dumani, B. (2009) “Zhvillimet në Tiranë:Refleksion mbi disa sfida”. *Revista Demografike*, Tiranë:ILAR.
Magner, E. (2010) *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*, Tiranë: UET PRESS.
Mead, H. G. (2001) *Mendja, vetja dhe shoqëria*, Tiranë: Prishtinë.
Meunier, J. & Peraya, D. (2009) *Hyrje në Teorinë e Komunikimit*, Tiranë: UET PRESS.
Toennies, F. (1963) *Communication and Society*, Harper & Row, New York.
IOM, (2008) “Identifikimi i zonave me të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer”, Tiranë: IOM.

- Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë (2000) “Shqipëria në shifra -1999, Tiranë: INSTAT.
- Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë (2005) “Shqipëria në shifra-2004”, Tiranë: NSTAT.
- Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë (2012) “Censusi 2011”, Tiranë: INSTAT.
- Ritzer, G. & Goodman, D. (2009) Teoria Sociologjike, Tiranë: UFO PRESS.
- Martin, J. N. & Nakayama, T. K. (2010) *Intercultural Communication in Contexts*. 5th ed. Boston: McGraw-Hill.
- Zecchini, P. S. (2006) Dizionario dei sinonimi della lingua Italiana, stereotipa. University Oxford.

Përrjashtimi social në lagjet e pafavorizuar për qytetin e Kukësit

Dokt. Rifat DEMALIJA¹

Abstrakti. *Koncepti i përjashtimit social është relativisht i ri në Shqipëri, në të dyja fushat, akademike dhe politike, ndonëse vetë fenomeni i përjashtimit të grupeve shoqërore të caktuara është i pranishëm dhe i përhapur në të gjithë shoqërinë shqiptare. Në këtë artikull ne përpigemi të analizojmë përjashtimin social, si një fenomen sociologjik që kalon nëpër etapat e: varfërisë, si elementi kryesor, me të cilin identifikohet përjashtimi social; pjesëmarrjes dhe përfshirjes si një mjet për të ndikuar në hartimin e politikave efektive dhe krijimin e aksesit si aktorë real në jetën komunitare për ta përmbyllur me lëvizjen demografike duke argumentuar faktin se ka ndikuar në bashkjetesën dhe stereotipet si pengesë për integrimin e të përjashtuarve. Përmes pohimeve dhe argumentave të gjetur në terren ne përforcojmë hipotezën se përjashtimi social ndikohet nga faktorë ekonomike, politikë dhe kulturor. Mënyra sesi lagjet e pafavorizuar periferike në Kukës janë të strukturuar, varen nga njëra anë nga zhvillimi kaotik i periudhës së tranzicionit dhe nga ana tjetër është sistemi i vjetër tipik komunist. Lëvizja demografike pas vitit 1992 në Shqipëri, është shoqëruar me mungesa të theksuara infrastrukturë, por të pranueshme për të ardhurit e rinj, shoqëruar kjo me mungesën e shërbimeve sociale, duke ndikuar në përjashtimin social. Trajtimi i çështjes së përjashtimit social në lagjet e pafavorizuar është një problem shumë kompleks dhe i pandarë nga institucionet vendore dhe qendrore, gjithashtu edhe nga vetë shoqëria në përgjithësi, e për pasojë përfundimet që dalin nga ky studim u adresohen pikërisht të gjithë këtyre aktorëve dhe zonave të marra si objekt studimi.*

Hyrje

Kjo trajtesë lidhet drejtëpërdrejtë me përjashtimin social si fenomen shoqëror. Rasti studimor merr në shqyrtim qytetin e Kukësit, dhe përkatësisht dy lagje të tij; Lagjen Drinas dhe Lagjen e Re. E para është populluar gjatë

¹ Rifat Demalija është doktorant pranë Universitetit Europian të Tiranës, si dhe Drejtori Ekzekutiv i Organizatës, “Youth in Free Initiative” .

sistemit komunist, e cila është ndërtuar për banorët e zhvendosur nga përmytja e Liqenit të Fierzës, ndërsa e dyta e populluar gjatë periudhës së tranzicionit. Ky punim ka për qëllim të identifikojë shkaqet e përjashtimit social për lagjet periferike, dhe mungesën e një strategjie ndërhyrje për përfshirje, duke i dhënë përgjigje pyetjes se: Çfarë e shkakton *përjashtimin social* tek grupet e mënjanuara si dhe cili është efekti në zhvillimin komunitar të përjashtimit social?

Zgjedhja e temës së përjashtimit social është bërë për disa arsye: Së pari, synon të ndihmojë në të kuptuarit mbi konceptin e përjashtimit social, kuptimin dhe dallimin e lagjeve të pafavorizuara dhe karakteristikat e tyre bazë në kontekstin social, si problematikë tipike e banorëve të këtyre lagjeve. Së dyti, punimi ynë, ka për qëllim të hulumtojë nëse niveli ekonomik, marrëdhëniet sociale dhe kulturorë dikojnë si faktorë bashkëshoqërues në përjashtimin social; gjithashtu nëse *bashkëjetesa* e të ardhurve të rinj në lagjen e tyre dhe përtej asaj, përshtatja dhe adaptimi i banorëve në vendbanimet e reja, si dhe ekzistenca e *steriotipeve* janë një pengesë në përfshirjen sociale, duke krijuar barriera midis banorëve dhe institucioneve, si dhe midis banorëve vetë. Për ne, edhe *mungesa e përfaqësimit* në vendimmarrjen lokale të grupeve të përjashtuara është faktor i cili largon interesin dhe vëmendjen e politikës ndaj tyre. Së fundi, do të shohim faktorët që ndikojnë tek fenomeni i përjashtimit social, për të adresuar më pas, rolin e institucioneve vendore, si dhe rekomandimet të cilat do të mund të krijonin premisa për ndryshim dhe përfshirje.

Gjatë këtij punimi janë kombinuar të dhënat nga burimet parësore, intervista gjysmë të strukturuar me banorë dhe drejtues të shërbimeve sociale në Kukës, përfaqësues të Shoqërisë Civile si dhe dy fokus grupe me banorët e lagjeve të ndryshme; ndërsa burimet dytësore janë statistikën dhe raportet që janë gjetur për rrethin e Kukësit. Studimi është kryer në gjysmën e dytë të vitit 2011. Mungesa e të dhënave të sakta në institucionet lokale dhe frika për të deklaruar rastet e përjashtimit nga shërbimet apo konkurrenca për punësim janë disa nga vështirësitë e hasura gjatë hulumtimit.

Koncepti i përjashtimit social?

Koncepti i përjashtimit social është relativisht i ri në Shqipëri, në të dyja fushat, akademike dhe politike. Ndëkohe që në Shqipëri përdorimi i këtij koncepti është i vonshëm, në botën perendimore, përjashtimi, përfshirja dhe kohezioni social, janë tema të rëndësishme të trajtuara gjerësisht nga studiues, institucione dhe organizata ndërkombëtare. Sot në Shqipëri, termi “përjashtim social” apo përfshirje sociale mbetet ende i vagullt, i papërcaktuar dhe i panjohur, ndonëse vetë fenomeni i përjashtimit të grupeve shoqërore të caktuara është i pranishëm dhe i përhapur në të gjithë shoqërinë shqiptare.

Përjashtimi social është një veprim i shkaktuar nga njerëzit, përmes veprimeve të tyre dhe vlerave të shkelura morale (Pierson, 2010). A mund ta marrim për të vërtetë pohimin e mësipërm të Pierson? Këtu mund të ketë vend për diskutime, pasi në pohimin e Pierson, vetë njerëzit përjashtojnë veten e tyre, duke e lënë kështu të vagullt dhe të papërcaktuar qartë nivelin shoqëror që përjashton dhe atë që përjashtohet, të cilat nuk mund të ngarkohen me të njëjtin nivel faji ose përgjegjësie për situatën, kur historikisht qëndrojnë në pozicionin humbës dhe nuk janë faktorë pushteti.

Banorët e lagjeve të pafavorizuara përbëjnë *nëngrupet e shpronësuar*, një term i përdorur nga S. Dovi nga Universiteti i Arizonës (Dovi, 2004), term i cili ka të bëjë me një grup historikisht i përjashtuar dhe i papërfaqësuar në politikë. Mbiemri *i shpronësuar* i referohet atyre grupeve që janë përjashtuar nga jeta politike, sociale dhe ekonomike në mënyrë të padrejtë, ka të bëjë me ata grupe, që nuk zotërojnë burime politike dhe ekonomike të mjaftueshme për përfaqësim efektiv. Nëse do të shtojmë edhe një term tjetër në trajtesën tonë, sikurse është *izolimi social* do të kontribuonim më shumë në kuptimin e *përjashtimit social* dhe mjeteve që e shkaktojnë atë. Çfarë ndryshimi kanë këto dy koncepte midis njëri-tjetrit? Ndryshimi midis izolimit dhe përjashtimit social është i dukshëm, duke qenë se izolimi nënkupton fenomenin e mospjesëmarrjes së një individi ose një grupi të caktuar në institucionet publike dhe jetën sociale. Izolimi mund të jetë i vullnetshëm ose i shkaktuar nga të tjerët.

Nëse nuk kemi arsye të shqetësohemi për izolimin e vullnetshëm², na duhet të shqetësohemi për përjashtimin social të grupeve shoqërore, për të cilat askush nuk do të merrte përsipër të përgjithësojë përjashtimin me izolim vullnetar, pasi nuk është e mundur që një grup me moshë, gjini dhe kulturë të ndryshme, të ketë vullnet të njëjtë për përjashtim vullnetar. Në vetvete, përjashtimi social sipas Pierson përbën edhe një dhunim të standardeve për drejtësi sociale, dhe një pamundësi për të marrë pjesë në mënyrë efektive në politikë (Pierson, 2010). Përjashtimi social është një kompleks dhe proces shumë dimensional sipas Levitas. Ky kompleks dhe proces përfshin mungesën apo mohimin e burimeve, të drejtave, të mirave materiale dhe shërbimeve, dhe pamundësinë për të marrë pjesë në marrëdhënie normale dhe aktivitetet e arritshme prej shumicës së njerëzve në shoqëri, qofshin ato në fushën ekonomike, kulturore apo politike (Levitas, 2007). Për pasojë ky proces ndikon në cilësinë e jetës së individëve, cilësinë dhe kohezionin e shoqërisë.

Në botimet zyrtare evropiane të vitit 1998 dhe studime mbi këtë fushë u shfaq një

² Izolimi i vullnetshëm nënkupton përjashtimin me dëshirë të individit ose të grupit nga aktivitetet social-ekonomike. Në këtë kontekst, shoqëria dhe shteti nuk mund të mbajnë përgjegjësi për veprimet e individit ose të grupit, si për shembull, në rastet kur një individ ose grup shoqëror vendos të mos marrë pjesë në zgjedhje, ose nuk pranon të kontribuojë në jetën komunitare të lagjes. Vetëizolimi është një përgjegjësi që ngarkon individin ose grupin vetë.

konsensus në idenë se, *përfshirja social* mund të ndërtohet si diçka që iu ishte dhënë me detyrim njerëzve më tepër sesa diçka që ata mund ta kenë zgjedhur për vetveten. Kështu, një përkufizim për përfshirjen social që duhet të merret në konsideratë është ai i Julian Le Grand, Profesor për Politikën Sociale në LSE: "Një individ (britanik) është i përfshiruar social nëse (a) ai/ajo është rezident në Britaninë e Madhe, por (b) për arsye përtej kontrollit të tij/saj, ai/ajo nuk mund të marrë pjesë në aktivitetet normale të qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar, dhe (c) ai ajo dëshiron të marrë pjesë" (Le Grand, 1998). Sipas këtij pohimi, ne mund të pohojmë se përfshirja social nuk është vullnetar, në momentin kur dikush dëshiron të marrë pjesë dhe diktohet nga një palë tjetër.

Si një veçori e konceptit të përfshirjes social, Atkinson nga London School of Economics futet më thellë në përkufizimin e tij duke përkufizuar dy artikuj: "1. Individin nuk merr pjesë për arsye përtej kontrollit të tij/saj, dhe 2. Ai/ajo dëshiron të marrë pjesë" (Atkinson, 1998:45). Por nëse dikush shtron pyetjen se, cili do të mund të ishte problemi me përfshirjen e vullnetshëm, në këndvështrimin tonë, përfshirja social i vullnetshëm dhe i detyruar kanë mjaft ndryshim mes tyre; problemi i përfshirjes te vullnetshëm është se ai ndikon në zhvillimin dhe bashkëpunimin e aktorëve të atij komuniteti për një solidaritet social. Në vijim të përpjekjes për të shpjeguar kuptimin e përfshirjes social, do të na ndihmonte shumë mendimi i sociologut francez R. Castel, i cili thotë se: "Ajo çka është shkruar për përfshirjen social ka përkufizuar çdo fakt, deri edhe të ndotur, të diskriminimit të lidhjeve sociale, e cila thuhet se ka pasur rezultat në humbjen individuale të sensit të tyre të përkatësisë sociale". Më tej i njëjti autor pohon se, *excluded*³ janë grumbullime të individëve të cilët nuk kanë asgjë të përbashkët përveç zbrazëtisë së përbashkët." (Castel, 2003:37-43)

Për shkak të kuptimeve dhe debateve të shumta mbi këtë koncept, në rastin tonë të *përfshirjes social*, do të konsiderohen ata banorë të cilët jetojnë në lagjet e pafavorizuara, të cilët janë të papunë, pa arsimin e duhur dhe jetojnë në kushte social-ekonomike të vështira, nën minimumin jetik të popullsisë, me mungesa të theksuara në infrastrukturë, si: rrugë, kanalizime, uji të pijshëm, drita ose shërbime publike përfshirë, por jo vetëm, shkolla fillore, kopshte, çerdhe dhe qendra shëndetësore. Pra, me përfshirje social do të kuptojmë mospërshtatjen ose marginalizimin për shkak të kulturës, edukimit dhe kushteve ekonomike.

Strukturat dhe ndryshimet në lagjet e pafavorizuara: rasti i Kukësit

Mënyra sesi lagjet e pafavorizuara periferike në Kukës janë të strukturuar, varen nga njëra anë nga zhvillimi kaotik i periudhës së tranzicionit dhe nga sistemi urbanistik i trashëguar nga periudha e komunizmit, nga ana tjetër. Në

terminologjinë akademike, shpesh kemi lexuar për pushtetin e 'vendodhje', impakti i lagjeve në jetën e atyre që jetojnë atje (Fuga, 2004). "Lagje Periferike, të varfëra, të lodhura, të vështira, fshatare, rrethina, të shkatërruara" (Council of Europe, 2007:16) janë disa nga termet që mund tu referohesh zonave komunitare, në të cilat ka një përqendrim të njerëzve me nivel ekonomik të ulët. Secili prej këtyre etiketimeve të zgjedhura për njësitë komunitare të cilat në i kemi quajtur lagje të pafavorizuara, reflektojnë procesin kronologjik dhe problematik, si rezultat i mungesës së politikave efektive për përfshirje sociale dhe zbatimit të detyrimeve ligjore dhe konventave ndërkombëtare të nënshkruara nga shteti Shqiptar⁴.

Pavarësisht numrit të vogël të banorëve që qyteti i Kukësit ka, rasti i lagjeve të pafavorizuara ose të përfshiruara mund të jetë pak a shumë i ngjashëm me qytetet e mëdha të vendeve të zhvilluara të Europës. Nëse hedhim një vështrim mbi strukturën e lagjeve me të ardhura të vogla në qytetet e mëdha, sikurse janë Parisi dhe Bordeaux në Francë, Barcelona në Spanjë do të vëmë re se këto lagje janë bastione historike të klasës punëtore të lidhura me industrinë dhe zejtarinë. Studiuesit Guilly dhe Noye në *Atlasin e ndarjeve të reja sociale në Francë*, tregojnë se klasat popullore krijuan shumicën e tyre në vitet 1980 në kohën kur bëhej presion për strehimin dhe ndërkohë u bënë shumë atraktive për popullsinë me më shumë kapital kulturor dhe ekonomik (mësues, gazetar, artistë etj.) pasi një numër i madh i tyre u zhvendosën brenda tyre (Guilly & Noye, 2004), ky përbën edhe modelin e parë të lagjeve të pafavorizuara. Historia është pak më e ndryshme me rastin e Kukësit vetëm për argumentin se popullimi i lagjeve në qytetet e Parisit, Bordeaux dhe Barcelonës ishte e lidhur me industrinë; në Kukës mungon industria, por strukturimi i lagjeve të pafavorizuara perputhet deri diku me strukturën sociale.

Ndërsa modeli i dytë është modeli peri-urban apo ai periferik. Ky model është ndërtuar gjatë viteve 1945 dhe 1970, në kohën kur ato ishin planifikuar për të zëvendësuar lagjet e varfëra, të cilat në atë kohë ishin të shumta, duke synuar për të përmirësuar kushtet e familjeve të varfëra dhe për të lëvizur punëtorët afër fabrikave të tyre (Treanor, 2003). Kjo strategji tentoi për ta kthyer në një periudhë të artë, por që rezultoi si e pamundur, megjithatë pati një periudhë progresi social për shumë familje punëtorësh të cilat kishin lehtësira modeste sikur; ujë, energji elektrike, por që nuk dukej se kishin një të ardhme të sigurtë.

Situatë e ngjashme me modelin e dytë është lëvizja demografike pas viteve 1992 në Shqipëri, ku popullsia zhvendoset nga zonat e thella për në periferi të qyteteve. Uji i pijshëm, kanalizimet, shërbimi shëndetësor dhe energjia elektrike për të ardhurit rishtas ishin mungesa të pranueshme prej tyre. Lagjet periferike në

⁴ Një rast që vlen për t'u përmendur për mungesë përmbushje të detyrimeve është: Karta Sociale Europiane (e rishikuar), Strasbourg 3 Maj 1996. Pavarësisht nënshkrimit të saj nga Shqipëria, sipas raporteve të Këshillit të Europës dhe situatës aktuale social - ekonomike, rezultojnë se nuk janë përmbushur detyrimet e kësaj konvente.

³ Të përfshiruarit.

qytetin e Kukësit, paraqesin probleme të dukshme në aspektin infrastrukturor dhe atë të shërbimeve sociale. Mungesa e çerdheve, kopshteve, qendrave shëndetësore dhe e institucioneve të tjera ku mund të ushtrohet veprimtaria publike mungojnë. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi komunitar për çështjet që lidhen me interes të tyre nuk kanë treguar organizim dhe pjesëmarrje, për sa kohë nuk ka përmirësim të shërbimeve bazë.

Do të kërkonim konsensus për termin ‘*lagje të pafavorizuara*’, duke kuptuar lagjet periferike, të varfëra, të vështira, në situatë të pafavorshme, pra ato që shpesh quhen edhe *lagje popullore*¹⁰, për të cilat ende nuk kemi një përkufizim të saktë.

Një kulturë periferike

Kultura në vetvete është si “mënyrë jetese” (Williams, 1976). Në parim, kulturat e reja theksojnë mënyrën e përdorur nga grupi vartës për t’u rezistuar kulturave të klasës dominante, duke krijuar me mënyrën e tyre kuptimin e simboleve apo të organizimit të jetës në komunitetin ku banojnë. Kjo ndodh shpesh për të mos u asimiluar nga grupi dominant, ndërkohë që nuk mund të aplikohet në të gjitha rastet kjo sjellje shoqërore, pasi ka raste të tjera kur grupet vartëse, përpiqen më së shumti për të kopjuar kulturën e grupit dominant, me qëllim që të mos ndihen inferior.

Ndryshimet postkomuniste të vitit 1991, me bashkimet kulturore që ndodhën në qytete të ndryshme, kanë ndikuar dukshëm proceset ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat edhe në rastin e Kukësit nuk mund të anashkalohen. Zhvendosja demografike gjatë periudhës së tranzicionit karakterizohet nga lëvizja e popullsisë së zonave rurale drejt asaj urbane. Pavarësisht se Qarku i Kukësit është një rajon me popullsi të vogël, prapëseprapë ndryshimet kulturore, sociale dhe ekonomike janë një diversitet i pasur, përsa i përket dialekteve të gjuhës, nivelit të edukimit, mirëqenies ekonomike apo traditave të ndryshme midis zonave urbane nga ato rurale.

Meqenëse hapësira gjeografike dhe sociale është një pikëtakimi ku kulturat bashkëveprojnë, është me rëndësi të pozicionojmë të ardhurit rishtaz brenda hapësirës komunitare. P.sh., rrymat e reja muzikore, moda dhe veshja shpesh duket sikur vijnë nga të rinjtë e këtyre lokaliteteve periferike, por në fakt më shumë është një përshtatje me kulturën globale, e cila aplikohet në nivelin e hapësirës komunitare ku ndikimi mund të jetë i shpejtë. Hapësira sociale nuk i ka humbur plotësisht konturet e saj, sipas Massey. Në të kundërtën, konturet e saj kanë siguruar specifikim shtesë. Në vend të të menduarit për hapësirë në termin e shkallës, tani është e nevojshme për të imagjinuar si një madhësi e vazhduar e rrjeteve komplekse


e marrëdhënieve reciproke të cilat nuk janë strukturuar qartësisht brenda shkallëve (Massey, 1998:124). Me fjalë të tjera, disa kultura lokale ndikojnë kulturat e tjera periferike përmes proceseve të lidhjeve reciproke, të cilat i japin formë karakterit të hapësirës sociale globale.

Ndikimi i varfërisë në përjashtimin social në Kukës

Sipas argumenteve të mësipërme kuptuam se, nga elementet më të rëndësishëm që ndikojnë në përjashtimin social janë varfëria, të ardhurat e pakta, mungesa e edukimit cilësor, mungesa e vëmendjes së mekanizmave që ofrojnë shërbime në komunitet, mospjesëmarrja dhe bashkëpunimi komunitar për çështjet e përbashkëta dhe kultura sociale si produkt nga stereotipet për të ardhurit e rinj nga zonat e thella. Prej vitit 1991 deri në vitin 2010, duke u bazuar në raportet e institucioneve ndërkombëtare, për të përmendur këtu Bankën Botërore (2006) dhe UNIFEM (2010) mund të themi se qarku i Kukësit është rajoni më i varfër në Shqipëri. Vetë nocioni i varfërisë është përcaktuar nga Pierson në dy mënyra: *varfëri absolute dhe varfëri relative*. “Varfëria absolute përbën minimumin e nevojave për ushqim dhe strehim, ndërsa varfëria relative ka të bëjë me mungesën e burimeve të nevojshme për të marrë pjesë në aktivitete dhe për të patur kushte jetese të ngjashme me shumicën e njerëzve në një shoqëri të caktuar” (Pierson, 2010:14).

Në Shqipëri pas vitit 1990, të dy karakteristikat e varfërisë përmendur më sipër kanë ekzistuar për zona të ndryshme, sidomos për zonat veriore të vendit. Sipas një studimi të kryer nga INSTAT, BB dhe UNDP në vitin 2002, niveli i varfërisë ishte 25.4% në shkallë vendi, ndërsa në vitin 2005 u zvogëlua në 18.5% dhe në vitin 2008 ra në 12.4%(INSTAT, 2008), shih tabelën 1.

Tabela 1: Trendi i varfërisë ekstreme



Përveç varfërisë absolute që përmendet në këtë studim, është theksuar edhe pabarazia midis të varfërve. Nëse shohim raportin e UNIFEM të vitit 2009, duket se situata nuk ka ndryshuar shumë për sa i përket nivelit të varfërisë në vendet malore ku bën pjesë edhe Kukësi, të cilat duhet të kishin ndodhur në sinkron me shpërndarjen e shërbimeve sociale tek pjesa e varfër e shoqërisë, duke identifikuar nivelin e lartë të varfërisë dhe pabarazinë sociale, një nga çështjet për të cilat ka patur strategji kombëtare që prej vitit 2002 për të adresuar këto çështje, por që shumë pak është bërë (UNIFEM, 2009:7).

Në strategjinë e mbrojtjes sociale të MPÇSSHB, varfëria mbetet shqetësimi i politikës dhe shkalla e varfërisë është nga më të lartat në Evropë. Grupe të identifikueshme të popullsisë janë të përjashtuar nga shoqëria në lidhje me “llojet e ndryshme të privimit dhe pengesave, të cilat vetëm apo sëbashku, pengojnë pjesëmarrjen e plotë në fusha si papunësia, arsimi, shëndetësia, strehimi, kultura, aksesit në të drejtën e përfitimit të mbështetjes familjare si dhe të mundësive të trainimit dhe punësimit” (MPÇSSHB, 2006:7).

Shkaqet e varfërisë dhe të përjashtimit social në lagjet periferike të Kukësit

Në pjesën më të madhe të anketimeve të publikuara nga INSTAT⁶ dhe UNIFEM (2010) mbi nivelin ekonomik, lëvizjet demografike, problemet sociale etj., shkaku kryesor është varfëria dhe papunësia. Do të shtrënim për diskutim disa gjetje nga intervistat e kryera gjatë këtij studimi me banorë në dy lagjet periferike të Kukësit: *mungesa e arsimit të duhur*, diskriminimi në shkollë, të ardhura të pakëta, mungesa e shkollave apo klasave të specializuara për fëmijët me probleme fizike dhe mendore; *papunësia*, mungesa e tregut për profesione tradicionale, rënia e kualifikimit/aftësive në një treg të ndryshueshëm të punës, mospërputhje e aftësive me vendin e punës, diskriminim, punë të rastësishme, sektori informal; *infrastrukturë e shkatërruar*, mundësi të kufizuara për nevojat bazë si, uji i pijshëm, higjenë, energji elektrike, ngrohje, shtëpi të mbipopulluara dhe të papërshtatshme; *mungesë aksesit në informacion dhe qeverisje*, përfshirja shoqërore, kufizime dhe mundësi pjesëmarrje, barriera institucionale, mungesë e përfaqësimit politik.

Përveç mungesës së arsimit cilësor, papunësia, infrastruktura e shkatërruar dhe mungesa e aksesit në informacion, do të shtonim lëvizjen demografike dhe nivelin kulturor. Lëvizja demografike ka sjellë që familjet e varfëra të shpenzojnë për lëvizjen e tyre, por përveç kësaj lëvizje atyre u duhet të investojnë në strehimin e tyre, për shtëpi të reja në vendbanime të reja. Niveli kulturor ka të bëjë me diferencat midis zonave urbane dhe rurale të cilat janë të theksuara, duke krijuar barriera, paragjykimet dhe përjashtime të grupeve të vogla.

⁶ Instituti i Statistikave, faqe zyrtare <http://www.instat.gov.al/> [vizituar në 10/01/12]

Efektet e përjashtimit social në Kukës?

Së pari duhet të pranojmë se përjashtimi social cënon vlerën e drejtësisë sociale dhe solidaritetin (Barry, 1998). Nëse një lagje e një qyteti për shkak politik apo preferencial të palës qeverisëse, bëjnë që përmes ndërhyrjes apo mosndërhyrjes të dallojnë në mungesa të dukshme në harmonizimin e jetës sociale, politike dhe pjesëmarrëse në ndryshim me një pjesë tjetër të këtij territori kaq të vogël, sikurse është njësi bashkiake (lagje), kjo mund të konsiderohet si një e keqe e madhe. Nëse pranojmë se drejtësia sociale bazohet në mundësi të barabarta, nënkupton se principi i drejtësisë, beson se njerëzit të cilët janë njesoj të aftësuar duhet të jenë barazisht të vlerësuar edhe në shërbime, përveç rasteve kur bëjnë zgjedhje vullnetare e cila rezultojnë në shfaqjen ndryshe të tyre dhe rrjedhimisht në mospërfshirjen e tyre.

Mungesa e mundësive për punë në lagjet e pafavorizuara, ka tendencë të zvogëlojë motivimin shkollor, për pasojë kjo kontribon në rezultatin e edukimit të mangët i cili ndëshkon gjeneratën e ardhëshme për mundësi punësimi tepër të limituara në kohën e tyre. Braktisja e shkollës në vitet e tranzicionit ka kapur një shifër rekord në rrethin e Kukësit, duke arritur në 5-8.6%, ky fenomen ndodh si rezultat i presionit ekonomik mbi djemtë e rinj apo në rastin e vajzave, si rezultat i mentalitetit (UNDP, 2004:50). Sigurisht varfëria në vetvete është pengesë për mundësitë në edukim të barabartë. Një fëmijë i uritur apo kequshqyer nuk mund të përqendrohet mirë në orën e mësimi.

Përjashtimi social ka ndikuar për keq edhe në pjesëmarrjen politike në qeverisjen vendore në Kukës. Parakushtet për t'u përfshirë në politika baraz, është e pamundur për disa kategori njerëzish, sikurse mund të përmendim nënat e divorcuara të papuna apo të pa strehë, kushte të cilat nuk ia lejojnë përmbushjen e dëshirave dhe detyrimeve për një aktivitet politik.

Varfëria dhe mungesa e sigurisë në një vendbanim të ri për të ardhurit ka qenë pengesa e parë për të krijuar një mjedis social të shëndetshëm. Rrethanat në të cilat kishin lëvizur këta migrantë brenda vendit të tyre, nuk i lehtësonin dhe nuk u krijonte mundësi për një përkrahje sociale të *pritisëve* si brenda dhe jashtë institucioneve. Rasti përzgjedhur nga intervista shfaq problematikën e shumicës së familjeve të të ardhurve në vitet e para të lëvizjes demografike brenda vendit, të cilët kanë vuajtur nga përjashtimi dhe mungesa e përkrahjes sociale. Një familje në këto kushte, nuk mund të pretendojë edhe për mbështetje sociale, megjithëse

Naxhija, banore e ardhur në vitin 1994 në Lagjen e Re, tregon se “...ishim pothuajse të turpëruar për mënyrën e jetesës, nuk prisnim as përcillnim miq e mysafirë sikurse e kishim traditë në fshatin nga vinim. Nuk kishim kushte brenda banesës së ndërtuar me lëndë druri, në të cilën nuk kishte ndarje dhomash për fëmijët, por të gjithë hanim dhe flinim në të njëjtën dhomë. Midis lagjes tonë dhe qytetit kishte kufij të pakapërcyeshëm, për shkak të infrastrukturës, varfërisë, mbështetjes, njohjes etj.”

do të pretendonte për mbështetje institucionale. Kjo është përvojë e provuar, të cilën e shprehin pjesa e madhe e të ardhurve, duke mos harruar stereotipet dhe paragjykimet që kanë qenë “mikëpritësit” e tyre në jetën e përditëshme.

Nëse shtrojmë një pyetje në lidhje me atë se çfarë duhet të bëjmë si shoqëri për të reflektuar në situatën e përjashtimit social të qytetarëve në lagjet e pafavorizuara, më siguri do të përgjigjeshim se pikësëpari duhet të kapërcejmë stereotipet, të cilat egzistojnë, në lidhje me banorët e këyre lagjeve. Këto stereotipe kanë tendencë të vendosin një mur ndarës midis grupeve sociale, duke zhdukur barazinë sociale dhe duke krijuar barriera e klasa sociale të përjashtuara të panevojshme. Banorët e lagjeve të marrë në vëzhgim shprehen se stereotipet egzistojnë dhe janë pothuajse pengesa kryesore për integrim për banorët e lagjeve periferike. Stereotipet, që në këtë rast lidhen me një grup të veçantë social, i cili në disa mënyra ndryshe nga *normat*, për shembull, kur flasim për të varfërit apo të ardhurit e ri, ndodh nga një grup më i madh se ai i diskriminuari duke gjykuar negativisht për aftësinë e tyre. David G. Mayers, shprehet:

të bësh stereotipe do të thotë të përgjithësosh ... Stereotipet janë bindje për një grup tjetër, bindje që mund të jenë të sakta, jo të sakta ose tejet të përgjithësuara nisur nga një thërrime e vërtetë. Ato kanë të bëjnë më tepër me varfërinë, shtëpitë jo të mira dhe kujdesin e dobët shëndetësor. Zezakët e pasur nuk janë në rrezik nga kjo sëmundje. Të bardhët e varfër po. (Mayers, 2003: 305-316).

Përgjithësimet që u bëhen grupeve të veçanta sociale bazohen në eksperiencën individuale duke u kthyer në stereotipe për gjithë grupin më vonë. E njëjta situatë ndodh edhe me të ardhurit e ri në lagjet periferike të Kukësit apo edhe me banorët në qytet brenda lagjeve të tij. Fëmijët e kësaj kategorie në shkollë lehtësisht identifikohen si “ata” dhe “ne” të cilët nuk i përkasin atij grupi. Të rinjtë të arsimuar të familjeve të të ardhurve nga zonat rurale në qytetin e Kukësit, pavarësisht profesioneve dhe rezultateve që mund të kenë, janë të paragjykuar dhe përballen përjashtimin nga konkurrenca dhe presionin e banorëve autoktonë.

Marrëdhëniet e fqinjësisë dhe vendimmarrja kolektive në lagjet e pafavorizuara.

Lëvizja demografike, e cila i dha mundësi një grupi social të *pushtojë* territore të reja, ishte një sfidë për të zhvendosurit në këto lagje të pafavorizuara të Kukësit, të cilët reflektojnë nivel të ndryshëm ekonomik. Marrëdhëniet imediate që duhet të ndërtohen janë brenda lagjes dhe përtej asaj, me pritësit e tyre, pronarët e tokave ku ata kanë vendosur banesat etj., por kjo marrëdhënie duhet të ndërtohet tashmë edhe me institucionet vendore, duke filluar me Gjendjen Civile, sportelet qiramarrëse për taksa dhe detyrime të ndryshme në rast se duhet të përfitosh nga shërbimet që ofron qeverisja vendore dhe të pranohesh

brenda *normave* të grupit pritës etj.

Banorët e “vjetër” të qytetit, janë ata që kanë gjithnjë më shumë akses në shërbime dhe influencë në vendimet që merren, për investimet të cilat ndikojnë në zhvillimin urbanistik dhe krijimin e lehtësirave për qytetarët. Ndërsa “të sapoardhurit” janë idividë tepër aktiv, kërkues të rinj për punë, plot me energji fizike dhe morale. Ata kërkojnë

të gjejnë me çdo kusht vendin e tyre në jetën shoqërore të qyteteve, pikërisht brenda një realiteti që, shpesh, është armiqësor me ta dhe shtypës ndaj tyre” (Fuga, 2004:33).

Meqenëse ky studim lidhet me një pjesë të rajonit të Veriut, vlen për tu theksuar fakti se marrëdhëniet e fqinjësisë konsiderohen si shumë të rëndësishme për malsorin. Nevojat për njëri-tjetrin në mëhalla të varfëra më së shumti, e bën të ndërvarur dhe krijon marrëdhënie bashkjetese në grupet komunitare të këtyre lagjeve. Përderisa *grupi shtëpiak* sikurse e përshkruan Weber nuk i përmbush gjithnjë nevojat e përditëshme, por këto nevoja “në raste të veçanta gjatë fatkeqësive dhe gjendjeve kritike, përmbushen nga veprimi përtej komunitetit shtëpiak individual: nga ndihma e fqinjëve” (Weber, 2004:92).

Marrëdhënia midis familjeve të cilat kanë pak a shumë të njëjtin nivel ekonomik vjen e forcohet gradualisht brenda lagjes, duke njohur ngadalë fqinjët përreth. Ky lloj *integrimi i brendshëm* duhet që të përcaktojë dhe të pranojnë qëllime të përbashkëta për ndërmarrje kolektive, që të kenë ndërveprime midis anëtarëve të grupit (Schnapper, 2008:47). Secili individ apo familje është i/e detyruar të pranojë pjesmarrjen në një komunitet të panjohur, të ri dhe me rregulla të reja. Kjo vlen edhe banorët e ‘vjetër’ të cilët duhet të përshtaten me banorët e rinj, pasi duhet t’i pranojnë fqinjët e rinj, të mendojnë për vendimmarrje të përbashkët dhe qëllime të përbashkëta. Kështu, marrëdhëniet në këto lagje të varfëra fillojnë e bëhen një *ndihmë reciproke* (Weber 2004). Këto marrëdhënie marrin formë të ndryshme në varësi të vendbanimit; në lagjet e varfëra, periferike dhe zonat rurale është më e zhvilluar se në qytetet moderne. Fqinjësia e mirë në komunitetet e vogla dhe në zonat e varfëra konsiderohet një virtut, paçka se nuk flitet hapur për një *varësi reciproke*.

Shkaqet dhe pasojat e lëvizjes demografike

Migrimi është ndoshta fenomeni i vetëm politik, social dhe ekonomik më i rëndësishëm në vendin tonë pas rënies së sistemit komunist në vitin 1991, i cili ka qenë një faktor dominues në krijimin e zonave informale, eksportimin e papunësisë brenda vendit dhe jashtë tij duke ndikuar drejtpërdrejt në përjashtimin social të lagjeve informale. Deri në vitin 2001 afërsisht 900 000 persona migruan drejt zonave urbane në brendësi të vendit

“Të ardhurit kanë përfituar më shumë se ju takon. Kanë zaptuar hapësirat dhe pronat tona dhe prapë kërkojnë favore. Ata kanë edhe fshatin edhe qytetin, ndërsa ne skemi gjë tjetër, prandaj qytetarëve të vjetër autoktonë u takon të kenë më shumë akses në shërbime. Investimet duhet të kryhen fillimisht në qytet për të vazhduar pastaj drejt periferisë” shprehet një banor.

gjithashtu edhe drejt vendeve të tjera. (INSTAT, 2004:10). Kjo për pasojë zvogëloi numrin e popullsisë në zonat rurale, dhe rriti përqendrimin e tyre në zonat urbane. Migrimi i brendshëm ka ndodhur brenda rajonit/qarkut dhe ndër-rajonal. Përqindjen më të madhe e zë lëvizja demografike ndër-rajonale që është brenda vendit, dhe kryesisht lëvizja më e madhe i përket zonë verilindore. Kukës me tregues migrimi që arrin 34% të popullsisë së këtij Qarku, duke u drejtuar kryesisht drejt rajonit qendror dhe bregdetar gjithashtu edhe brenda vetë qarkut gjithashtu.

Migrimi ishte ndoshta mjeti më i rëndësishëm për të luftuar varfërinë e familjeve fshatare i cili ka shërbyer për të shkarkuar papunësinë dhe problemet e tjera ekonomike. Ndërsa, migrimi drejt lagjeve më të varfëra periurbane ka rritur varfërinë e këtyre zonave duke shtuar në të njëjten kohë edhe presion mbi shërbimet bashkiake, të cilat edhe pa migrim kanë deficiencë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të tyre. Zhvendosja e popullsisë së këtyre zonave drejt zonave urbane dhe qendrore të vendit ka ndodhur për shkak se shumica e popullsisë ishte e përqendruar në bujqësi, e cila nuk siguronte të ardhura të mjaftueshme për familjen. Kjo lëvizje u shkaktua edhe për shkak të mundësive për shkollim të fëmijëve dhe infrastrukturës së shkatërruar dhe të munguar në zonat e varfëra. Në vitin 2001 rrethi i Kukësit me 96 fshatra pati një popullsi prej 69 mijë banorësh, nga 89 mijë në vitin 1991 dhe nga 17 shkolla të mesme numri ra në 9 të tilla⁷.

Konkluzione

Trajtimi i çështjes së përjashtimit social në lagjet e pafavorizuara është një problem shumë kompleks dhe i pandarë nga institucionet vendore dhe qendrore, gjithashtu edhe nga vetë shoqëria në përgjithësi, e për pasojë përfundimet që dalin nga ky studim u adresohen pikërisht të gjithë këtyre aktorëve dhe zonave të marra si objekt studimi. Përmes pohimeve dhe argumentave të mësipërm ne përforcojmë hipotezën se përjashtimi social ndikohet nga faktorë ekonomike, politikë dhe kulturor. Të dhënat e mbledhura përmes grupeve të fokusit me banorët e lagjeve dhe intervistat me zyrtarët e shërbimeve sociale zbulojnë se:

Së pari, ka fenomene të lëvizjes demografike, që shkaktojnë përplasje kulturore mes banorëve; së dyti, ka indiferencë të institucioneve të shtetit në nivel lokal dhe qendror përgjatë viteve të tranzicionit, në shpërndarjen e investimeve dhe mungesë vëmendje politike dhe strukturash efektive për të luftuar përjashtimin social; së treti, vetë banorët e këtyre lagjeve, nuk organizohen dhe nuk interesohen për të mbrojtur të drejtat e tyre, apo për tu bërë pjesë e vendimarrjes në nivel vendor, për shkak se shqetësimi kryesor i tyre është siguri i të ardhurave për familjet e tyre, duke penguar mospjesëmarrjen në vendimarrje. Së katërti, mungesa e arsimit cilësor dhe

të kualifikuar, krijon pengesa kulturore për pjesëmarrje në jetën komunitare.

Këto gjetje synojnë të ndihmojnë adresimin tek aktorët përgjegjës dhe gjetjen e mekanizmave efektive për trajtimin e tij. Gjithashtu, trajtesa kishte për qëllim të kthejë në vëmendje përjashtimin social si objekt studimi për hulumtuesit e rinj, duke u mbështetur tek të dhënat dhe gjetjet e këtij studimi. Përjashtimi social në lagjet e pafavorizuara në qytetin e Kukësit është çështja e trajtuar në këtë punim, e cila kalon nëpër etapat e: *varfërisë*, si elementi kryesor, me të cilin identifikohet ky përjashtimi social, për të kaluar në aspektin kulturor, *bashkjetesën dhe stereotipet* si pengesë për integrimin e të përjashtuarve, *pjesëmarrjen në vendimarrje* si një mjet për të ndikuar në hartimin e politikave efektive dhe krijimin e aksesit si aktorë realë në jetën komunitare për të përmbyllur me *lëvizjen demografike* duke argumentuar faktin se ka ndikuar në përjashtimin social duke sjellur në një territor të ngushtë dy fenomene të ndryshme, popullimin për një lagje dhe braktisjen për një tjetër. Të dhënat nga terreni na bëjnë të mendojmë se faktorët e përjashtimit social, sikurse i parashtruam pak më sipër, janë vërtet ekonomike, politike dhe kulturore, dmth, në rast se heqim një nga këto faktorë nuk do të kemi më përjashtim social, por mund të ketë një fenomen tjetër.

Pas kësaj trajtese, rekomandimet që mund t'u bëhen institucioneve vendore dhe atyre të ministrive të linjës mund të jenë:

Së pari, të vihen në zbatim metoda moderne për konsultim publik dhe pjesëmarrja qytetare në shpërndarjen e shërbimeve në nivel lokal, për shërbime të tilla si strehimi, edukimi dhe shëndeti, me qëllim arritjen e grupeve historikisht të përjashtuar. Ka dy mënyra për të arritur përfshirjen e të varfërve dhe të përjashtuarve: a) duke punuar me drejtuesit e komunitetit, dhe b) përmes OJQ-ve, të cilat mund të jenë më afër me të përjashtuarit social.

Së dyti, të ndërfiten veprime dhe programe efektive politikash realiste dhe të realizueshme sipas komuniteteve në nevojë. Së treti, të rritet pjesëmarrja politike dhe përfaqësim interesash nga vetë grupet e përjashtuara, me orientim drejt edukimi profesional, akses në informacion për të rritur mundësinë e punësimit. Së katërti, të ketë më shumë informim të pjesëmarrësve mbi rezultatet dhe ndikimin e përfshirjes së tyre. Kjo për të shmangur lodhjen nga konsultimet, si dhe për të ndërtuar besimin reciprok, duke i bërë të bindur se nuk e humbën kohën kot gjatë pjesëmarrjes në shpërndarjen e shërbimeve dhe se sugjerimet e tyre nuk do të manipulohen. Së fundmi, nevojitet ndërtimi i kapaciteteve dhe specializimi i asistencës teknike në lidhje me kryerjen e proceseve të konsultimeve dhe të pjesëmarrjes si për zyrtarët shtetërorë, ashtu dhe për qytetarët.

Bibliografia

Atkinson, A.B. and Hills, J. (1998). *Exclusion, Employment and Opportunity*, LSE STICERD Research Paper No. CASE004. Available at SSRN: <http://ssrn.com/abstract=1158895> (u pa dt: 3 Gusht 2010).

⁷ Informacioni nga intervista me specialistin e zyrës së qeverisjes vendore në Prefekturën e Kukësit.

Berry, B. (1998), *Social Exclusion, Social Isolation and the Distribution of Income*
 Castel, R., (2003). *From manual workers to wage labours. Transformation of the Social question*. Neë Brunswick, NJ: Transaction Publishers.
 Council of Europe, (2007) *Towards an active, fair and socially cohesive Europe. Report of high Level task force on social cohesion in the 21st Century, Executive Summary*
 Dovi, S. (2004). *Making Democracy Work for Women*. http://americandemocracy.nd.edu/assets/11303/dovi_conference.pdf
 Fuga, A. (2004) *Shoqëria Periferike*, Tiranë: Ora
 Guilly, C dhe Noye, C., (2004). *Atlas des nouvelles fractures sociales en France*, Paris, http://www.cafe-geo.net/article.php3?id_article=366&var_recherche=%E9lectorale (u pa dt. 23 Prill 2010)
 Hills, J., Le Grand, J., Piachaud, D. (2002) *Understanding Social Exclusion*, New York: Oxford University press.
 Hurst, Ch.E. (2007). *Social Inequality: Forms, Causes and Consequences*. Boston: Person Education, Inc.
 INSTAT, BB, UNDP, (2008) *Shqipëria: Trendi i Varfërisë 2002-2005-2008. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës*.
 Le Grand, J. (1991) *Equity and Choice*, London: Harper Collins.
 Levitas, R., Pantazis, C., Fahmy, E., Gordon, D., Loyd, E., and Patsios, D. (2007) 'The multi-dimensional analysis of social exclusion' Social Exclusion Task Force.
 Massey, D. (1998), *The Spatial Construction of Youth Cultures* in T. Skelton and G. Valentine (eds), *Cool Places: Geographies of Youth Cultures*, New York: Routledge.
 MPÇSSHB (2006) "Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013", Tiranë.
 Myers, D.G, (2003) *Socialpsikologjia*, Tiranë: Uegen.
 Pierson, J., (2010) "Tackling Social Exclusion", Oxford: Routledge.
 Power, A and Tunstall, R. (1997) *Dangerous Disorder: Riots and Violent Disturbances in Thirteen Areas of Britain, 1991-92*, York: Joseph Roëntree Foundation.
 Schnapper, D. (2008), *Bashkësia e qytetarëve*, Tiranë: Dituria
 Thornton, S., (1995), *Club Cultures: Music, Media and Subcultural Capital, Polity*, Cambridge: Polity Press
 UNDP, (2004) "Strategjia e Zhvillimit të Qarkut të Kukësit", Tiranë.
 UNIFEM, (2010) Mapping of Economic Aid - Kukës.
 Walter, A. And Pohl, A. (2005) "Thematic Study on Policy Measures Concerning Disadvantaged Youth' European Commission", *DG Employment and Social Affairs in the framework of the Community Action Programme to Combat Social Exclusion 2002-2006*
 Weber, M. (2004) *Studime Sociologjike*, Tiranë: Plejad.
 Williams, R. (1976), *Keywords: A Vocabulary of Culture and Society*, London: Fontana.
<http://www.instat.gov.al/> [vizituar në 10/01/12]

Qasjet politikëbërëse për grupet e skajuar: kufijtë e ligjërimit në hapësirën publike për "fëmijët në situatë rruge"

Dokt. Blerjana Bino¹

Abstrakt. Ky artikull trajton një nga fenomenet më shqetësuese të shoqërisë bashkëkohore shqiptare, atë të "fëmijëve të rrugës" apo në situatë rruge. Qëllimi parësor i këtij projekti kërkimor është që të analizojë kuadrin konceptual për "fëmijët e rrugës", që qëndron në themel të programeve ndërhyrëse të qeverisë shqiptare dhe organizatave joqeveritare për përfshirjen në arsim të këtij grupi. Ky hulumtim bazohet në metodologji cilësore dhe veçanërisht në analizën kritike të ligjërimit për të shqyrtuar të dhënat cilësore të mbledhura përmes analizës së dokumentacionit dhe intervistës së thelluar. Artikulli e ka pikënisjen të qasja se fëmijëria është një proces i ndërtuar shoqërisht, i cili varet nga konteksti kulturor, social dhe historik në të cilën ndërtohet si dhe në një kuadër teorik për një konceptualizim të fëmijëve si aktorë shoqërorë me të drejtat dhe liritë e tyre. Studimi tregon se ka dy qasje kryesore në politikëbërje në Shqipëri në lidhje me "fëmijët në situatë rruge": (i) modeli korrigjues i politikëbërjes që nënkupton masa shtrënguese për "normalizimin" e mënyrës së jetesës së fëmijëve; dhe (ii) modeli i politikëbërjes, i orientuar drejt rehabilitimit dhe mbrojtjes ku fëmijët konsiderohen si viktimë. Analiza kritike e ligjërimit tregon se mënyra sesi ligjërohet për "fëmijët e rrugës" dhe ndërtimi shoqëror i këtij fenomeni dhe grupimi sjell natyralizimin e privimit social dhe stigmatizimin e familjeve të varfra duke ndikuar kështu në përjashtimin dhe tëhuajësimin shoqëror të "fëmijëve të rrugës" dhe familjeve të tyre. Kështu është i nevojshëm rikonceptimi i termit "fëmijët e rrugës", duke marrë në konsideratë fëmijën si aktor social me të drejta të plota dhe në gjendje të reflektojë e të vendosë për të mirën dhe interesin e vet; po ashtu është i nevojshëm rikonceptimi i marrëdhënies

¹ Blerjana Bino është doktorante në Universitetin Europian të Tiranës dhe hulumtuese shkencore pranë Qendrës UET.

² * Termi "fëmijët e rrugës" – "street children" - është shumë i kontestueshëm dhe pjesë e këtij studimi do të jetë edhe shtjellimi i mënyrës së përdorimit të termit dhe implikimeve në ligjërimin në hapësirën publike. Përdorimi i thonjëzave nënkupton vështirësinë në gjetjen e një termi për të përshkruar fenomenin me një gjuhë neutrale dhe pa konotacione diskriminuese.

së tij me familjen si dhe ndërlidhjen me hapësirat e rrugës; ndërtimin e identitetit dhe proceset e socializimit etj. Kërkimi i mëtejshëm duhet të synojë jo vetëm analizën e fenomenit, shkaqet dhe pasojat e tij negative, por edhe kuptimin e proceseve të socializimit, rezistencës dhe ndërtimit të identiteteve të fëmijëve në hapësirat e rrugës.

Hyrje

Studimet tregojnë se perceptimet për “fëmijët e rrugës” kanë një natyrë të dyfishtë: ata herë shihen si viktimë të dhunës dhe kushteve ekstreme të varfërisë dhe herë të tjera shihen si keqbërës dhe rrezik për pjesën tjetër të shoqërisë (Connolloy & Ennew, 1996). Në këtë projekt kërkimor “fëmijët e rrugës” dhe lidhjet e tyre familjare konceptualizohen si një grup i skajuar që përjeton përjashtim social dhe politik, pabarazi ekonomike dhe pabarazi në shpërndarjen e vlerave në shoqëri. Përcaktimi nëse një grup është i skajuar apo jo lidhet edhe me mënyrën sesi perceptohet ky grup nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe cili është perceptimi që grupi ka për veten (Williams, 1998: 16). Ky përjashtim dhe këto pabarazi riprodhohen përmes praktikave sociale dhe institucionale si dhe përmes ligjërimit diskriminues dhe përjashtues. Skajimi dhe përjashtimi kanë pasoja negative për zhvillimin socio-psikologjik si dhe për vetërealizimin e “fëmijëve të rrugës”. Një dimension i rëndësishëm këtu është arsimi, i cili është një aspekt themelor për vetëpërmbushjen individuale, ashtu sikurse edhe për zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Në këtë kuptim, arsimi përbën jo vetëm një të drejtë themelore të çdo fëmije, por njëkohësisht edhe një instrument për “fëmijët e rrugës” për të përmbushur aspiratat individuale dhe për t’u vetërealizuar. Qëllimi parësor i projektit kërkimor, mbi të cilin bazohet ky artikull, është që të analizojë kuadrin konceptual për “fëmijët e rrugës” **që qëndron në themel të programeve ndërhyrëse të qeverisë shqiptare dhe organizatave joqeveritare për përfshirjen në arsim të këtij grupi. Ky projekt kërkimor synon të analizojë mënyrën sesi** “fëmijët e rrugës” si koncept ndërtohet shoqërisht përmes ligjërimit dhe sesi ligjërimi dhe ndërtimi shoqëror ndikon më pas në hartimin e programeve ndërhyrëse të përfshirjes në arsim dhe në fenomenin shumë dimensional të “fëmijëve të rrugës”. Bazuar në gjetjet e projektit kërkimor, ky artikull analizon ligjërimin në hapësirën publike mbi “fëmijët e rrugës” të cilët zbulohen në programet ndërhyrëse për përfshirjen e “fëmijëve të rrugës” në arsim.

Kompleksiteti i përcaktimit të termit “fëmijët e rrugës”

Ekzistenca e fëmijëve në rrugë është treguesi më i qartë i pabarazive shoqërore që karakterizojnë shoqërinë bashkëkohore si në vendet të konsideruara të zhvilluara edhe në vendet të ashtuquajtura në zhvillim (Lucchini, 1996; Thomas

de Benitez, 2008). Fenomeni i “fëmijëve të rrugës” është i njohur si në fushën e politikëbërjes, ashtu edhe në atë të kërkimit shkencor (Punch, 2002; Thomas de Benitez, 2008). Megjithatë, literatura bashkëkohore nuk njeh një përkufizim të qartë e të gjithëpranuar në lidhje me konceptin e “fëmijëve të rrugës”. Kjo sepse përkufizimet shpesh ndërtohen në mënyrë të tillë që të mbartin qëllime dhe konotacione politike si p.sh. organizatat ndërkombëtare apo kombëtare mund të priren të ekzagjerojnë fenomenin me synim përfitimin e burimeve financiare më të mëdha (Aptekar & Abebe, 1997: 478). Së dyti, mungon një përkufizim i qartë dhe i gjithëpranuar edhe për shkak të etnocentrizmit kulturor dhe sistemit të referimit që përdoret për të përcaktuar “fëmijët e rrugës”. Problemi qëndron në përpjekjen për të përkufizuar “fëmijët e rrugës” nisur nga modeli i familjes së shtresës së mesme në vendet e zhvilluara perëndimore (Ennew, 2003). Mungesa e një përkufizimi të gjithëpranuar sjell përdorime të ndryshme të termit në kontekste të ndryshme si në kërkimin shkencor edhe në politikëbërje.

Fenomeni i “fëmijëve të rrugës” është ndërkombëtarizuar tashmë qysh nga publikimi i një studimi fillestar në vitin 1981 nga Peter Taçon-i, përfaqësues i UNICEF-it. Në literaturë njihen një numër i madh studimesh në lidhje me këtë fenomen dhe ligjërimi për “fëmijët e rrugës” është bërë pjesë e politikëbërjes, kryesisht në formën e përshkrimit të realiteteve në të cilat jetojnë me miliona fëmijë në mbarë botën (De Moura, 2002: 354). UNICEF-i i klasifikon ata në dy kategori: *fëmijë që punojnë në rrugë*, pra jetojnë me familjet e tyre, por e kalojnë shumicën e ditës në rrugë duke u përfshirë në aktivitete pune dhe *fëmijë që jetojnë në rrugë*, për të cilët “shtëpia” është rruga dhe që jetojnë të pavarur dhe të shkëputur nga familja apo supervizimi dhe kujdesi i të rriturve (De Moura, 2002: 358). UNICEF-i në këtë mënyrë merr përsipër të kategorizojë një grup specifik në shoqëri, pavarësisht dinamikave dhe kompleksitetit të tij dhe sugjeron përmes këtij kategorizimi një teori lineare shkak-pasojë të procesit të shndërrimit në një “fëmijë të rrugës”, bazuar në shkallën e lidhjes me familjen. Kësisoj, si pasojë e problemeve makroekonomike në shoqëri, të shprehura përmes varfërisë ekstreme të shoqëruar me lëvizje të brendshme urbane, migracion, rritje të nivelit të dhunës dhe abuzimit me gratë/fëmijët/grupet vulnerable, kemi të bëjmë me shkatërrimin apo mosfunksionimin e familjes nukleare tradicionale dhe me shembje të vlerave dhe normave të komunitetit. Ky zinxhir linear sjell më pas fenomenin e fëmijëve që punojnë dhe/ose jetojnë në rrugë.

Në analizën e tij për identifikimin e modeleve të përshkrimit, karakterizimit dhe shpjegimit të origjinës së fenomenit të “fëmijëve të rrugës”, De Moura (2002) argumenton se mënyra sesi flitet për fëmijët e rrugës natyralizon deprivimin e tyre social dhe stigmatizon familjet dhe fëmijët e varfër, por dhe çon në programe e politika ndërhyrëse, të cilat mbështesin *status quo*-në e pabarazive shoqërore. Sipas tij, koncepti i “fëmijëve të rrugës” është i ndërtuar përmes ligjërimit dhe kjo sjell implikime jo vetëm në portretizimin e fëmijëve të rrugës, por edhe për politikat

ndërhyrëse dhe vetë jetën e këtij grupi. Ndërtimi shoqëror i “fëmijëve të rrugës” përbën një instrument të rëndësishëm, i cili udhëheq hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave sociale dhe programeve ndërhyrëse. Edhe pse në literaturë, kërkime shkencore dhe, shpesh, në politikëbërje mund të pranohen mospërputhjet ose vështirësitë e gjetjes së një përkufizimi të përshtatshëm për këtë fenomen, termi “fëmijët e rrugës” mbetet gjithsesi i përdorur si një mjet për të pranuar ekzistencën e problemit, identifikimin e nevojave të këtij grupimi dhe zbatimin e politikave dhe programeve ndërhyrëse (Epstein, 1996; Ennew, 1996). Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i Këshillit për të Drejtat e Njeriut me rezolutën 16/12 i referohet këtij grupi heterogjen si “fëmijë në situatë rruge”. Ky projekt kërkimor nuk nisët nga një përkufizim i paracaktuar për fenomenin e “fëmijëve të rrugës” në Shqipëri, por përpiket të zbulojë dhe analizojë sesi përshkruhen dhe conceptualizohen “fëmijët e rrugës” në programet ndërhyrëse të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, duke u ndalur te politikat dhe programet arsimore. Ky studim qaset ndaj qëndrimit se ligjërimi nuk është një reflektim asnjans i realitetit ose fenomeneve shoqërore, por përbën një numër interpretimesh përmes së cilave ndërtohet objekti nën vëzhgim. Ligjërimi në këtë mënyrë ndikon perceptimet e publikut rreth një fenomeni të caktuar, ashtu sikurse edhe programet ndërhyrëse të organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

Kuadri konceptual: ndërtimi shoqëror i shumësisë së fëmijërive

Në studimet për fëmijërinë, James dhe James (2001) ofrojnë një model për të kuptuar ndërtimin shoqëror të shumësisë së fëmijërive që ndeshen në shoqërinë bashkëkohore. Ata paraqesin nocionin e fëmijërisë si një kategori e ndërtuar shoqërisht në kultura të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, pra fëmijëria e parë si një ndërthurje mes kontekstit kulturor, praktikave shoqërore dhe proceseve politike. Gjithashtu, ata theksojnë edhe rolin e ligjit si një trupëzim institucional i praktikave shoqërore në ndërtimin dhe në rregullimin e fëmijërisë (James, 2010: 487). Kjo qasje thekson dimensionin e shumësisë së kuptimeve për fëmijërinë dhe diversitetit të fëmijërisë si dhe argumenton se nuk mund të flitet për një përvojë unike të fëmijërisë, por për fëmijëri në numrin shumë. Në studimet për fëmijërinë, autorë të tjerë (Qvortrup, 2008) e kundërshtojnë këtë përqendrim te shumësia e fëmijërive dhe theksojnë rëndësinë që duhet t'i kushtohet universalitetit të fëmijërisë si një kategori shoqërore. Duke qenë se kjo qasje e konsideron fëmijërinë si një kategori shoqërore dhe si pjesë e pandashme e strukturës së shoqërisë, ajo thekson më tepër dimensionin e ngjashmërisë të fëmijërisë. Ky i fundit i referohet atyre elementeve që janë të ngjashme për të gjithë fëmijët në të gjithë botën nisur nga pozicioni i fëmijës në strukturën e shoqërisë dhe nga marrëdhëniet mes gjeneratave. Shqetësimi është se duke e vënë theksin te pluraliteti dhe te diversiteti i

fëmijërisë/ve mund të nënvlerësohet pushteti politik që mbart fëmijëria si kategori shoqërore për të analizuar dhe për të përcaktuar pozicionin e fëmijëve përkundrejt të rriturve dhe për të siguruar zbatimin me efektivitet të të drejtave të fëmijëve dhe garantimin e mirëqenies së tyre (James, 2010: 489). Për këtë arsye, është e nevojshme të nënvizohen ngjashmëritë mes fëmijëve dhe jo ndryshimet e tyre nga një kontekst në tjetrin (Qvortrup, 2008). Megjithatë, qasja e parashtruar nga James dhe James (2001) është më e përshtatshme për studimet për fëmijërinë pasi lejon hapësira për t'u dhënë zë pikëpamjeve dhe përvojave të fëmijëve si individë në kontekste kulturore, shoqërore e politike të ndryshme.

Ky projekt kërkimor bazohet në një kuadër teorik për një konceptualizim të fëmijëve si aktorë shoqërorë me të drejtat dhe liritë e tyre (Boyden & Ennew, 1997; Beazley, 2001). Në këtë pikëpamje, fëmijëria është një proces i ndërtuar shoqërisht, i cili varet nga konteksti kulturor, social dhe historik në të cilin ndërtohet dhe për më tepër është hapësira publike shoqërore ajo që përcakton sesi jetohe dhe perceptohet (James & Prout, 1998). Ky kuadër konceptual për fëmijërinë nënkupton që projektet kërkimore ose programet ndërhyrëse për “fëmijët e rrugës” duhet të kenë një qasje pjesëmarrëse dhe dinamike që merr në konsideratë diversitetin e profileve të tyre, kompleksitetin e mënyrave të jetesës së këtij grupi të skajuar, mobilitetin e konsiderueshëm, kontekstin shoqëror e kulturor si dhe mjedisin që ndryshon vazhdimisht. Një kuadër i tillë konceptual është i rëndësishëm pasi shmang nxjerrjen e përfundimeve përgjithësuese për fenomenin e “fëmijëve të rrugës”. Kështu, hapësira e “rrugës” luan një rol kyç për shqyrtimin e proceseve shoqërizuese të fëmijëve të rrugës dhe për mënyrat sesi ndërtojnë identitetet e tyre. Për këtë është e qenësishme analiza e marrëdhënies së fëmijëve me “rrugën”. Megjithatë, “rruga” merr kuptime të ndryshme në zona urbane të ndryshme (Lucchini, 1996) dhe, për më tepër, kuptimi i “rrugës” ndryshon nga një kontekst kulturor në tjetrin (Connolly and Ennew, 1996: 142). Prandaj, ky projekt kërkimor është i kujdesshëm që të marrë në konsideratë kontekstin kulturor dhe karakteristikat urbane në analizën e fenomenit.

Një pikëpamje alternative për ligjërimet rreth “fëmijëve të rrugës” është ajo e bazuar në qasjen antiesencialiste sipas së cilës ligjërimet janë produkte shoqërore të krijuara dhe mbështetura nga veprimtaria shoqërore në një kontekst të caktuar (De Moura, 2002: 354). Një konceptualizim i tillë i ligjërimeve të jep mundësinë që ato të përbëjnë një objekt studimi në vetvete. Ligjërimi i referohet “*kuptimeve, metaforave, përfaqësimeve, imazheve, historive, narrativave, pohimeve etj.*, që së bashku prodhojnë një version të një ngjarjeje” (Burr, 1995: f. 48). Në këtë kuptim, ligjërimet përshkruajnë jo thjesht botën fizike ose materiale apo realitetin shoqëror, por ky realitet shoqëror dhe fenomenet që e karakterizojnë ndërtohen përmes ligjërimit. Kësisoj “fëmijët e rrugës” si fenomen apo si kategori shoqërore janë të ndërtuar shoqërisht nga ligjërimet e aktorëve të ndryshëm shoqërorë, të cilët janë pjesë e të njëjtit kontekst kulturor e historik (Burr, 1995; De Moura,

2002; Ennew, 1996). Për më tepër, pikëvështrime dhe interpretime të ndryshme për botën sjellin lloje të ndryshme veprimesh shoqërore. Në këtë kuptim, ndërtimi shoqëror i fëmijëve të rrugës çon në lloje të caktuara politikash ndërhyrëse. Një konceptualizim i tillë bazohet në qasjen sipas së cilës gjuha jo vetëm reflekton realitetin, por e krijon atë: “*gjuhë të ndryshme prodhojnë vlera, kuptime dhe përvoja të ndryshme*” (Howe, 1994: 522). Ndikimi i fuqishëm i gjuhës në politikat sociale dhe programet ndërhyrëse për grupet e skajuar është tashmë i njohur në literaturë dhe në kërkimin shkencor (De Moura, 2002: 355). Ndërtimi shoqëror i fenomenit të “fëmijëve të rrugës” përmes gjuhës dhe ligjërimit është një strategji diskursive e fuqishme për të ndërgjegjësuar qeverinë apo aktorë të tjerë në shoqëri për ekzistencën e këtij grupimi heterogjen dhe për vështirësitë e kushteve të tyre të jetesës. Megjithatë ky ndërtim shoqëror përfaqëson shumë më tepër sesa thjesht një përshkrim të këtij fenomeni shoqëror. Ndërtimi i një skeme kategorizuese për të shpjeguar fenomenin, i përshkruan fëmijët e rrugës dhe familjet e tyre, bazuar në vlerat morale të shoqërisë perëndimore dhe konceptualizimin e këtij grupimi si të izoluar nga pjesa tjetër e shoqërisë, ka implikime të rëndësishme edhe në politika sociale, përfshi këtu edhe ato të arsimit.

Kërkuesit shkencorë, politikëbërësit, media dhe aktorë të tjerë i referohen “fëmijëve të rrugës” si një kategori e paradhënë/përcaktuar në natyrë dhe në mjedisin shoqëror, kategori e cila mund të zbulohet përmes variablave të ndryshëm shpjegues dhe të përfytyrohet dhe përcaktohet përmes investigimeve. Këtyre narrativave u mungon një përkufizim i gjithëpranuar për “fëmijët e rrugës” dhe shpesh kur një përkufizim paraqitet është shumë i gjerë dhe tenton të përfshijë dimensione të ndryshme të këtij fenomeni e më gjerë. Ky studim nuk nis nga një përkufizim i gjithëpranuar për fenomenin e fëmijëve të rrugës, por synon të zbulojë mënyrën sesi përshkruhen, përcaktohen, përkufizohen dhe konceptualizohen këta fëmijë në programet ndërhyrëse të përfshirjes së tyre në arsim. Ky studim përpiket të zbërthejë ligjërimet rreth fëmijëve të rrugës në programet ndërhyrëse të organizatave qeveritare dhe joqeveritare duke u përqendruar në rastin e politikave arsimore. Studimi përpiket që të çmontojë tekstet e këtyre programeve, strategji, politikave për të analizuar mënyrën sesi konceptualizohen fëmijët e rrugës, konceptualizim ky që ndikon më pas në mënyrën sesi hartohen, zbatohen dhe vlerësohen këto politika apo programe ndërhyrëse.

Qasja metodologjike: kërkimi cilësor dhe roli i ligjërimit

Ky projekt kërkimor bazohet te qasja metodologjike cilësore dhe veçanërisht ajo e analizës kritike të ligjërimit (AKL) për të shqyrtuar të dhënat cilësore të mbledhura përmes analizës së dokumentacionit dhe intervistës së thelluar. Ky projekt kërkimor përqendrohet te ligjërimi dhe te ndërtimi shoqëror i kuptimeve,

kocepteve apo fenomeneve të lidhura me përfshirjen në arsim të fëmijëve të rrugës. Në këtë projekt kërkimor, dokumentet kuptohen si të ndërtuar shoqërisht, pra jo thjesht si tekst, por si ligjërim. Në këtë kuptim, dokumentet janë jo vetëm mbartësit e fjalëve, imazheve, informacionit, të dhënave apo përmbajtjes, por ato ndikojnë drejtpërdrejt ndërveprimet njerëzore dhe skemat e organizimit shoqëror (Prior, 2008: 822). Në këtë projekt kërkimor dokumentet do të studiohen jo vetëm nga përmbajtja e tyre, por edhe për nga funksioni i tyre në krijimin e kuptimeve për realitetin shoqëror si dhe në ndikimin që dokumentet si aktorë kanë në praktikën shoqërore dhe në ligjërim. **Të dhënave të mbledhura** nga kjo metodë u shtohen edhe të dhënat e mbledhura përmes intervistave të thelluara me përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare që punojnë për dhe me “fëmijët e rrugës”. Intervistat e thelluara, të përdorura në këtë projekt kërkimor, kanë për qëllim që të zbulojnë mënyrat sesi vlerësohen e kuptohen programet ndërhyrëse për përfshirjen në arsim të “fëmijëve të rrugës” nga aktorë që janë të përfshirë në procese dhe në praktika të ndryshme me këtë grup. Të dhënat cilësore të mbledhura nga zhvillimi i intervistave të thelluara analizohen më pas përmes analizës kritike të ligjërimit për të zbuluar supozimet dhe kuadrin ligjërues për konceptin e “fëmijëve të rrugës” që qëndron në themel të programeve të përfshirjes së tyre në arsim.

Analiza Kritike e Ligjërimit është një metodë kërkimore që mundëson kritikën ndaj dijes së gjithëpranuar dhe një sfidë ndaj koncepteve ose proceseve të marra si të mirëqena duke u ndalur kështu në interpretimet shumëdimensionale të “tekstit” (Fairclough, 2005). Me “tekst” në këtë projekt kërkimor do të kuptojmë dokumentet e marra në shqyrtim si: strategjitë kombëtare, programet ndërhyrëse, planet e veprimit etj., si dhe transkriptet e intervistave. AKL-ja interesohet për mënyrat sesi realiteti, praktikën dhe proceset shoqërore ndërtohen përmes ligjërimit (Fairclough, 1995). Rrjedhimisht, analiza e ligjërimit ndalet tek aftësia e një teksti të caktuar për të përçuar kuptime të shumëfishta në varësi të kontekstit shoqëror e politik si dhe në varësi të marrësit-interpretuesit. Kjo metodë kërkimore interesohet të zbulojë kuptimet e fshehura, implicite në tekst, si dhe mënyrat sesi marrëdhëniet shoqërore, identitetet apo sistemet e dijes ndërtohen shoqërisht përmes ligjërimit dhe sesi ligjërimi ruan marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit si dhe ideologjitë mbizotëruese. Përdorimi i termit “kritik” **në analizën kritike të ligjërimit nënkupton nevojën për të shqyrtuar elementet ideologjike të ligjërimit të cilat janë natyralizuar me kohën dhe trajtohen si të zakonshme, të pranueshme dhe “normale”** (Fairclough, 1995). Në të njëjtën kohë termi “kritik” është një tregues që analiza e ligjërimit nuk ka një natyrë përshkruese, por kritike të teksteve që shqyrton. Analiza kritike e ligjërimit është e nevojshme për të kuptuar kuadrin konceptual për fëmijët e rrugës që qëndron në themel të programeve ndërhyrëse për përfshirjen e tyre në arsim.

Kufizimi kryesor i analizës kritike të ligjërimit si metodë kërkimore është që nuk të mundëson nxjerrjen e përfundimeve përgjithësuese dhe përfaqësuese për të gjithë popullatën teorike. Megjithatë, sikurse argumenton edhe Gill (1996), analiza

kritike e ligjërimit nuk synon të identifikojë ndonjë ligjësi universale, përkundrazi lidhet ngushtë me kontekste politike, shoqërore, kulturore e historike të caktuara. Synimi i këtij projekti kërkimor nuk është gjetja e ligjësive universale, por bërja e një analizë kritike që sfidon konceptet e marra si të mirëqena dhe bazohet te paradigma sipas së cilës fëmijëria është një proces i ndërtuar shoqërisht. Një kufizim tjetër është edhe mungesa e “objektivitetit” të kërkuesit/es shkencorë që përdor analizën e ligjërimit pasi argumentohet se për zgjedhja e objektit kërkimor, përcaktimi i objektivave, metodave apo teorive nuk janë të pavarura nga pozitat social-kulturore të kërkuesit/es, interesave të tyre dhe kontekstit më të gjerë shoqëror në të cilin ata ndodhen (van Dijk, 1993:1). Çështja e objektivitetit të kërkuesve shkencorë është pjesë e një debati të kahershëm në shkencat sociale dhe përshtjellimi teorik i këtij debati qëndron jashtë spektrit të këtij projekti kërkimor. Megjithatë, ky projekt kërkimor bazohet te qasja cilësore, pra te një kuptim i botës sipas të cilit kërkuesi/ja nuk mund të jetë asnjëherë plotësisht i shkëputur nga vlerat, interesat apo mendimet personale, si dhe as nga konteksti në të cilin ndodhet. Kufizimi tjetër i AKL-së është se nuk na tregon asgjë rreth ndikimit të tekstit të marrësi i “tekstit”, pra nuk na tregon për mënyrën sesi ligjërimit dhe kuadri konceptual për “fëmijët e rrugës” në programet ndërhyrëse të përfshirjes së tyre në arsim ndikon këtë grup të skajuar apo fëmijët si individë apo aktorë të tjerë. Për këtë do të duhej përdorimi i metodave të tjera kërkimore si, p.sh., kërkimi pjesëmarrës në veprim me fëmijët e rrugës, etnografia, vëzhgimi, grupet e fokusuara etj. Ky do të përbente fokusin e një projekti tjetër kërkimor edhe më ambicioz, por i bazuar te rezultatet e nxjerra nga analiza kritike e ligjërimit të kuadrit konceptual të “fëmijëve të rrugës” në programet ndërhyrëse të përfshirjes së tyre në arsim.

Përfshirja e “fëmijëve të rrugës” në arsim: konceptualizimi në programet ndërhyrëse të qeverisë dhe të organizatave joqeveritare

Analiza e dokumentacionit tregon se ky fenomen kompleks, edhe pse i njohur si një nga treguesit e pabarazive shoqërore dhe ekonomike dhe i diskriminimit e skajimit të një pjese të shoqërisë bashkëkohore shqiptare, trajtohet kryesisht përmes: (i) legjislacionit për të drejtat e njeriut, kombëtar dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar; dhe (ii) strategjive dhe politikave me bazë të gjerë si: ato të përfshirjes sociale, arsimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Në përputhje me përfundimet e nxjerra nga studimet në vendet e tjera*, analiza e dokumenteve tregon se edhe në Shqipëri mungojnë politika të qeverisë që të adresojnë drejtpërdrejt fenomenin e “fëmijëve të rrugës” si dhe përfshirjen e tyre në arsim. Një nga programet ndërhyrëse të

* Studime të kryera në vendet e Amerikës Latine, Afrikës, Azisë, në Mbretërinë e Bashkuar, Europën Lindore e Qendrore, të përmbledhura në punimin e Thomas de Benitez, 2008, publikuar nga Konsortiumi për Fëmijët e Rrugës.

drejtpërdrejt për përfshirjen e “fëmijëve të rrugës” në arsim është projekti “Shansi i dytë” i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës që synon të “riintegrojë në sistemin arsimor bazë fëmijët e komunitetit Rom që kanë braktisur shkollën ose janë gati ta braktisin atë” (intervistë me përfaqësues të MASH-it). Për të realizuar këtë qëllim, ky projekt është fokusuar te komuniteti Rom si dhe te fëmijët që jetojnë në zona të izoluara dhe më pak të zhvilluara dhe ndërhyrjet kryesore janë të tilla si: *rinovimi i shkollave në zona të prapambetura, ndërtimi i shkollave të reja, shpërndarja e teksteve falas, përgatitja e mësuesve të kualifikuar, klasa me madhësi më të vogël, sensibilizim i prindërve* (intervistë me përfaqësues të MASH-it). “Shansi i dytë” bazohet te subvencionet e qeverisë shqiptare për arsimin dhe është në përputhje me objektivat strategjikë për arsim për të gjithë dhe përfshirjen e fëmijëve të skajuar, por shënjestron vetëm shkolla në zona të caktuara ku mendohet se ka një përqendrim më të lartë të komunitetit rom. Projekti bazohet në diskriminim pozitiv të një grupi të caktuar dhe nga vetë termi, “shans i dytë”, në një ligjërimit racist dashamirës të qeverisë kundrejt komunitetit Rom sikurse do të shohim edhe përmes analizës kritike të ligjërimit.

Strategjitë ose politikat me bazë të gjerë i qasen fenomenit përmes adresimit të nevojave elementare të fëmijëve dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre. Ky model i politikëbërjes i bazuar te konceptualizimi i fëmijëve mbi bazën e nevojave të tyre dhe mbrojtjen e rehabilitimit të tyre nënkupton kthimin e fëmijëve në familjet e tyre dhe në mungesë të familjes vendosjen e tyre në institucione të përkujdesit për fëmijët, qoftë edhe përmes përdorimit të mekanizmave shtrëngues. Përpjekja për të (ri)integruar fëmijët në familjet e tyre apo për t’i vendosur në institucione të përkujdesit sikurse janë edhe qendrat ditore të organizatave joqeveritare nënkupton që “fëmijët e rrugës” konsiderohen si: *të paafte për të vendosur se çfarë është në të mirë të tyre dhe nuk merr në konsideratë dinamikën e marrëdhënies të këtyre fëmijëve me prindërit apo familjarët e tyre, si dhe zhvillimet psiko-sociale të arritura përmes procesit të socializimit dhe punës në hapësirat e rrugës* (ekspert i studimeve për fëmijët). Kësisoj, politikëbërja në lidhje me fenomenin e “fëmijëve të rrugës” dhe përfshirjen e tyre në arsim duket sikur humbet kompleksitetin e stileve të jetesës së fëmijëve, diversitetin e profileve të tyre dhe rolin e marrëdhënies që ata krijojnë me hapësirat e rrugës.

Kërkimet shkencore në lidhje me programet ndërhyrëse për adresimin e fenomenit të “fëmijëve të rrugës” dhe arsimit të tyre tregojnë se ka një mospërputhje mes përvojave të fëmijëve dhe qasjeve apo modeleve të politikave (de Benitez, 2003). Në këtë kuptim, strategjive kombëtare dhe politikave me bazë të gjerë, që rrjedhin prej tyre si politikat për mbrojtjen shoqërore, përfshirjen sociale dhe arsimin, u mungon dimensionin i “fëmijëve të rrugës” si aktorë socialë me të drejta të

* Udhëzimi Nr. 34, datë 08.12.2004 “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

plota, ndërsa programet ndërhyrëse të rigjenerimit urban në nivel vendor priren të kriminalizojnë varfërinë dhe, për rrjedhojë, edhe fëmijët që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë (Ennew, 2003; de Benitez, 2008). Problemi kryesor qëndron në mungesën e lidhjes mes kërkimit shkencor dhe atij të zbatuar me politikëbërjen për adresimin e fenomenit kompleks të “fëmijëve të rrugës”. Edhe në nivelin e politikëbërjes, në fushën e përfshirjes së “fëmijëve të rrugës” në arsim në Shqipëri, vihet re prania e kufizuar e përshtjellimit të konceptit të “fëmijëve të rrugës” dhe lidhja e politikave me kërkimin shkencor e të zbatuar. Programet ndërhyrëse shpesh rezultojnë të pasuksesshme pasi nuk i përgjigjen dinamikave të stileve të jetesës së fëmijëve, diversitetit të profileve të tyre dhe kompleksitetit të marrëdhënies dhe proceseve të socializimit, rezistencës dhe ndërtimit të identiteteve të fëmijëve në hapësirat e rrugës. Krahës përpyekjeve të politikëbërjes për të trajtuar fenomenin, programe ndërhyrëse për përfshirjen e këtij grupi në arsim zhvillohen edhe nga organizata joqeveritare në Shqipëri. Mënyra sesi konceptualizohen fëmijët në këtë rast do të shtjellohet më poshtë.

Rezultatet nga intervistat e thelluara sugjerojnë se politikat ndërhyrëse për “fëmijët e rrugës” dhe për përfshirjen e tyre në arsim, përbëjnë më tepër iniciativë të organizatave joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si dhe ndërhyrje nga qeveria vendore dhe njësitë vendore arsimore. Programet ndërhyrëse të organizatave kombëtare/lokale janë kryesisht sociale, pra adresojnë problemet e socializimit dhe integritetit të fëmijëve të skajuar me pjesën tjetër të shoqërisë duke punuar pranë komuniteteve dhe në projekte të përbashkëta me institucionet lokale dhe ato arsimore. Në këto programe ndërhyrëse për përfshirjen në arsim “fëmijët e rrugës” shihen si *viktima të kushteve social-ekonomike, përkatësisë etnike dhe si një grup që përjeton përjashtim e pabarazi dhe vendoset në skajet e shoqërisë* (intervistë me përfaqësues të World Vision në Shqipëri). Në këtë kuptim, programet ndërhyrëse për përfshirjen e këtij grupi në arsim synojnë së pari të adresojnë nevojat bazë të fëmijëve të lidhura me arsimin dhe të mundësojnë mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë janë bërë hapa drejt përfshirjes së qëllimshme të fëmijëve në këto programe. Kështu, në programet ndërhyrëse për fëmijët, World Vision në Shqipëri ka iniciuar përdorimin e teknikës së Zhvillimit të Aseteve të Fëmijëve sikurse në studimin e kryer në vitin 2008 në lidhje me një vlerësim cilësor të fëmijëve që lypin dhe punojnë në rrugët e Tiranës*. Studimi në fjalë synonte *identifikimin e problemeve aktuale dhe shkaqet e tyre me të cilat ndeshen fëmijët që lypin dhe punojnë në rrugët e Tiranës dhe përdor një metodë cilësore duke i eksploruar problemet nisur nga këndvështrimi i komunitetit dhe jo nga ai i ekspertëve të jashtëm* (intervistë me përfaqësues të World Vision në Shqipëri). Në këtë kuptim ka një përpyekje për t’i konsideruar “fëmijët e rrugës” si *aktorë socialë me të drejta të*

* Për më tepër rreth teknikës së *Child Development Assests* referojuni *Search Institute* dhe *World Vision*.

plota për të vendosur për veten e tyre dhe që janë të aftë të përcaktojnë se çfarë është në interes të tyre, çfarë është e mirë apo e keqe (intervistë me ekspert të studimeve për fëmijët).

Megjithatë, këto përpyekje janë të izoluara dhe nuk i drejtohen në mënyrë të veçantë grupit të “fëmijëve të rrugës”, duke marrë parasysh gjithë diversitetin e profileve të tyre dhe kompleksitetin e fenomenit. Në pjesën dërmuese, programet ndërhyrëse për përfshirjen në arsim ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për fëmijët si dhe ndërtim kapacitetesh për mësuesit dhe edukatorët si dhe sensibilizim të familjes dhe komunitetit (Tamo & Karaj, 2007). Për më tepër programet ndërhyrëse janë të kushtëzuara nga konteksti në të cilin veprojnë organizatat joqeveritare në Shqipëri, pra varësia nga fondet e donatorëve dhe rrjedhimisht ndjekja e prioriteteve të përcaktuara nga donatorët. Rrjedhimisht shpesh këtyre programeve ndërhyrëse u mungon *baza e duhur teorike dhe mbështetja në gjetjet e rekomandimet e kërkimeve shkencore* (intervistë me përfaqësues të World Vision në Shqipëri). Intervistat e thelluara tregojnë se përfaqësuesit e këtyre organizatave pranojnë se është e rëndësishme që programet ndërhyrëse të përfshirjes në arsim dhe planet e veprimit të organizatave joqeveritare të bazohen në studime të aspekteve psiko-sociale të fëmijëve si personaliteti i tyre, proceset e socializimit, ndërtimi i identitetit, marrëdhënia me hapësirat e rrugës, përvojat dhe kuptimi për punën dhe familjen si dhe të merret parasysh kompleksiteti i fenomenit nisur jo vetëm nga etnia dhe statusi social ekonomik, por edhe gjinia, përjetimet emocionale, mosha dhe konteksti.

Ligjërimi për “fëmijët e rrugës” dhe qasjet/modelet e politikëbërjes

Strategjitë kombëtare, planet e veprimit, raportet dhe programet e qeverisë shqiptare dhe të institucioneve përkatëse të linjës kanë të përbashkët konceptualizimin e “fëmijëve të rrugës” në drejtim të statusit social-ekonomik të familjeve të tyre të lidhura me varfërinë, migrimin e brendshëm dhe përkatësinë etnike, p.sh., si: pjesëtarë të komunitetit Rom e Egjiptian në Shqipëri. Gjithashtu, ka një mungesë referimi të drejtpërdrejtë tek termi apo koncepti “fëmijët e rrugës”, me gjithë problematikën e termit në vetvete, si grup i skajuar, me përjashtim të SKF-së dhe një mungesë të shtjellimit të konceptit dhe kuptimeve të tij në kontekstin e shoqërisë dhe politikëbërjes në Shqipëri. Mungesa e referimit të drejtpërdrejtë shoqërohet edhe me një paqartësi në termat e përdorur. Analiza e dokumenteve tregon se në strategjitë, programet ndërhyrëse dhe në politikëbërje ka një përdorim konfuz të termave në lidhje me “fëmijët e rrugës” dhe me përfshirjen e tyre në arsim, p.sh. përdoren në mënyrë të këmbyer dhe pa një shtjellim konceptual terma si: “fëmijë të marginalizuar”; “fëmijë në nevojë”; “fëmijë të familjeve romë”; “fëmijë në vështirësi”; “fëmijë të braktisur”; “fëmijë që punojnë”; “fëmijë të rrugës”. Analiza kritike e ligjëritimit tregon se ky ngatërrim nuk është vetëm çështje gjuhësore, por

tregon vështirësinë e përfshirjes së këtij grupimi në fjalorin e politikëbërjes dhe adresimin e fenomenit përmes analizës së marrëdhënies me hapësirat e rrugës dhe njohjen e fëmijëve si aktorë socialë me të drejta të plota. Paqartësia dhe përdorimi i këmbyer bazohet në “hamendësimet” mbi të cilat funksionon politikëbërja, pra marrja si e mirëqenë e një koncepti, fenomeni apo praktike shoqërore nga ndërvepruesit. Përdorimi i paqartë dhe i këmbyer i termave për fenomenin tregon për vështirësinë e politikëbërjes për të përdorur një term të vetëm për të përshkruar grupin e skajuar të “fëmijëve të rrugës”, por edhe një përpjekje të limituar për të shtjelluar konceptin dhe implikimet që rrjedhin prej përdorimit apo mospërdorimit të tij.

Sipas Ruth Wodak (2004), në hartimin dhe në komunikimin e politikave të caktuara, kur një informacion i ri paraqitet si i hamendësuar, pra si i ditur më parë, i pranuar dhe i mirëqenë, atëherë ka më shumë të ngjarë të mbështetet nga publiku, ndërkohë që nëse një informacion i ri paraqitet në mënyrë eksplicite si i tillë atëherë ngjall më shumë kundërshti dhe kritika. Në këtë kuptim, në strategjitë, programet ndërhyrëse dhe në politikëbërje nuk paraqitet fenomeni në formën e një informacioni të ri, por si një praktikë shoqërore e pranuar dhe e mirëqenë e lidhur me statusin socio-ekonomik dhe përkatësinë etnike. Sikurse argumenton Fairclough (2003), përdorimi i hamendësimeve në politikat arsimore, publike, sociale etj., shërben për të paraqitur supozimet e ngarkuara ideologjikisht si “dije e zakonshme”. Përdorimi i hamendësimeve dhe i elementeve të tjera implicite në një tekst është jo vetëm një mjet i fuqishëm komunikimi, por edhe një instrument për të përçarur përmbajtje të ngarkuar ideologjikisht, vlera dhe qëndrime si diçka e gjithëpranuar (Sbisà, 1999). Në këtë kuptim, analiza kritike e ligjërimit zbulon sesi fenomeni nënkuptohet si një praktikë shoqërore e mirëqenë dhe e gjithëpranuar, duke mos lejuar zgjerimin e kufijve të ligjërimit në hapësirën publike të politikëbërjes drejt shkatërrimit të koncepteve e fenomeneve të marra si “dije e zakonshme”. Për më tepër ky fenomen shihet si një proces linear e organik i lidhur me faktorë socialë-ekonomikë.

Konceptimi i procesit të daljes dhe përfshirjes së fëmijëve në “jetesën në rrugë” si një proces linear dhe organik, pra i paracaktuar nga faktorë natyrorë, si dhe ndërtimi shoqëror i “fëmijëve të rrugës” sjellin “natyralizimin” e deprivimit shoqëror (De Moura, 2002). Kështu mendohet se problemet makroekonomike sjellin migracion të brendshëm të shoqëruar me nivele të larta të varfërisë, e cila shkakton mosfunksionim të familjes dhe, si pasojë, daljen e fëmijëve në rrugë. Kjo skemë lineare dhe organike paraqet një konceptualizim hermetik të fenomenit. “Fëmijët e rrugës” dhe familjet e tyre shihen si grupime të cilëve u mungojnë vlerat dhe normat e shoqërisë dominuese, të cilat janë të pranuar si “normale”. Kjo mënyrë e të menduarit për fëmijët e rrugës shpreh një tëhuajësim të plotë të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe një mungesë të ardhmeje për këtë grupim (De Moura, 2002: 361). Sipas ligjërimit ekzistues për “fëmijët e rrugës”, varfëria dhe jeta në hapësirën

e rrugës janë bërë sinonime të egërsisë dhe mungesës së vlerave morale. Familjet e varfra stigmatizohen dhe karakterizohen si mbartëse të elementeve negative si: abuzimi me fëmijët, alkoolizmi, abuzimi me substanca narkotike etj. Në këtë kuptim, fëmijët janë viktimë të familjeve dhe të rriturve, por, në të njëjtën kohë, edhe mbartës të sjelljeve të padëshiruara dhe të pranuar nga normat shoqërore. Stigmatizimi qëndron në mënyrën sesi familjet e varfra portretizohen si mbartëse apo si kultivuese të korrupsionit moral dhe mungesës së vlerave të botës së civilizuar. Kjo vihet re në përdorimin e termit “të prapambetur” në strategjitë dhe programet ndërhyrëse të qeverisë. Pra, implikimi i dytë i ligjërimit për “fëmijët e rrugës” është stigmatizimi i familjeve të varfra dhe i “fëmijëve të rrugës” duke përjetësuar kështu përjashtimin e tyre shoqëror. Një konceptualizim i tillë kushtëzon më pas edhe qasjet apo modelet e politikëbërjes. Gjetjet e projektit kërkimor tregojnë për dy qasje kryesore në politikëbërje në Shqipëri në lidhje me këtë fenomen: modeli korrigjues dhe modeli i orientuar nga mbrojtja dhe rehabilitimi.

Modeli korrigjues i politikëbërjes, që nënkupton masa shtrënguese për “normalizimin” e mënyrës së jetesës së fëmijëve vihet re te Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit, e cila shënon një riprodhim të ligjërimit diskriminues, përjashtues dhe të një racizmi dashamirës ndaj grupit të skajuar Rom (Hasimja, 2006). Kësisoj në hapësirën publike ka një përpjekje të vazhdueshme për të përcaktuar kufijtë e ligjërimit politik lidhur me grupet e skajuar në Shqipëri, të përqendruara rreth situatës social-ekonomike nën një konceptualizim për “normalizimin” e mënyrës së jetës së romëve. Ligjërimit në hapësirën publike është kufizuar vetëm tek integrimi i romëve në shoqëri sipas modelit të shumicës dhe të përmirësimi i kushteve të jetesës, pa marrë parasysh se zgjidhjet e problemeve janë politike dhe se mungon përfaqësimi politik i romëve. Megjithatë në politikëbërje është pranuar rëndësia e arsimit gjithëpërfshirës dhe për të gjithë jetën dhe gjendet një përdorim i gjerë i konceptit në planet për atë çka pritët të bëhet nga qeveria dhe aktorë të tjerë. Analiza e dokumenteve përmes analizës kritike të ligjërimit zbulon se modelet kryesore të politikëbërjes, në lidhje me përfshirjen në arsim të “fëmijëve të rrugës”, janë ato të orientuara për nga rehabilitimi dhe mbrojtja me përpjekje për t’u orientuar drejt një qasjeje të bazuar tek të drejtat e fëmijëve.

Kështu, Strategjia e Përfshirjes Sociale nënkupton një qasje politikëbërëse rehabilituese apo të mbrojtjes duke iu referuar grupeve vulnerabël, të rrezikuar e të skajuar dhe duke përdorur këto terma si të këmbyeshëm me njëri-tjetrin. Gjithashtu edhe në themel të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët qëndron parimi i mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtje që duhet të garantohet nga familja, qeveria dhe nga institucionet e tjera si shkolla apo organizatat joqeveritare nisur nga veçoritë e moshës dhe papjekuria fizike dhe intelektuale (SKF, 2005: 3). Në strategji vëmendje i kushtohet edhe shprehjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve sipas modelit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

ku synohet pjesëmarrja e fëmijës në jetën e familjes, shkollës dhe shoqërisë. Plani i Veprimit i SKF-së përcakton sigurimin e një sistemi arsimor cilësor dhe veprimet që lidhen me fenomenin e fëmijëve të rrugës janë: përfshirja e fëmijëve romë në kopsht dhe në arsimin e detyruar si dhe zbatimi i projektit të MASH-it “Shansi i dytë”, për fëmijët që kanë braktisur shkollën, fëmijët e ngujuar, fëmijët që punojnë si dhe reduktimi i numrit të fëmijëve që punojnë dhe rikthimi i tyre në shkollë (Plani i Veprimit, SKF, 205: 15). Fëmijët shihen në lidhje me nevojat e tyre dhe programet ndërhyrëse ndërtohen nisur nga adresimi i nevojave të fëmijëve.

Konceptualizimi i programeve ndërhyrëse për përfshirjen në arsim të “fëmijëve të rrugës” në lidhje me nevojat e fëmijëve zbulohet edhe te Ligji për Arsimin Parauniversitar (Nr. 69/2012). Çështja këtu është se kush përcakton se çfarë është në interes të fëmijëve. Legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar ia cakton këtë detyrë qeverisë, familjes, prindërve dhe institucioneve arsimore, por jo fëmijës edhe pse parimisht garanton të drejtën e fëmijëve për t’u shprehur për vendime që i prekin ata (Ennew, 2003). Qasja rehabilituese ose modeli i orientuar për nga mbrojtja e fëmijëve vihet re edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në përcaktimin e të drejtave të tilla si e drejta për arsim dhe zhvillim dhe e drejta për mbrojtje shoqërore, por këtu nuk ka një referim të drejtpërdrejtë për grupin e “fëmijëve të rrugës”. Në përputhje me këtë ligj si dhe me SKF-në, Plani i Veprimit për Fëmijët 2012 – 2015 vë në qendër zbutjen e përjashtimit shoqëror të fëmijëve përmes politikave të gjithëpërfshirjes, arsimimit, dhe nxitjes së qeverisë vendore të hartojë strategji e plane veprimi rajonale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Veç theksit të fëmijët si viktimë dhe mbrojtjes së tyre, ka një përpjekje fillestare për t’i konceptuar ata në lidhje me drejtat më tepër sesa nevojat dhe të përfshihen në procesin e hartimit të programeve ndërhyrëse. Kjo bëhet e mundur më tepër në rastet kur ka një proces konsultimi me organizatat joqeveritare apo institucionet kërkimore*.

Shënime përmbyllëse

Programet ndërhyrëse për “fëmijët e rrugës” dhe për përfshirjen e tyre në arsim përbëjnë më tepër iniciativa të organizatave joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si dhe ndërhyrje nga qeveria vendore dhe njësitë vendore arsimore. Këto programe janë kryesisht sociale, pra adresojnë problemet e socializimit dhe të integritetit të fëmijëve të skajuar me pjesën tjetër të shoqërisë duke punuar pranë komuniteteve dhe në projekte të përbashkëta me institucionet lokale dhe ato arsimore. Programet ndërhyrëse për përfshirjen në arsim të “fëmijëve të rrugës” të organizatave joqeveritare tregojnë për një prirje në

* Sipas intervistës me përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

rritje për të përfshirë aktivisht fëmijët në hartimin e politikave apo në studimet rreth tyre. Megjithatë këto përpjekje janë të izoluara dhe nuk i drejtohen në mënyrë të veçantë grupit të “fëmijëve të rrugës” me gjithë diversitetin e profileve të tyre dhe kompleksitetin e fenomenit. Kështu jo vetëm politikëbërja të informohet nga gjetjet e kërkimeve shkencore në lidhje me fenomenin, por edhe me programet ndërhyrëse të organizatave joqeveritare për përfshirjen në arsim të “fëmijëve të rrugës” kanë nevojë të bazohen në studime të aspekteve psiko-sociale të fëmijëve si personaliteti i tyre, proceset e socializimit, ndërtimi i identitetit, marrëdhënia me hapësirat e rrugës, përvojat dhe kuptimi për punën dhe familjen. Për më tepër është e nevojshme të merret parasysh kompleksiteti i fenomenit nisur jo vetëm nga etnia dhe statusi social ekonomik, por edhe gjinia, përjetimet emocionale, moshë dhe konteksti. Kërkimi i mëtejshëm duhet të synojë jo vetëm analizën e fenomenit, shkaqet dhe pasojat e tij negative, por edhe kuptimin e proceseve të socializimit, të rezistencës dhe të ndërtimit të identiteteve të fëmijëve në hapësirat e rrugës. Për më tepër trekëndëshi politikëbërje, shoqëri civile dhe institucione të arsimit mund të kontribuojnë në ndërtimin e një hapësire politike pjesëmarrëse për “fëmijët e rrugës” dhe të rinjtë e skajuar në mënyrë që të bëhen pjesë e agjendave të zhvillimit dhe politikëbërjes në fusha të tilla si mbrojtja dhe përfshirja sociale, arsimi, drejtësia dhe mirëqeverisja.

Bibliografia

- Aptekar, L. & Abebe, B., (1997) “Conflict in the Neighborhood: Street and working children in the public space”, *Childhood*, Vol. 4, No. 3, pp. 477 – 490.
- Beazley, H., (2001) “Home Sweet Home? Street children’s sites of belonging”, in S. L. Holloway and G. Valentine, (Eds.) *Children’s Geographies: playing, living, learning*, London: Routledge, pp. 194-210.
- Boyden, J., & Ennew, J., (Eds.), (1997) *Children in Focus: A Manual for Experiential Learning in Participatory Research with Children*, Stockholm: Rädda Barnen.
- Burr, V., (1995) *An Introduction to Social Constructionism*, London: Routledge.
- Connolly, M., & Ennew, J., (1996), “Introduction: children out of place”, *Childhood: Special Issue on Working Children*, Vol. 3, No. 2, pp. 131-146.
- De Moura, S.L., (2002) “The social construction of street children: Configuration and implications”, *British Journal of Social Work*, Vol. 32, pp. 353-367.
- Ennew, J., (2003) “Difficult circumstances: some reflections on street children in Africa”, *Children Youth and Environment*, Vol. 13, No. 1, pp. 1-21.
- Ennew, J., (1996) “The Child Business: Comments on the Management of International Policies for Children”, *Journal of International Development*, Vol. 8, No. 6, pp. 849-858.
- Epstein, I., (1996) “Educating Street Children: Some Cross-Cultural Perspectives”,

- Comparative Education*, Vol. 32, No. 3, pp. 289–302.
- Fairclough, N., (2005) “Critical discourse analysis in transdisciplinary research”, in R. Wodak & P. Chilton, (Eds), *A New Agenda in (Critical) Discourse Analysis: Theory, Methodology and Interdisciplinarity*, John Benjamins Publishing Company.
- Fairclough, N., (1995) *Critical Discourse Analysis*, London: Longman.
- Gill, R., (1996) “Discourse Analysis: practical implementation”, in J. T. E. Richardson (Ed), *Handbook of Qualitative Research Methods for Psychology and the Social Sciences*. BPS Blackwell.
- Hasimja, E., (2006) *Les défis de la représentation démocratique en Albanie*. Université Paris 8.
- Howe, D., (1995) “Modernity, Postmodernity and Social Work”, *The British Journal of Social Work*, Vol. 24, pp. 513–532.
- James, A., (2007) “Giving voice to children’s voices: practices and problems, pitfalls and potentials”, *American Anthropologist*, Vol. 109, No. 2, pp. 261–272.
- James, A., & James, A. L., (2001) “Childhood: Toward a Theory of Continuity and Change”, *The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science*, Vol. 575, pp. 25–37.
- James, A., & Prout, A., (1998) *Constructing and Reconstructing Childhood: Contemporary Issues in the Sociological Study of Childhood*, 2nd Edition, London: Routledge.
- Lucchini, R., (1996) “The street and Its Image”, *Childhood*, Vol. 3, No. 2, pp. 235–246.
- Prior, L., (2008) “Repositioning Documents in Social Research”, *Sociology*, Vol. 42, No. 5, pp. 821–836.
- Qvortrup, J., (2008) “Childhood in the Welfare State”, in A. James and A.L. James (Eds) *European Childhoods: Cultures, Politics and Childhood in Europe*, Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Tamo, A., & Karaj, Th., (2007) “Situata Arsimore e Fëmijëve Romë në Shqipëri”, Raport Studimor i financuar nga UNICEF-i dhe Save the Children, Tiranë.
- Thomas de Benitez, S., (2003) “Reactive, protective and rights-based approaches in work with homeless street youth”, *Children, Youth and Environments*, Vol. 13, No. 1, pp. 1–15.
- Van Dijk, T.A., (1993) “Principles of Critical Discourse Analysis”, *Discourse & Society*, Vol. 4, pp. 249–283.
- Williams, M., (1998) *Voice, trust and memory. Marginalized Groups and the Failings of Liberal Representation*, Princeton University Press. Princeton.
- Wodak, R., (2004) “Critical Discourse Analysis”, in C. Seale, G. Gobo, J.F. Gubrium and D. Silverman (Eds) *Qualitative Research Practice*, London: SAGE, pp. 197–213.

Ndërtimi i identiteteve nëpërmjet arkitekturës

Dr. Vera BUSHATI*

MA. Bisej KAPO**

Abstrakti. Ky punim fokusohet dhe ka për qëllim të kuptuarit e ndikimit të artit, në veçanti arkitekturës, në ndërtimin e identiteteve. Në këtë punim arkitektura shihet si tekst nëpërmjet të cilit ne kuptojmë modelimin dhe krijimin e një identiteti të caktuar social dhe nacional. Për të kuptuar këtë rol duhet të kuptojmë se cili është impakti i ndërsjellët midis identiteteve (kolektive, nacionale) dhe arkitekturës? Si modelohen identitetet nëpërmjet arkitekturës? Në çfarë raporti qëndron Arti dhe Arkitektura? A janë këta komplementarë të njëri-tjetrit? Cilat janë imazhet apo elementet e përdorura nga arkitektura për të ndihmuar në përbrendësimin dhe forcimin e një identiteti socio-politik dhe, mbi të gjitha, të një identitet kombëtar? Bazuar në një analizë vizuale ky punim priret të kuptojë atë pjesë të botës fizike të ndërtuar dhe të konceptuar në dhe nga përmasa njerëzore. Analiza në këtë punim do të jetë krabasuese midis periudhës së mbretit Zog me periudhën e sotme të post viteve 90-të, duke parë kështu sesi janë ruajtur, kultivuar, ndryshuar ose adaptuar shenjat e identitetit shqiptar. Punimi bazohet në një metodë cilësore ku qasja teorike është ajo e konstruktivizmit, mbështetur në interpretimin e objekteve sociale që gjejnë shëmbëlltynë e tyre te veprat arkitektonike.

Hyrje

Është e kuptueshme dhe natyrisht e perceptueshme për dikë të interesuar për çështjet identitare dhe simbolikën që të shtrojë pyetje rreth identitetit dhe nëse, ky, mund të gjejë shfaqjen e tij edhe në objektet për të cilat tashmë nuk ka

* Vera Bushati është pedagoge e Arkitekturës në universitetin Polis, Tiranë

** Bisej Kapo është studente e Programit Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin European të Tiranës

më mëdyshje. Kjo ekspozitë ka si synim të kuptuarit e ndikimit të artit e posaçërisht arkitekturës në strukturimin e identiteteve. Arkitektura duke pasur si karakteristikë të vetën utilitaritetin, zërthen në mënyrë të hapët identitetin social dhe atë nacional. Qëllimi është të kuptuarit në kontekste të ndryshme historike, e rolin të arkitekturës si medium për shprehjen dhe krijimin e identiteteve socio-politiko-kulturore, në një kontekst dinamik si ai shqiptar. Dinamik sepse vetë historia e tij ka lejuar përqafimin e një sërë elementesh kulturore të shteteve dhe identiteteve të ndryshme.

Si modelohen identitetet nëpërmjet arkitekturës?

Për këtë duhet ta shohim arkitekturën dhe qytetin jo vetëm si një mundësi për të jetuar, por edhe si një veprim të vetëdijshëm të komunitetit për urbanizimin e tij. Çdo vepër arkitektonike nuk është e ndarë nga konteksti në të cilin ajo ndërtohet. Si çdo vepër arti, ashtu edhe veprat arkitektonike mbartin në vetvete afirmimin ose edhe mundësinë e krijimit të një identiteti. Kjo nuk është absolutisht një risi, por është përdorur që prej kohësh, ku nëse iu referohemi Bulevardeve të Mëdha të Parisit, të njohur si Bulevardet Hausmann, kemi të bëjmë me krijimin dhe afirmimin e identiteteve sociale (Dhamo 2011:11), pra nga njëra anë kishim borgjezinë e re dhe nga ana tjetër kishim shtresat e paprivileguara të kundërvëna. Bulevardet prishën rrugicat e vjetra duke i lënë vend rrugëve të gjera që lidhnin kazermat e ushtrisë me qendrën (Ragon, 1971:97).

Mbështetur në një analizë pamore, format marrin rëndësinë dhe mund të trajtohen si tekste, por dhe si pjesë të ligjëtimeve sociale mbi identitetin. Si të tilla, këto tekste nuk kufizohen vetëm në kontekstin ku operojnë, por influenca dhe kuptimi që ata marrin shtrihen dhe përtej kontekstit nga dalin. Një vepër arti/arkitektonike është në vetvete një formë ndërveprimi midis tre variabla shumë të rëndësishëm që përbëjnë të kuptuarin dhe perceptimin tonë rreth asaj çka na rrethon. Ku kjo e fundit, pra bota reale e prekshme, është gjithnjë e ndërtuar dhe e konceptuar, apo do të thoshim e përjetuar, në sajë të një përvoje ku këto tre variabla luajnë një rol thelbësor në ndërtimin dhe konceptimin e realitetit. Së pari *Vështrimi*, si një proces i natyrshëm, i cili është i organizuar dhe i rrethuar nga variabël i dytë, *mendimi*, dhe së treti *emocioni* (Qëndro, 2012:12).

Arkitektura e fazave të ndryshme të historisë sonë shpreh traditën, kodet e të jetuarit, vendin e individit në brendësi të shoqërisë, integritetin fizik dhe territorial të komunitetit. “Në të shprehet raporti ndaj territorit si dhe kultura lokale e mënyrës sonë të të jetuarit” (Footer, 2002:54). Ballkani në tërësi e veçanërisht Shqipëria lejon të vështrosh se fenomeni i arkitekturës identitare ka qenë një aksion me eko të ndërsjellët. Në të ne shohim një shembull të hershëm, të afirmimit të kodeve, vlerave të identitetit socio-kulturore, në *Kishën e Sh. Kollit të Mesopotamit* në Sarandë, ku përveç tipologjisë bizantine të përcaktuar në mënyrë empirike në shek.

IX-XII, të tipit kryq të brendashkruar me kupolë, kemi një rast unikal me katër kupola dhe dy altarë, gjë që e kthen njëherësh kishën në Ortodokse dhe Katolike (figura 1). Kjo është vërtetuar edhe nga themelet e saj (Meksi et al. 1980:305).




Figura 1. Kisha e Mesopotamit në Sarandë (plan & pamje)



Figura 2. Piaça e Shkodrës.

Ky fakt i historisë së arkitekturës na vjen në ndihmë në një farë mënyre për të artikuluar mbi mosekzistencën e problematikës fetare në kontekstin shqiptar, pra identitetet fetare kanë gjetur një bashkekzistencë thuajse të natyrshme. Një tjetër element urbanistik është ai i *Piacës* së Shkodrës (figura 2), e cila është ndërtuar në fillim të shekullit XX dhe ka shërbyer si vijë ndarëse dhe përbashkuese e dy identiteteve fetare. Një element të cilin e marrim për shembull është Kolegji i Motrave Stigmatine, ku shkolloheshin vajzat shkodrane të dy komuniteteve fetare, apo Shoqata e Filatelistëve, të cilët e kishin qendrën në Piacë me anëtarë të dy komuniteteve fetare (Bushati, 1998:606). Këto dy fakte objektive na nxjerrin në konkluzionin se edhe sot bashkekzistenca fetare është një shenjë dalluese e identitetit shqiptar dhe duhet konsideruar si një nga elementet tepër pozitive të tij.

Bazuar në një analizë pamore dhe duke u munduar të zbërthejmë shkaqet do të japim disa elemente arkitektonike dhe urbanistike që shfaqin identitetin e Tiranës. Që nga krijimi i saj Tirana është shembulli i qytetit si “pikëpërqendrimi” maksimal i fuqisë dhe kulturës së komunitetit. Në qytetin spontan të modeluar sipas mënyrës sinoiciste¹ dhe atë të planifikuar kemi elemente të forta e të qëndrueshme që forcojnë identitetin. Ndër to Pazari i Vjetër i Tiranës (që sot nuk ekziston më)




Figura 3. Plani i Tiranës

¹ Me sinoicizëm kuptojmë grumbullimin spontan rreth një qendre urbane.

në qendër ka përcaktuar bërthamën si një element i fortë që vazhdon me arterien e gjatë të Bulevardit me orientimin Veri-Jug. Ndërkaq, lumi Lanë, si kufi natyror jep shprehje të qarta midis Tiranës spontane dhe asaj të mirëplanifikuar (Bushati, 2012:8-9; Plani i Tiranës, figura 3).

Në sajë të analizës vizuale dhe të tri niveleve të saj, atij fizik, psikologjik dhe simbolik (Rose, 2007:151), mund të argumentohet se, ashtu sikurse pikturat, skulpturat edhe veprat arkitekturore janë të destinuara të përmbushin funksione fizike si zgjatimi i trupit të njeriut (Cirici, 1976:18) dhe, më pas, kalojnë në nivelin e dytë, në momentin që janë kthyer në konvencionale, pra në atë psikologjik (ibid). Kësisoj vepra flet me një gjuhë të mirëfilltë, e cila mund të interpretohet dhe që krijon pra një strukturë kuptimore.

Kështu arkitektura shqiptare midis dy Luftërave Botërore reflekton kuintesencën e vendit që ka prodhuar marrëdhëniet sociale, ekonomike, praktike duke ndërtuar në të njëjtën kohë dhe imazhin e tij. Me ndërtimin e Bulevardit të madh, ose të ashtuquajturit Aksi Brazini (figura 3), si një çarje e rëndësishme e Kryeqytetit të ri (Bulevardi më i madh në Ballkan midis dy Luftërave Botërore) plazmohet imazhi i një shteti të pavarur nga pushtimi Otoman. Por krahas zgjidhjeve hibride të trajtuara në mënyrë eklektike nga De Fausto (figura 4) ashtu edhe ajo e sheshit të Universitetit së bashku me Kryeministrinë dhe Hotel Dajtin (nga Bosio) me një zgjidhje bashkëkohëse me Italinë Fashiste (E.U.R në Romë) shohim dhe në detaje të vogla tendencën vizuale për të njehsuar brenda Italisë Fashiste dhe Shqipërinë, duke pretenduar kufijtë e dikurshëm të Perandorisë Romake.

Ajo çka është thuajse e sigurt është se si çdo formë komunikimi verbal, edhe ajo pamore ka ndryshuar duke iu përshtatur konteksteve historike të ndryshme, ashtu sikurse edhe arkitektura i është përshtatur rrjedhave historike (Forty, 2005:14). Thuajse në çdo vepër arkitektonike ajo çka vihet re është qëllimi i saj funksionalo-estetik. Ky i fundit, pra qëllimi estetik, përbëhet nga elemente të cilat kombinohen në mënyrë harmonike (De Fusco, 2005:18) dhe kjo harmoni tashmë na duket kaq e natyrshme sa




Figura 4. Ministria, arkitekt De Fausto

është kthyer “normale”. Shembulli më tipik, i cili nuk na bën më përshtypje, është ai i ndërtesave të periudhës së pushtimit italian në Shqipëri, ku kemi një veshje të ndërtesës me terakotë të kuqe (figura 4). Kjo simbolikë është e lidhur me Romën Perandorake ku dominonte ndërtimi me Opus Latericium, metodë kjo e cila është përdorur gjerësisht në shekullin 1-4 të erës sonë (Bushati, 2007). Këtë formë e ndeshim në ndërtesa si: Banka Kombëtare, ndërtesa në rrugën e Kavajës, si dhe në disa ndërtesa të Shkollës së Oficerëve, por edhe akoma më plauzibël të pallatet e aviacionit në Tiranën e Re.

Nisur nga premisa se identiteti është një prej “problematikave” të botës bashkëkohore, qytetet dhe organizimi i tyre ndihmon, jo vetëm sot, për të kuptuar identitetet kolektive, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm edhe në ndërtimin e tyre. Themi “Problematikave” pasi sot vërehet se nëpërmjet proceseve integruese, ku sigurisht i referohemi aty ndërtimit të identitetit Europian, arkitektura është kthyer në një diskurs të rëndësishëm të shprehjes së vlerave nacionale identittrare (Delanty & Jones, 2002). Bazuar në ato struktura kuptimore, që krijon gjuha, dhe në rastin tonë arkitektura, mund të artikulojmë mbi implikimet që ajo mbart në ndërtimin e identiteteve duke u bazuar në rastin e Shqipërisë.

Po të analizojmë një shfaqje sinoiciste të rrethinave të Tiranës pas viteve 90-të, si për shembull Bathoren, ndërtimet spontane të cilat shprehin dhe energjinë, vitalitetin e një komuniteti që zhvendoset në kërkim të një jete më të mirë, duhet ta konsiderojmë si një fenomen normal që ka ndodhur në vende të ndryshme si në Amerikë rreth shekullit të 19, Athinë pas Luftës së Dytë Botërore etj. Integrimi i këtij komuniteti në jetën e kryeqytetit bëhet nëpërmjet urbanizimit. Tendencat e paraqitura për zgjatimin e Bulevardit, duke e ndërthurur skemën urbanistike me



Zonë spontane Zonë spontane Zgjatimi i Bulevardit në formë zig-zagu

Figura 5. Projekti i Polis-it për konkursin e zgjatimit të Bulevardit të Tiranës




Figura 6. Tapet tradicional

zig-zaget e një qilimi tradicional, duan që perceptimi vizual të përputhet me idenë e thurjes shtresore dhe me akset lidhëse të pjesës joformale me qytetin tradicional (projekti i Polis-it për konkursin e zgjatimit të Bulevardit të Tiranës (figura 5) post 90-të. Megjithatë mund të mendojmë sot, pas 22 vjetësh, se bumi i ndërtesave dhe i de-urbanizimit sidomos i Tiranës është një fenomen negativ, i cili e ka lenë qytetin pa një identitet të mirëfilltë, ky bum tregon në vetvete vullnetin dhe dëshirën për të ridimensionuar ekzistencën brenda kufijve territorialë shqiptarë. Koncepti i “bathorizimit” është artikuluar nga urbanistët shqiptarë duke e lidhur me ndryshimin e kushteve politiko-ekonomiko-sociale të fazës së parë të shtetit pluralist. Në këtë periudhë vërehen ndërtesa më tepër stremimi, ku nga periferia shohim se kemi ndërtesa një deri në dy kate, ndërsa qendra dominohet nga ndërtesa të cilat shkojnë deri në dymbëdhjetë kate (Aliaj et al., 2009:15). Vërtet kemi një minimizim të hapësirave publike, por ajo çka mund të shihet si pozitive në këtë realitet është fakti i krijimit të një kohezioni, pra në këto ndërtesa, që kryesisht ndodhen në qendër të Tiranës, ndarja sociale është e minimizuar pasi në fillimet e këtij bumi ndërtimor iu dha mundësia thuajse të gjitha shtresave sociale apo edhe grupeve, të themi të “margjinalizuara”- të kishin akses në blerjen e banesave, duke mos krijuar ndarje sociale. Sot në vitet 2000-jë kemi një ridimensionim të urbanistikës sidomos në zona të tilla si Bathorja, ku ajo çka është ndërtuar nuk mund të prishet, por ajo çka është sugjeruar nga urbanistët shqiptarë është përdorimi i tematikave stilistikore tradicionale, si për shembull tapetet (figura 5 - 6).

Ajo çka mund të thuhet sot është se tendencat e reja, sidomos pas vitit 2000, kanë qenë ato që i japin përparësi hapësirave publike, duke nënkuptuar kështu socializimin. Vitaliteti dhe dëshira për të pasur kushte më të mira, pas viteve 2000, tregonin një ndërgjegjësim të kontekstit për të rivitalizuar dhe për të ridimensionuar atë pjesë të ndërtesave të cilat tashmë koha i kishte “plakur”. Të paktën në rastin e Tiranës ngjyresat e pallateve i dhanë një identitet dhe një dinamikë tjetër qytetit.

Sot ndaj traditës ka disa perceptime si mbështetëse ashtu dhe mohuese. Arkitekti

Aldo Rossi thekson se forma e qëndrueshme identifikohet me të sotmen dhe asgjë nuk lind nga asgjë (intertekstualiteti). Në Tiranë këtë fenomen e gjejmë të mishëruar në lagjet e anës jugore të Lanës (figura 3), të cilat kanë pëlhurën urbane të qëndrueshme (hipodamike²) që ruan tiparet e qytetit pavarësisht ndryshimeve sasiore brenda saj. Kështu ideja e identitetit nacional kundërshtohet nga arkitekti Rem Kohlas, i cili shprehet se “është qesharake të krijojmë një arkitekturë moderne të mbështetur në identitetin nacional sepse do të ishte sikur t’i servinim turistëve një ushqim tradicional” (Kohlas nga Hugron). Reagimi vjen nga Konferenca e Universitetit të Delfit duke ngritur pyetjen nëse realisht e kuptonte rëndësinë e asaj çka po pohonte? (Hugron, 2010). Gjithashtu historiani i Arkitekturës, Framton, shton se mund të jesh modern duke u kthyer te burimet. Shembulli më i përsosur na paraqitet nga Opera e Sydney ku arkitektura evokon vlerat e një anijeje në bregdet.

Frojdi e konsideronte qytetin si një metaforë të kujtesës, si themel të identitetit (1971:12). Identiteti në arkitekturë është estetik, ashtu sikurse edhe arti dhe midis tyre ekziston një lidhje e ndërsjellë me kontekstin dhe kontekstet ku operojnë dhe kanë operuar. “Nëse nuk je nostalgjik nuk je modern” (Le Grand Paris, 2010). Dhe në fakt tendenca “Retro” jo vetëm në art, por edhe në arkitekturë ka filluar të lëvrohet në vitet 70-80-të të shekullit XX. Kjo na vërtetohet në rastin e Shqipërisë në momentet dhe në veprat arkitektonike që përmendëm më sipër, siç ishin ndërtesat gjatë pushtimit italian me karakteristikën e terakotës, apo edhe më të hershme se kaq me shprehjen e dy ideologjive fetare të ndryshme në një kishë të vetme. Sot, post 90 dhe post 2000, në sajë të punës së arkitekturës së sotme kartat e memories sonë nuk janë të pandryshueshme. Ato na ndihmojnë të bëjmë lidhjet midis kontekstit dhe tekstit, pra veprës dhe periudhës historike kur është ndërtuar. Vërtet ka vend për kritika, të cilat absolutisht qëndrojnë, për sa i takon elementit jo vetëm urbanistik, por edhe funksionit estetik, por duhet theksuar se përdorimi i motiveve tradicionale në planet urbanistike është një tregues i cili në një farë mënyre përforcon argumentin tonë se arkitektura është në një formë ndikuese dhe incentivuese e rivitalizimit apo forcimit dhe ridimensionimit të një identiteti, qoftë ky kolektiv social dhe nacional.

Bibliografia

- Aliaj B. (2009) *Midis Vakumit dhe Energjisë*. Tiranë: Polis.
 Bushati H. (1998) *Shkodra dhe motet*, Shkodër: Rozafat.
 Bushati V. (2012) *Vilat e Tiranës*. Tiranë: Polis.
 Cirici A. (1976) *Arte e Società*. Bari: Edizioni Dedalo.

² Struktura Hipodamike është pëlhuara ortogole e një qyteti.

- De Fusco R. (2005). *L'architettura come mass medium*. Bari: Edizioni Dedalo srl.
 Delanty G. Jones P.R. (2002) European Identity and Architecture. *European Journals of Social Theory*. November 2002 vol. 5 (4), f.453-466.
 Dhamo S. (2011) Ndërtimi përmes shkatërrimit dhe shkatërrimi përmes ndërtimit. *Forum A+P Periodik Shkencor për Arkitekturën dhe planifikimin urban*. nr.8, Tiranë: Polis.
 Forty A. (2005) *Parole ed Edifici. Un vocabolario per l'architettura moderna*, Bologna: Pendragon.
 Freud S. (1971) *Malaise dans la civilisation*, Paris: Odier.
 Meksi et al. (1980) *Historia e arkitekturës në Shqipëri*. Maket, Instituti i Monumenteve të kulturës, Tiranë.
 Qëndro G. (2012) *Gjuha Pamore*. Pjesa e parë. Polis, Tiranë.
 Ragon M. (1971). *Histoire Mondiale de l'Architecture et de l'Urbanisme Modernes*. Casterman, Paris.
 Rose G. (2007). *Visual Methodologies. An introduction to the interpretation of visual materials*. SAGE, California.
Webografi:
 Denis Dessus, D., Coste, I. & Orbach, D. (2010), Konferencë- *Le Grand Paris comme un New York* (25.10.2010). Parë më 07.06.2013, parë në: www.lejd.fr/YDDParis.
 Hugron J.P (2010). *Le courrier d'Architecte*. Cyber Archi. Parë më 07.06.2013, parë në: http://www.lecourrierdelarchitecte.com/album_1866.

Udhëtimi i teorive neoliberales në fushën e zhvillimit urban në vendet postsocialiste.

Rasti shqiptar

____ *Ph.D. Marcela MELE*¹ _____

____ *Entela SHEHU*² _____

Abstract. Paradigma neoliberale ka dominuar analizën e politikave në qytetet postsocialiste në dy dekadat e fundit. Koncepti “Travel theory” i Edward Said (1983) ose udhëtimi i teorive hap një agjendë të rëndësishme kërkimore, që nënkupton zhvendosjen e ideve neoliberale në vende të ndryshme kulturore ose kombëtare, si një aspekt i rëndësishëm i prodhimit të njohurive. Bazuar tek “Travel theory” i Said-it, Smith (2006) sugjeron se teoria e tranzicionit në vende të ndryshme postsocialiste udhëton me ritme të ndryshme. Ky parim mund të aplikohet për situatën në Shqipëri, që vazhdon të sfidojë një përkthim të drejtpërdrejtë të teorisë urbane perëndimore në kontekstin lokal. Analiza e zhvillimit (sub)urban në qytet-rajonin e Tiranës është e lidhur me analizën e marrëdhënieve të pronësisë dhe bazohet në të dhënat e mbledhura përmes vëzhgimeve në terren dhe nga intervistat me aktorët lokalë, duke u fokusuar në vështirësitë aktuale rreth përvetësimit të njohurive lokale të çështjes së pronës dhe strategjive të (mbi)jetesës. Në perspektivë krahasuese, konteksti politik dhe praktikë urbane në Shqipëri sigurojnë një shembull të mirë nëse teoritë perëndimore të tranzicionit urban “përshtaten” apo jo. Ky artikull ofron një kritikë postsocialiste të studimeve urbane, duke shpjeguar neglizhencën e teorisë

¹ Marcela Mele është pedagoge e jashtme pranë Universitetit European të Tiranës. Ajo ka përfunduar PhD në Shkencat Humane, 2012 pranë Universitetit Kingston upon Hull, në Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë qëndrimit të saj disavjeçar për mbarimin e doktoraturës, ajo ka referuar mbi rastin shqiptar në shumë simpoziume, konferenca dhe tavolina me akademikë të shquar perëndimorë dhe lindorë. Një version i këtij punimi në gjuhën angleze është prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare RC1, në Shkencat Sociale, pranë Universitetit të Amsterdemit 7-9 July 2011.

² Entela Shehu është kandidate për Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, pranë Institutit të Studimeve Europiane (ISE) dhe me një përvojë disavjeçare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

urbane të qyteteve në Shqipëri. Artikulli argumenton se rasti shqiptar zbulon diversitetin e pandarë të përvojave urbane të vendeve postsocialiste në Europën Juglindore.

Fjalë Kyçe: “Travel theory”, vendet postsocialiste, qytet rajoni- Tiranë, zhvillimi (sub)urban, prona private.

Hyrje

Në fillim të viteve 90-të, me rënien e sistemit socialist, dhe me vendosjen e sistemit të ri ekonomiko-politik në vendet ish-socialiste, studiuesit britanikë dhe amerikanë e kthyen vëmendjen e tyre në studimin e ekonomive në tranzicion dhe proceset e transformimit urban (për shembull, Smith, 2002, 2006, 2007; Stenning, 2002, 2006). Zhvillimi i fundit i vendeve postsocialiste ka qenë i ndikuar fuqimisht nga kornizat e reja rregullative bazuar në kapitalizmin neoliberal dhe të pronës private si dhe nga rruga-varësitë (path-dependencies) me origjinën në ish-sistemet komuniste. Relativisht strukturat dhe modelet hapësinore të qëndrueshme, trashëguar nga periudha socialiste, tani ndërthuren me format e veçanta të kapitalizmit gjatë transformimeve pas viteve 90-të.

Një çështje e rëndësishme për këtë artikull është statusi i teorisë postsocialiste dhe marrëdhëniet e saj me metodat e përdorura për të vëzhguar modelet empirike urbane. Në vitet e fundit, një organ i konsiderueshëm i punës teorike dhe politike - zhvilluar kryesisht nga shkollarët perëndimorë - ka qenë aplikuar në kontekstin e Europës Lindore. Pjesa më e madhe e tyre ka qenë përkushtuar në marrëdhëniet sociale dhe komplekse hapësinore të ekonomive të vendeve lindore, ndërsa ato i nënshtrohen një tranzicioni nga niveli qendror i planifikuar drejt regjimeve të orientuara nga tregu i lirë ose nga neoliberalizmi. Në të vërtetë, “Western theory” dhe politika ka ndihmuar për t’i dhënë formë këtij transformimi. Sikurse Pickles dhe Smith (2006) kanë sugjeruar, se përmbysja e socializmit të *stilit-sovjetik* nuk ishte vetëm një ngjarje që transformoi peizazhet ekonomike dhe politike të Europës, por gjithashtu kishte efekte më të gjera globale ideologjike dhe teorike³. Shqipëria ofron një shembull të mirë të të dyja aspekteve të “Travel urban theory” (ose teorisë urbane të udhëtimit): (1) transferimi i modeleve ose “praktikave të mirë” e qeverisjes urbane, dhe (2) aplikimi i teorisë anglo-amerikane për të kuptuar qeverisjen urbane dhe zhvillimin (sub)urban. Duke u ndalur në aspektin(2), në analizën e zhvillimit suburban në qytet-rajonin Tiranë, ky artikull shqyrton në çfarë mënyrash mund, apo duhet, “Travel urban theory” zbatuar në terren, në

gamën e kompleksiteteve dhe kontradiktave të jetës urbane periferike në Tiranë dhe më gjerë, për ekonominë urbane dhe suburbane në tranzicion.

Pickles dhe Smith (2006) sugjerojnë se neoliberalizmi global ndikon më shumë në strukturimin e të menduarit rreth postsocializmit sesa modelet e zhvillimit social demokratike dhe ekonomia politike kritike. Në të njëjtën mënyrë, diskutimi neoliberal ka dominuar analizën e politikave në qytetet lindore. Por, si është hetuar dhe çfarë konkluzionesh janë arritur rreth efekteve urbane hapësinore të tranzicionit në rastin e Shqipërisë? Transferimi i teorisë nga një kontekst në një tjetër përfaqëson një sfidë për autorët.

Në këtë aspekt, “Travel theory” është përdorur për të shpjeguar lëvizjen dhe importimin e teorisë, kryesisht perëndimore me kornizë ideologjike neoliberale në kontekste të tjera lokale, si rasti i shoqërive postkomuniste, me koncepte më të gjera dhe diskurse lidhur në kontekste tranzitore të veçanta, por këto kontekste në kthim duhet të tregojnë si dhe në çfarë forme teoria udhëton prapa në kontekstin e saj origjinal. Rezultati është më pak i një modeli të zhvillimit urban postsocialist dhe më shumë një grup i koncepteve dhe abstraksioneve që janë pak a shumë të ndjeshme ndaj procesit, vendit, dhe kontekstit lokal. Kjo qasje është e ngjashme me mënyrën të sintezës gjeohistorike dhe abstraksionit si të përshkruara nga preferencat e Sayer-it (1989) në studimin e fenomeneve urbane dhe suburbane. Prandaj, ky artikull merr parasysh mënyrat në të cilat teoritë e veçanta janë apo jo të dobishme në shpjegimin e proceseve specifike të vendbanimeve urbane të veçanta.

Teoritë e zhvillimit urban në periudhën e tranzicionit: rasti i Shqipërisë

Harta 1.1 ilustron kufijtë politikë dhe administrativë të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore. Për shumë vende të Europës Lindore, fundi i komunizmit solli një mundësi për të përqaftuar një neoliberalizëm global të rigjallëruar dhe mundësi të reja ekonomike dhe politike. Në këtë pikëpamje, fundi i komunizmit solli shpresa të mëdha për *kthim* në Europë, si: krijimi i mundësive ekonomike, liritë personale dhe politike (Pickles, 2005). Në të njëjtën kohë, dhe në mbështetje të këtij *kthimi*, teoritë neoliberale udhëtuan gjerësisht në Europë, duke demonstruar atë që Smith e quan “Travel theory”.

Metodologjia e kërkimit : “Vetja” në terrenin lokal

Vetja ime (jonë), si një hulumtuese e trajnuar në vendet perëndimore dhe një zbatuese në Shqipëri, kërkon të shikojë efektet praktike të këtyre teorisë në terrenin lokal shqiptar. Ky artikull rivlerëson vështirësitë metodologjike në lidhje

³ Bazuar te koncepti “Travel Theory” i sociologut Edward Said (1983), Smith (2006) sugjeron se teoritë e tranzicionit kanë udhëtuar me ritme të ndryshme në vende të ndryshme postsocialiste. Ky parim mund të aplikohet për situatën në Shqipëri, i cili vazhdon të sfi- dojë një përkthim të drejtpërdrejtë të teorisë urbane perëndimore në kontekstin lokal.



Harta 1.1: Harta politike dhe administrative e Europës Qendrore dhe Lindore
Burimi: Përgatitur nga Shehu, E., pjesërisht adaptuar nga http://europa.maps/index_en.htm

me aplikimin e formave të ekonomisë së tregut të lirë, me strategjitë alternuese të mënyrës së jetesës dhe menaxhimit emocional gjatë punës në terren. Çështjet ku hulumtuesit fokusohen janë: problemet e përfaqësues neoliberales, lloje të ndryshme të intervistimit, interpretimi i të dhënave të gjeneruara përmes intervistave dhe çështjeve etike. Ato argumentojnë se shumica e rasteve, gjatë procesit të hulumtimit me njerëz të pushtetit lokal, nuk ndryshon shumë nga hulumtimi me njerëz të kategorive të tjera, sepse pak a shumë të gjithë kategoritë preken nga problemet neoliberales në praktikë.

Qëllimi i analizës të të dhënave në këtë studim është të ofrojë dëshmi në lidhje me rregullimin e hapësirave periferike në rajonin e qytetit të Tiranës dhe për efektivitetin e modeleve perëndimore në vendet postsocialiste. Unë shqyrtoj në veçanti vështirësitë dhe sfidat e ngritura në ndërtimin e mënyrës së jetesës dhe aplikimin e neoliberalizmit në praktikë dhe jetën e përditshme. Zbatueshmëria në praktikë e aspekteve emocionale me dimensionet e saj, përfshin edhe kufizimet që dalin nga analizimi i konflikteve të vlerave themelore me grupin nën vëzhgim. Një rëndësi të veçantë përbën reflektimi mbi efektet e këtyre përvojave për metodologjinë etnografike, sesi ne i menaxhojmë përgjigjet tona emocionale, dhe sesi mund të lidhen ato në procesin e hulumtimit.

Nga pikëpamja e koncepteve sociologjike të qasjeve neoliberales në zbatimin e qeverisjes lokale urbane në zonat (sub)urbane, udhëtimi i teorive perëndimore në kontekstin shqiptar shoqërohet me simbiozën e strategjive lokale të mbijetesës në lidhje me çështjen e pronës private. Në perspektivën krahasuese, konteksti politik dhe praktikë urbane në Shqipëri sigurojnë një shembull të mirë nëse teoritë perëndimore të tranzicionit urban “përshtaten” apo jo.

Interpretimi i intervistave

Interpretimi i të dhënave të gjeneruara nga intervistat është gjithmonë i vështirë dhe problematik. Intervistat me nëpunësit civilë janë edhe më të vështira për t’u interpretuar sepse janë politike dhe Ball (1994) ilustron natyrën “game-like” të disa prej këtyre intervistave. Prandaj humultuesja përpiqet të njohë dhe të eksplorojë në mënyrë më të plotë intervistën si “loja e pushtetit”.

Nëpunësit civilë që u intervistuan ishin rrallë herë vetëm dhe pas paraqitjes disa here në Bashkinë Kamëz, vetë shefi i personelit shprehu pakënaqësinë e tij. Pra është e paqartë deri në çfarë mase i intervistuari thotë hapur mendimin e tij, në krahasim me përgjigjen e prodhuar në grup. Edhe kur janë vetëm, megjithatë, të anketuarit priren për t’u përgjigjur pyetjeve sipas këndvështrimit “zyrtar” sesa të përgjigjen sipas mendimit të tyre (Neumann 2011). Në këtë këndvështrim çështjet etike marrin një rëndësi të veçantë, sepse hulumtuesja e parë ndodhet njëkohësisht në rolin e përkthyeses dhe kërkueses shkencore.

Pjesa në vijim ofron një pasqyrë të zhvillimit urban në Europën Lindore para dhe pas periudhës socialiste, duke u përpjekur për të identifikuar modelin e përbashkët dhe dallimet midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera socialiste në politikën e zhvillimit urban. Nisur nga një kritikë postsocialiste të studimeve urbane, shpjegohet neglizhenca në zbatimin e teorisë urbane të qyteteve në rastin e Shqipërisë (qytet-rajoni Tiranë) dhe rasti shqiptar zbulon diversitetin e pandarë të përvojave urbane midis vendeve postsocialiste në Europën Qendrore dhe Lindore. Duke komentuar mbi trajektoret e zhvillimit urban në ekonominë në tranzicion, Sykora (2008: 289) sugjeron se ka disa konvergjenca me format perëndimore urbane dhe kjo është problematike të imponojnë “western theory” të tranzicionit në formave të tilla neoliberales urbane në këto kontekste tranzitore.

Zhvillimi urban në Europën Lindore e Qendrore para dhe pas periudhës socialiste

Humultues të periudhës postsocialiste, si Sykora (1995, 1998, 2008, 2009), kanë ofruar një përshkrim të modelit të qytetit postsocialist. Megjithatë, historia e jetës dhe e kontekstit të Tiranës nuk është si ajo e disa qyteteve postsocialiste të tilla

si Praga. Tirana është një qytet i zënë dhe i gjallë dhe ka “fuzzy model” të tij. Më tepër se një tranzicion i qetë drejt zgjidhjes së çështjes së pronës private, të drejtat e pronësisë në zonat periferike suburbane janë bërë vazhdimisht, ribërë dhe ç'bërë nga praktikatat e jetesës së përditshme aktuale.

Gjatë periudhës socialiste, Shqipëria kishte një nga ekonomitë më të centralizuara në Europën Juglindore, ku shteti ka luajtur një rol të madh në kufizimin e zhvillimit urban. Shkalla e deri ketuurbanizimit kontrollohej përmes imponimit të kontrolleve të migrimit dhe njerëzit nuk ishin të lirë të ndryshuar vendbanim sa herë të donin. Kushtetuta e vitit 1976 imponoi një ndalim të plotë për të drejtat e pronësisë (ose pronë private). Deri para vitit 1989, Shqipëria kishte mbipopullim strehimi me disa nga cilësitë më të ulëta në Europën Juglindore. Viti 1991 shënoi një bum në tregun e shtëpive dhe rriti kërkesën për strehim. Shtimi i shtëpive të reja në periferitë e qyteteve kryesore dhe ndryshimet e pakontrolluara në ndërtesat ekzistuese kanë qenë karakteristikë e urbanizimit të Shqipërisë në periudhën e tranzicionit. Gjatë kësaj periudhë, norma e urbanizimit në Shqipëri në vitin 2000 ishte përafërsisht 41.2% dhe gati 35% e popullsisë totale jetonte në qytet, rajoni Tiranë (Aliaj, 2006).

Që nga viti 1990 pati një lëvizje relativisht e lirë e njerëzve në Shqipëri nga zonat rurale drejt zonave urbane. Popullsia urbane u rrit në mënyrë dramatike nga 35.8% në vitin 1990 në 44.5% në vitin 2004 (Aliaj, 2006; INSTAT, 2006). Fermat shtetërore kolektive u kthyen në truall ndërtimi për strehim mbi pronën private të fragmentuar në periferitë e qyteteve urbane. Pas një periudhe liberalizimi, u bënë përpjekje për të rregulluar përdorimin e tokës dhe të drejtat pronësore në zonat suburbane. Në trekëndëshin urban Tiranë, Durrës dhe Fushë-Krujë, popullsia urbane brenda saj dhe rurale përreth këtyre qyteteve u rrit në nivel të ndjeshëm. Rrjedhimisht, kantieret e ndërtimit u zgjeruan me shpejtësi.

Prona private ka më shumë rëndësi për njerëzit në Shqipëri sesa në vendet e tjera socialiste për shkak të mohimit pothuaj total të saj në vitin 1976. Procesi i privatizimit në tokat bujqësore dhe urbane u ratifikuan me ligje substanciale. Njerëzit që janë të privuar padrejtësisht nga pasuria e tyre në të kaluarën u tha se mund të rifitojnë pronën e tyre apo një ekuivalent i alternativës pronë apo të holla nga qeveria qendrore. Megjithatë, ligjet ishin të diskutueshme dhe çështja e tokës u la për zgjidhje të mëvonshme.

Si rezultat i migrimit në shkallë të gjerë rural-urban, tokat periferike të qyteteve kryesore, por sidomos në Tiranë, që ishin në pronësi të shtetit, u zunë nga banorë të zbritur nga zona të thella rurale. Që nga viti 1990, në qytet-rajon Tiranë ka një rritje me dendësi urbane në qendër të qytetit, përgjatë korridoreve të zhvillimit dhe në periferitë e saj. Për shkak të lëvizjes së lirë të popullsisë, zonat periferike të Tiranës morën një karakter krejtësisht të ri që nga viti 1991 duke ndryshuar morfologjinë e qytetit. Tokat bujqësore i hapën rrugë strehimit dhe ndërtesave. Rreth 40% e investimeve në ndërtimet informale u mbështetën kryesisht nga

remitancat. Ndërmjet viteve 1992 dhe 1996, sektori privat (sektori i ndërtimit për shkak të kërkesës shumë të lartë për strehim) GDP-ja u rrit nga 10% në 45%. Vendbanimet informale në veri të Tiranës, në Bashkinë Kamëz, zunë një sipërfaqe prej 23.2 km² dhe me një popullsi nga 6 000 banorë (1989) në afërsisht 100 000 banorë (2009) (Buletin i Bashkisë Kamëz, 2010). Qeveria duke qenë fillimisht e dobët dhe e papërgatitur nuk ndërhyri në fillimet e saj. Megjithatë, legalizimi i zonave informale mbeti një nga prioritetet politike të çdo qeverie.

Që prej tranzicionit drejt ekonomisë së tregut të lirë (neoliberalizmit), gati në të gjithë kryeqytetet e Europës Juglindore ka ndodhur një urbanizim i shpejtë duke çuar në përhapje të ndërtimeve informale suburbane. Rasti i Tiranës nuk është e ndryshme në këtë aspekt. Pas 90-ës, kriza ekonomike, ndryshimet politike dhe demografike u zhvilluan gjatë kohës kur mungonte kontrolli i tokës, zbatimi i ligjit dhe shumë banorë ndërtonin pa autorizim ligjor. Këto veprime rezultuan në ngritjen e zonave informale përreth qyteteve Tiranë, Durrës, Fushë-Krujë etj. Reformat në lidhje me çështjen e së drejtës së pronës private, inventari i pronës shtetërore dhe veprimet ilegale/informale e ndanë Shqipërinë në 4.5 milionë parcela toke dhe njësi prone të patundshme. Privatizimi i strehimit vazhdoi me shpejtësi të madhe. Programi filloi në maj të vitit 1993 dhe brenda vitit përfundoi transferimi i pronësisë së rreth 97% e banesave (Felstehausen, 1997).


Për shkak të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe zhvillimit të parregullt të tokës, hapësira suburbane e Tiranës ka marrë një karakter të ri që nga viti 1991. Përdorimi i tokës bujqësore i dha rrugë problemit të strehimit dhe ndërtimit. Fluksi i migrimit nga fshati në qytet rriti kërkesat për strehim në qytet-rajon Tiranë. Ndërsa shumë pjesë të periferisë mbeten në pronësi të shtetit, asnjë entitet publik nuk ishte në gjendje të blejë ose të mbajë të ardhmen e tokës në të njëjtin rajon.

Pjesa në vijim do të përshkruajë më në detaje praktikatat postsocialiste në betejat rreth të drejtave të pronësisë në zonat suburbane të qytet-rajonit Tiranë.

Zhvillimi periferik në qytet-rajon Tiranë

Karakteri kompakt i qytetit ish-socialist është duke u ndryshuar përmes suburbanizimit të shpejtë komercial dhe rezindencial që merr formën e shtrirjes urbane të parregulluar. Ndërtimet e reja rreth periferive të rajoneve rezidenciale janë të fragmentuara në vende të shumta në zonat metropolitane rreth qyteteve kryesore. Shfaqja e qytetit periferik “fuzzy” lidhet kryesisht me shkaqet politike, ekonomike, sociale dhe institucionale e transformimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut të lirë (Carnobell dhe Gërzhani, 2004). Por ndryshe nga qytetet periferike në

Amerikën e Veriut, vendet perëndimore dhe lindore të Europës, nuk janë rezultat i shkallës të madhe të zhvillimit privat. Për më tepër zonat periferike në



Harta 1.2: Zgjerimi i Tiranës 1990-2005

Burim: **Burimi:** Kortezi e organizatës jofitimprurëse Co-Plan, Tiranë, Maj 2008

Tiranë përfaqësojnë një vendbanim informal, krijuar prej të drejtave pronësore të fragmentuara.

Harta 1.2 ilustron shtrirjen e qytet-rajonit Tiranë midis vitit 1990 dhe vitit 2002 si pasojë e rritjes së shpejtë të popullsisë në skajet e saj. Ka presion si pasojë e shpërthimit në rritjen e banesave informale, probleme rreth sigurimit dhe infrastrukturës dhe çështjet e financimit të pushtetit lokal, sidomos në zonat periferike lulëzim të qytet-rajonit Tiranë. Këto tensione përfshijnë një shpërthim në rritjen e banesave informale private, problemet rreth sigurimit dhe infrastrukturës dhe çështja e financimit të pushtetit lokal, sidomos në zonat periferike që lulëzojnë në qytet-rajon të kryeqytetit.

Hapësirat e reja periferike të Tiranës reflektojnë ndërveprimin e strukturave ligjore dhe administrative të trashëguara të Shqipërisë me presione të reja të zhvillimit të tokës në sistemin e tregut të lirë. Sigurimi i të drejtave të pronësisë është një pjesë e rëndësishme në kontekstin e ri- rregullimit në zonat periferike të Tiranës. Analiza e zhvillimit (sub)urban në qytet-rajon të Tiranës është e lidhur me analizën e marrëdhënieve të pronësisë⁴ dhe bazohet në të dhënat e mbledhura përmes vëzhgimeve në terren dhe intervistave me aktorë lokalë, kategoritë e migrantëve dhe ish-pronarëve, duke u fokusuar në vështirësitë aktuale rreth përvetësimit të njohurive lokale të çështjes së pronës dhe strategjive të (mbi) jetesës. Arsyeja pse janë zgjedhur këto lloj kategorish lidhen me parimin e zënies

⁴ Analiza e marrëdhënieve të pronësisë në Shqipërinë postsocialiste është më shumë komplekse në krahasim me vendet e tjera Lindore (për shembull pasaportizimi si një procedurë shumë e ndërlikuar).

se tokës i pari. Sipas Bardhoshit (2009: 122) në kontekstin e zonave informale përdoret ndarja *i ardhur/vendas*. Për arsye studimi, në këtë punim termi *i ardhur* do të njësohet me termin *migrant/vendas* (Shih tabelën 1.1).

Tabela 1.1: Përbërja e kategorive të pjesëmarrësve të anketuar

Kategoritë:	Numri i pjesëtarëve
Mi Migrantët	Ky grup përfshin njerëz nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë, të cilët zaptuan* dhe u ngulitën në periferi të rajonit të Tiranës pas vitit 1990.
Banorët	Ky grup përfshinte njerëz që vendosen në periferi të Tiranës para vitit 1990 dhe në toka të lira shtetërore pas vitit 1990.
Ish-Pronar*	Ky grup përfshin njerëzit, prona e të cilëve u shpronësua gjatë Reformës Agrare në vitin 1976.
Zyrtarët Lokalë	Ky grup përfshin zyrtarët lokalë dhe kombëtarë, akademikë, sektorin publik dhe privat.

* Zënia ka kuptimin e vendosjes fizike, dhe duket se vjen prej foljes zë, që do të thotë, “kap”, “zotëroj” me forcë diçka. Edhe zaptimi shpreh një proces që ka të bëjë me zotërimin me forcë të diçkaje, kur faktori forcë është përcaktues në këtë drejtim, dhe çdo pasojë që vjen prej saj, vetëm sa i bie të njihet ose jo nga palët.

** Sipas Bardhoshit (2009: 120) termi ish-pronar “është një kategori e re juridike në vendin tonë, e cila është krijuar nga legjislacioni postsocialist shqiptar. Krahas këtij termi përdoret termi pronar i ligjshëm përkundërt pronarëve të paligjshëm. Këto terma më tepër sesa produkte të legjislatorit, janë pjellë e debatit mediatik”.

Në seksionet e mëposhtme do të jepen dy kontekste ku “Travel theory” përplasit me teorinë urbane të njohurive lokale në terren, respektivisht në çështjen rreth të drejtave pronësore në periferi të qytet-rajon Tiranë. Ndërsa disa koncepte bazë teorike janë të dobishme në konkretizimin e situatës në Shqipëri, unë propozoj që teoria perëndimore nuk “përshtatet” mirë brenda kontekstit të proceseve të kuptimit në zhvillimin (sub)urban të Tiranës. Aplikimi i “Travel urban theory” me njohuritë lokale në terren çon në një modifikim të temave konceptuale. Këto janë, respektivisht, (a) njohuri lokale mbi çështjen e pronës private dhe (b) njohuri lokale të mbijetesës.

Dije lokale mbi çështjen e pronës private

Smith dhe Timar (2010:121) argumentojnë që angazhimet dhe zhvillimi i interpretimeve të zhvillimit post-socialist urban dhe rajonal nuk është detyrë e lehtë. Një çështje kritike është sesi llojet e njohurive mund të zhvillohen për të siguruar kuptim efektiv të postsocializmit.

Teoritë e zhvillimit të neoliberalizmit negociohen në mënyra të ndryshme në kontekstin e qytet rajon Tiranë. Tirana nuk është si qytetet e tjera postsocialiste, të tilla si Budapest, Varshavë, Beograd, dhe Pragë. Qytet-rajon Tiranë ndryshon

nga këto përvojat e qyteteve postsocialiste. Fluksi i emigracionit rural dhe shtrirjes urbane konsekuente ka nënkuptuar se konfliktet dhe tensionet rreth të drejtave të pronësisë janë të ngjarë të ndodhë (Hartkoorn, 2000; Petroviq, 2003: 20). Në rajonin e Tiranës historitë e shumta janë aktivizuar dhe qarkullojnë gjatë periudhës 2006-2009. Banorët dhe migrantë luftojnë për të bërë pretendime mbi pronën private dhe mjetet e jetesës.

Konkretisht, emigrantët e fundit nëpërmjet vetërregullimit dhe më vonë përmes legalizimit ushtruan të drejtat e tyre të pronësisë dhe në të njëjtën kohë mblodhën njohuri të këtyre të drejtave. Analizat në vijim jo vetëm konfirmojnë mënyra komplekse në të cilat të drejtat e pronësisë në ekonominë urbane tranzitore të qytet-rajonit- Tiranë lidhen me mekanizmin e mbijetesës, por edhe ajo ka të bëjë me përforcimin e rolit të njohurisë mbi pronën në formimin e strategjive të mënyrës së jetesës në Tiranë.

Gjatë sistemit socialist, pronësia e tokës dhe vetë termi “pronë” ishte një ide abstrakte. Shqipëria ishte e pazakontë, nëse jo unike, midis ekonomive të tjera në tranzicion me një privatizim të banesave urbane në mënyrë të shpejtë dhe radikale. Historia politike e Shqipërisë (që prej Kodit të pronës Osmane 1858) ka krijuar një pamflet të të drejtave pronësore të cilat janë të një kompleksiteti të madh ligjor. Të dhënat parësore dhe dytësore në lidhje me pronën private janë të pazakonshme në zonat informale të banimit e cila u ngrit rreth e rrotull Tiranës që nga viti 1990. Klasa që zotëronte pronat që nga periudha prekomuniste (Zogut) është përpjekur për t'i rimarrë tokat e saj. Problemi i ndërtimeve të paligjshme është rritur në shkallë të gjerë dhe kthimi përsëri në sektorin formal të ndërtimit për të zbatuar sundimin e ligjit dhe për të zhvilluar një sistem financiar brenda një kornize ligjore është një sfidë.

Migrimi masiv ka sjellë ndërtime të paligjshme mbi tokën bujqësore, me mungesë në infrastrukturë. Vendbanimet informale kanë ekzistuar për 15 vjet dhe ata migrantë që ndërtuan fillimisht atje, ende ndërtojnë shtëpitë e tyre. Vendbanimet joformale kanë një ndikim serioz social, ekonomik dhe mjedisor. Një numër i konsiderueshëm konfliktesh dhe tensionesh janë lidhur me vendbanimet e paplanifikuara (Felstehausen, 1999; Bertaud, 2006; Childress, 1999, 2006).

Reforma e privatizimit gjatë periudhës së tranzicionit ndihmoi aktorë të ndryshëm për të kuptuar rëndësinë e pronës dhe si të menaxhojnë hapësirën urbane të jetesës në mënyra të ndryshme. Mund të argumentohet se zhvillimi i tokës u planifikua dobët, me sigurim minimal për shërbimet dhe infrastrukturën bazë. Në praktikë do të thotë se, në mënyrë që të përfshihen në ekonominë e tregut të lirë dhe të mobilizohet titulli i pronësisë, aktorë të ndryshëm duhet të marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e tokës dhe të përshtatin hapësirën e tyre urbane edhe pse ligji dhe rregulloret në pronësi dhe të tregut të tokës janë pezulluar ose mbahen varur. Analiza e zhvillimit periferik në qytet rajonin -Tiranë bazohet në

të dhënat e mbledhura përmes vëzhgimeve në terren dhe përmes intervistave me aktorët lokalë, migrantë, banorët dhe ish-pronarët dhe tregon sesa njohuritë lokale të pronës ndryshojnë nga praktikatat e ndryshme dhe nga përvojat e aktorëve të ndryshëm në njërin anë, dhe si njohuritë mbi pronën private ndihmon të kuptuarit e saj nga ana tjetër.

Shumica e migrantëve shpjeguan në detaje arsyet kryesore pse u zhvendosën në periferi të qytet rajon -Tiranë dhe sesi ata siguruan titullin nga pronarët e ligjshëm. Në një farë mase, këto zona periferike kanë prodhuar një gjeografi të ndërlikuar midis zonave të largëta veriore dhe qendrore dhe atyre jugore. Një numër i konsiderueshëm i migrantëve në fillimet e periudhës së tranzicionit midis viteve 1994 dhe 1998 siguruan tokën nga zënia me forcë në tokën e padëshiruar apo të neglizhuar në zonën e Kamzës. Për shumicën e tyre, e drejta e pronësisë konsiderohet ende si një koncept abstrakt. Përderisa prona private është një parakusht i rëndësishëm për shkëmbim në kapitalizëm, shkëmbimi ndodh në kontekste të ndryshme. Intervistat gjysmë të strukturuar me kategoritë e ndryshme të pjesëmarrësve (migruesit, banorët, ish-pronarët, zyrtarët lokalë) ekzaminon konfliktet në zhvillim rreth zhvillimit periferik në rajonin e Tiranës. Intervistat janë përdorur për të mbledhur informacion në lidhje me karakteristikatat e veçanta të zhvillimit urban, duke u fokusuar në veçanti në rregullimin e pronës private dhe sesi pronësia ndikon në sigurimin e mjeteve të jetesës në qytet. Nga analiza e të intervistuarve del sa e rëndësishme është sesi zbatohet në terren ideja abstrakte e së drejtës së pronës në praktikatat e njohurive të ndryshme në zonat urbane dhe suburbane. Shumë migrantë dhe banorë e kishin përdorur deri para pak vitesh më parë tokën e tyre vetëm si një strehë bazë. Një migrant, vendosur në Kamëz që nga viti 1995 deklaroi:

“Pas 1990 në fshatrat tona të largëta e gjetëm veten pa punë dhe jetesë të papërbalueshme. Kjo çoi në zënie në gjendje të lirë ose në tokë në pronësi private në periferitë e qytet-rajonit Tiranë. Të privuar nga pronësia e tokës më shumë se katër dekada, ne menduam se mund ta përdornim tokën si të dëshironim. Në vitet e para të vendosjes ne ishim egoistë dhe nuk u kujdesëm shumë për mjedisin përreth. Në këtë kontekst, ne nuk menduam sesi të krijonim një mjedis të brendshëm urban dhe një fqinjësi të mirë në lagje, por vetëm sa për të ndërtuar një shtëpi si strehë banimi. Kohët e fundit filluam të kuptojmë se diçka ishte e gabuar dhe mungonte në peizazhin dhe lagjen. Sigurimi i titullit të pronësisë është i rëndësishëm”,

Migrant, Kamëz, mars 2009.

Siç del dhe nga fjalët e intervistuesit, një strehë dhe një copë tokë nuk është e mjaftueshme. Ata duan të mobilizojnë pronat e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në zhvillimin e tokës urbane. Ata janë të vetëdijshëm se ekzistenca e rregullave urbane

dhe rregullorja e planifikimit urban do t'i ndihmojnë në transaksione ndaj pronës dhe në raportin këmbim-shkëmbim të saj. I njëjti migrant vazhdoi:

"Pas vitit 2000 qëndrimi ynë në lidhje me pronën filloi të ndryshojë. Përpara kur ne ngrinim një shtëpi në një vend të zbrazët, nuk pyesnim 'ç'do bëhej më tej'. Kohët e fundit, ne filluam të kuptojmë se në qoftë se toka jonë nuk është regjistruar zyrtarisht dhe për të marrë një titull/tapi nga ajo, atëherë ne nuk mund të kemi të drejta në transaksionin e tokës, infrastrukturës, postës etj.

Migrant, periferi e Tiranës, mars 2009.

Me fjalinë "ç'do bëhej më tej" migranti donte të thoshte se në të kaluarën ata nuk i kushtuan vëmendje rregullave të planifikimit urban ekzistues ose të shkojnë në zyrën urbane dhe të marrin informacion rreth planit të zonës së zonimit. Midis viteve 1995 dhe 2002, shumica e migrantëve e konsideronte si më të rëndësishme të zinin dhe të përdornin tokën sesa pronësinë ligjore. Përvetësimi i paligjshëm i tokës nëpërmjet ndikimit të miqve ose farefisit të migrantëve ka qenë një burim i madh pasigurie për ato migrantë që nuk kanë titull të qartë për tokën e tyre. Pasiguria ka krijuar ankth dhe ata me dëshpërim kërkojnë të kenë dokumente për tokën në mënyrë të ligjshme. Një migrant ardhur në 2006-en, në një zonë afër qytet rajonit- Tiranë, deklaroi:

"Gjithkush u largua nga fshati dhe ne nuk mund të qëndronim më vetëm. Ne kemi ardhur në Kamëz për një jetë më të mirë dhe për të qëndruar afër me fqinjët tanë. Meqenëse asnjë tokë s'ka mbetur, ne jemi të detyruar të marrim me qira shtëpitë e përdorura për strehë nga një mik që erdhi para vitit 2000. Kushet ekzistuese janë shumë bazike dhe ne ndihemi të huaj. Ne kemi filluar të kuptojmë se pa një titull të qartë të pronës, nuk kemi as përfitime sociale."

Migrant, qytet-rajoni Tiranë, maj 2008.

Megjithatë, të drejtat pronësore nga një ide abstrakte, siç ishin për dekada të tëra, gjatë tranzicionit ato janë duke u mobilizuar dhe kategoritë e ndryshme kërkojnë të përfshihen në tregun e lirë të tokës. Kjo mënyrë jetese po arrihet nëpërmjet përdorimit të një numri strategjish. Strategjitë lokale të kategorive të ndryshme në lidhje me të drejtën e pronësisë janë praktike dhe njohuritë e tyre lokale për pronën, ndihmojnë komunitetin në tërësi për të mbijetuar.

Dije të jetesës lokale

Sipas Sykora (2004), i cili ka kryer punime shkencore në qytetet socialiste në tranzicion, mospërputhja hapësinore midis vendndodhjes së vendeve të punës dhe rezidencat, kontribuojnë në rritjen e lëvizjes së punës në zonat metropolitane. Në rastin e Shqipërisë, zgjidhja e vetme për njerëzit e varfër ishte shtimi dhe ndryshimi i pallateve parafabrike (ndërtuar gjatë sistemit komunist) dhe ndërtimi i

paligjshëm, pas 1992, një prirje që u përhap kryesisht në të gjithë vendin. Për shkak të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe zhvillimit të parregulluar tokës, zonat periferike të Tiranës kanë marrë një pamje krejtësisht të re karakteri. Përdorime të tokës bujqësore i hapën rrugë banimeve dhe fushës së ndërtimit (Aliaj et al. 2003: 89).

Intervista gjysmë të strukturuar dhe vëzhgimi pjesëmarrës adreson çfarë presionesh të reja janë krijuar në qytet rajonin -Tiranë për shkak të pronës private dhe zhvillimit të tokës. Këto presione formojnë një lloj të ri tensioni dhe një lloj të ri konflikti lidhur me zhvillimin e hapësirave të reja periferike. Bazuar në gjetjet, arrijmë në përfundimin se teoritë e veçanta nuk mund të jenë të dobishme në shpjegimin e proceseve specifike në konfigurimet e veçanta urbane në qarkun e Tiranës. "Travel theory" (përmes procesit të neoliberalizmit) në Shqipëri prodhon konflikte rreth mënyrave të rregullimit të ndryshëm të të drejtave të pronësisë.

Natyrë informale e zhvillimit periferik është një mënyrë e sigurimit të pasurisë dhe qasje e jetesës (Bertaud, 2006). Pritet që hapësirat e reja periferike të rirregullimit të reflektojnë bashkëveprimin e strukturave të trashëguara ligjore dhe administrative të Shqipërisë me presione të reja të zhvillimit të tokës në sistemin e tregut të lirë. Duke pasur akses në pronën, banorëve dhe migrantëve u është dhënë një stekë në mënyrën sesi komunitetet e tyre ofrohen dhe prandaj prona dhe rregullimi i përdorimit të tokës bëhet një mënyrë për të konsoliduar mënyrën e jetesës.

Tranzicioni postsocialist është një proces i gjerë, kompleks dhe i gjatë i ndryshimit shoqëror. Smith dhe Stenning (2002) diskutojnë praktikën e komunitetit dhe të familjeve për të menaxhuar rritjen e përjashtimit social në ekonomitë posttranzitore. Ata fokusohen në rolin strategjik të familjeve në praktika të tilla, si dhe për identifikimin e praktikave antropologjike. Në ekonomitë urbane tranzitore, të drejtat pronësore në Europën Juglindore lidhen me përdorimin, shkëmbimin e tokës, pronës private dhe rregullimin e hapësirës urbane dhe suburbane. Këto në kthim reflektojnë në mënyra komplekse nga të cilat sigurohen mënyrat e jetesës.

Disa nga përfundimet: vënia në funksionim e së drejtës së pronësisë u dha mundësi migrantëve të përballen me sfidat e mënyrës së jetesës në Bashkinë Kamëz. Megjithatë, në një kontekst të tranzicionit këto sfida janë bërë më të vështira nga kontradikta rreth të drejtave pronësore. Edhe pse njerëzit në ekonomitë në tranzicion kanë rritur aksesin ndaj pronës private, ende ekzistojnë presione që të rregullojnë pasurinë e cila krijon tensione rreth këtyre strategjive të jetesës që varen nga pronësia dhe aksesin në të drejtën e pronës private.

Konkluzione

Rënia e sistemit komunist u shoqërua me ndryshime e transformime urbane në Europën Juglindore. Ajo që në ditët e sotme bëhet gjithnjë e më e qartë është se ndryshimi postsocialist urban nuk është një proces i thjeshtë evolutiv udhëhequr

nga një pikë e njohur e nisjes (socializmi shtetëror) drejt një destinacioni. Zhvillimi i qyteteve në rajon është i larmishëm dhe këto ndryshime mund të rrjedhin nga shtigjet e reformës ekonomike të zgjedhur gjatë tranzicionit, ndryshime në preferencat rezidenciale dhe tranzicioneve urbane dhe jo më pak, struktura të trashëguara nga epoka socialiste. Qëllimi i këtij artikulli është të investigojë mënyrat divergjente të transformimeve urbane që nga rënia e socializmit në Europën Qendrore-Lindore duke identifikuar rolin e faktorëve lidhur me trashëgiminë dhe tranzicionin në “Travel theory” në kontekstin shqiptar.

Artikulli duke mbledhur disa nga arritjet e shkollave perëndimore dhe lindore për të shkëmbyer idetë dhe arritjet në lidhje me problemet e ndërsjella të vendeve në tranzicion në rrjedhën e transformimit urban. Debati neoliberal ka dominuar analizën politike në qytetet postsocialiste. “Travel theory” i Said-it (1983), si një aspekt i rëndësishëm i prodhimit të njohurive shpjegon zhvendosjen e ideve në vendet kulturore ose kombëtare të ndryshme. Tërhequr nga “Travel theory” Said, Smith (2006) sugjeron se teoria e tranzicionit udhëton në një ritëm të ndryshëm në vende të ndryshme postsocialiste. Pickles dhe Smith (2006) sugjerojnë se njohuritë neoliberale duket se kanë strukturuar të menduarit në lidhje me vendet postsocialiste në mënyra më të fuqishme sesa modelet e zhvillimit demokratiko-social dhe të ekonomisë kritike politike.

Ky artikull mori në shqyrtim vetëm një nga dy aspekte të Travel theory”, atë sesi janë interpretuar, negociuar dhe kontestuar teoritë e shkollarëve perëndimorë në praktika të ndryshme (sub)urbane të qytet rajonit- Tiranë. Supozohet se teoria e tranzicionit duhet të jetë në gjendje të “përshtatet” në çdo qytet postsocialist. Analiza e të dhënave tregon se kjo teori nuk “përshtatet” mirë brenda kontekstit të Shqipërisë. Duket se “Travel theory” duhet të përshtatet dhe të modifikohet sipas kontekstit lokal historiko-kulturor dhe këto strategji dhe teori duhet të përshtaten dhe fiksohen kundrejt kufizimeve të tilla dhe jo anasjelltas.

Ky artikull hedh dritë mbi zgjerimin e njohurive mbi politikat urbane të vendeve në tranzicion dhe mbi urbanizmin neoliberal duke treguar si strategjitë e jetesës edhe përpjekjet mbi të drejtat e pronësisë në zonat urbane dhe në hapësirat periferike urbane të Tiranës. Politikat e hapësirës së jetesës (sub)urbane në qytet-rajonin Tiranë janë thellësisht të kontestuar. “Neoliberalizimi” i zhvillimit urban në Shqipëri duket se ka prodhuar konflikte rreth rregullimit të zonave (sub)urbane.

Teoritë urbane neoliberale (perëndimore) nuk udhëtojnë mirë në Shqipëri. Në tërësi, ato dështojnë të vlerësojnë në mënyrë adekuate sesi tranzicioni postsocialist zhvillohet në një kontekst të shtetit të dobët si qytet-rajoni Tiranë. Në këtë artikull ne argumentuam një alternativë për sfidën e “Travel theory” që është ripërtëritja e imagjinatës historike, e cila sfidon tendencat totalizuese jo vetëm në teoritë e qyteteve socialiste, por edhe në ato të tranzicionit postsocialiste.

Në fakt, konstatimet sugjerojnë se teoritë neoliberale të zhvillimit urban negociohen në mënyra të ndryshme dhe janë sfiduar dukshëm nga konteksti

tranzitor në Shqipëri. Si një humultuese shqiptare gjej mënyrën e aplikimit të modeleve më të gjera të Europës Lindore të tranzicionit postsocialist në Shqipëri në mënyrë jokritike: Çështja unike shqiptare kërkon njohje.

Bibliografia

- Abitz, J. (2006) *Post-Socialist City Development in Tirana*, Speciale internationale udviklingsstudier, Roskilde Universitet, Vejleder: Steffen Jensen. Marrë nga: <http://rudar.ruc.dk/bitstream/1800/2321/1/Postsocialist%20city%20development%20in%20pdf>.
- Andrusz, G., Harloe, M. and Szelenyi, I. (eds) (1996) *Cities after socialism-Urban and Regional Change and Conflict in Post-socialist Societies*, Oxford: Blackwell.
- Aliaj, B. et al. (eds) (2003) *Tirana: The Challenge of Urban Development*, Tirana: Cetis Press.
- Andoni, D. (2000) “Factors influencing the performance of cities, Historic Values and the role of politics – Case of Albania”, Paper presented on Conference: *Urban and Regional Research: Redefining the Public Interest for Territorial Development in the UNECE Region*.
- Andoni, D. (2007) “The paradigm of Legalization – a Paradox or the Logic of Development”, Paper presented at *-Informal Settlements – Real Estate Markets Needs Related to Good Land Administration and Planning* FIG Commission 3 Workshop, Athens, 1-10.
- Andoni, D. (2010) *Informal development solutions in Albania* – Summary report, Informal urban development in Europe – experiences from Albania and Greece, United Nations.
- Bardhoshi, N. (2009) “Njeriu i Kanunit” në një Shoqëri post-socialiste, *Polis 8 - Media dhe Politika*, Universiteti Europian i Tiranës, f. 114-132.
- Bertaud, A. (2006) “Urban development in Albania: the success story of informal sector”, Marrë nga: http://alainbertaud.com/AB_Files/AB_Albania%20Urban%20informal%20Sector%20paper.pdf: 1-19 (Accessed January 2008).
- Childress, D. M. (2006) “The unfinished business of land and property reform in Albania” In: Bezemer, J. D. (ed) *On eagle's wings: The Albanian economy in transition*, New York: Nova Science Publishers, Inc.: 115-129.
- Childress, D. M. (1999) Trip Report: Eastern Europe and Eurasia and Central America - Albania, Kyrgyz Republic, Russia, Nicaragua.
- Clunnes-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*. Aldershot: Ashgate.
- Co-PLAN Centre for Habitat Development (2002) “Strategic Urban Development Plan of the Municipality of Kamza”, Marrë nga: <http://www.logincee.org/remote/libraryitem/23720?lang=en>

Council of Europe (CoE) (2008) "Kamza, development strategy, 2008-2015", Tirana, Marrë nga: <http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/CentreExpertise/Programmes/AlbaniaKamezPlan.pdf>. Parë për herë të fundit më 20/11/2008.

Economic Commission for Europe- ECE (2002) Country Profile on the Housing Sector – Albania, Available At: www.logincee.org

Enyedi, G. (1990) "Specific Urbanization in East-Central Europe", *Geoforum*, **21**(2): 163- 172.

Felstehausen, H. (1999) "Urban Growth and Land Use Changes in Tirana, Albania: with Cases Describing urban Land Claims", *Working Paper on Albania series*, No.31, Madison: Land Tenure Center, University of Wisconsin: 1-24.

Hall, D. (1999) "Rural Diversification in Albania", *GeoJournal*, **46**(4): 283-297.

Hartkoorn, A. (ed) (2000) *City Made by People*, Tirana: CoPlan, Centre for Habitat Development

IMF (International Monetary Fund) (2006) *Albania- Selected issues*, IMF Country report No. 06/285, Marrë nga: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2006/cr06285.pdf>. Parë për herë të fundit më 10/03/2008.

Milanovich-Pichler, N. (1994) "The Role of Housing Policy in the Transformation Process of Central-East European Cities", *Urban Studies*, **31**(7): 1097-1115.

Milanovich-Pichler, N. (1996) "Response to 'Comments on the Role of Housing Policy in the Transformation Process in Central East European Cities'", *Urban Studies*, **33** (1): 117-123.

Murray, P. and Szelenyi, I. (1984) The City in the transition to socialism, *International Journal of Urban and Regional Research* **8** (1): 90-107.

Nientied, P. (1998) "The Question of Town and Regional Planning in Albania", *Habitat International*, **22** (1), 41-47.

Pickles, J. and Smith, A. (eds) (1998) *Theorising Transition: the Political Economy of Post-Communist Transformation*, London and New York: Routledge.

Pickles, J. and Smith, A. (2005) Post-socialism and the Politics of Knowledge Production, **In:** Tickell, A. et al. (eds) *Politics and Practice in Economic Geography*, London, Sage Publications: 151-162.

Said, E. (1983) *Secular Criticism: Critical Theory since 1965*, London: Vintage.

Smith, A. (2004) "Regions, Territories and Diverse Economies in New Europe", *European Urban and Regional Studies*, **11**: 9-25.

Smith, A. (2006) Beyond Household Economies: Articulations and Spaces of Economic Practice in Post-Socialism, *Progress in Human Geography*, **30** (2): 190-213.

Smith, A. (2007) Articulating Neoliberalism: Diverse Economies and Everyday Life in Postsocialist Cities, **In:** Leitner, H., Peck, J. and Sheppard, S. E. (eds.) *Contesting Neoliberalism: Urban Frontiers*, pp. 204-222, New York: The Guilford Press.

Smith, A. and Timar, J. (2010) "Uneven transformation: Space, Economy and Society after 20 years after the collapse of state socialism", *European Urban and Regional Studies*, **17**: 115-125.

Stenning, A. (2003) Shaping the economic landscapes of postsocialism? Labour, workplace and community in Nowa Huta, Poland, *Antipode*, **35**(4), 761-780.

Sykora, L. (1999) "Processes of Socio-spatial Differentiation in Post-communist Prague", *Housing Studies*, **14** (5): 679-701.

Sykora, L. (2006) "Urban Development, Policy and Planning in the Czech Republic and Prague", **In:** Altrock, U. et al. (eds) *Spatial Planning and Urban Development in the New EU Member States: from adjustment to reinvention*, Aldershot: Ashgate, 113 - 140.

Sykora, L. (2008) "Revolutionary Change, Evolutionary Adaption and New Path Dependencies: Socialism, Capitalism and Transformations in Urban Spatial Organizations", **In:** City and the Region Papers in honour of Jiri Musil, Leverkusen: Opladen Budrich Unipress and Farmington Hills, 283-295.

Sykora, L. (2009) "Post-Socialist Cities", **In:** Kitchin, R. And Thrift, N. (eds) *International Encyclopedia of Human Geography*, Elsevier: 387-395.

Szelenyi I (1996) "Cities under Socialism—and after", **In:** Andrusz, G., Harloe, M. and Szelenyi I (eds) *Cities after Socialism - Urban and Regional Change and Conflict in post-socialist Societies*, Oxford: Blackwell, 286-317.

Tsenkova, S. (2006) Housing Policy and Housing Markets in South East Europe: Nations of Homeowners, ENHR conference 2006 Ljubjana.

Turnock, D. (1996) Agriculture in Eastern Europe: Communism, the Transition and the Future, *GeoJournal* **38**(2): 137-149.

Wheeler-Sabates, R. & Waite, M. (2003) "Albania Country Brief: Property Rights and Land Markets", Land Tenure Center, Under Subcontract to Development Alternatives, Inc. Financed by (USAID) US Agency for International Development, BASIS IQC LAG-I-00-98-0026-0. Marrë nga: <http://www.minds.wisconsin.edu/browse?rpp200etal1typedateissuedsortbyorderDESC&offset6200>. Parë për herë të fundit më 11/11/2007.

Dëshira e "Tjetrit" si indikator për të lexuar vuajtjen psikike ose mutacionet bashkëkohore në lidhjet sociale

Dokt. Klodiana Turhani¹

Abstrakt. *Nëpërmjet konceptit të « Dëshirës së Tjetrit », do të përpigemi të kuptojmë se si shpalosen proceset e prindërimit në rastin e një gruaje që bëhet nënë. Për të kuptuar Dëshirën e tjetrit si koncept duhet që së pari të analizojmë funksionin e Tjetrit, Për këtë do të referohemi punimeve të psikanalisteve freudian, postfreudian. Nisemi nga paradigma se një nga funksionet e Tjetrit janë përfaqësimet imgjinare që subjekti ka ndaj tij dhe se Tjetri ka funksion reference mbi subjektin. Tjetri është një vend ku subjekti flet dhe i adreson ankesën e tij. Në fund të fundit se, si pa Tjetrin, s'mund të ketë kuptime.*

Rasti konkret që, do të prezantohet do të ketë në fokus studimin e rastit të një gruaje të intervistuar para dhe mbas shtatzanisë. Dëshira e kësaj gruaje është të lindë një fëmijë djalë. Dëshira për të patur një fëmijë djalë shkon deri aty sa, ajo mohon arritjet e shkencës duke venë në pikëpyetje rezultatet e « Ekove gjenekologjike », të cilat, përcaktojnë që në paralindje gjininë e fëmijës. Përballë këtyre dilemave, ajo zgjedh të mohojë të vërtetën e servitur nga teknika ose « të vërtetën shkencore » dhe preferon sistemin që mund ti japi shpresë ose « besimin në zot ».

Pyetja e këtij studimi është se a kemi ndryshime themelore në ligjërimin social për sa i përket mënyrës se si gruaje shpreh dhe krijon dëshirën e saj si prind dhe si ndikon teknologjia në këtë drejtim. Për të qenë më konkrete në analizën rreth Dëshirës së Tjetrit do të analizojmë proceset shndërruese në të shprehurin e « dëshirës » duke marrë si rast studimi, « Dëshirën e tjetrit në procesin e të bërit nënë », në një periudhë ku teknologjia përdoret për të ditur para se të lind fëmija çfarë seksi ka

¹ Klodiana Turhani është doktorante në vitin e tretë në Universitetin Nice Sophia-Antipolis për psikologji klinike dhe psikopatologji. Punon si pedagoge e brendshme në Universitetin European të Tiranës.

fetusi. Ardhja në jetë e një fëmije femër jo e dëshiruar nga Tjetri social, sjell në jetën e gruas, nënës një konfuzitet ndjenjash dhe mohimesh mbi realitetit. Si grua e një burri, ajo refuzon seksualitetin e fëmijës dhe dëshiron të vetë sakrifikohet që dëshira të realizohet. Si nënë, ajo gjenden midis dëshirës për ti dhënë jetë këtij fëtusi çfarë do të jetë seksi i fëmijës por, duke shpresuar se dëshira e saj do të plotësohet.

Fjalë kyçe: Tjetri, Tjetri social, ligjërimet, fakti klinik, gruaja, amësia, subjektiviteti, teknologjia.

Hyrje

Në këtë studim do të flasim për rëndësinë që ka koncepti i Tjetrit për fushën e psikologjisë klinike, e cila ka objekt studimi individin, mënyrën sesi ai identifikohet, pra si e përfaqëson veten, ambivalencat që ai ka në raport me veten dhe me Tjetrin. E gjithë kjo dinamikë e manifestuar apo e fshehur mbi përfytyrimet që individit ka mbi veten është e ndikuar nga mënyra sesi individit pozicionohet në raport me Tjetrin parësor (nëna), dhe Tjetrin social që mund të jetë babai ose dhe të ngjashmit e tjerë, të cilët kanë një kuptim simbolik për individin. Të studiosh konceptin e subjektit në fushën e psikologjisë klinike ka dy mënyra: njëra është nëpërmjet praktikës klinike dhe tjetra nëpërmjet punës kërkimore ose punës në terren. Këtu do të analizohen të dhëna të mbledhura nga punë kërkimore në terren². Shkencat sociale dhe humane janë marrë shumë me debatin mbi raportin mendje/trup, por Lacan (1967) ka një këndvështrim kritik duke thënë se ndarja qëndron midis psikikes dhe logjikes dhe jo midis fizikes (që kupton biologjiken, trupin) dhe psikikes. Pikërisht në këtë punim koncepti i Tjetrit do të na shërbejë për të folur mbi debatin që është zhvilluar në fushën e psikologjisë klinike, e cila është e influencuar nga psikanaliza mbi mënyrën sesi është i strukturuar *subjekti* nga dëshira e Tjetrit.

Paradigma dominante e psikologjisë klinike është që « Dëshira e njeriut është dëshira e Tjetrit » dhe që subjekti banon në gjuhën dhe se vetë kuptimi, të themi gjuhësor, krijohet duke pasur si seli kuptimi Tjetrin.

Pra, qëllimi ynë nuk është të analizojmë Tjetrin social si kategori empirike, por të kuptojmë individin si pjesë e sociale. Nuk mund të themi se kemi një Tjetër imagjinar si sistem besimi fiks, por mund të sugjerojmë që Tjetri negociohet nga individit sipas konteksteve sociale në të cilat gjendet apo me të cilët ndeshet.

² Të dhënat empirike, të analizuar në këtë punim janë rezultat i punës kërkimore në projektin « Prévention en périnatalité. Etude comparative interculturelle de l'attente des femmes et des hommes d'aujourd'hui en période périnatale, au regard de la démarche préventive d'éducation à la parentalité » Convention Uds/INPES n°133/09DAS të drejtuar nga prof. Claude Schauder me drejtim shkencor prof. Serge Lesourd. Të dhënat etnografike janë mbledhur gjatë dy ekspeditave të realizuara në verën e vitit 2009-2010 në verilindje të Shqipërisë dhe Kosovë në kuadrin e projektit kërkimor mbi babanë..

Për të kuptuar më mirë se çfarë po ndodh në kontekstin/et shqiptarë/re, para dhe mbas viteve 1990-të, mendoj se leximi nëpërmjet faktit klinik na ndihmon për të analizuar “faktin social” si produkt të subjektives. Rasti konkret, që do të prezantohet, do të ketë në fokus studimin e rastit të një gruaje të intervistuar para dhe mbas shtatzënisë. Dëshira e kësaj gruaje është të lindë një fëmijë djalë. Dëshira për të pasur një fëmijë djalë shkon deri aty sa ajo mohon arritjet e shkencës duke venë në pikëpyetje rezultatet e « Eko-ve gjinekologjike » të cilat përcaktojnë që në paralindje gjininë e fëmijës. Përballë këtyre dilemave ajo zgjedh të mohojë të vërtetën e servirur nga teknologjia bashkëkohore ose « të vërtetën shkencore ». Në vend të dijes ekzakte ose kuazi-ekzakte, që servir teknologjia, ajo preferon sistemin që mund t'i japë shpresë për plotësimin e dëshirës së Tjetrit (në këtë rast burri i saj) dhe ky sistem është një trajtë kulturore dhe njëherazi subjektive e besimit në Zot. Thënë kështu, si besimi në Zot, ashtu sikurse dhe leximi i dijes teknologjike merr kuptimet e veta lokale dhe personale. Prandaj dhe në nivel social apo kulturor subjektivja vjen dhe bëhet temë qendrore për të analizuar të tërën sociale. Për arsye etike, emri i gruas që do të përdoret në këtë punim është një pseudonim dhe do të quhet Fiona.

Nëpërmjet konceptit të « Dëshirës së Tjetrit », do të përpiqemi të kuptojmë jo vetëm dëshirën e Tjetrit, por dhe sesi shpalosen proceset e prindërimit në rastin e një gruaje që bëhet nënë, e gjendur përballë ambivalencave dashuri/urrejtje (Kristeva 2011). Njeriu është një qenie “neotene” e varur nga mjedisi social gjatë dy viteve të tij të para. Subjekti, “subjekti i pandërgjegjshmes”, individit, personaliteti nuk lind, ai formohet kur individit fillon dhe hynë në gjuhë, kur ai fillon ta banojë gjuhën, fillon ta përdorë gjuhën si një mjet për të shprehur ambivalencat e mendimeve të tij. Që nga momenti që fëmija vjen në jetë ai është i varur totalisht nga Tjetri, si për sa i përket realizimit të kënaqësive të tij, ashtu edhe për sa i përket dëshirave.

I. Një draft teorik mbi dëshirën e "Tjetrit", tjetrin dhe kulturoren

Në një numër të revistës mbi *Figurat e Psikanalizës* (2009) zhvillohet një debat me rastin e 100- vjetorin të lindjes së Levis-Strauss. Ky debat i gjerë zhvillohet në mes dy lëmeve të dijes mbi njeriun, respektivisht mes antropologjisë dhe psikanalizës. Këto dy fusha janë marrë dhe merren shumë me konceptin e Tjetrit. Ky debat ishte një kujtesë për studimet në të dyja këto fusha se njeriu nuk mund të kuptohet dhe as të analizohet pa mbajtur parasysh rezultatet më provokuese teorike të dy perspektivave: ajo se njeriu është dhe asaj çfarë njeriu ndien mungesë. Në qoftë se antropologjia si fushë studimi ka si subjekt studimi “njeriun”, psikanaliza ka si objekt studimi çfarë i mungon njeriut. Në qoftë se antropologjia sociale në përgjithësi ka pasur si objekt studimi kolektiven njerëzore, psikologjia klinike me referencë teorike psikanalizën ka si fokus studimi individualitetin. Prandaj, në periudhën

e studimeve poststrukturaliste, të dyja këto fusha ritakohen në shqetësimin rreth nocionit e subjektit. Kuptohet, secila fushë rimodelon në mënyrën e vetë konceptet klasike midis individit dhe kolektives.

Siç do të shohim më poshtë, paradigma e marrë prej psikologjisë klinike dhe që aplikohet këtu si hipotezë kryesore, domethënë: “Dëshira e subjektit është dëshira e Tjetrit”, flet për këtë mungesë, e cila e strukturon subjektin dhe e ndihmon atë të ripozionohet në lidhje me dëshirat e tij të cilat mund të shkojnë deri përtej kënaqësisë. Por është pikërisht koncepti i mungesës dhe i “jo-ve” që i vijnë nga mjedisi social (si fillim, është nëna e cila fillon të dëshirojë dikë tjetër, babi, pastaj të Tjerët sociale) që bëjnë që subjekti të zhvendoset nga një problematikë ku ai ishte objekti i dëshirës së nënës, në një subjekt në mungesë, sepse subjekti nuk zotëron atë çfarë nëna dëshiron të cilin e ka Tjetri. Pra, fëmija/subjekti në këtë rast, kalon nga pyetja “çfarë më dëshiron kjo?” te pyetja “çfarë dëshiron Tjetri që unë nuk e kam?”. Por fjala kyç që vjen në këtë rast është se në gjithë këtë lojë dëshirash, luhet krijimi i subjektit.

Lakani (1958) shkruan « Se dëshira për subjektin rezulton nevojë për të kaluar nëpërmjet manifestimit të asaj që ka marrë kuptim për të « i shënjuari ». Ky vend që është “shënjuar” është i banuar nga subjekti që ka një dëshirë enigmatike, e cila është dëshira e Tjetrit”. Janë shqetësime teorike se cila është dëshira e Tjetrit dhe çfarë i mungon Tjetrit, që i mundësojnë subjektit të përfshihet në rrugëtimin për të simbolizuar ndryshimet midis sekseve, problematikës së kastrimit dhe proceseve edipiane, që bëhen objekt i një analize të hollësishme të këtij autori (Lacan 1972-1973). Lakani jep një interpretim topologjik të konceptit të Tjetrit³. Sipas tij, Tjetri duhet përkufizuar si selia⁴e ligjërit. Jo si vendi ku shqiptohet fjala, por si vendi ku merr vlerën e vet ligjërimi. (Lacan 1968:54) Por Tjeri, dhe logjika e dëshirës janë të lidhura bashkë. Ai shkruan “...që dëshira është pasojë e nyjetimit të gjuhës në nivelin e Tjetrit [...] - dëshira, me një fjalë është gjithnjë dëshira e Tjetrit. Çfarë do të thotë se ne gjithnjë ia kërkojmë Tjetrit dëshirën e vet.” Por pyetja që lind është “Nëse dëshira përftohet në fushën e Tjetrit dhe nëse “Dëshira e njeriut është dëshira e Tjetrit” (Lacan 1968:57) atëherë pyetja që ngrihet është çfarë ndodh me dëshirën e tij. Lakani shkruan se kur njeriut i

duhet të hyjë në gjuhë konstaton se: “Kur dëshira e njeriut nxirret nga fusha e Tjetrit për t’u bërë dëshira ime, ndodh diçka e çuditshme. Tani që është radha ime për të dëshiruar, unë vë re që qenkam kastruar”. Pra kupton që më mungon realizimi i dëshirës sime dhe dëshira e Tjetri ka vënë poshtë dëshirën time, për faktin se, individ i është një subjekt “néotène” që gjatë dy viteve të para është i varur nga Tjetri social/mjedisor.

Lakani, gjithashtu shpjegon se kur flitet për dëshirën e subjektit për Tjetrin ajo nuk mund të zotërohet, ajo nuk mund të jetë diçka që e kemi, ajo nuk është një organ (biologjik), që mund ta kontrollojmë, nuk mund të jetë as të “Jesh” as ta “Kesh”. “Phallusi”⁵ shërben për diçka që funksionon në rrafshin e dëshirës, ai është objekt i humbur, sepse ai vjen në vend të subjektit në trajtën e dëshirës. Sipas Lakanit, Tjetri duket i ndarë midis selisë së të vërtetës (aty ku nis dëshira e subjektit të pandërgjegjshëm) dhe selisë së dëshirës së Tjetrit . Po kështu, edhe subjekti është i ndarë, midis së vërtetës biologjike, që është trupi fizik, dhe dëshirës së tij. Për ta thënë më ndryshe, subjekti është i ndarë midis Individit biologjik (natyrë) dhe Subjektit të dijes (kulturë). Kur ai hynë në gjuhë është një individ në mungesë. Sipas Lakanit “subjekti farkëtohet nga një varg i caktuar nyjetimesh që kanë ndodhur, dhe bie nga zinxhiri shënjuar njëloj sikurse bie fruti i pjekur nga dega. Sapo ai vjen në botë, ai bie nga një zinxhir shënjuar, që mund të jetë fare mirë i ndërlikuar, ose të paktën i nyjetuar, dhe ajo çfarë ne e quajmë dëshirë e prindërve të tij i nënvendoset të njëjtës zinxhir. Do të ishte e vështirë të shpërfillje këtë kur është fjala për lindjen e tij, sidomos kur dëshira ishte, pikërisht, që ai të mos lindte.” (Lacan 1968: 62). Që të dalë nga kjo varësi që ka me Tjetrin, Subjektit i duhet në çdo hap të shpëputet duke formuar vete të ndryshme nga ajo që të tjerët kanë projektuar tek ai. Winnicott 1960 e thotë bukur kur do të bëjë dallimin midis “Vetes së stisur” (“False self”), ku Subjekti është i influencuar prej dëshirës së Tjetrit dhe “Vetes së vërtetë”, “True Self” ku Subjekti negocion dhe synon që dëshirat e tij të realizohen. Por që Subjekti të funksionojë, ai funksionon mirë vetëm kur ndahet prej dëshirës jo të tij, por prej dëshirës për t’u bërë pjesë e sociale (funksionimi normale/nevrotik i cili është një ligjërime në ankesë ndaj Tjetrit i cili nuk është i ngjashëm.

Lakani na flet edhe për subjektin “parlêtre”/ “subjekti që flet” subjekti i cili ka vendosur të bëhet pjesë e kulturës. “Por ky subjekt “parlêtre” nuk mund të jetë kurrë nismëtar i ligjëratës së vet, ngaqë, si i ndarë që është, ai mbetet i lidhur me atë subjektin tjetër-subjektin e së pandërgjegjshme, i cili në fakt ekziston i varur nga struktura gjuhësore. Pikërisht ky është zbulimi i të pandërgjegjshmes.” (Lacan 1968:74). Më poshtë do t’i rimarrim këto

⁵ Lakani ka parasysh me "phallusin" simbolin libidinal që i përfaqëson të dyja seksat.; shënjuar, i cili përmbledh në tërësi të gjitha efektet që shënjojnë subjektin dhe në mënyrë më specifike emërton humbjen dhe "riemërtimin" e seksualitetit me hyrjen në gjuhë. Dictionnaire de la psychanalyse. Larousse Chemama. R.Vandermersch. B.Paris: 2005, f. 312-313.

³ Në artikullin e Frédérique Berger et al.(2009) "Subjekti dhe lidhjet sociale bashkëkohore" në revistën Cliniques méditerranéennes 1/2009 (n° 79), p. 279-295. Berger, shpjegon se Lakani kur na flet për subjekt ka parasysh "subjektin e pandërgjegjshëm" i cili ka disa staturë: si topologjikë, i ndarë midis dëshirës së vetë dhe të Tjetrit; topikë, si supozime midis instancash "Kjo", Uni, "Mbiuni"; dinamikë ku veprojnë mekanizmat mbrojtës për të mbrojtur unin; ekonomikë raporti midis dëshirës/jouissances; etikë sjellja e parë në një këndvështrim gjeanallogjik midis dinamikës "infantil" /i përgjegjshëm. ” f. 28

⁴ Lakani me konceptin "selie" kupton se Tjetri, është vendi ku merr kuptim fjala, pika kyçe ku ngjizet mendimi. Koncepti në frëngjisht është "lieu de trésor" që e përkthyer fjalë për fjalë do të thotë "vendi i thesarit".

argumente duke i sjellë në fillim në rolin që ka Tjetri dhe në një kohë të dytë do të sjellim një parashtrim mbi mënyrën sesi ndërtohet subjekti, “subjekti i pandërgjegjshëm duke e sjellë debatin midis individit dhe kulturës nëpërmjet rastit të studimit të Fionës.

II. Në mes të "Tjerëve": rasti i Fionës në një shoqëri posttotalitare ose postgjithëshpjeguese

Pak vite para se Shqipëria të hynte në kozmosin e shoqërive liberale, lindja e fëmijës dhe shtimi i popullsisë ishte sa një shprehje e diapozitivit fisnor, aq dhe një dëshirë e diapozitivit shtetëror. Nga ana tjetër, edhe pse shoqëria totalitare deri në vitin 1990-të të shek. XX kishte inkurajuar barazinë gjinore, në kontekstin e përpjekjeve për të krijuar një shoqëri lufte/revolucionare, gjithsesi kjo shoqëri tipin e saj ideal kishte mashkullin. Aborti ishte thuajse tabu, shtimi i numrit të popullsisë shikohet si një shenjë suksesi e gjithë shoqërisë, e favorizuar nga politika « nataliste ». Kurse në kohën kur isha duke realizuar kërkimin tim, Shqipëria cilësohet në një raport të Komitetit European si vendi ku balancat gjinore po prishen si rezultat i aborteve selektive ndaj gjinisë femër. (Raport, Gendercide: The missing Women? DEVE. European Parliament 2012). Shqetësimi i këtij raporti ishte se rritja e lartë e numrit të aborteve selektive të programuara, po çon drejt asaj që Héritier do ta quante, të një risku antropologjik, (Héritier 2013). Sot, vetëm me një hap mundësohet selektimi i embrionit për të përzgjedhur seksin e fëmijës. Për të vijuar me shënimet e Héritier, ne si shoqëri përballemi me teknika moderne të cilat na prezantohen si përkushtim për të kënaqur nevojat dhe dëshirat femërore. Këto teknika kanë si objekt përsosjen e modelit duke vepruar mbi dy “mungesa” që njeriu nuk i zotëronte kohë më parë dhe së pari, njerëzit nuk kishin mundësi të dinin seksin e fëmijës së ardhshëm, dhe kjo shtonte probabilitetin që të kishim shumë lindje vajzash, sepse çifti ishte në kërkimin e lindjes së djalit. Së dyti, në shoqërinë së cilës i mungonte dija e tanishme shkencore, askush nuk mund të thoshte me siguri se bashkëshorti është prindi i fëmijëve të cilin ai ka rritur. Kjo mund të realizohej vetëm në qoftë se e mbyllje femrën brenda. Sakaq, kultura i ishte përgjigjur ndryshe kësaj mungese dhe dëshire për djalë. Dëshira për djalë, e parë kjo si një dëshirë për vijimin e trungut të fisit ose në fakt simbolikisht të vijimit të trupit të babait, kishte shpikur disa besime e institucione. Për shembull, edhe sot gjen njerëz që besojnë se vendosja e një emri të caktuar vajzës së fundit (për shembull, Shkurtë, Sose etj.) do të sillte lindjen e një djali. Besohej deri aty sa vajta ndër varre të shenjta me djep do të sillte lindjen e djalit të munguar. Sot, besohet se njerëz të mirë, fallxhorë etj., kanë forcën hyjnore për të sjellë në jetë një fëmijë të munguar, ose një djalë të munguar. Dikur kanë ekzistuar deri besime mbi barrën e vrame sipas së cilës fëmija i parë, i gruas që ishte rimartuar, do t'i kthehej bashkëshortit të saj tashmë të vdekur. E gjithë kjo për të

mos lënë pa trashëgimtar një burrë që kishte ndërruar tashmë jetë. (Tirta: 2006, 39). E thënë me fjalët e Fukosë, ky është konteksti ku diapozitivi fisnor mbizotëron dhe kërkon që ta strukturojë kulturalisht dëshirën e Tjetrit/Baba. Ndryshe nga ndokush, që mund të ketë pandehur, kjo dëshirë u struktura deri diku dhe në nivel shtetëror gjatë periudhës totalitare. Por ajo që ka më shumë rëndësi për rastin që po analizohet është se dëshira e Fionës është e kushtëzuar nga ky kontekst fisnor.

Më poshtë do të ilustruam, nëpërmjet rastit të Fionës, sesi përballët subjekti midis dëshirës për të lindur një djalë dhe kujt ia adreson ajo këtë dëshirë. Ambivalencat që ka ajo si nënë midis dëshirës së saj dhe ndjesisë së amësisë që ajo ka, është që pavarësisht seksit fëmija të lindë shëndoshë. Fiona është një grua 40- vjeçare, e cila jeton në periferi të Tiranës. Ajo si shumë shqiptarë të tjerë ka migruar, nga fshati i saj i thellë malor, para 10 vjetëve me burrin e saj dhe familjen e tij. Ajo jeton vetëm me dy vajzat në një vilë dykatëshe të cilën e ka ndërtuar burri i saj me lekët që ka fituar në emigrim. Vajza e madhe është 16 vjeç, vajza e dytë është 12 vjeç. Ajo beson në Zot dhe është praktikante e fesë katolike. Punon si edukatore në një kopsht privat. Dy lindjet e para i ka lindur në shtëpi (fshat). Vajza e madhe e pret jo mirë që ajo është shtatzënë me fëmijën e tretë. Ajo ka abortuar një herë para kësaj shtatzënie. Fiona e vuan faktin se i duhet të ngeli shtatzënë në atë moshë që ka por, tregon se edhe nëna e saj ka qenë shtatzënë kur ajo kishte moshën e vajzës së saj. Fiona është fëmija i madh i një familje me 3 vajza dhe 3 djem. Ajo dëshiron shumë që të lindi një fëmijë djalë. Ajo dëshiron që fëmija të lindi i shëndetshëm. Ajo dëshiron që familja e saj t'i ketë të dyja llojet e gjinive. Ajo thotë: “dy sekset s’është keq.”. Pastaj saktëson se dëshira e saj është që të ketë djalë:

(...)në fund të fundit prandaj dhe e ka nisur këtë fëmijë në moshën 40-vjeçare”. Që kjo gjë të ndodhi ajo shpreson që Zoti ta ndihmojë në dëshirën e saj që fëmija të jetë djalë sepse sipas saj: “Një çun edhe dy goca janë shumë mirë. Por, gjithsesi është diçka që nuk e ndryshon dot. E para e punës kam qejf që të jetë djalë trashëgimtar. Të njihemi edhe me djemtë, sepse është mirë që fëmijët t'i kesh të të dyja sekseve edhe gjatë rritjes edhe gjatë jetës. Si të gjithë njerëzit që t'i provosh. U desht edhe su desht... Të trashëgojë sepse çdo njeri nuk e lind fëmijën për veten e vet. Ai është dhurata e Zotit, fryti i dashurisë së tij. Në fund të fundit pa fëmijë as familja nuk i ka rrënjët e vendosura mirë si thuhet thafi. Gjithsesi dëshira ka qenë të ishte djalë. Dëshira është, por vetëm Zoti e di.” [...Fiona⁶....]

Ajo shton se: “Fëmija është dhurata për Tjetrin”. Kur flitet për dëshirë dhe për

⁶ Fiona është emri pseudonim i subjektit kërkimor. Me Fionën, janë realizuar 5 intervista gjatë shtatzënisë dhe 1 vit mbas lindjes. Në datat, 21/02/2011: Intervista ka zgjatur 1 orë e 54 minuta ; I-II, Datë,: 30/05/11 : 27 min ; I-III, Datë,28/07/2011: 36 min; I-IV, Datë :20/12/2011: 56 min; I-V, Datë, 11/09/2012, 1, orë et 30 min.

dhuratë ajo dëshiron që ajo të jetë e ndryshme, që familja e saj t'i ketë të dyja sekset, por kur ajo përballet me dilemën të japi jetë apo të marri jetë (gjatë shtatzanisë Fiona ka pasur disa shqetësime) ajo uron që fëmija të jetë i shëndetshëm. Por, dëshira për të lindur djalë e çon subjektin të vërë në pikëpyetje edhe ekzistencën e saj: Ajo në një moment shprehet: “Dëshira për të lindur djalë më është bërë fiksion pastaj le të vdes. Rëndësi ka që e realizova për këtë jetë.” Dinamikë që trajton problematikën e sakrificës. Pra të sakrifikohem unë, vetëm ti lind një djalë. Pra, në kozmologjinë ku ajo jeton mendon se për të ndodhur një mrekulli duhet të ketë sakrificë. Fiona uron shumë që t'i plotësohet bashkëshortit dëshira. Lindja e djalit do të ishte një mrekulli e madhe. Fiona thotë:

Burri e pyet me shaka: “A ke ndonjë bebe?” I them që për një e kam të sigurt, por për ndoshta mund t'i kesh edhe dy. Më thotë që po të linde gocë do të lë atje edhe nuk do të marr me vete (me atje nënkupton spitalin). Por edhe unë kam dëshirë që të jetë çun, por nuk i dihet. Megjithatë në qoftë se do të lindja djalë do të ishte një mrekulli e madhe. Edhe kur thotë kështu , jo që nuk e dua edhe unë sa ai, por them që më mirë të ishte një, se ti plotësohen më shumë dëshirat sesa dy. Edhe pse e mbaj brenda vetes. Por sido që të jetë, femra është më e ndjeshme sesa mashkulli. Edhe më duket sikur do ia plotësojë Zoti dëshirën. Ishalla. Shumë po mbaj shpresa, por tek ai moment i fundit, edhe të më thotë dikush djalë. [...Fiona. Intervista e tretë, Datë, 28/07/2011: 36 min ;...]

Edhe në rastin tonë të studimit realizimi i një aborti është prezent në mendimet e subjektit nga momenti që ajo merr vesh nga ekoja e parë që ka vajzë, por ajo zgjedhë të mos i tregojë askujt se çfarë ka dhe të shpresojë se Zoti do të bëjë mrekullinë duke i dhënë *dhuratë* një djalë. Dhe kjo dhuratë kalon nëpër trupin e saj për t'iu bërë dhuratë bashkëshortit të saj. Besimi i saj do të shkojë deri aty sa të vendosë të mbajë fëmijën. Kjo ndodhë edhe pse ajo do të bëjë edhe tri eko gjatë gjithë procesit. Ajo do të ndihet në mëdyshje midis asaj çfarë i thotë shkenca mbi fëmijën, dhe asaj që shkenca gabon, dhe asaj midis asaj çfarë thotë fallëxhorja, midis ndjesisë amësore për ta ruajtur fëmijën duke “uruar gjithmonë të jetë i shëndetshëm dhe mirë me shëndet dhe se për të si nënë nuk ka rëndësi se çfarë seksi ka”. Përfjetimet dhe gjendja para lindjes dominohet prej “dëshirës për të besuar se shkenca gabon dhe se Zoti bënë mrekulli”.

Ajo aludon se ka raste që nuk thotë të vërtetën, sepse gratë tregojnë se u kishin thënë për vajzë, por u doli djalë. Kur ajo nuk është mirë me shëndet nuk do ta dijë seksin, por të dijë a është mirë. Për të ka rëndësi e para e ekos por, heziton të përballet sepse ka frikë se do të marr vesh edhe seksin dhe do të ishte stresu. Fiona i bënë ekot, por është në dilemën midis asaj që i thonë dhe asaj që dëshiron dhe shëndetit të foshnjës. Motra i thotë që të mos u besojë ekove: “më thotë mos

i beso. Më tha që mos u beso ekove, sepse derisa të lirohesh nuk duhet t'u besosh.” Fiona është në kërkimin e një ekoje speciale që t'i thotë “. Por gjithsesi nuk e di për këtë. “Sinqerisht me patë gjet një mjek të mirë, një *eko speciale* me qenë e sigurt të më tregojë si një si dy, vetëm të më tregojë në detaje do e kisha bërë.” Fiona është në kërkimin e një “ekoje speciale”. Një ekoje që mund t'i thotë përgjigjen që ajo kërkon. Ajo i vë në dyshim të gjithë mjekët që i japin përgjigjen që ka vajzë, por mendon se një “eko speciale” ia vlen që ta bëjë dhe të paguajë.

Në këtë kozmologji pikash referimi, besimi te “Zoti”, “fallxhorja” etj., i mundësojnë asaj “shpresën” dhe e sigurojnë përkundrejt dyshimeve mbi dijen shkencore të mjekut, teknologjisë etj. Në fund të fundit, sipas saj, të gjitha këto dije shkencore barazohen me njeriun. Njerëzit gabojnë, Zoti jo. Pra, ky reflektim imagjinar i mundëson që ankthi që ajo po kalon duke u përballur me faktin shkencor “ se fetusin në bark është femër” dhe se doktoresha i thotë “se nuk mund të ndihmojë” të suportojë këtë shtazani që sjell në jetë një fëmijë femër. Së dyti burri dhe rrethi familjar i burrit si dhe i saj, flasin për rëndësinë që ka për ta që një familje ta ketë një djalë. Në të tria intervistat para lindjes, ajo përmend shpeshherë “burrin”, “vëhrrën”, “motrat”, “komshinjtë” si personat që ia kujtojnë faktin se ajo nuk ka djalë. Kur lindi vajzë, ajo replikon duke thënë se të tjerët ta kujtojnë vazhdimisht duke të thënë “A u mërziqe që linde vajzë!”. Ajo tregon sesi burrin e urojnë njerëzit “Hajtë me një çun.” Dhe si ai iu përgjigjet se “...nuk është në dorën tonë, ne nuk e kemi nisur për çun, në fund të fundit e kemi nisur për qejf. Kur ta fal Zoti një fëmijë duhet ta kesh shëndosh e mirë.”.:

Ai më thotë (burri) po sikur të na lindi vajzë. I them hej o burrë nuk të dalin çun ty. Po pse çun, ti deshe? Ne për gocë e kemi nisur”. Problematika dhe për vajzat e familjes sepse kur të tjerët i pyesin atyre u duhet të kenë një përgjigje. Fiona tregon se: “Kur vajza e madhe, fol në telefon me xhaxhin, ai thotë se kur ka për ta lindur mami vëllai. Kjo i thotë se këta nuk dinë të bëjnë vëlla, i kanë vënë gocat në seri [...Fiona, I-III, Datë, 28/07/2011: 36 min...]

Ankthi që bashkëshorti i Fionës parashtron në qoftë se do të lindë vajzë tregon se Fiona jo vetëm kthehet në mbështetëse por, ajo e sublimon me humor dhimbjen e saj duke ngritur pyetje mbi dëshirën e bashkëshortit me afirmim dhe mohim në formë pyetjeje. “...I them hej o burrë nuk të dalin çun ty. Po, pse çun, ti deshe...” Ambivalenca që e shoqëron Fionën gjatë pjesës së fundit të shtatzënisë. Edhe pse ekot i kanë thënë se ajo e ka vajzë ajo ndihet e copëzuar midis së vërtetës shkencore, besimit të saj dhe ndjenjës së amësisë për ta mbajtur vajzën e saj . Më poshtë do ta rimarrim argumentin duke folur sesi Tjetri brendëson subjektiven e Fionës dhe sesi ajo do të përballet me realitetin e jashtëm i cili, nuk dëshiron lindjen e një fëmije vajzë.

II. Ndërtimi subjektiv në raport me "Tjetrin": amësia/femërorja

Rasti në fjalë meriton një analizë të kujdesshme teorike. Pak më lart folëm për ndërtimin e subjektit, por subjekti varet nga mjedisi social dhe njeriu është një qenie sociale i cili banon në gjuhë. Por, është nëna ajo që e ndihmon fëmijën të kalojë nga gjuha e tij e shumëdashur në gjuhën e Tjetrit (amësor) Kjo tematikë është shumë e lëvruar në studimet në fushën e psikologjisë klinike që trajtojnë pozicionin e nënës "good enough mother"- "nënë mjaftushmërisht e mirë" (Winnicott 1956). Hyrja në socializim i mundëson fëmijës të përballet me ndalesat që i vijnë nga jashtë dhe e mëson që ai të japë dorëheqje nga realizimi i kënaqësive "jouissance". Rasti në fjalë na flet për ambivalencën që kalon apo përçon qenia e një nëne e cila ndodhet në mes dy kozmologjive. Në njërin anë, është konstruktuar dëshira për djalë (nga Tjetri i jashtëm), madje dhe me sakrificën e jetës së saj, ndërsa nga tjetër është kozmologjia amësore e cila e bënë atë që t'i japë kuptim mohimit që ajo po sjell në jetë një tjetër vajzë (refuzimi i rezultateve të ekove që i pohojnë se ka vajzë). Lindja e një tjetër vajze nuk është dëshirë e Tjetrit. Në këtë rast Tjetri është jo vetëm bashkëshorti, por është fisi dhe madje nga të dyja anët. Prandaj dhe mund të guxohet të riartikulohej e të thuhet se kjo është një dëshirë e strukturuar kulturalisht. Një dëshirë e prodhuar prej funksionimit të dispozitivit fisnor. Dëshirë që mban në këmbë funksionin e riprodhimit të babait.

Tjetri duke qenë instancë kuptimi dhe instancë limiti njëherazi kthehet në një objekt dëshire. Ky limit që i bëhet subjektit të pandërgjegjshëm është një fakt kulturor dhe në qoftë se në historinë e subjektit, kauza e dëshirës dhe origjina janë purifikisht subjektive, mënyra sesi kjo dëshirë do të gjejë vend të shprehet në raport me Tjetrin do të varet nga të tjerët, pra nga ligjërimet e ndryshme sociale. Mishel Fuko (1976) edhe pse pak faqe më parë në librin e tij, *Vullneti për dije*, ngre një hipotezë ndajfrodjane, duke u shprehur se "seksualiteti nuk duhet parë si ndonjë e dhënë natyrore, të cilën pushteti kërkon ta bëjë zap, apo si ndonjë fushë e errët primordiale, të cilën dija, pak nga pak, synon ta shpalosë e ta nxjerrë në dritë". Ai vijon më dy konstatime shumë provokuese që lidhen drejtpërdrejtë dhe tërthorazi me rastin që kemi në diskutim. "Ai (seksualiteti) është emri që mund t'i jepet një dispozitivi historik të caktuar: jo realiteti i nëndheshëm mbi virgjërinë e të cilit ushtrohen gllabërime të zorshme, porse një rrjet i madh në sipërfaqe ku acarimi i trupave, intensifikimi i kënaqësive, nxitjet për ligjërimet, grumbullimi i dijeve dhe përforcimi i dyanshëm i kontroleve dhe qëndresave vargëzojnë me njëri-tjetrin në përputhje me strategji të veçanta dijesh dhe pushteti (Fuko: 143).

⁷ Koncepti "Jouissance" është një term në gjuhën frënge dhe koncept bazë i teorisë Lacaniane për të shpjeguar marrëdhënien që individi ka me nevojën, dëshirën, kënaqësinë dhe "Jouissancën". Përthimi që ka përdorur Ardian Vehbiu në tekstin *Mësimet e mija* të Jaques Lacan (2012) është: "Endje" por, unë pëlqej më shumë versionin freudian që kupton përtej kënaqësisë ose më mirë të themi në qoftë se kënaqësia është ndjesi pozitive, "jouissance" është një kënaqësi që i shkakton trupit vuajtje.

Nisur kryesisht nga shekulli XVIII, shoqëritë moderne përëndimore shpikën e vunë në veprim një dispozitiv të ri, i cili i mbivendoset atij të parit, duke ia zbehur rëndësinë, po pa e zhdukur plotësisht atë [...] **Dispozitivi fisnor** strukturohet në përputhje me një sistem rregullash ku përkufizohet ç'ka lejohet dhe ç'ka ndalohej, ç'ka këshillohet dhe ç'ka dënohet [...] një nga objektivat kryesore të dispozitivit fisnor është riprodhimi i ciklit të marrëdhënieve dhe ruajtja e ligjit që i rregullon ato: në të kundërtët, dispozitivi i seksualitetit sjell shtrirjen e përhershme të fushës së kontrollit dhe zgjerimin e formave të tij. (Fuko: 144). Dhe vijon "mirëpo nuk është e saktë të thuhet se dispozitivi i seksualiteti ka zënë vendin e atij fisnor. Ndoshta ndonjë ditë do ta ketë zëvendësuar plotësisht atë (Fuko: 145). Ndoshta ajo që duhet theksuar në këtë pikë, është se dispozitivi fisnor ka forcën sikurse dispozitivët e tjerë për të krijuar shije dhe dëshira. Këto shije dhe dëshira nganjëherë ose shpeshherë janë krejt të strukturuar aq thellë në gjuhë sa ato janë trualli gjuhësor dhe gjuha trualli i tyre.

Lakani shkon më tutje me teorinë e tij për Tjetrin, duke kaluar nga analiza se Tjetri është selia e kuptimit në një paradigmë të dytë teorike se "E pandërgjegjshmja është ligjërimi i Tjetrit", Marcel Czermak, (2005:7) që kupton se e pandërgjegjshmja nuk fillon kur lind fëmija; ajo nis procesin e saj pikërisht kur fëmija heq dorë nga gjuha e tij "la-la-gjuhë" dhe hynë në gjuhën amësore. Për të kuptuar më mirë këtë pohim kemi nevojë të shpjegojmë si ndërtohet "subjekti i pandërgjegjes". Lesourd (2006) shkruan: Subjekti i pandërgjegjes ndërtohet nën efektin e gjuhës « shënjesve »: në rastin e të sapolindurit, "subjekti i pandërgjegjes" nuk ekziston në momentin e lindjes por, ai mund të supozohet nga mjedisi i tij social: nëna, babi, apo personave të tjerë që bebja është një subjekt. Marrëdhënia e parë midis fëmijës dhe nënës është një kohë pulsionale pa gjuhë, një kohë reale. Kjo kohë është e rëndësishme për ndërtimin subjektiv sepse fëmijës do t'i prezantohen, pra të brendësojë, përpunojë në psikik përfytyrimet në raport me Tjetrin që do të thotë se do të adaptojë një sjellje. Nuk ka gjë më të keqe dhe patologjike për një fëmijë që nuk i adapton sjelljen e tij në bazë të kërkesës së Tjetrit. Një kohë e dytë është marrëdhënia imagjinare, identifikuese që fëmija formon në raport me objektin e dëshirës. Nëse në një kohë të parë fëmija ngre pyetjen « çfarë ajo më do? », në një kohë të dytë, fëmija kërkon të bëhet objekt i dëshirës së nënës.

Në një moment të tretë, fëmija kupton se nëna dëshiron diku tjetër, kemi zhvendosje të nënës për sa i përket objektit të dëshiruar, që shoqërohet me zhvendosje të fëmijës i cili kërkon të jetë objekt i dëshirës së nënës. Kjo kohë njihet si hyrje në "kompleksin e kastrimit" për vajzën dhe dalje për djalin. Djali kupton se nëna dëshiron dikë dhe ky Tjeri « zotëron » një « phallus »/ « pushtet simbolik » të cilin ai kërkon ta zotërojë. Problematika e "kastrimit", që e shoqëron fëmijën si dinamikë dhe që në adoleshencë ripozicionohet (Lesourd 2007) e shpjegon nëpërmjet formulës për vajzën: "ajo nuk mund të jetë pa qenë phallus"⁸ dhe për

⁸ Lesourd me këtë shprehje do të emërtojë dinamikën e zhvillimit psikik gjatë identifikimit me Tjetrin për vajzën e cila në adoleshencë hynë në fazën gjenitale (Freud 1905).

djalin “ai nuk mund të jetë, pa e pasur phallusin”. Dy dinamika identifikimi psikik të ndryshme për vajzën dhe djalin⁹. Ku vajzës, për të qenë “phallusi”, i nevojitet të përballat me problematikën e saj infantile, ku babai është akoma Tjetri (që zotëron phallusin, Tjetri që vendos limitet, që në teorinë Lakanië njëhet me metaforën “Në emër të babait” “Le nom du père”), që sipas teorisë psikoafektive të Frojdit (1905) vajza në raportin fantazmatik që ka me babanë kërkon t’i bëjë atij “dhuratën”. Një ndër dispozitivët e hyrjes në feminitet është të pranojë se “nuk mund të jetë “phallusi” pra, sublimon duke hyrë në amësi duke u kthyer “vendi”¹⁰. Por, pikërisht në adoleshencë ajo duke u përballur me këtë problematikë identifikimi “Kush jam unë?” ripozicionohet duke kaluar nga identifikimi me babanë në njohjen dhe pranimin e Tjetrit gjenital që mund të jetë shoku, miku, bashkëshorti i ardhshëm duke i kërkuar jashtë familjes lidhjet e saja. Në këtë fazë të kthimit të dhuratës duhet kërkuar të lexohet dëshira e Tjetrit. Një dëshirë e cila është përbrendësuar dhe kërkon të kthehet te babai, dmth te babai në kuptimin psikanalitik.

IV. Konkluzione

U nisëm me argumentin se « Dëshira e njeriut është dëshira e Tjetrit » dhe se subjekti banon në gjuhën dhe se vetë kuptimi, të themi gjuhësor, krijohet duke pasur si seli kuptimi Tjetrin. Si dhe subjekti, “subjekti i të pandërgjegjshmes”, individi, personaliteti nuk lind, ai formohet kur individi fillon dhe hynë në gjuhë, kur ai fillon ta banojë gjuhën dhe fillon ta përdori gjuhën si një mjet për të shprehur ambivalencat e mendimeve të tij. Parashtruam se një nga funksionet e Tjetrit, janë përfaqësimet imagjinare që subjekti ka ndaj tij dhe se Tjetri ka funksion reference mbi subjektin. Ndër të tjera Tjetri është një vend ku subjekti flet dhe i adreson ankesën e tij dhe se pa Tjetrin vetë subjekti s’mund të ketë kuptim. Gjithashtu Tjetri ndikon në mënyrën sesi perceptohen dallimet seksuale, dhe sesi subjekti në adoleshencë, në rastin e vajzës, kupton se “nuk mund të jetë phallusi” por, si në rastin e Fionës të kërkojë të jetë nëna që dëshiron t’i lindi të dyja sekset, si vajzën dhe djalin. Nëpërmjet faktit klinik, të mbledhur nga një projekt studimor mbi proceset e prindërimit, u përpoqëm të parashtrojmë rastin e Fionës. E cila e formon subjektivitetin e saj duke u përballur me pushtetin që ofron të jetuarit në mes ideologjisë liberale/moderne dhe asaj fisnore. Kjo e fundit konstruktin dëshirën për pasjen e një djali si ideal. Ajo është një gjuhë reale – nëne. Nga ana tjetër, për nënën dhënia e jetës së një djali shikohet si një dhuratë që vjen ose

⁹ Kurse për djalin pyetja që ngrihet në adoleshencë mbasi ka kuptuar se “phallusi” nuk ekziston, por është një koncept komplet imagjinar i tij që një ditë ta zotërojë pushtetin e tij për të qenë “objekti i dëshirës së nënës”, ngrihet pyetja: Çfarë dëshiron një grua? Të njohë femëroren është dëshira e tij.

¹⁰ Hyrja në « amësi » është vetëm një nga format sesi derivon seksualiteti femëror.

kërkohet të vijë prej Zotit dhe që i adresohet babait të saj ose babait të fëmijës.

Vetë logjika fisnore është e mbushur me plot besime me origjina të ndryshme të cilat krijojnë kozmologjinë e njeriut fisnor. Pjesë e saj kërkon të bëhet dhe dija teknologjike e cila nganjëherë kur besohet si Tjetri gjithëshpegues, përdoret për heqjen e fëmijëve vajza. Por, ndodh që kjo dije të çkualifikohet plotësisht nga një nënë si Fiona e cila edhe pse është vënë në mungesë për pasjen e një djali dhe në ndjesinë e tepërisë për pasjen e një vaje tjetër. Ajo zgjedh besimin në Zot, si një situatë mohimi dhe besimi, duke mohuar mundësinë për të abortuar fëmijën e bashkë me të mundësinë se ky fëmijë është djale. Kjo ambivalencë i mundëson vijimin e dëshirës së Tjetrit duke iu referuar besimit dhe shpresës në fallxhore, në fat, apo në besimin te Zoti.

Bibliografi

- Chemama, R. Vanderersch, B. (2005) Dictionaire de la psychanalyse. Larousse .Paris: 2005, fq. 312-313.
- Czermak, M. (2005). Dictionnaire de la psychanalyse. Larousse. Roland Chemama, Bernard Vabderersch Paris : Larousse. fq.7.
- Figures de la psychanalyse. (2009). *Argument: Anthropologie, psychanalyse: les états de la structure* : Eres. n° 17/1. fq.4
- Foucault, M. (1976). Historia e seksualitetit 1, Vullneti për dije. Përkthyer nga Orgest Azizi, Tiranë : UET/Press. 2011.
- Freud, S. (1905). Trois essais sur la théorie de la sexuelle. 1987, Gallimard: Folio essais.
- Héritier, F. (2013). « Le mariage n’a rien de sacré », Lacan quotidien. n° 316.
- Kristeva, J. (2011). « Être mère aujourd’hui », Revue française de psychosomatique. n° 40/2, fq. 43-51.
- Lacan, J. (1957-1958). Les formations de l’inconscient, le séminaire V, 1998, Paris : Seuil. fq.179
- Lacan, J. (1966). Ecrit I, Texte intégral, ESSAIS, Points, version poche, Paris : Seuil, 1999. Fonction et champs de la parole et du langage en psychanalyse. fq. 235-321
- Lacan, J. (1967-1968). Mësimet e mija. Përkthyer në shqip nga Ardian Vebiu, Tirane : Onufri. 2012. Tre leksione të mbajtura në Strasbourg, Lion. fq. 53-68.
- Lacan, J. (1968-1969). D’un autre à l’autre, le séminaire XVI, 2006, Paris : Seuil. Chapitre, III, Topologie de l’Autre, 27 novembre 1968. fq. 45-61.
- Lacan, J. (1972-1973). Ancora, Il seminario, libro XX, 2011, Torino: Piccola Biblioteca Einaudi, Psicologia, Psicoanalisi, Psichiatria. VI. Dio e il godimento de La donna. fq. 61-72.
- Lesourd, S. (2005). « La famille maternelle », La lettre de benfance et de

- l'adolescence. Eres: Toulouse. n° 59/1, fq. 121-126.
- Lesourd, S. (2006) Cikël leksionesh të pa botuara të lëndës : Ndërtimi psikik. Dega psikologji klinike, psikopatologji. Universiteti i Strasburgut 1. Datë. 02.10.2006.
- Lesourd, S. (2006). Comment taire le sujet? Des discours aux parolottes libérales. Eres, Humus : Toulouse.
- Lesourd, S. (2007). « Le féminin à l'adolescence : constitution d'un lieu », *Adolescence* . n° 60/2, fq. 359-371.
- Tirta, M. (2006) Etnologjia e Shqiptarëve, Tiranë. Geer.
- Winnicott, W. D. (1956). Primary maternal preoccupation. In *Collected papers, through paediatrics to psychoanalysis* London: Tavistock Publications, 1958. fq. 300-305.
- Winnicott, W. D. (1960). The theory of infant-parent relationship. In *his Maturation processes and the facilitating environment* London: Hogarth and the Institute of Psycho-Analysis. 1965. fq. 17-55.

Rapporte :

Raport, Gendercide: The missing Women? DEVE. European Parliament. Directorate-General for External Policies. (2012).

Poshtë korrupsioni! Rroftë Neoliberalizmi! Politika e fushatës ndërkombëtare antikorrupsion në Shqipëri, 1998 – 2005

Ph.D. Blendi Kajsu¹

Abstrakt. Gjatë periudhës 1998 – 2005 në Shqipëri u zbatua një program shumëdimensional antikorrupsion. Institucione të ndryshme ndërkombëtare si Banka Botërore, Këshilli i Europës dhe donatorë si USAID në bashkëpunim me qeverinë dhe me shoqërinë civile shqiptare ndërtuan dhe zbatuan një sërë programesh antikorrupsion. Këto programe varionin nga ndërgjegjësimi i popullatës dhe deri te politika specifike ekonomike që duhet të shërbenin për reduktimin e korrupsionit. Pas një luftë intensive dhe shumë dimensionale për thuhet tetë vite, nivelet e korrupsionit në Shqipëri nuk treguan ndonjë ulje të rëndësishme. Përkundrazi në disa aspekte, si kapja e shtetit, korrupsioni dukej se u rrit gjatë periudhës 1998–2005. Për të shpjeguar këtë paradoks ky artikull argumenton se fushata antikorrupsion i shërbeu implementimit dhe forcimit të një rendi neoliberal në Shqipëri. Pra ndonëse kjo fushatë nuk pati sukses në uljen e niveleve reale ose të perceptuara të korrupsionit ajo arriti të forconte rendin neoliberal në Shqipëri. Korrupsioni shërbente si një kërcënim përballë të cilit legjitimitohej rendi neoliberal.

Hyrje

Gjatë periudhës 1998–2005 Shqipëria gëzonte njëkohësisht programet më të suksesshme antikorrupsion dhe nivelet më të larta të korrupsionit në rajon. Në vitin 2006 Banka Botërore deklaronte se në fushën

¹ Blendi Kajsu është një kërkues i pavarur që hulumton aspekte të ndryshme të demokratizimit shqiptar.

e antikorruptionit Shqipëria kishte “disa nga institucionet më të mira të administratës publike në rajon.” (The World Bank, 2006b) Këshilli i Europës i konsideronte aq të suksesshme projektet e tij PACO në Shqipëri sa që i përdori ato si modele për projektin rajonal PACO Impact (Carlbom & Wistrom, 2006, p.14). Por pavarësisht institucioneve dhe programeve të suksesshme antikorruption korruptioni në Shqipëri jo vetëm nuk eliminohej, por madje as nuk ulej. Sipas një vlerësimi të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim të vitit 2003 “si kapja e shtetit edhe korruptioni administrativ u rritën për periudhën 1999–2002. Për më tepër shpeshësia e ryshfetit gjithashtu u rrit në Shqipëri gjatë kësaj periudhe.” (Steve & Ruso, 2003, p. 33). Në një vlerësim të mëvonshëm të viti 2006 Banka Botërore arrin në konkluzionin se “nga pikëpamja e kompanive ... nivelet e korruptionit nuk ndryshuan ose u përkeqësuan nga 2002–shi deri në 2005–ën” (The World Bank 2006b). Pra nga viti 1998 deri në vitin 2005, periudha më intensive e antikorruptionit në Shqipëri, korruptioni në fakt u rrit. Kemi dy fenomene kontradiktore; nga njëra anë kemi një kuadër fantastik institucional dhe legjislativ kundër korruptionit, programe pa fund antikorruption nga qeveria, dhe fushata të shumta antikorruption të financuara nga donatorët e huaj, dhe nga ana tjetër kemi rritje të vazhdueshme të nivelit të korruptionit.

Paradoksi i mësipërm buron nga premisa bazë se fushata antikorruption kishte si synim parësor reduktimin e korruptionit. Argumenti kryesor i këtij punimi është se korruptioni shërbeu para së gjithash si një kërcënim nëpërmjet të cilit një rend neoliberal u instalua dhe u legjitimua në Shqipëri nga aktorët ndërkombëtarë. Fushata antikorruption përgjatë periudhës 1998 – 2005 ndonëse nuk uli apo nuk eliminoi korruptionin *per se* (pavarësisht përkufizimit) arriti të legjitimojë rendin neoliberal në Shqipëri. Së pari, duke identifikuar korruptionin si pengesën kryesore të zhvillimit ekonomik ligjërimi i korruptionit mënjanoi kritikën ndaj mangësive të modelit të zhvillimit neoliberal që zbatohet në Shqipëri. Korruptioni artikulohej si karakteristikë e sferës publike që buronte nga ndërhyrja e tepërt e shtetit në ekonomi. Për pasojë antikorruptioni nënkuptonte më shumë privatizim, derregullim dhe liberalizim. Së dyti, ligjërimi ndërkombëtar rreth korruptionit riprodhonte marrëdhënien asimetrike mes Shqipërisë dhe komunitetit ndërkombëtar. Përballë një Shqipërie tërësisht të korruptuar ligjërimi ndërkombëtar sendërtonte një faktor ndërkombëtar që gëzonte pastërtinë morale dhe njohuri të nevojshme për të luftuar korruptionin. Kjo marrëdhënie asimetrike legjitimonte implementimin kallëp të reformave që propozoheshin nga institucionet ndërkombëtare, edhe pse këto reforma më shumë sesa eliminimin e korruptionit synonin integrimin e Shqipërisë në tregun global.

Në funksion të argumentit të mësipërm ky studim është ndarë në tri pjesë kryesore. Në pjesën e parë jepet një pamje e përgjithshme e rendit neoliberal shqiptar, duke u përqendruar në dy momente kyçe të tij; modeli zhvillimor neoliberal, dhe marrëdhënia asimetrike mes Shqipërisë dhe organizmave ndërkombëtarë si

Bashkimi European. Në pjesën e dytë tregohet sesi organizata ndërkombëtare si Banka Botërore (BB) e përdorën ligjërimin antikorruption për të mënjeluar kritikën e politikave zhvillimore neoliberale, dhe për t’i ripërtërirë këto politika. Së fundi, në pjesën e tretë argumentojmë se ligjërimi ndërkombëtar e riprodhoi marrëdhënien asimetrike mes Shqipërisë dhe komunitetit ndërkombëtar duke e artikuluar korruptionin si një karakteristikë të brendshme të Shqipërisë. Teza jone është se kjo marrëdhënie asimetrike u bë baza e zbatimit të një sërë reformash që më shumë se eliminimin e korruptionit synonin integrimin e ekonomisë shqiptare në tregun global.

Rendi neoliberal në Shqipëri

Rendi neoliberal që u konsolidua në Shqipëri pas rënies së komunizmit në vitin 1991 përbëhej nga dy momente që përforconin njëri-tjetrin. Së pari, një model zhvillimi neoliberal sipas të cilit tregu ishte motori i zhvillimit ekonomik dhe shteti pengesa kryesore e tij. Nga njëra anë ky model theksonte reduktimin e sektorit publik dhe të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, nëpërmjet privatizimit të vazhdueshëm, dhe nga ana tjetër theksonte hapjen e tregut lokal ndaj atij global, tërheqjen e kapitalit të huaj, si dhe tregtinë e lirë si instrumente zhvillimi. Nga pikëpamja e këtij modeli shteti duhet të ishte në shërbim të tregut. (Khan, 2002, f. 172). Së dyti, modeli neoliberal i zhvillimit kombinohej me një marrëdhënie tejet asimetrike mes Shqipërisë dhe organizmave ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Bashkimi European. Këto të fundit jo vetëm do të ofronin burimet financiare për zhvillimin e Shqipërisë, por edhe do të monitoronin progresin e saj, duke garantuar zbatimin e modelit zhvillimor neoliberal.

Modeli neoliberal i zhvillimit në Shqipëri

Gjatë viteve 1992– 997, Shqipëria e përqafoi modelin zhvillimor neoliberal më fort sesa shumica e vendeve të tjera të ish-kampit socialist. Gjatë kësaj periudhe institucione ndërkombëtare si FMN-ja dhe Banka Botërore e konsideronin Shqipërinë si vend model që duhej të ishte shembull për vendet e tjera të rajonit (Bezemer, 2006, f. 17). Shqipëria me shpejtësi liberalizoi çmimet, hapi tregjet, vendosi politika fiskale shtrënguese, dhe ndërmoi privatizime masive (The World Bank, 1994, f. 81–2). Tri shtyllat e modelit neoliberal që u zbatua në fillim të viteve 1990–të në Shqipëri ishin: stabilizim, liberalizim dhe privatizim. Stabiliteti makroekonomik ishte përparësia e qeverisjes së parë demokratike dhe nënkuptonte uljen e inflacionit dhe reduktimin e deficitit buxhetor nëpërmjet politikave fiskale shtrënguese, siç ishin reduktimi i nivelit të kreditimit nga bankat shtetërore, ulja e ofertës

së parasë në treg, dhe reduktimi i pagave në sektorin publik (Kaser, 2006, f. 6). Reduktimi i pagave në sektorin publik ishte një nga politikat kryesore shtrënguese të qeverisë. Për këtë qëllim u përdorën një sërë instrumentesh, kufizim i rrogës mesatare, kontrolli i rrogës minimale dhe kompensim direkt për inflacionin në vend të indeksimit të pagave (Vaughan-Whitehead, 1999, p. 97). Kjo ishte një politikë mjaft e suksesshme po të kemi parasysh uljen e pagave që ajo prodhoi. Midis vitit 1992 dhe 1993 paga reale në sektorin publik u ul me 26 % dhe u rrit mesatarisht vetëm me 4% për vitet 1994 - 1995 (Bezemer, 2001, f. 261). Punonjësit e sektorit publik u detyruan të pranonin reduktime të thella në kuadrin e zbatimit të programit të stabilizimit ekonomik (Çuka, et al., 2003, f. 220). Ky ishte një program që arriti me mjaft sukses ta ulte inflacionin e lartë të trashëguar nga sistemi komunist (Clunies-Ross & Sudar, 1998, f. 120).

Shumë prej reformave ekonomike që u ndërmorën nga Qeveria shqiptare nën kujdesin e FMN-së dhe të Bankës Botërore prodhuan tronditje ekonomike dhe sociale. Ndër to më e rëndësishmja ishte kriza e piramidave e vitit 1997. Ndonëse shkaqet dhe arsyet e zhvillimit të piramidave në periudhën 1992-1996 janë të shumta dhe komplekse, një prej tyre janë edhe politikat e ndjekura nga Qeveria shqiptare nën udhëheqjen e FMN-së. Vaughan-Whitehead e shikon burimin e skemave piramidale të politikave monetare shtrënguese që e reduktuan ndjeshëm kreditimin e ekonomisë për të ulur inflacionin. Kombinuar me papunësinë e lartë si pasojë e deindustrializmit kjo politikë stimuloi zhvillimin e skemave piramidale, disa prej të cilave operuan për vite me radhë, si alternativa për kreditim dhe fitim, duke i bërë ato tërheqëse për popullatën në përgjithësi (Vaughan-Whitehead, 1999, f.191- 218). I njëjti arsyetim është bërë edhe nga ekonomisti Bezemer, sipas të cilit përparësia e stabilitetit makroekonomik, domethënë. ulja e inflacionit dhe e deficitit buxhetor, nga njëra anë e injoroi rrezikun e piramidave dhe nga ana tjetër e nxiti krijimin e tyre:

...politika monetare ishte shtrënguese. Jo shumë banka lejoheshin të funksiononin dhe ato që lejoheshin kishin kufizime të forta në lidhje me kreditimin. ...Dërgesa të mëdha parash që futeshin në ekonomi dhe që nuk kalonin dot nëpërmjet sistemit bankar apo që nuk investoheshin në mënyrë produktive krijuan mundësi për një sistem bankar informal, që shumë shpejt filloi të përdorte metodat Ponzi [piramidale] (Bezemer, 2006, f. 29).

Arsyetimi i mësipërm mbështetet edhe nga Korovilas sipas të cilit një nga shkaqet kryesore të formimit të piramidave ishte sasia e madhe e remitancave që vinte në Shqipëri nga jashtë, dhe që nuk kanalizoheshin dot në sistemin ekzistues bankar (Korovilas, 1999, f. 399 – 415).

Marrëdhënia asimetrike mes Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare

Deri tani jemi marrë vetëm me dimensionin e parë të rendit neoliberal në Shqipëri; dmth modelin neoliberal të zhvillimit. Një moment i dytë i këtij rendi ishte marrëdhënia thellësisht asimetrike mes Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bashkimi Europian (BE). Shembulli më i qartë i kësaj marrëdhënie asimetrike ishte marrëdhënia e Shqipërisë me BE-në. I gjithë procesi i integritit të Shqipërisë në BE bazohej te paradigma e kushtëzimit sipas së cilës BE-ja përcaktonte objektivat politike, ekonomike, legjislative dhe institucionale që duheshin përmbushur nga Shqipëria. Kushtëzimi nënkuptonte “një marrëdhënie në të cilën njëri prej partnerëve kishte më tepër peshë sepse kontrollonte përfitimet e dëshiruara nga partneri tjetër” (Bogdani & Loughlin, 2009, f. 107). Presupozimi mbi të cilin bazohej paradigma e tranzicionit ishte se në mungesë të kontrollit, presionit dhe kushtëzimit nga BE-ja vendet e Ballkanit ishin të destinuara të rrëshqisnin në kaos dhe varfëri. Siç vërente Komisioni Ndërkombëtar për Ballkanin, detyra e BE-së ishte të “ndihmonte në transformimin e një Ballkani të paparashikueshëm, të përgjakshëm dhe kaotik në të shkuarën në një Europë Juglindore të qëndrueshme, paqësore dhe të përgjegjshme në të ardhmen” (te Bogdani & Loughlin, 2009, f. 88). Sipas së njëjtës logjikë Bogdani dhe Loughlin argumentojnë se: “Po të mungonte roli i BE-së...Shqipëria do të vazhdonte të ishte një ‘Republikë Bananesh’, në duart e politikanëve dhe qeverive egocentrike, të papërgjegjshme dhe të paafta, ku lulëzon krimi i organizuar dhe korrupsioni (Bogdani & Loughlin, 2009, f. 241). Procesi i stabilizimit asocimit midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor bazohej mbi premisën se motivimi kryesor për reforma në rajon buronte nga dëshira e secilit vend për t’u anëtarësuar në Bashkimin Europian (Hoffman, 2005, f. 59). Prandaj BE-ja ka qenë një aktor i rëndësishëm në skenën politike shqiptare që nga fundi i viteve 1990-të. Ajo e ka monitoruar vazhdimisht Shqipërinë duke identifikuar në raportet e saj dështimet e qeverisjes shqiptare në pothuajse çdo fushë, tek administrata publike, gjyqësori, policia, klasa politike etj., dhe duke theksuar nevojën e zbatimit me përpikmëri të rekomandimeve të BE-së. Legjitimiteti i BE-së nuk buronte thjesht nga fakti se ajo mund t’i ofronte ndihmë financiare Shqipërisë, por edhe sepse ky organizëm funksiononte si burim dijesh rreth demokracisë dhe qeverisjes demokratike (Bogdani & Loughlin, 2009, f. 219).

Marrëdhënia asimetrike mes BE-së dhe Shqipërisë u përdor për të zbatuar rendin neoliberal në Shqipëri, që ndër të tjera synonte integritimin e ekonomisë shqiptare në tregun e përbashkët Europian. Në rastin e Shqipërisë BE-ja bashkëpunonte ngushtë me BB-në dhe FMN-në duke rekomanduar një model neoliberal të zhvillimit që bazohej te reduktimi i rolit të shtetit në ekonomi, tregtia e lirë, dhe hapja ndaj investimeve të huaja. Sikurse vërejnë Bogdani dhe Loughlin, Tregu i Përbashkët Europian “ka qenë një burim presioni për të nxitur derregullim

dhe liberalizim të tregjeve të brendshme, privatizim të monopoleve kombëtare dhe kufizim të pronës publike dhe ndihmës shtetërore” (Bogdani & Loughlin, 2009, f. 220). Një nga elementet themelore të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit midis Shqipërisë dhe BE-së ishte krijimi i një zone të tregtisë së lirë midis tyre brenda dhjetë viteve. Në funksion të këtij qëllimi, Shqipëria ndër morri përaftrimin gradual të legjislacionit të saj me atë të BE-së. Kjo marrëdhënie asimetrike mes Shqipërisë dhe BE-së, apo dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë ishte pjesë përbërëse e rendit neoliberal, pasi në thelb ky rend bazohej te premisa se zhvillimi i Shqipërisë do të buronte nga jashtë. Ishte kjo premisë që legjitimonte jo vetëm hapjen e tregjeve, por edhe kopjimin e legjislacionit dhe të institucioneve nga jashtë, duke lehtësuar kështu një marrëdhënie asimetrike që mundësonte zbatimin e një rendi neoliberal në Shqipëri.

Korrupsioni: gjithmonë i dyshuar

Në analizën e Bankës Botërore (BB), kriza shqiptare paraqitej si pasojë e specifikës së brendshme shqiptare, dhe jo produkt i politikave neoliberale të rekomanduara prej saj apo FMN-së. Korrupsioni ishte një nga elementet kyç të kësaj “specifike të brendshme”. Studimi i parë antikorrupsion, ndërmarrë në vitin 1998 nën udhëheqjen e BB-së e citonte korrupsionin si problemin kryesor me të cilin përballej Shqipëria dhe si shkakun kryesor të krizës piramidale të vitit 1997. Duke iu referuar një sondazhi të ORT/USAID studimi vërente se 83% e të intervistuarve fajësonin korrupsionin si shkaktar të krizës piramidale në vitin 1997 (Kaufmann, 1998, f. 6- 8). Edhe strategjia e parë antikorrupsion, e miratuar nga Qeveria shqiptare nën kujdesin e Bankës Botërore identifikonte korrupsionin si një nga shkaqet e krizës së vitit 1997: “Dështimi i qeverisë së mëparshme në zbulimin e korrupsionit në skemat piramidale pati pasoja shumë të rënda si për shtetin ashtu edhe për njerëzit” (Council of Ministers, 1998, f. 19). Ishte prezenca e korrupsionit ajo që shpjegonte mungesën e përfitimeve nga proceset e liberalizimit. Sipas BB-së:

Dështimi i qeverisë për të krijuar një mjedis stimulues për rritjen ekonomike nëpërmjet zhvillimit të sektorit privat duke...ulur korrupsionin e gjithëpërhapur nuk i ka lejuar vendit të nxjerrë përfitimet e pritshme nga procesi i liberalizimit për të përmbushur potencialin e lartë ekonomik që ka (The World Bank, 1998b, f. 2).

Politikat shtrënguese monetare dhe fiskale, derregullimi, liberalizimi dhe terapia e shokut, që citoheshin nga BB-ja dhe FMN-ja si arsytet e mrekullisë ekonomike shqiptare deri në vitin 1996, nuk kishin të bënin aspak me krizën e vitit 1997. Ndaj në vitin FMN-ja vendosi po të njëjtat kushte mbi Shqipërinë

në marrëveshjen e vitit 1998 si ato para vitit 1997, duke përfshirë politika monetariste strikte dhe kufizim të kreditimit për sektorin privat (Vaughan-Whitehead, 1999, f. 315).

Nga viti 1998 dhe deri në vitin 2005 Banka Botërore bëri çdo përpjekje, duke përfshirë edhe ato krijuese, për ta identifikuar korrupsionin si pengesën më të madhe për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Shembulli më i qartë i kësaj përpjekje madhore ishte memorandum i ekonomik për Shqipërinë i vitit 2004 *Shqipëria: Ruajtja e rritjes së qëndrueshme* edhe përtej *tranzicionit*. Në këtë dokument të rëndësishëm BB-ja theksonte se në Shqipëri “indeksi i korrupsionit” dhe “indeksi i presionit të korrupsionit” gjatë viteve 2001 dhe 2002 ishin në nivelet më të larta në rajon (The World Bank, 2004, f. 125). Në mbështetje të tezës se korrupsioni ishte problemi më i madh me të cilin përballesh biznesi në Shqipëri raporti citonte një sondazh të vitit 2003 nga Foreign Investment Advisory Service (FIAS) sipas të cilit sasia e pagesave jozyrtare nga biznesi në Shqipëri ishte në nivelin 1.4 miliard dollar amerikanë (The World Bank, 2004, f. 123). Kjo ishte një shifër tejet e lartë po të kemi parasysh se PPB-ja për Shqipërinë në vitin 2002 ishte rreth 4.5 miliardë USD (Index Mundi 2011). Problemi është se të gjitha të dhënat e mësipërme në lidhje me korrupsionin ose citoheshin gabim, ose shpikeshin, ose paraqisnin si indikatorë objektivë ato që në fakt ishte thjesht perceptim. Kështu shifra e ryshfetit prej 1.4 miliard USD jepej si e marrë nga një tabelë e studimit të FIAS:

Një anketë e vitit 2002 ka treguar se bizneset private kanë raportuar pagesa jozyrtare prej 1,4 miliardë dollar amerikanë (Tabela 55)

Tabela 55: Pagesat e raportuara jozyrtare gjatë procedurave

Procedura	Numri i vëzhgimeve	% e personave që raportuan pagesa informale	Vlera mesatare e çdo pagese (US\$)
Dogana: zhdoganim	18	36.	167.7
Leje ndërtimi	14	32.	406.6
Insp tatim	48	26.	265.5
Leje biznesi	26	11.	108.0
Regjis Bizn (gjykatë)	13		173.1
Regjis tapie	24		225.1

Burimi: FIAS 2003” (The World Bank, 2004, f. 123).

Problemi i parë është se në tabelën e mësipërme nuk ka asnjë indikacion që tregon se shifra e ryshfetit për vitin 2002 ishte 1.4 miliard US\$. Problemi i dytë

është se kjo shifër nuk përmendet askund në sondazhin origjinal të FIAS që citohet nga raporti i Bankës Botërore, por që mungon në bibliografinë e tij. Problemi i tretë është se tabela e mësipërme është një riprodhim i paplotë dhe i pasaktë i tabelës origjinale të studimit të FIAS. Shiko Tabelën 10: Tabela Originale e FIAS

Tabela 10: Tabela Originale e FIAS

TABLE II-1: ALBANIA: REPORTED UNOFFICIAL PAYMENTS BY PROCEDURES			
Procedure	Number of observations	Percentage of those who reported unofficial payments	Average amount of each payment (in US\$)
Customs: Import Clearance	184	36.0	167.70
Construction Permit	146	32.0	406.60
Tax Inspection	482	26.0	265.50
Business Licenses	263	11.6	108.00
Business Registration (Court)	137	9.5	173.10
Land Title Registration	244	5.7	225.10

Burimi. FIAS, 2003, f 8.

Sikurse e tregon tabela e mësipërme qëllimi i sondazhit të FIAS ishte identifikimi i pagesave informale nga biznesi për zyrtarët publikë në Shqipëri. Por tabela e mësipërme nuk tregon se ky nivel ishte 1.4 miliard US\$, çka do të përbënte pothuajse një të tretën e PPB-së shqiptare! Për më tepër, ky numër nuk shfaqet në asnjë moment të studimit të FIAS.

Natyrish në këtë pikë mund të thuhet se kemi të bëjmë thjesht me një lapsus apo gabim teknik. Por citimi i një shifre fantazmë rreth korrupsionit nuk ishte rastësi. Raporti i BB-së në mënyrë sistematike paraqiste perceptimet rreth korrupsionit si indikatorë të nivelit të tij real. Kështu në faqen 121 raporti tregonte se indeksi i korrupsionit në Shqipëri ishte më i larti në Europën Juglindore duke paraqitur tabelën e mëposhtme:

Tabela 11: Indeksi i korrupsionit për vendet e EJL-së

Vendi	2002	2001
Shqipëri	68.4	60.8
Rumani	59.9	59.9
Bosnje dhe Hercegovinë	48.3	47.6
Kroaci	41.1	41.7
Serbi	37.3	37.2
Mal i Zi	35.9	30.8
Bullgari	35.1	37.5
Maqedoni	31.2	35.1

Burimi. The World Bank, 2004, f. 121.

Tabela e mësipërme krijon përshtypjen e gabuar se kemi të bëjmë me nivelin e korrupsionit në vendet përkatëse, pasi ajo titullohet “indeksi i korrupsionit”. Problemi është se të dhënat e mësipërme janë përqindja e qytetarëve që mendojnë se korrupsioni është problem kryesor në vendin e tyre. Ato janë marrë nga një sondazh i kryer prej organizatës Southeast European Legal Development Initiative (SELDI) e cila i pyeti të intervistuarit; “Cili është problemi kryesor në vendin tuaj?” Në rastin e Shqipërisë në vitet 2001 dhe 2002, respektivisht 60.8% dhe 68.4 % u përgjigjën se problemi kryesor ishte korrupsioni (SELDI, 2002, f 6). Këto shifra transformohen në raportin e Bankës Botërore në “indeksin e korrupsionit” duke e nxjerrë Shqipërinë në krye të rajonit, edhe pse përqindjet e mësipërme nuk masin nivelin e korrupsionit, por ndjeshmërinë ndaj tij. Në të njëjtën mënyrë “treguesi i presionit të korrupsionit”, që jepet në faqen 125 të raportit, ishte marrë nga i njëjti sondazh dhe paraqiste përqindjen e atyre që u përgjigjën se kur ata kishin kontaktuar zyrtarë publikë u ishte kërkuar në shkëmbim “para, dhurata ose favore” (SELDI, 2002, f. 10 -11). Kjo përqindje u kthye në treguesin e presionit të korrupsionit në Shqipëri, duke futur në përkufizimin e korrupsionit paratë, dhuratat dhe favoret, edhe pse këto janë fenomene krejt të ndryshme.

Por problemi themelor me shifrat e mësipërme nuk është thjesht pasaktësia ose deformimi i tyre. Problemi është se ato ishin pjesë e një profecie vetëpërmbytëse. Nga njëra anë Banka Botërore dhe institucionet e tjera ndërkombëtare propagandonin pafund se problem themelor i Shqipërisë ishte korrupsioni, duke e kthyer atë në çështjen kryesore të debatit politik në vend. Nga ana tjetër, po këto institucione citonin perceptimet e larta rreth nivelit të korrupsionit në vend, që ishin pjesërisht produkt i fushatës së tyre antikorrupsion, për të vërtetuar se korrupsioni ishte problematik. Që në vitin 1998 BB-ja e paraqiti korrupsionin si problemin themelor me të cilin përballej Shqipëria. Konferenca kombëtare për korrupsionin, organizuar nga Qeveria shqiptare dhe Banka Botërore në 30 qershor, 1998, pati një mbulim mediatik spektakolar. Një ditë më pas të gjitha gazetat kryesore u hapën me tituj si “Shpërthen korrupsioni” (*Koha Jonë*, 1998, f. 1), “Luftë kundër korrupsionit” (*Zëri i Popullit*, 1998a), “Qeveria pranon: Na mbyti korrupsioni” (*Republika*, 1998, f. 1). Një muaj pas konferencës rreth 300 artikuj që trajtonin problemin e korrupsionit dolën në medien e shkruar, pa përmendur debatet televizive për këtë temë (*Ekonomia dhe tranzicioni*, 1998). Në vitin 2001 USAID organizoi dhe financoi një nga fushatat më të mëdha kombëtare për ndërgjegjësimin e popullatës rreth rrezikut të korrupsionit që prodhoi me dhjetëra OJQ antikorrupsion dhe kulminoi në vitin 2004 edhe me një protestë antikorrupsion. (OECD, 2002, f 31).

Pas ndërhyrjes së Bankës Botërore në vitin 1998 Partia Demokratike, tashmë në opozitë, e përqafoi antikorrupsionin si kauzën e saj madhore, duke e bërë atë çështjen kryesore si në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Së fundi, në periudhën tetor 2001 – janar 2002, vetë udhëheqësi i Partisë Socialiste, Fatos Nano, akuzonte

për korrupsion kryeministrin e qeverisë socialiste, Ilir Meta, në një nga fushatat politike më të mediatizuara dhe më të ndjekura nga publiku, e quajtur *katarsis*. Pikërisht në këtë periudhë (janar – shkurt 2002) SELDI ndërmori sondazhin e saj të dytë në lidhje me perceptimin e korrupsionit në Shqipëri, që tregoi një rritje të ndjeshme, prej 8%, në krahasim me vitin 2001. Kjo ishte rritja më e madhe në rajon. Shiko Tabelën 12 më poshtë.

Tabela 12. Problemet kryesore në vendet e Europës Juglindore

	Shqipëri		Bosnia-Herceg.		Bullgari		Maqedoni		Rumani		Kroaci		Serbi		Mal i Zi	
	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002
Papunësia	44.4	44.8	60.9	60.9	67.8	68.9	75.3	58.2	39.5	33.9	66/0	78.5	30.3	38.0	53.1	51.1
Pagat e ulëta	39.3	40.8	39.6	39.3	49.0	47.0	62.0	26.7	41.3	49.4	39.1	44.2	39.2	33.6	35.6	37.2
Varfëria	24.4	28.2	29.8	31.9	41.5	42.7	-	43.9	50.6	57.4	31.6	28.7	39.7	44.4	34.8	43.4
Korrupsioni	60.8	68.4	47.6	48.3	37.5	35.1	35.1	31.2	59.9	59.9	41.7	41.1	37.2	37.3	30.8	35.9

Burim, SELDI, 2002, p 6.

Ky ishte sondazhi të cilit i referohej BB-ja si evidencë e nivelit të lartë të korrupsionit (që shpesh nënkuptonte ryshfetin) në Shqipëri. E thënë ndryshe, në vitin 1998 Banka Botërore bashkë me aktorë të tjerë ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare identifikojnë dhe propagandojnë korrupsionin si problemin dhe shkakun themelor të problematikës shqiptare. Pas disa vitesh propagandimi intensiv qytetarët pyeten nëse mendonin se korrupsioni ishte problemi madhor me të cilin përballej vendi. Së fundi, perceptimi i krijuar se korrupsioni ishte problem themelor me të cilin përballej vendi, jepej si provë e faktit se korrupsioni ishte problemi më madhor me të cilin përballej Shqipëria, edhe pse ajo që përkufizohej si korrupsion nga Banka Botërore dhe ajo që nënkuptohej me korrupsion nga popullsia ishin shpesh fenomene krejt të ndryshme.

Për ta kuptuar më mirë procesin e mësipërm duhet të theksojmë se Banka Botërore ishte një institucion tejet prestigjioz dhe me shumë impakt në Shqipëri. Raportet dhe deklaratat e saj nuk kontestoheshin nga asnjëri prej aktorëve kryesorë në vend. Përkundrazi ato përdoreshin për të legjitimuar synimet e aktorëve lokalë. Më konkretisht Memorandumi Ekonomik i vitit 2004 për Shqipërinë, i Bankës Botërore, të cilin ne e kemi trajtuar deri tani, pati ndikim direkt në debatin politik shqiptar dhe në fushatën elektorale të vitit 2005. Shifra prej 1.4 miliard dollar e ryshfetit dhe indeksi 68 i korrupsionit citoheshin si në Parlament edhe gjatë fushatës elektorale të vitit 2005 nga Sali Berisha ose Ridvan Bode. Fakti që asnjëri nga aktorët politikë lokalë nuk i kontestonte këto shifra, që sikurse pamë ishin sajesa më shumë se fakte, tregon nivelin e besueshmërisë të Bankës Botërore në Shqipëri.

Fajësimi i korrupsionit për mungesën e zhvillimit ekonomik shërbente edhe

për të injoruar problemet e prodhuara nga vetë modeli zhvillimor neoliberal. Nëse problemi themelor me të cilin përballej biznesi në Shqipëri ishte ryshfeti, atëherë mund të injoroheshin probleme të tjera si mungesa e kreditimit që për periudhën 1998 –2001 ra në mënyrë drastike. Për këtë periudhë Shqipëria kishte nivelin më të ulët të kreditimit në rajon. Shiko Tabelën 13 më poshtë.

Tabela 13. Kreditimi bankar për sektorin privat (si % e GDP-së)

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Shqipëria	3.6	3.9	3.9	0.6	2.1	2.9	3.8	4.7
Bosnia-Hercegovina	Na	NA	NA	NA	8.9	7.4	9.5	12.0
Bullgaria	21.1	35.3	12.3	12.2	14.0	11.6	14.6	18.0
Kroacia	22.9	21.4	25.3	26.6	22.1	27.8	34.2	45.0
Maqedonia	23.1	26.5	27.3	17.7	10.4	10.5	12.8	14.4
Rumania	7.8	11.5	8.4	11.6	8.1	7.2	7.7	8.4
Serbia-Mali i Zi	-	9.2	10.8	11.2	9.8	7.6	5.6	-

Burimi: The World Bank 2004, f. 141.

Rënia e nivelit të kreditimit sidomos pas vitit 1997 ishte pasojë e drejtpërdrejtë e politikave kushtëzuese të FMN-së që synonin kontrollimin e inflacionit duke vendosur kufizime të kreditit edhe pse një sondazh i kryer me rreth 1000 biznese shqiptare në vitin 1997 tregonte se mungesa e kërkesës dhe e investimeve po e bënin të pamundur rivitalizimin e biznesit shqiptar. Në këto kushte politikat monetare shtrënguese të FMN-së ishin mjaft problematike (Vaughan-Whitehead, 1999, f. 259). Përqendrimi tek nivelet e larta të korrupsionit eliminonte nevojën për një analizë kritike të politikave neoliberale dhe efekteve të tyre negative mbi ekonominë shqiptare. Sikurse vëren Heather Marquette teksa analizon politikat anti-korrupsion të Bankës Botërore në nivel global:

Interesi i Bankës rreth korrupsionit kishte arsye pragmatike. Dështimi i politikave të përshtatjes strukturore [structural adjustments] për të prodhuar ndryshimet e dëshiruara iu faturua mosfunksionimit të institucioneve në vendet që ndihmoheshin prej saj, çka përfshinte edhe paaftësinë për të luftuar korrupsionin (Marquette, 2003, f. 156).

Korrupsioni shikohej si pasojë e institucioneve të dobëta, çka nënkuptonte forcimin e tyre në kuadrin antikorrupsion. Në këtë kontekst politikat antikorrupsion në Shqipëri bazoheshin te forcimi i institucioneve, por pa ndryshuar aspak politikat që ato duhet të zbatonin. Pra forcimi i institucioneve nënkuptonte zbatimin e të njëjtave politika.

Kundër korrupsionit: më shumë neoliberalizëm

Politikat antikorrupsion nënkuptonin më shumë derregullim, tregtitë të lirë, liberalizim dhe privatizim. Në një nga strategjitë e saj të para antikorrupsion Banka Botërore deklaronte se: “Derregullimi dhe zgjerimi i tregjeve janë mjete të fuqishme për të kontrolluar korrupsionin dhe Banka do të inkurajojë qeveritë për të ndjekur këto objektiva kurdo që është e mundur” (The World Bank, 1997a, f. 35). Sipas së njëjtës logjikë Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) rekomandonte si politika antikorrupsion privatizimin dhe liberalizimin:

Privatizimi – ...Duke eliminuar qeverinë nga aktiviteti ekonomik [privatizimi] eliminon mundësinë e marrëveshjeve të korruptuara në shitje, në punësim, në tenderim...

Liberalizimi – Liberalizimi është një instrument direkt në kufizimin e autoritetit të shtetit. Eliminimi i tarifave, kuotave, kufizimeve në këmbimin valutor, kontrollit të çmimeve dhe kriterëve për licencim i heq mundësinë zyrtarëve për të marrë ryshfet (USAID, 1999, f. 8).

Këto ishin disa nga politikat që promovoheshin në kuadrin e antikorrupsionit edhe në Shqipëri. Filozofia antikorrupsion e qeverisë shqiptare në vitin 1998 bazohej tek ideja e Bankës Botërore se korrupsioni rezultonte, ndër të tjera, nga ndërhyrja e tepër e shtetit në ekonomi. Sikurse deklaronte zv.kryeministri, Kastriot Islami, në vitin 1998, Qeveria e shikonte “derregullimin progresiv të ekonomisë nëpërmjet zvogëlimit të rolit të shtetit në ekonomi si një profilaksi efektive për minimizimin e korrupsionit” (Islami, 1998). Disa nga politikat ekonomike të ndërmarra nga Qeveria shqiptare nën kujdesin e institucioneve ndërkombëtare, në kuadrin e procesit antikorrupsion ishin si më poshtë:

- Reduktimi i tarifave dhe i barrierave për tregtinë ndërkombëtare.
- Eliminimi i subvencioneve për ndërmarrjet.
- Minimizimi i ndërhyrjeve të shtetit.
- Demonopolizim dhe vazhdim i privatizimit të pronës shtetërore (Çepiku, 2004, f. 117-8).

E njëjta filozofi ishte edhe në themel të fushatës së ndërgjegjësimit publik rreth korrupsionit, financuar dhe ideuar nga USAID në vitin 2001. Organizatat jofitimprurëse, që u krijuan dhe u financuan nga USAID, si Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit kishin si qëllim të “rrisnin ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare në lidhje me shkaqet dhe kostot e korrupsionit dhe ta transformojnë këtë ndërgjegjësim në mbështetje për reformat që synojnë të reduktojnë dhe të luftojnë

korrupsionin”, ndër të cilat përfshihej edhe privatizimi (OECD, 2002, f. 31). Në fushatat ndërgjegjëse korrupsioni portretizohej si karakteristikë e sektorit publik, ndërsa bizneset private shikoheshin si viktimë të korrupsionit. Sikurse vëren Smilov në këto fushata: “Biznesi portretizohej si viktimë e korrupsionit, ndërsa nëpunësit publikë (si kategori anonime) si keqbërësit potencialë” (Smilov, 2009, f. 92). Në këtë aspekt fushatat e ndërgjegjësimit antikorrupsion shërbenin për të legjitimuar vendosjen e një rendi neoliberal në luftën kundër korrupsionit.

Ruajtja e asimetrisë: zbatimi i kuadrit institucional neoliberal

Mënyra e dytë në të cilën ligjërimi ndërkombëtar rreth korrupsionit i shërbeu forcimit të rendit neoliberal në Shqipëri ishte nëpërmjet riprodhimit të asimetrisë së thellë mes Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare që e monitoronin atë. Në ligjërimin ndërkombëtar institucionet shqiptare, klasa politike shqiptare dhe shoqëria shqiptare ose ishin infektuar nga korrupsioni ose ishin burim i tij. Sikurse e pamë në kapitullin paraardhës një nga arsyet që shpjegonte përhapjen e korrupsionit sipas ndërkombëtarëve ishte toleranca e shoqërisë shqiptare ndaj tij. Pikërisht për këtë arsye shoqëria shqiptare duhej edukuar në lidhje me pasojat e rrezikshme të korrupsionit. Sikurse vërente një vëzhgues ndërkombëtar, në Shqipëri: “Problemi i korrupsionit është përkeqësuar si pasojë e aspekteve kulturore [shqiptare]” (Mathisen, 2003, f. 4). Kjo nënkuptonte jo vetëm tolerancën, por edhe injorancën e popullatës shqiptare në lidhje me korrupsionin. Premisa bazë e fushatës antikorrupsion të financuar nga USAID ishte se:

ka mundësi që një pjesë e mirë e publikut shqiptar nuk e kupton se cilat janë praktikatat korruptive. Diçka e tillë vjen pjesërisht si pasojë e kulturës klanore shqiptare që inkurajon kujdesin për anëtarët apo shokët e klanit dhe zgjidhjen e problemeve brenda këtij rrethi. Është gjithashtu rezultat i një tradite të gjatë paternaliste që ruhet nga një shoqëri e mbyllur dhe e shtresëzuar (USAID/Albania, 2000, f. 3).

Në ligjërimin e korrupsionit Shqipëria pra shpesh paraqitej si një shoqëri paramoderne, e mbyllur dhe e shtresëzuar që për pasojë prodhon korrupsion.

Ky ishte një portretizim mjaft i çuditshëm për këdo me njohuri elementare rreth Shqipërisë. Së pari, pavarësisht nivelit të ulët të të ardhurave, pas dyzet viteve modernizim komunist Shqipëria kishte një nivel të ulët analfabetizmi dhe një nivel të lartë mesatar të jetëgjatësisë (në vitin 2000 rreth 93% dinin të shkruanin dhe lexonin, ndërsa jetëgjatësia mesatare ishte 72 vjeç), ndaj ishte e vështirë që vendi të përshkruhej si paramodern. Së dyti, në vitin 2000 Shqipëria kishte përqindje të madhe të popullsisë jashtë vendit, dhe për pasojë një pjesë e

madhe e popullsisë ishin bilingual, dhe kuptonin e flisnin italisht dhe greqisht përveç shqipes. Ndaj ishte e vështirë ta përshkruaje Shqipërinë si një shoqëri të mbyllur në vitin 2000. Së dyti, si pasojë e historisë së saj dhe e diktaturës komuniste Shqipëria ishte një vend më egalitar dhe më pak i shtresëzuar se SHBA-ja apo Britania e Madhe, edhe pse rendi neoliberal e kish thelluar pabarazinë. Shiko Tabelën 14 më poshtë.

Tabela 14. Shpërndarja e të ardhurave për Shqipërinë, SHBA-në dhe Britaninë

Vendi	Indeksi Gini	Viti
Shqipëria	26.7	2005
Britania	34.0	2005
SHBA-të	45.0	2007

Burimi: The CIA WorldFactbook, 2011. Indeksi Gini tregon shpërndarjen e të ardhurave në popullatë; 0 shënon barazi totale në shpërndarjen e të ardhurave, ndërsa 100 do të thotë pabarazi totale.

Së fundi, si pasojë e historisë së saj, Shqipëria kishte një ndarje shumë më të vogël klasore në raport me SHBA-në apo Britaninë e Madhe. Në këtë aspekt shoqëria shqiptare ishte mjaft më egalitare dhe ofronte mobilitet të lartë social ndaj nuk mund të quhej e shtresëzuar fort.

Duke e portretizuar shoqërinë shqiptare si të mbyllur dhe injorante ligjërimit ndërkombëtar e vendoste atë në një pozicion inferior nëpërmjet të cilit legjitimoheshin përkufizimet ndërkombëtare të korrupsionit dhe skarcoheshin botëkuptimet lokale për të. Kështu një sondazh i financuar nga USAID, që identifikonte perceptimin e shqiptarëve në lidhje me korrupsionin në vitin 2008, argumentonte se:

Ekziston ende njëfarë konfuzioni në publikun shqiptar për sa i përket kuptimit të qartë se çfarë përbën korrupsion. Të pyetur për “pronarin e një dyqani lulesh i cili rrit çmimin e luleve gjatë festave”, 52% e qytetarëve u përgjigjën se ky pronar është “i korruptuar dhe duhet ndëshkuar” (IDRA, 2008, f 24).

Në po të njëjtin sondazh argumentohej se:

Dëshmi e konfuzionit të këtij “abuzimi” të perceptuar (biznese që vendosin çmime tejet të larta për produktet apo shërbimet e tyre) me fenomenin e korrupsionit, ndeshet edhe në përgjigjet e pyetjeve se çfarë i bën avokatët të korruptuar. 60% e të intervistuarve thanë se, nëse një avokat kërkon pagesë të lartë, ai/ajo është i korruptuar (IDRA, 2008, f 24).

Siç e shikojmë nga shembujt e mësipërm, botëkuptimi lokal në lidhje me korrupsionin interpretohet si konfuzion dhe skualifikohet në raport me përkufizimin ndërkombëtar. Në fund të fundit ishte faktori ndërkombëtar ai që ndërtonte fushatën e ndërgjegjësimit dhe që edukonte publikun shqiptar.

Kjo ishte një marrëdhënie paternaliste që riprodhonte vazhdimisht pozicionin inferior të Shqipërisë përballë institucioneve ndërkombëtare që e monitoronin atë. Ishte një marrëdhënie në të cilën institucionet ndërkombëtare përcaktonin agjendën lokale antikorrupsion, edhe pse shpesh me konsensusin e klasës politike lokale. Si e tillë ajo fshihej me kujdes duke theksuar shpesh rolin aktiv të Shqipërisë në të. Kështu Banka Botërore e paraqiste iniciativën antikorrupsion që filloi në vitin 1998 si nismë e vetë qeverisë shqiptare. Në një raport të vitit 2000 ajo vëren se “në vitin 1998 [Banka Botërore] kreu punë innovative në Shqipëri, Gjeorgji dhe Letoni me kërkesë të lidhshpimit të këtyre vendeve për të diagnostikuar natyrën dhe shpërndarjen e korrupsionit” (The World Bank, 2000b, f. 28). Nga intervistat në terren unë verifikova se në vitin 1998 ishte Qeveria shqiptare ajo që pranoi kërkesën e Bankës Botërore për të kryer një sondazh në lidhje me korrupsionin dhe jo anasjelltas (Pasha, 2008). Sipas Marquette vende të ndryshme u inkurajuan nga Banka Botërore të dërgonin letra në adresë të “James Wolfenshon [president i BB 1995-2005], për të kërkuar asistencë antikorrupsion” (Marquette, 2004, f. 417).

Ligjërimit ndërkombëtar rreth korrupsionit e forcoi marrëdhënien asimetrike mes Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare edhe duke goditur besimin e qytetarëve tek institucionet lokale. Një studim që vlerësonte fushatat antikorrupsion në rajon arrinte në konkluzionin se në rastin e Shqipërisë fushatat antikorrupsion ndërgjegjësonin qytetarët rreth përhapjes së gjerë të korrupsionit, por që nuk ndihmonin në uljen e niveleve aktuale të korrupsionit që prodhuan “një rënie të besimit të publikut për institucionet publike dhe politikanët duke krijuar një spirale perceptimi që e konsideronte korrupsionin si të paevitueshëm” (ANTE, 2005, f 24). Sikurse vërente një tjetër raport në lidhje me fushatat antikorrupsion në Europën Juglindore ato përçonin mesazhin se “sistemi politik i vendit dominohej nga aktorë të korruptuar çka prodhonte varfëri, pengonte zhvillimin ekonomik etj.” (Tisne & Smilov, 2004, f 61). Kështu në një fushatë ndërgjegjësimi të organizuar nga Mjaft! Një OJQ shumë aktive dhe e suksesshme, që financohej nga donatorët e huaj, paraqitej një poster me titullin “Mjaft me korrupsionin!” ku Skënderbeu thoshte: “Politikanë shqiptarë korrupsionin nuk ua solla unë, atë e gjeta në mes jush”.² Mesazhi se klasa politike shqiptare ishte e korruptuar përputhej mjaft mirë me ligjërimitin dominues antipolitik në sferën publike shqiptare, ku për çdo problem fajësohej klasa politike (Kajsiu, 2010, f. 244-5). Për pasojë fushatat e ndërgjegjësimit antikorrupsion edhe nëse nuk patën ndonjë ndikim direkt në uljen e të ashtuquajturit “nivel rea” të korrupsionit ndikuan në uljen e mëtejshme të besimit tek institucionet dhe klasa politike lokale.

² Për ta parë këtë poster shkoni tek http://www.mjaft.org/en/media_promocion.php

Zbatimi i kuadrit institucional neoliberal

Ligjërimi ndërkombëtar rreth korrupsionit e vendoste Shqipërinë në një pozicion të pashpresë. Nuk kish asnjë mundësi që Shqipëria të vetëshërohej sepse ish prekur prej korrupsionit në të gjitha aspektet e saj: institucionet, politikanët dhe shoqëria. E vetmja shpresë ishte ndërhyrja nga jashtë nëpërmjet ndihmës, presionit apo edukimit që ofronte “komuniteti ndërkombëtar”. Në vlerësimin e tyre të fushatave antikorrupsion nga ana e institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri Tisne dhe Smilov arrijnë në konkluzionin se:

Ngërçi në të cilin ndodhen shumë vende në tranzicion i ka bërë donatorët e huaj të rekomandojnë një përqendrim të mëtejshëm te mekanizmat që imponojnë përgjegjshmërinë nga jashtë duke ushtruar presion mbi qeveritë dhe duke thyer kështu ekuilibrin e keqqeverisjes në të cilin ato ndodhen. Zgjidhjet përfshijnë ...presionin ndërkombëtar nëpërmjet qasjeve që bazohen te përfitimet – futja në BE, anëtarësimi në NATO/OBT, kushtet e IFI-së [institucionet ndërkombëtare të financës] – kombinuar me kërcënimin e sanksioneve të forta (Tisne and Smilov, 2004, f 64).

E thënë ndryshe, niveli i lartë dhe i thellë i korrupsionit në nivel lokal bënte të domosdoshme më shumë ndërhyrje dhe kufizime nga jashtë. Përballë një Shqipërie tërësisht të korrumpuar, ligjërimi ndërkombëtar rreth korrupsionit artikulonte institucione të pastra ndërkombëtare që kishin besueshmërinë, njohuritë dhe dëshirën e mjaftueshme për ta pastruar Shqipërinë. Kjo e fundit thjesht duhej të përqafoje institucionet, legjislacionin dhe rekomandimet që ofroreshin nga institucionet ndërkombëtare për të reduktuar korrupsionin. Shtylla e parë e Iniciativës Antikorrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI) për Europën Juglindore ishte: “Pranim dhe implementim i instrumenteve ligjore antikorrupsion universale dhe Europiane” (SPSEE 2008).

Zbatimi i kuadrit legjislativ dhe institucional antikorrupsion synonte integrimin e Shqipërisë në tregun global duke e bërë ekonominë shqiptare më të hapur dhe tërheqëse ndaj kapitalit të huaj. Sipas Nismës Antikorrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI) në kuadrin e përpjekjeve antikorrupsion vendet e Europës Juglindore zhvilluan “një legjislacion që i bënte më transparente procedurat për investimet e huaja dhe biznesin ndërkombëtar (p.sh. duke zbatuar, si në rastin e Kroacisë, parimin e trajtimit të barabartë si të kapitalit të huaj edhe të atij vendas)” (SPAI, 2001a, f. 15-16). Një nga rekomandimet e para të Grupit Drejtues të SPAI-së në raportin e tij për Shqipërinë në vitin 2001 ishte: “Rishikim i Ligjit për Prokurimin Publik për ta përshtatur legjislacionin me Marrëveshjen për Prokurimet Qeveritare të OBT-së dhe me direktivat e BE-së” (SPAI, 2001a, f. 47). Po i njëjti raport vërente në mënyrë aprovuese se ligji ekzistues për prokurimin publik nuk parashikonte trajtim preferencial për kapitalin lokal. Pra ky ligj i trajtonte njësoj, si kapitalin e

huaj edhe atë lokal. Në analizë të fundit korrupsioni duhej luftuar në mënyrë që të tërhiqeshin më shumë investime të huaja. Madje këto të fundit ishin kaq prioritare sa në njërin nga programet kryesore antikorrupsion të Këshillit të Europës për Shqipërinë reduktimi i korrupsionit nuk përmendej si objektiv konkret:

Programi Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar në Europën Juglindore (PACO) projekti për Shqipërinë (PACO Albania) i Këshillit të Europës kishte si synim afatgjatë ...të asistonte Shqipërinë për të zhvilluar shtetin e së drejtës, për të rritur mundësinë për të tërhequr investimet e huaja në vend...Reduktimi i korrupsionit nuk përmendej në mënyrë eksplicite si objektiv (Tisne & Smilov, 2004, f 43).

Po kështu, Konventa Civile Kundër Korrupsionit, që u aprovua edhe nga Shqipëria, ndër të tjera synonte të garantonte investimet e huaja duke përcaktuar dëmshpërblim për ato biznese që ishin dëmtuar si pasojë e korrupsionit. Neni 3 i kësaj Konvente kërkonte që çdo vend, që e ratifikonte konventën, duhej të garantonte që në “ligjet e brendshme personat që janë dëmtuar nga korrupsioni duhet të kenë të drejtën të kërkojnë kompensim të plotë për këtë dëmtim” (CoE, 1999, Neni 3). Sikurse shpjegon Raporti Shpjegues i Konventës, kompensimi nënkupton “fitimet që pritej të realizoheshin, por që nuk u realizuan si pasojë e korrupsionit” (CoE, 1999, Explanatory Report, paragrafi 37). E thënë shkurt antikorrupsioni shërbente për të zbatuar një sërë reformash që do ta integronin më mirë ekonominë shqiptare me atë ndërkombëtare.

Kuadri institucional antikorrupsion, që u zbatua në Shqipëri, shërbeu për të krijuar atë që Barry Hindess e ka quajtur një “mjedis institucional në të cilin investuesit e huaj mund të ndihen si në shtëpi dhe në të cilin ata ndihen të aftë për të bërë biznes” (Hindess, 2009, f. 28). Natyrisht ky nuk ishte një proces unik për Shqipërinë. Sikurse deklaroi Mlada Bukovansky “retorika aktuale antikorrupsion shënon zgjerimin e përpjekjeve multilaterale për të zgjeruar dhe konsoliduar themelet institucionale për një ekonomi të tregut në nivel global” (Bukovansky, 2006, f. 182). Në këtë kontekst korrupsioni shërbente për legjitimimin dhe implementimin e një sërë reformash që forconin rendin neoliberal më shumë sesa këto reforma shërbenin për të eliminuar korrupsionin. Sikurse vërejnë Tisne dhe Smilov në analizën e tyre të fushatave antikorrupsion në rajon:

Disa nga reformat mund të ishin ndërmarrë nën një tjetër “moto” [jo nën moton e korrupsionit]...Por duke i përfshirë ato në paketën antikorrupsion shpresohet se qeveritë do të ishin më të interesuara në zbatimin e tyre, që shoqëria civile do të ushtronte më shumë presion në procesin e implementimit të tyre, dhe që donatorët do ta kishin më të lehtë të ushtronin presion mbi politikën qeveritare në fushat kyç të reformës (Tisne & Smilov, 2004, f. 50).

Pra korrupsioni ishte i dobishëm si mjet presioni ndaj qeverive për të zbatuar një sërë reformash. Kuadri legjislativ dhe institucional që u përqaftua nga Shqipëria edhe pse e afroi vendin me kërkesat ndërkombëtare nuk shërbeu shumë për uljen e korrupsionit, pavarësisht përkufizimit të tij. Ai ishte i dobishëm për të zbatuar një sërë reformash që forconin rendin neoliberal më shumë sesa për të luftuar korrupsionin.

Prandaj nuk është çudi që shumë nga reformat që u ndërmorën në Shqipëri për të luftuar korrupsionin në disa raste e bënë më të vështirë luftën ndaj tij. Rasti më tipik është futja e korrupsionit si vepër penale specifike në Kodin Penal në vitin 2004 pas ratifikimit të Konventës Civile Kundër Korrupsionit të Këshillit të Europës (KE). Në përputhje me Konventën korrupsioni tashmë u përkufizua si: “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ... nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij ...” (Ligji 9275, nenet 22 & 23). Tashmë korrupsioni nuk nënkuptonte thjesht shkeljen e ligjit, por edhe zbatimin e tij me qëllim përfitimin personal. Sikurse behet e qarte nga një intervistë me një anëtar të Gjykatës së Lartë, diçka e tillë ishte më e vështirë për t’u provuar se vepra penale të mëparshme si mita, apo shpërdorimi i detyrës, sepse duhej provuar që një veprim edhe nëse ishte i ligjshëm mund të ishte kryer me qëllim përfitimin personal (Dvorani, 2010). Në këtë aspekt korrupsioni si një vepër e re penale kërkonte më shumë burime financiare dhe njerëzore për hetim sesa mita apo shpërdorimi i detyrës. Këto ishin burime që Prokuroria nuk i kishte. Në raportin e vitit 2004 në Parlament në lidhje me korrupsionin në administratën publike Prokurori i Përgjithshëm deklaronte se “edhe sikur të mendojmë që Prokuroria nuk ka pengesa për të nisur hetimet, kryesisht, për të kontrolluar ligjshmërinë e aktivitetit të administratës publike, kjo do të ishte e pamundur nga ana ekonomike dhe e burimeve njerëzore, që do të kërkonte një angazhim i tillë.” (Sollaku, 2004, f 409).

Konkluzione: fundi i gjëgjëzës së korrupsionit

Në kuadrin e antikorrupsionit institucionet ndërkombëtare prezantuan në Shqipëri një kuadër ligjor dhe institucional standard që i përshtatej pak ose aspak realiteteve lokale. Ky ishte një kuadër që rekomandohej dhe imponohej nga institucione si Banka Botërore jo vetëm në vendet postkomuniste apo në tranzicion, por edhe në vendet në zhvillim në përgjithësi. Në vlerësimin që i kanë bërë politikave antikorrupsion të Bankës Botërore në Shqipëri Tisne dhe Smilov arrijnë në konkluzionin se:

Është shqetësuese tendenca për zbatimin e strategjive kombëtare antikorrupsion nga njëri vend tek tjetri pa marrë parasysh nëse zgjidhja i

përshtatet problemit. Në Shqipëri pothuajse gjashtë vite pas përpjekjes së Bankës Botërore për ndërtimin e një strategjie kombëtare antikorrupsion për këtë vend në vitin 1998, ende pak është arritur (Tisne & Smilov, 2004, f. 51).

Shumica e vëzhguesve ishin dakord me vlerësimin e mësipërm. Në një vlerësim të vitit 2003 nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) konkludohej se “si kapja e shtetit edhe korrupsioni administrativ u rritën gjatë periudhës 1999-2002.” (Steve & Ruso, 2003, f. 33) Vetë Banka Botërore pranonte se “nga pikëpamja e firmave...nivelet e korrupsionit mbetën të pandryshuara ose u përkeqësuan në periudhën 2002-2005.” (The World Bank, 2006b) Pra gjatë periudhës 1998 – 2005, që përbënte edhe periudhën më intensive antikorrupsion në Shqipëri, korrupsioni në fakt ose nuk ndryshoi ose erdhi duke u rritur, sipas vetë institucioneve ndërkombëtare.

Edhe pse jo shumë të suksesshme në uljen e nivelit të korrupsionit programet antikorrupsion ishin mjaft të suksesshme në zbatimin e një kuadri ligjor dhe institucional neoliberal që justifikohesh dhe legjitimohej në kuadrin e luftës antikorrupsion. Rendi neoliberal nga ana tjetër ndihmonte në prodhimin e korrupsionit përballë të cilit ai legjitimohej. Shumë prej politikave neoliberale si politikat shtrënguese monetare dhe fiskale prodhonin uljen e rrogave të buxhetorëve dhe nxisnin rritjen e nivelit të ryshfetit në administratën publike. Politika të tjera si privatizimi i vazhdueshëm i shërbimeve publike prodhonin vazhdimisht grupe private interesi që gjithnjë e më tepër kapnin shtetin, çka shpjegonte edhe nivelin në rritje të kapjes së shtetit sidomos pas vitit 1998.

Bibliografia

- ANTE (2005), *International Cooperation to Fight Corruption in South-eastern Europe: Achievements, Lessons Learned, And Future Challenges*, Anticorruption Network for Transition Economies. Paris: Anticorruption Network For Transition Economies.
- ARCOTRASS (2006) *Study on the State of Agriculture in Five Applicant Countries, Albania: Country Report*, ARCOTRASS- Consortium.
- Berisha, S. (1997). Viti 1997, përcaktues në konsolidimin e shtetit ligjor, ekonomisë së tregut, integritimit në institucionet Euro-Atlantike. *Rilindja Demokratike*, 11 janar, 1997. f. 1.
- Bezemer, D. (2006). Growth but Not Development: The Ponzi Economy and its Lessons. In: Bezemer, D. (ed). *On Eagle's Wings: The Albanian Economy in Transition*, New York: Nova Science Publishers, Inc. p. 17-33.
- Bogdani, M. and Loughlin, J. (2009) *Albania and the European Union: The Tumultuous Journey Towards Integration and Accession*. London, New York:

- I.B.Tauris.
- Bukovansky, M. (2006). The Hollowness of Anti-Corruption Discourse. *Review of International Political Economy*. 13 (2). f. 181 – 209.
- Carlbon, L. and Wistrom, J. (2006) *Final Report: Evaluation of the Swedish Support in the Area of Anti-corruption in South Eastern Europe – PACO Impact 2004 – 2006*, Stockholm: Institute of Public Management.
- CEC. (2001). *Report from the Commission to the Council: On the work of the EU/Albania High Level Steering Group, in preparation for the negotiation of a Stabilisation and Association Agreement with Albania*, (Brussels: Commission of the European Communities).
- CIA World Factbook. (2011). *Country Comparison: Distribution of Family Income – Gini Index*. The CIA World Factbook. Gjendet tek: <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/rankorder/2172rank.html?countryName=Albania&countryCode=al®ionCode=eu&rank=126#al> [aksesuar me 20 Prill, 2011]
- CID (2011) *Washington Consensus*. Harvard University: Centre for International Development (CID). Marre nga: <http://www.cid.harvard.edu/cidtrade/issues/washington.html> [aksesuar me 16 korrik 2011]
- Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998). *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990–1997*. Aldershot: Ashgate.
- CoE (1999a). *Civil Law Convention On Corruption*. Strasbourg: Council of Europe. 27 Janar.
- CoE (1999b). *Criminal Law Convention On Corruption*. Strasbourg: Council of Europe. 27 Janar.
- Council of Ministers of Albania. (1998). *Combating Corruption in Albania: A Comprehensive reform program*. Tirana: Council of Ministers of Albania.
- Çepiku, D. (2004). Coping with Corruption in Albanian Public Administration and Businesses. *International Public Management Review*. Vol. 5, nr. 1, f.99-137.
- Dvorani, A. (2010). *Korrupsioni në Legjislacionin Shqiptar*. [Intervistë personale]. Tiranë, 11 qershor.
- EBRD (1996). *Transition Report 1996*. London: European Bank for Reconstruction and Development.
- Ekonomia dhe tranzicioni* (1998). Informacion mbi veprimtarinë e Q.SH.K.E-së. *Ekonomia dhe tranzicioni*. Vol. 17, nr. 3. korrik – shtator, f. 105.
- FIAS (2003) *Albania, Removing Administrative Barriers to Investment: A Critical Component of the National Development Strategy*. Washington D.C.: Foreign Investment Advisory Service (FIAS).
- Foucault, M. (2004). *The Birth of Biopolitics*. New York: Palgrave Macmillan.
- GRECO (2002) *Evaluation Report on Albania: First Evaluation Round*, (Strasbourg: Group of States Against Corruption).
- Index Mundi (2011) *Albania GDP*, Gjendet tek: <http://www.indexmundi.com/facts/albania/gdp> [16 korrik, 2011]
- Islami, K. (1998). Kërkohet sakrificë dhe angazhim maksimal. *Zëri i Popullit*, 1 korrik, 1st. f 7.
- Johnson, C. (1999). The Developmental State: The Odyssey of a Concept. In: Cummings, W, M. (ed.) *The Developmental State*. Ithaca and London: Cornell University Press. p. 32-61.
- Harvey, D. (2005) *A Brief History of Neoliberalism*. (Oxford: Oxford University Press)
- Hashi, I., Xhillari, L. (1999). Privatisation and Transition in Albania. *Post-communist Economies*. Vol. 11, nr. 1, f. 99-125.
- Hindess, B. (2005). Investigating International Anti-corruption. *Third World Quarterly*. 26 (8), f. 1389-1398.
- IDRA (2008) *Corruption in Albania– Perception and Experience: Summary Findings*, Institute for Development and Research Alternatives. (Tirana: Institute for Development and Research Alternatives). Gjendet tek: http://projects-albania.usaid.gov/rol/IDRA-CPE-2008-Survey_Summary-of-Findings_EN.pdf [17 korrik, 2011].
- Kajsiu, B. (2010). Down with Politics! The Crisis of Representation in Albania. *Journal of East European Politics and Societies*. Vol. 24, nr. 2, f. 229-253.
- Kaser, M. (2006). A Political Economy History of Albania's Transition to the Market (1990-2004). In: Bezemer, D.J. (ed). *On Eagle's Wings: The Albanian Economy in Transition*. New York: Nova Science Publishers, Inc. f. 1-15.
- Kaufmann, D., Ryterman, R., Zoido-Lobaton, P., Preci, Z and Pasha, A. (1998). Qeverisja dhe korrupsioni në Shqipëri: Çështje e ditës për reformat institucionale. *Ekonomia dhe tranzicioni*. Vol. 17, nr. 3, korrik – shtator, f. 5 – 11.
- Khan, M (2002). Corruption and Governance in Early Capitalism: World Bank Strategies and their Limitations. In: Pincus, J. and Winters, J. (eds.) *Reinventing the World Bank*. Ithaca: Cornell University Press.
- Koha Jonë*. (1998). Plas korrupsioni. 1 korrik, f. 1.
- Konica, N. (2006). The Emigration Experience and Its Impact on the Albanian Economy in Early Transition Period. In: D.J. Bezemer (red.) *On Eagle's Wings: The Albanian Economy in Transition*, New York: Nova Science Publishers, Inc. F. 51-69.
- Korovilas, J. (1999). The Albanian Economy in Transition: The Role of Remittances and the Pyramid Investment Schemes. *Post-Communist Economies*. Vol. 11, nr. 3, f. 399 – 415.
- Ligji Nr. 9275. Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, Datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Tiranë, 16 shtator, 2004.
- Marquette, H. (2004). The Creeping Politicization of the World Bank: The Case of Corruption. *Political Studies*, 52 (3) p. 413 – 430.
- Marquette, H. (2003). *Corruption, Politics, and Development: The Role of the World*

Bank, Basingstoke: Palgrave Press.

Mathisen, H. W. (2003), *Donor Roles in face of endemic corruption – Albania in the policy debate*. Oslo: Chr. Michelsen Institute, Utstein Anti-corruption Resource Centre.

Muço, M. (1997). Economic Transition in Albania: Political Constraints and Mentality Barriers. *NATO Individual Fellowship Program 1995-1997*.

OECD (2002). *Anti-corruption Measures in South Eastern Europe: Civil Society's Involvement*. Paris: Organization for Economic Cooperation and Development.

Pasha, A. (2008). Studimi i korrupsionit në Shqipëri. [Intervistë personale]. Tiranë, 7 maj.

Republika. (1998) Qeveria e pranon: Na mbyti korrupsioni, 1 korrik, f. 1.

Schnytzer, A. (1982). *Stalinist Economy in Practice: The Case of Albania*. Oxford: Oxford University Press.

SELDI (2002) *Corruption Indexes: Regional corruption monitoring in Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Macedonia, Romania and Yugoslavia*. Southeast European Legal Development Initiative (SELDI). Sofia: Vitosha Research. Gjendet tek: http://www.seldi.net/SELDI_fin_e2.PDF [16 korrik, 2011]

Smilov, D. (2009). Anti-corruption bodies as discourse-controlling instruments: Experience from south-east Europe. In: De Sousa, L., Larmour, P. and Hindess, B. (red.) *Governments, NGOs and Anti-Corruption: The New Integrity Warriors*. London, New York: Routledge.

Sollaku, Th. (2004). Seancat plenare të Parlamentit Shqiptar. (Tiranë: Zyra e botimeve, Parlamenti Shqiptar), 23 mars.

SPAI (2001a) *Anti-corruption Measures in South-eastern Europe: Country Reviews and Priorities for Reform*. Stability Pact Anti-corruption Initiative (SPAI) Steering Groups. Strasbourg: Council of Europe Publishing.

SPSEE (2008) *Regional Anti-Corruption Initiative*, Stability Pact for South-East Europe. Gjendet tek: <http://www.stabilitypact.org/anticorruption/> [aksesuar me 16 korrik, 2010]

Steves, F. and Ruso, A. (2003). *Anti-corruption Programs in Post-Communist transition countries*, Working Paper, No. 85. European Bank for Reconstruction and Development (EBRD).

The World Bank. (1994). *Albania and the World Bank: Building the Future*. Washington D.C.: The World Bank Group.

The World Bank. (1997a). *Helping Countries Combat Corruption: The Role of the World Bank*. Washington D.C.: The World Bank Group.

The World Bank. (1997b). *World Development Report 1997: The State in the Changing World*. Washington: The World Bank Group.

The World Bank. (1998a). *Albania Country Assistance Strategy*, Report No. 18161-ALB. The World Bank Group: Albania and Croatia Country Unit, Europe and

Central Asia Region.

The World Bank. (1998b). *Albania beyond the Crisis: A Strategy for Recovery and Growth*, Report No. 18658-ALB. Washington D.C.: The World Bank Group.

The World Bank. (2000b) *Helping Countries Combat Corruption: Progress at the World Bank Since 1997*. Washington D.C.: The World Bank Group.

The World Bank. (2004) “Shqipëria, ruajtja e rritjes së qëndrueshme edhe përtej tranzicionit”, *Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë*, Raport nr. 29257-AL. The World Bank: Europe and Central Asia Unit, Poverty Reduction and Economic Management Unit.

The World Bank. (2006b) *Corruption Significant Problem in Albania Despite Reforms*. [Online] 26th, July. Marre nga: <http://go.worldbank.org/T237VKF670> [Aksesuar me 16 korrik, 2011]

Tisne, M. and Smilov, D. (2004). *From the Ground Up: Assessing the Record of Anticorruption Assistance in Southeast Europe*. Budapest: Centre for Policy Studies, Central European University.

Treichel, V. (2006). Stabilisation Policies and Structural Reforms in Albania since 1997. In: D.J. Bezemer (ed.) *On Eagle's Wings: The Albanian Economy in Transition*, New York: Nova Science Publishers, Inc. f. 35-49.

USAID (1999). *A Handbook on Fighting Corruption*, Centre for Democracy and Governance. Washington D.C.: U.S. Agency for International Development.

USAID/Albania (2000). *Scope of Work: Albania Reduction Program*. Tirana: USAID/Albania.

Vaughan-Whitehead (1999). *Albania in Crisis: The Predictable Fall of the Rising Star*. Cheltenham, UK: Edward Elgar.

Zëri i Popullit (1998). Luftë kundër korrupsionit, 1 korrik, f. 3.

Niveli i kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë: efektet e drejtimit të zyrtarëve të lartë dhe besimit në institucione

Ph.D. Marsela Dauti¹

Abstrakt: Ky studim shqyrton efektet që drejtimi i zyrtarëve të lartë dhe besimi në institucionet sociale dhe politike kanë në nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë në Shqipëri. Rezultatet tregojnë se individët të cilët janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë janë të kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë dhe kanë besim në institucionet sociale dhe politike. Drejtimi i zyrtarëve të lartë luan rol kyç në shpjegimin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë. Ky konkluzion nuk ndryshon edhe pasi merren në konsideratë efektet e sigurisë financiare, arsimit, dhe rajonit gjeografik. Këto rezultate kontribuojnë në debatet aktuale rreth qeverisjes dhe demokracisë dhe sugjerojnë se drejtimi i zyrtarëve të lartë dhe besimi në institucionet sociale dhe politike luajnë një rol të rëndësishëm në nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë në vend.

Hyrje

Raportet kombëtare dhe ndërkombëtare evidentojnë një sërë problemesh me zhvillimet demokratike në Shqipëri. Shqipëria cilësohet si një prej vendeve ku pabarazitë ekonomike dhe sociale, pjesëmarrja e dobët në vendimmarrje, zbatimi i dobët i ligjit, mungesa e transparencës dhe dhënia e

¹ Marsela Dauti, MA, MSW, është kandidatë doktore në Universitetin e Washingtonit, One Brookings Drive, Campus Box 1196, St. Louis, Missouri, 63130; e-mail: mdauti@go.wustl.edu

ryshfeteve përbëjnë probleme shqetësuese (US Department of State, 2012; Instat & UNODC, 2011; OSCE, 2010; Transparency International, 2012). Përballjet e vazhdueshme me një sistem qeverisës që shpesh karakterizohet si i korruptuar kanë çuar në pakënaqësi me mënyrën sesi ka evoluar demokracia në dy dekadat e fundit. Pakënaqësia reflektohet qartë në të dhënat më të fundit të Hulumtimit Social European (OSFA, 2013). Shqipëria renditet e teta ndër 28 vende europiane për sa i përket nivelit të kënaqësisë së popullsisë me funksionimin e demokracisë, me një diferencë prej vetëm 0.8 pikësh me shtetin fqinj Greqinë, e cila prej kohësh është zhytur në krizë ekonomike.

Ky studim fokusohet në përcaktuesit e nivelit të kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë. Një sërë projektesh studimore të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare fokusohen në progresin e demokracisë në Shqipëri; megjithatë, analizat e tyre shpesh mbeten në nivelin përshkrues. Deri më sot, ne dimë shumë pak mbi perceptimet e shqiptarëve në lidhje me zhvillimin e demokracisë në vend. Ky studim përbën një përpjekje për të testuar përmes modeleve statistikore impaktin që drejtimi i zyrtarëve të lartë të vendit dhe besimi në institucionet sociale dhe politike kanë në nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë. Ky studim do të çojë në një njohje më të mirë të faktorëve që ndikojnë nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë në vend.

Rishikimi i literaturës

Më tepër se një dekadë më parë, Barometri i Europës Qendrore dhe Lindore (1996) theksoi se Shqiptarët ishin më optimistë sesa bullgarët, çekët, estonezët, hungarezët, rumunët, sllovakët, armenët dhe rusët. E ardhmja e Shqipërisë dukej premtuese. Sipas Barometrit (1996), “Tani, shqiptarët janë më të lumtur se gjithë pesëvjeçari që lamë pas në lidhje me drejtimin në të cilin vendi i tyre po shkon, me krijimin e ekonomisë së tregut, dhe me mënyrën sesi të drejtat e njeriut po respektohen në vendin e tyre. Për herë të parë që prej vitit 1991, pjesa më e madhe e shqiptarëve janë të kënaqur me mënyrën si demokracia është zhvilluar në vendin e tyre.” Kjo pikëpamje kaq pozitive nuk zgjati për një kohë të gjatë. Rezultatet e Sondazhit të Vlerave Botërore të vitit 2002 paraqesin një tablo pesimiste. Afërsisht, 27.2 për qind e të anketuarve u shprehën se nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend. Perceptimet nuk duken të kenë ndryshuar në mënyrë dramatike pas gjashtë vitesh. Rezultatet e Sondazhit European të Vlerave të vitit 2008 tregojnë se 26.3 për qind e të anketuarve nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend.

Megjithatë, nuk është e lehtë të bëhen krahasime në vite. Për shembull, në Sondazhin e Vlerave Botërore, përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme jepen në një shkallë prej 10 pikësh (1 = i pakënaqur, 10 = i kënaqur): Sa të kënaqur apo të pakënaqur jeni ju me situatën financiare të familjes suaj? Sa të kënaqur jeni ju me jetën tuaj?

Sa shumë liri gëzoni? Një gamë kaq e gjerë përzgjedhjeje (nga numri 1 në numrin 10) e bën të vështirë diferencimin, për shembull, midis një individi që përzgjedh numrin 6 dhe një individi që përzgjedh numrin 8. Pavarësisht nga kjo, një përshkrim i të dhënave tregon se pjesa më e madhe e përgjigjeve janë të përqendruara rreth vlerave 3 dhe 8. Shumë pak të anketuar raportojnë se janë të kënaqur (përzgjedhin numrin 10) dhe të pakënaqur (përzgjedhin numrin 1). Për shembull, 6.8 për qind e të anketuarve raportojnë se janë të kënaqur me lirinë që gëzojnë dhe 3.2 për qind raportojnë se nuk janë aspak të kënaqur; 2.7 për qind e të anketuarve raportojnë se janë të kënaqur me jetën e tyre dhe 4.6 për qind raportojnë se nuk janë të kënaqur.

Treguesit e qeverisjes si, për shembull, stabiliteti politik, efektiviteti i qeverisë, sundimi i ligjit dhe kontrolli i korrupsionit janë në nivele të ulëta sidomos nëse krahasohen me vendet që janë anëtare të Bashkimit European (US Department of State, 2012; OSCE, 2012). Besimi në institucionet sociale dhe politike është gjithashtu në nivele të ulëta. Një nga argumentet që haset shpesh në literaturë është se besimi i ulët në institucione është tregues i një demokracie të dobët. Një sërë studiuesish mbështeten në të dhënat e Sondazhit të Vlerave Botërore për të shqyrtuar çështje të lidhura me konsolidimin e demokracisë në Europën Qendrore dhe Lindore. Norris (1999) argumenton se individët që jetojnë në demokracitë e konsoliduara kanë më shumë gjasa të kenë besim në sistemin politik. Ndërkohë, në vendet ku zgjedhjet elektorale janë të manipuluar dhe korrupsioni përbën një problem shqetësues, individët janë skeptikë ndaj sistemit politik. Një sërë autorësh të tjerë fokusohen te përcaktuesit e besimit në institucione. Për shembull, Miller & Listhaug (1999) argumentojnë se besimi në institucione ndikohet nga deficitet e qeverisë. Norris (1999) argumenton se besimi në institucione në një vend të dhënë mund të shpjegohet duke u bazuar në karakteristikat kulturore, ekonomike, politike dhe sociale. Autorë të tjerë fokusohen në një sërë aspektesh të tranzicionit në vendet ish-komuniste, si besimi social dhe politik (Badescu, 2003; Newton, 1999), kapitali social (Bartkowski, 2003; Howard, 2003; Rose & Weller, 2003), kultura politike (Fuchs & Klingemann, 2006; Inglehart, 2006; Mansfeldová, 2006; Haerpfer, 2006), sundimi i ligjit (Cook, Hardin & Levi, 2005), dhe korrupsioni (Cook, Rice & Gerbasi, 2004; Rose-Ackerman, 2001).

Ky studim do të kontribuojë në literaturën ekzistuese duke u fokusuar në nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë në vend. Studimi do të çojë në një njohje më të mirë të faktorëve që ndikojnë nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë duke u fokusuar në dy aspekte: (a) drejtimi i zyrtarëve të lartë dhe (b) besimi në institucionet sociale dhe politike. Dy hipoteza do të testohen: (a) niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë ka efekt pozitiv në nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë dhe (b) besimi në institucionet sociale dhe politike ka efekt pozitiv në nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë.

Niveli i kënaqësisë me demokracinë mund të ndikohet nga një sërë faktorësh, jo vetëm drejtimi i zyrtarëve të lartë dhe besimi në institucione. Është e rëndësishme që

këta faktorë të përfshihen në analizën statistikore për të vlerësuar efektet e tyre dhe rrjedhimisht për të nxjerrë konkluzione të sakta. Në këtë studim do të konsiderohen efektet e sigurisë financiare, arsimimit dhe rajonit gjeografik. Këta tre faktorë mund të influencojnë perceptimet e individëve rreth zhvillimit të demokracisë. Për shembull, individët që janë financiarisht të sigurt apo jetojnë në rajonin më të zhvilluar të vendit (Tiranë) mund të jenë më të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend, krahasuar me ata që jetojnë në kushte të vështira financiare ose në rajonin më të varfër të vendit (rajonin malor). Situata ekonomike do të reflektohet në nivelin e kënaqësisë me demokracinë. Një lidhje pozitive mund të ekzistojë midis arsimit dhe nivelit të kënaqësisë me demokracinë. Mund të argumentohet se individët e mirarsimuar, krahasuar me individët e paarsimuar, kanë më shumë mundësi për të përfituar nga mundësitë sociale dhe ekonomike në vend dhe rrjedhimisht janë edhe më të kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Nga ana tjetër, mund të argumentohet se individët e mirarsimuar janë kritikë dhe rrjedhimisht të pakënaqur me zhvillimet demokratike. Në këtë rast, nuk do të vihen re diferenca të mëdha midis grupeve të ndryshme arsimore. Modelet statistikore do të lejojnë matjen e këtyre efekteve.

Ky studim nuk synon të shpjegojë zhvillimin e demokracisë në Shqipëri, por nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Niveli i kënaqësisë është një koncept subjektiv. Ai mat nivelin e kënaqësisë në një moment të dhënë ashtu siç perceptohet nga individit dhe jo nivelin aktual të demokracisë. Ky diferencim është i rëndësishëm veçanërisht gjatë interpretimit të rezultateve.

Metodologjia

Ky studim mbështetet në të dhënat e Sondazhit të Vlerave Botërore të vitit 2002. Ky sondazh realizohet në më shumë se 80 vende dhe mat impaktin e vlerave dhe besimeve në jetën politike dhe sociale (World Value Survey, 2006). Ky studim do të fokusohet në të dhënat e grumbulluara në Shqipëri. Kampioni që u përzgjedh përfaqëson popullsinë mbi 18 vjeç (N = 1000). Përzgjedhja e kampionit u mbështet në të dhënat e siguruara nga Instituti i Statistikës. Të gjitha rrethet u përfaqësuan në kampionin e përzgjedhur. Intervistat u realizuan në zonat urbane dhe rurale (Technical Report on World Value Survey in Albania, 2002).

Variablat e përfshirë në modelin statistikor

Niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë në vend. Kënaqësia me demokracinë është përkufizuar si masa në të cilën individët mendojnë se pritshmëritë e tyre me zhvillimet demokratike janë përmbushur. Të anketuarve iu drejtua pyetja e mëposhtme: “Në tërësi a jeni shumë i kënaqur, deri diku i kënaqur, jo shumë i

kënaqur, aspak i kënaqur me mënyrën sesi po zhvillohet demokracia në vendin tonë?” Ky variabël u ripërkufizua dhe u nda në dy kategori: i kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe aspak i kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Variabli origjinal përbëhej nga katër kategori. Duke qenë se vetëm 24 të anketuar përzgjedhën alternativën shumë i kënaqur, kjo alternativë u kodua si i kënaqur. Kategoria e tretë (jo shumë i kënaqur) nuk u përfshi në analizë, në mënyrë që dyja kategoritë e mbetura (N = 531), i kënaqur me zhvillimin e demokracisë (shumë i kënaqur dhe deri diku i kënaqur) dhe aspak i kënaqur me zhvillimin e demokracisë të krahasoheshin me njëra-tjetrën në analizën e regresionit.

Niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë. Ky është një variabël rendor që përfshin tri kategori: aspak i kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, jo shumë i kënaqur dhe i kënaqur (shumë i kënaqur dhe deri diku i kënaqur). Variabli origjinal përbëhej nga katër kategori. Duke qenë se vetëm 11 të anketuar raportuan se ishin shumë të kënaqur, kjo kategori u ripërkufizua si i kënaqur. Edhe pse në sondazh nuk jepet një përkufizim i zyrtarëve të lartë, në këtë studim supozohet se zyrtarët e lartë janë zyrtarë të qeverisë të cilët mund të jenë të zgjedhur ose të emëruar dhe kanë pushtet vendimmarrës. Shembuj të zyrtarëve të lartë janë kryeministri, ministra, dhe deputetë.

Besimi në institucionet sociale dhe politike. Ky është një variabël rendor që përfshin katër kategoritë e mëposhtme: aspak, jo shumë, deri diku, dhe shumë besim. Për të matur besimin në institucione, u krijua një shkallë matëse (shkalla e besimit) e përbërë nga 16 elementet e mëposhtme: besimi në kishë, forcat e armatosura, media e shkruar, media vizive, sindikatat, polici, qeveri, parlament, partitë politike, shërbimi civil, kompanitë e mëdha, lëvizja për mbrojtjen e mjedisit, lëvizja e gruas, Bashkimi Europian, NATO-n, dhe Kombet e Bashkuara. Shkalla e besimit u krijua duke marrë vlerën mesatare të besimit të 16 elementeve për secilin të anketuar. Besueshmëria e shkallës së besimit u mat përmes Cronbach Alpha. Vlera e Cronbach Alpha ishte 0.83, gjë që evidenton se shkalla matëse karakterizohet nga nivele të larta besueshmërie.

Siguria financiare. Ky variabël përbëhet nga dy kategoritë e mëposhtme: familja nuk ka marrë borxh gjatë vitit të kaluar dhe familja ka shpenzuar kursimet dhe ka marrë borxh. Variabli origjinal përbëhej nga katër kategoritë e mëposhtme: familja ka kursyer, vetëm ka shpenzuar ato që ka fituar, ka shpenzuar disa nga kursimet, dhe ka shpenzuar kursimet dhe ka marrë borxh. Variabli u ripërkufizua dhe u nda në dy kategori për të diferencuar midis familjeve që nuk kanë marrë borxh dhe atyre që kanë marrë borxh një vit përpara së të realizohej sondazhi.

Arsimi. Ky variabël rendor përbëhet nga katër kategoritë e mëposhtme: pa arsim ose arsim fillor, arsim tetëvjeçar, arsim i mesëm dhe arsim i lartë. Variabli origjinal

përbëhej nga tetë kategori. Variabli u nda në këto katër kategori për të reflektuar nivelet e arsimit në sistemin arsimor shqiptar.

Rajoni gjeografik. Ky variabël përbëhet nga katër kategori që përfaqësojnë rajonet në Shqipëri: Tirana, rajoni jugor, rajoni qendror dhe rajoni verior.

Analiza e të dhënave u realizua në programin STATA. Tre tipa analizash u realizuan. Së pari, u realizua analiza përshkruese e variablave të përfshirë në model. Së dyti, u realizuan analizat statistikore – chi-square dhe ttest – që fokusohen në marrëdhënien mes dy variablave (bivariate). Kjo analizë hodhi dritë mbi marrëdhënien statistikore midis nivelit të kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të vendit, besimit në institucionet sociale dhe politike, sigurisë financiare, arsimit, rajonit gjeografik dhe nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Përmes testit chi-square u shqyrtua marrëdhënia statistikore midis variablave kategorikë – marrëdhënia midis nivelit të kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të vendit, sigurisë financiare, arsimit, rajonit gjeografik, dhe nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Përmes testit u shqyrtua marrëdhënia statistikore midis besimit në institucionet sociale dhe politike dhe nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Kjo analizë lejoi krahasimin e vlerave mesatare të besimit në institucione midis të anketuarve që janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe atyre që nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Së treti, u realizua regresioni i mbivendosur apo në grupe (nested logistic regression) për të shqyrtuar marrëdhënien statistikore midis nivelit të kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë, besimit në institucionet sociale dhe politike dhe nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Gjatë analizës së regresionit u morën në konsideratë efektet e sigurisë financiare, arsimit dhe rajonit gjeografik. Rezultatet e konvergencës së modelit statistikor dhe saktësisë parashikuese të tij mund të vihen në dispozicion për të interesuarit.

Rezultatet

Rreth 50.47 për qind e të anketuarve raportuan se nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend dhe 49.53 për qind raportuan se janë të kënaqur (N = 531); 90.78 për qind raportuan se familja e tyre nuk ka marrë borxh gjatë vitit të kaluar dhe 9.22 për qind raportuan se familja e tyre ka shpenzuar kursimet dhe ka marrë borxh (N = 965); 42.54 për qind nuk janë aspak të kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, 38.24 për qind janë jo shumë të kënaqur, dhe 19.22 për qind janë të kënaqur (N = 978); 12.5 për qind e të anketuarve janë të paarsimuar ose kanë vetëm arsim fillor, 26.4 për qind kanë arsim tetëvjeçar, 44.7 për qind kanë arsim të mesëm, dhe 16.4 për qind kanë arsim të lartë (N = 1000); 16.9 për qind

e të anketuarve jetojnë në Tiranë, 35.3 për qind në rajonin jugor, 26.3 për qind në rajonin qendror, dhe 21.5 për qind në rajonin verior (N = 1000). Vlerat e shkallës matëse të besimit tek institucionet variojnë nga 1.12 në 4. Një përmbledhje e analizës përshkruese paraqitet në Tabelën 1 dhe Tabelën 2:

Tabela 1: Përmbledhje e Variablave Kategorikë të Përfshirë në Model

Variabli	Kategoritë	N	Përqindja
Niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë në vend	0 = Aspak të kënaqur	268	50.47
	1 = Të kënaqur	263	49.53
Niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë	1 = Aspak të kënaqur	416	42.54
	2 = Jo shumë të kënaqur	374	38.24
	3 = Të kënaqur	188	19.22
Siguria financiare	0 = Familja nuk ka marrë borxh	876	90.78
	1 = Familja ka marrë borxh	89	9.22
Arsimi	1 = Arsim fillor ose pa arsim	125	12.50
	2 = Arsim tetëvjeçar	264	26.40
	3 = Arsim i mesëm	447	44.70
	4 = Arsim i lartë	164	16.40
Rajoni gjeografik	1 = Tirana	169	16.90
	2 = Jugu	353	35.30
	3 = Qendra	263	26.30
	4 = Veriu	215	21.50

Tabela 2: Përmbledhje e Variablit të Vazhdueshëm të Përfshirë në Model

Variabli	Vlera Mesatare	Kufijtë e Vlerave	Varianca
Besimi në institucionet sociale dhe politike	2.5 (.47)	1.12 – 4	.22

Shënim. Devijimi standard jepet në kllapa.

Një sërë testesh statistikore u realizuan për të shqyrtuar marrëdhënien statistikore midis variablave dy e nga dy. Më poshtë paraqiten rezultatet përmes grafikëve.

Niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë. Krahasuar me individët të cilët janë të pakënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, individët të cilët janë të kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë kanë më shumë gjasa të jenë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë [$Z = -14.49$; $p < .0001$]. Rezultatet paraqiten në Figurën 1.

Në Figurën 1 duket qartë se pjesa më e madhe e të anketuarve, të cilët janë të pakënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, janë të pakënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend. Marrëdhënia midis dy variablave është pozitive. Më konkretisht, 81.93 për qind e të anketuarve, të cilët nuk janë aspak të kënaqur




Figura 1: Niveli i Kënaqësisë me Drejtimin e Zyrtarëve të lartë dhe Zhvillimin e Demokracisë në Përqindje

me drejtimin e zyrtarëve të lartë, nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 18.07 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 39.68 për qind e të anketuarve, të cilët nuk janë shumë të kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 60.32 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 7.48 për qind e të anketuarve, të cilët janë të kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 92.52 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë.

Arsimi. Sa më të arsimuar janë individët, aq më shumë gjasa ka që ata të jenë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë [$Z = -2.39$; $p = 0.008$]. Rezultatet paraqiten në Figurën 2.

Sa më i ulët niveli arsimor i të anketuarve, aq më të pakënaqur janë ata me zhvillimin e demokracisë. Rreth 62.07 për qind e të anketuarve me arsim fillor ose të paarsimuar nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 37.93 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 52.59 për qind e të anketuarve me arsim tetëvjeçar nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 47.41 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 49.80 për qind e të anketuarve me arsim të mesëm nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 50.20 janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; dhe 41.76 për qind e të anketuarve me arsim të lartë nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 58.24 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë.




Figura 2: Niveli Arsimor dhe Niveli i Kënaqësisë me Zhvillimin e Demokracisë në Përqindje

Rajoni gjeografik. Individët që jetojnë në rajonin verior kanë më pak gjasa të jenë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë, krahasuar me individët që jetojnë në rajonet e tjera – Tiranë, rajoni qendror dhe rajoni jugor [$\chi^2 (3) = 22.27$; $p < .0001$]. Rezultatet paraqiten në Figurën 3.

Rreth 52.38 për qind e të anketuarve në Tiranë nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 47.62 për qind janë të kënaqur; 57.47 për qind e të




Figura 3: Rajoni Gjeografik dhe Niveli i Kënaqësisë me Zhvillimin e Demokracisë në Përqindje

anketuarve në rajonin jugor nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 42.53 janë të kënaqur; 35.03 për qind e të anketuarve në rajonin qendror nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 64.97 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 59.48 për qind e të anketuarve në rajonin verior nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 40.52 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë.

Siguria financiare. Analiza u fokusua edhe në marrëdhënien midis sigurisë financiare dhe nivelit të kënaqësisë me demokracinë. Rezultatet tregojnë se individët të cilët shpenzuan kursimet dhe morën para borxh një vit përpara realizimit të sondazhit janë më të pakënaqur me zhvillimin e demokracisë, krahasuar me ata të cilët nuk morën para borxh [$\chi^2(1) = 11.65; p < 0.001$]. Rezultatet paraqiten në Figurën 4.

Në Figurën 4 duket qartë se pjesa më e madhe e të anketuarve, të cilët nuk janë financiarisht të sigurt, nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Më konkretisht, 46.92 për qind e të anketuarve (ata ose anëtarët e familjes) të cilët nuk kanë marrë para borxh nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 53.08 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; 71.70 për qind e të anketuarve, të cilët kanë marrë para borxh, nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë dhe 28.30 për qind janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë.

Besimi në institucione. Krahasuar me individët të cilët kanë nivele të ulëta besimi

në institucionet sociale dhe politike, individët të cilët kanë nivele të larta besimi në institucionet sociale dhe politike janë më të kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Rezultatet paraqiten në Figurën 5.

Të anketuarit, të cilët janë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend, raportuan nivele më të larta besimi në institucionet sociale dhe politike ($M = 2.79, SD = .43$), krahasuar me të anketuarit të cilët nuk janë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend ($M = 2.36, SD = .48$), $t(529) = -10.75, p < .0001$.

Në këtë studim u aplikua regresioni i mbivendosur. Kjo formë regresioni lejon përfshirjen në model të variablave me grupe (Acock, 2006). Kjo sjell dy avantazhe. Së pari, lejon që të merren në konsideratë efektet e variablave që nuk kanë domosdoshmërisht rëndësi teorike, por që janë të lidhur me kontekstin e studimit. *Këta variabla përfshihen në model* në një grup të vetëm apo në disa grupe. Së dyti, lejon vlerësimin e kontributit që secili variabël apo grup variablash jep në shpjegimin e fenomenit të marrë në studim. Kjo formë regresioni lejon matjen e efektit që niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë dhe besimi në institucione ka në nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë pasi merren në konsideratë efektet e sigurisë financiare, arsimit, dhe rajonit gjeografik. Njëkohësisht, kjo formë *regresioni* lejon vlerësimin e kontributit që secili variabël apo grup variablash jep në shpjegimin e nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Pra, gjatë analizës mund të diferencohet midis efektit të sigurisë




Figura 4: Siguria Financiare dhe Niveli i Kënaqësisë me Demokracinë në Përqindje




Figura 5: Besimi në Institucionet Sociale dhe Politike dhe Niveli i Kënaqësisë me Demokracinë

Tabela 3: Përmbledhje e Rezultateve të Regresionit. Efektet e Sigurisë Financiare, Arsimit, Rajonit Gjeografik, Nivelit të Kënaqësisë me Drejtimin e Zyrtarëve të Lartë, Besimit në Institucionet Sociale dhe Politike në Nivelin e Kënaqësisë me Zhvillimin e Demokracisë

Variabli	Chi-Square	<i>p</i>	Raporti i Mundësive	Kufijtë e Besimit
Blloku 1	27.29	<.0001		
Siguria financiare		0.82	1.1	0.45 – 2.7
Arsimi		0.13	1.21	0.94 – 1.57
Rajoni gjeografik Tirana (referenca)				
Jugu		0.54	1.27	0.58 – 2.78
Qendra		0.05	2.18	1 – 4.77
Veriu		0.09	.46	0.19 – 1.12
Blloku 2	123.93	<.0001		
Niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë		<.0001	6.58	4.50 – 9.60
Blloku 3	23.84	<.0001		
Besimi në institucione		<.0001	4.82	2.56 – 9.07
Konstante		<.0001	.00	0.0 – 0.02

Shënim. N = 442; $\chi^2(7) = 252.68$; $p < 0.0001$, $r^2 = 0.41$; ROC = 0.82.

financiare, arsimit, dhe rajonit gjeografik dhe efektit të nivelit të kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë. Njëkohësisht, mund të diferencohet midis efektit të nivelit të kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë dhe efektit të besimit në institucionet sociale dhe politike. Si fillim, në analizën statistikore u përfshi blloku i parë i cili përfshinte tre variabla – siguria financiare, arsimi, dhe rajoni gjeografik. Më tej, u përfshi niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë dhe besimi në institucionet sociale dhe politike.

Rezultatet e analizës së regresionit tregojnë se marrëdhënia midis bllokut të parë të variablave dhe nivelit të kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë është statistikisht domethënëse [$\chi^2(5) = 27.29$; $p < 0.001$; $r^2 = 0.05$]. Kjo do të thotë se siguria financiare, arsimi dhe rajoni gjeografik kontribuojnë statistikisht në shpjegimin e nivelit të kënaqësisë me zhvillim e demokracisë. Megjithatë, ky kontribut është inferior nëse krahasohet me kontributin që jep niveli i kënaqësi me drejtimin e zyrtarëve në shpjegimin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Kur në modelin statistikor përfshihet variabli i dytë – niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë – aftësia shpjeguese e modelit statistikor përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme [$\chi^2(1) = 127.82$; $p < 0.0001$; $r^2 = 0.37$]. Aftësia shpjeguese e modelit përmirësohet edhe pasi përfshihet në model variabli i tretë – besimi në institucionet sociale dhe politike [$\chi^2(1) = 24.26$; $p < 0.0001$; $r^2 = 0.41$]. Megjithatë,

përmirësimi nuk është në nivelet e mëparshme kur niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë u përfshi në model. Tabela 3 paraqet rezultatet e regresionit:

Niveli i kënaqësisë me drejtimin e zyrtarëve të lartë ka efekt pozitiv në nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Koeficienti me një vlerë prej 6.58 (shih Tabelën 3, kolona e katërt) sugjeron se niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë së një individi i cili është i kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, krahasuar me një individ i cili nuk është aspak i kënaqur me drejtimin e zyrtarëve të lartë, është rreth 6.58 herë më i lartë. Gjithashtu, besimi në institucionet sociale dhe politike ka efekt pozitiv në nivelin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Koeficienti me një vlerë prej 4.82 (shih Tabelën 3, kolona e katërt) sugjeron se me rritjen prej një njësie në shkallën matëse të besimit në institucione (që do të thotë rritje nga një vlerë e ulët besimi në një vlerë më të lartë besimi, p.sh. rritja nga aspak besim në jo shumë besim), shanset për të qenë të kënaqur me nivelin e demokracisë rriten rreth 4.82 herë. Efektet e sigurisë financiare, arsimit, dhe rajonit gjeografik janë të dobëta.

Konkluzione

Ky studim evidenton se shqiptarët që kanë karakteristikat e mëposhtme kanë më shumë gjasa të mos jenë aspak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë: jetojnë në kushte financiare të vështira, kanë nivele të ulëta edukimi dhe jetojnë në rajonin më pak të zhvilluar. Individët që jetojnë në rajonin malor, rajoni më i varfër në Shqipëri, janë më pak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë, krahasuar me individët që jetojnë në rajonet e tjera – Tiranë, rajonin qendror dhe rajonin jugor. Këto gjetje sugjerojnë se pabarazia midis rajoneve nuk ka vetëm natyrë ekonomike, por edhe sociale. Individët që jetojnë në një rajon të varfër jo vetëm që hasin vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë, por janë edhe të pakënaqur me zhvillimin e demokracisë.

Drejtimi i zyrtarëve të lartë luan një rol shumë të rëndësishëm në nivelin e kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë. Krahasuar me rolin e faktorëve të tjerë të përfshirë në analizë, si siguria financiare, arsimi dhe rajoni gjeografik, drejtimi i zyrtarëve të lartë luan rol parësor në shpjegimin e kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë. Shqiptarët e shohin progresin e demokracisë në vend të lidhur ngushtësisht me drejtimin e zyrtarëve të lartë, qofshin ata ministra, deputetë, presidentë, apo kryeministra. Ky konkluzion sugjeron se shqiptarët do të jenë më të kënaqur me zhvillimin e demokracisë në vend kur zyrtarët e lartë të bëjnë një punë më të mirë në drejtimin e vendit.

Ky studim evidenton se besimi në institucionet sociale dhe politike luan një rol të rëndësishëm në nivelin e kënaqësisë me demokracinë. Një sërë autorësh fokusohen në besimin tek institucionet në vendet ish-komuniste. Ata theksojnë

se besimi tek institucionet është tregues i zhvillimit të demokracisë. Për shembull, Miller & Listhaug (1999) argumentojnë se një qeveri e paaftë e cila nuk mund të kontrollojë nivelin e papunësisë, të inflacionit dhe të deficitit mund të gërryje besimin në institucionet politike. Megjithatë, pjesa më e madhe e autorëve krahasojnë nivelet e besimit në institucione midis vendeve ish-komuniste ose shqyrtojnë ndryshimin e besimit në institucione në kohë (shih për shembull, Bartkowski, 2003; Mansfeldová, 2006; Miheljak, 2006). Të tjera studime fokusohen në imazhin publik të politikanëve dhe te besimi i ulët në klasën politike.

Ky studim shkon një hap më tej duke u fokusuar në rolin e besimit tek institucionet në nivelin e kënaqësisë me demokracinë. Një nga kufizimet e këtij studimi është se ai nuk diferencon ndërmjet besimit në institucionet sociale dhe politike. Duke iu referuar të dhënave të Sondazhit të Vlerave Botërore të vitit 2002, shqiptarët kanë më tepër besim tek NATO (83.2 për qind), Kombet e Bashkuara (81 për qind) dhe Bashkimi Europian (80 për qind). Ndërkohë, shqiptarët kanë më pak besim te sindikatat (27.8 për qind), partitë politike (28.6 për qind), lëvizja për mbrojtjen e mjedisit (31.3 për qind), dhe lëvizja e gruas (32.1 për qind). Besimi në median e shkruar, median vizive, kompanitë e mëdha, parlamentin, forcat e armatosura, qeverinë, dhe policinë varion nga 34.1 në 64.3 për qind. Këto ndryshime duhet të merren në konsideratë. Për shembull, efekti i besimit te Bashkimi Europian apo te lëvizja e gruas në nivelin e kënaqësisë me demokracinë mund të mos jetë i njëjtë me efektin e besimit te partitë politike. Studime të mëtejshme duhet të hedhin dritë mbi ndryshimet që ekzistojnë midis besimit tek institucionet sociale dhe politike në kontekstin shqiptar. Njëkohësisht, analiza e prezantuar në këtë studim paraqet një pikëpamje të kufizuar të sigurisë financiare. Siguria financiare është një koncept shumë i gjerë që nuk përfshin vetëm marrjen ose jo borxh të parave. Aspekte të tjera, si të ardhurat nga punësimi dhe emigracioni, pasuria e tundshme dhe e patundshme duhet të merren në konsideratë në studimet e mëtejshme.

Rezultatet e këtij studimi mbështeten në të dhënat e vitit 2002. Sa aktuale janë rezultatet në vitin 2013? A ka ndryshuar niveli i kënaqësisë së shqiptarëve me zhvillimin e demokracisë? Po drejtimi i zyrtarëve të lartë dhe besimi në institucionet sociale dhe politike? Këtyre pyetjeve mund t'u jepet vetëm një përgjigje e pjesshme për shkak të të dhënave të kufizuara. Hera e fundit që Sondazhi i Vlerave Botërore u realizua në Shqipëri ishte viti 2002. Sondazhi i Vlerave Europiane (2008) ofron një tjetër burim të dhënash, megjithatë jo të gjitha pyetjet janë të krahasueshme midis sondazheve. Për shembull, në Sondazhin e Vlerave Europiane (2008) të anketuarit nuk janë pyetur rreth drejtimit të zyrtarëve të lartë. Një tjetër problem është se njësitë e matjes ndryshojnë në vite. Për shembull, në Hulumtimin Social Europian (2013) të publikuar nga Fondacioni Soros kohët e fundit, niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë është matur në një shkallë që varion nga 0 në 10, ndërkohë që në Sondazhin e Vlerave Botërore shkalla e matjes varion nga 1 në 5. Krahasimet mes njërive matëse të ndryshme nuk çojnë në rezultate

të sakta. Megjithatë, nëse fokusohemi vetëm në pyetjet që janë të krahasueshme midis Sondazhit të Vlerave Botërore (2002) dhe Sondazhit të Vlerave Europiane (2008), mund të nxjerrim disa konkluzione.

Krahasuar me vitin 2002, në vitin 2008 shqiptarët ishin më pak të kënaqur me zhvillimin e demokracisë. Në sondazhin e vitit 2002, 26.7 për qind e të anketuarve u shprehën se ishin të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; ndërkohë, kjo përqindje për vitin 2008 është 19.23. Ose, në vitin 2002, 46 për qind e të anketuarve u shprehën se ishin jo shumë të kënaqur me zhvillimin e demokracisë; kjo përqindje për vitin 2008 është 54.5. Tendenca e përgjithshme që mund të vihet re nga këto krahasime është se niveli i kënaqësisë me zhvillimin e demokracisë ka ardhur duke u ulur.

Besimi në institucionet sociale dhe politike në vitin 2008 ka një vlerë mesatare prej 2.6 (devijimi standard = .44), një ndryshim pothuajse i papërfillshëm me vitin 2002 (vlera mesatare e besimit në institucionet sociale dhe politike në vitin 2002 ishte 2.5, devijimi standard = .47). Megjithatë një krahasim midis treguesve të besimit në institucionet sociale dhe politike midis viteve 2002 dhe 2008 hedh dritë në një sërë ndryshimesh. Krahasuar me vitin 2002, në vitin 2008 shqiptarët kanë pasur më pak besim te qeveria (57.3 për qind kundrejt 26.47 për qind), partitë politike (28.6 për qind kundrejt 21.6 për qind), dhe parlamenti (43.7 për qind kundrejt 31.8 për qind). Jo të gjithë treguesit mund të krahasohen. Për shembull, besimi te lëvizja e gruas dhe te media vizive nuk është matur në vitin 2008. Ndërkohë, besimi në sistemin e drejtësisë nuk është matur në vitin 2002. Të dhënat e vitit 2008 tregojnë se vetëm 25.2 për qind e shqiptarëve kanë besim në sistemin e drejtësisë. Nivelet e ulëta të besimit në qeveri, partitë politike, parlamenti, dhe sistemi i drejtësisë reflektojnë cilësinë e dobët të institucioneve.

Këto krahasime nuk janë precize. Ato ofrojnë një panoramë të përgjithshme të ndryshimeve në kohë. Perceptimet ndikohen nga një sërë faktorësh, si për shembull kriza ekonomike botërore, që nuk janë drejtpërdrejt të lidhur me zhvillimet demokratike në vend. Njëkohësisht, një sërë gabimesh mund të kenë ndodhur në matje. Norma e përgjigjes në sondazhe është e ulët. Për shembull, numri i të anketuarve që refuzuan të merrnin pjesë në sondazhin e vitit 2002 ishte shumë i lartë (48.3 për qind) (Technical Report on World Value Survey in Albania, 2002). Një nga problemet që u has gjatë punës në terren ishte mungesa e besimit të të anketuarve. Ky problem ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe rrjedhimisht në vlefshmërinë e të dhënave të grumbulluara. Krijimi i besimit tek të anketuarit përpara grumbullimit të informacionit, gjë e cila ka pak gjasa të ndodhë gjatë sondazheve, që plotësohen brenda një kohe të shkurtër, është thelbësore.

Të dhënat dytësore paraqesin një tablo të pjesshme të zhvillimit të demokracisë në Shqipëri. Ky studim fokusohet vetëm në disa aspekte. Studime të mëtejshme duhet të fokusohen në karakteristikat e qeverisjes në Shqipëri veçanërisht te ndryshimet që kanë ndodhur në kohë. Një përjasje e cila mbështetet në evidencë

statistikore mund të çojë në njohuri më të mirë të zhvillimit të demokracisë dhe përmirësimit të cilësisë së saj

Bibliografia

- Acock, A. C. (2006) *A Gentle Introduction to Stata*, Texas: Stata Press.
- Badescu, G. (2003) "Social Trust and Democratization in the Post-Communist Societies", in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds.), *Social Capital and the Transition to Democracy*, (fq.120-139). London & New York: Routledge.
- Bartkowski, J. (2003) "Social capital in Poland", in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds), *Social Capital and the Transition to Democracy*, (fq.184-199), London & New York: Routledge.
- Central and Eastern Eurobarometer. (1996) *Economic and Democratic Reforms*. [Online]. Parë më 04 korrik, 2013. Marrë në: http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ceeb/ceeb6/ceeb6_en.htm#text2.
- Cook, K. S., Rice, E. R. W. and Gerbasi, A. (2004) "The Emergence of Trust Networks Under Uncertainty: The Case of Transitional Economies – Insights from Social Psychological Research" in J. Kornai, B. Rothstein and S. Rose-Ackerman (eds), *Creating Social Trust in Post-Socialist Transition*, (f.193-212), New York: Palgrave Macmillan.
- Cook, K. S., Hardin, R. and Levi, M. eds. (2005) *Cooperation without Trust?* New York: Russell Sage Foundation.
- European Values Survey. (2008) [Online]. Parë më 2 korrik 2013. Marrë në: <http://www.europeanvaluesstudy.eu/>
- Haerpfer, C. H. (2006) "Hungary. Structure and Dynamics of Democratic Consolidation" in H. Klingemann, D. Fuchs and J. Zielonka (eds), *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, (f.148-171). London and New York: Routledge.
- Howard, M. M. (2003) "Why Post-communist Citizens do not join Voluntary Organizations?" G. Badescu and E. M. Uslaner (eds), *Social Capital and the Transition to Democracy*, (fq.165-183). London and New York: Routledge.
- Inglehart, R. (2006) "East European Value Systems in Global Perspective" in H. Klingemann, D. Fuchs and J. Zielonka (eds), *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, (fq. 67-84). London and New York: Routledge.
- Instat & UNODC. (2011). *Corruption in Albania: Bribery as experienced by the population*. [Online]. Marrë më 3 korrik 2013. Marrë në: http://www.instat.gov.al/media/169788/survey_on_use_of_public_services_and_public_integrity_.pdf
- Mansfeldová, Z. (2006) "The Czech Republic. Critical Democrats and the Persistence of Democratic Values" in H. Klingemann, D. Fuchs and J. Zielonka

- (eds), *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, (f.101-118). London and New York: Routledge.
- Miheljak, V. (2006) "Slovenia in Central Europe. Merely Meteorological or a Value Kinship" in H. Klingemann, D. Fuchs and J. Zielonka (eds), *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, (fq. 119-147). London and New York: Routledge.
- Miller, A. and Listhaug, O. (1999) "Political Performance and Institutional Trust" in P. Norris (ed), *Critical Citizens. Global Support for Democratic Government*, (f.204-216). New York: Oxford University Press.
- Newton, K. (1999) "Social and Political Trust in Established Democracies" in P. Norris (ed), *Critical Citizens. Global Support for Democratic Government*, (f. 169-187). New York: Oxford University Press.
- Norris, P. (1999) "Institutional Explanations for Political Support" in P. Norris (ed), *Critical Citizens. Global Support for Democratic Government*, (f.217-235). New York: Oxford University Press.
- OSCE. (2010) *Report by the Head of the OSCE presence in Albania to the OSCE Permanent Council*. [Online]. Marrë më 3 korrik 2013. Marrë në: <http://www.osce.org/albania/82273>
- OSFA. (2013). *Gjetjet Paraprake të Hulumtimit Social Evropian*. [Online]. Marrë më 10 prill 2013. Marrë në: <http://www.soros.al/2010/article.php?id=437>
- Rose-Ackerman, S. (2001) "Trust, Honesty and Corruption: Reflection on the State-Building Process" *Arch. Europ. Sociol.* XLII, f. 526-570.
- Rose, R. and Weller, C. (2003) "What does Social Capital add to Democratic Values?" in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds), *Social Capital and the Transition to Democracy*, (f.200-217). London & New York: Routledge.
- Technical Report on World Value Survey in Albania. (2002). [Online]. Marrë më 01 korrik 2013. Marrë në: <http://www.worldvaluessurvey.org/> [1 July, 2013]
- Transparency International. (2012). *Corruption Perceptions Index*. [Online]. Marrë më 4 korrik 2013. Marrë në: <http://cpi.transparency.org/cpi2012/results/>
- US Department of State. (2012). *Country Reports on Human Rights Practices for 2012: Albania*. [Online]. Marrë më 3 korrik 2013. Marrë në: <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm#wrapper>
- World Value Survey. 2002 [Online]. Marrë më 1 korrik 2013. Marrë në: <http://www.worldvaluessurvey.org/>

Media sociale, audienca dhe politika. Çfarë audience synojnë politikanët nëpërmjet internetit?

MA. Erald Kapri¹

Abstrakt. Ky punim do të ekzaminojë rolin e medias sociale në politikë dhe do të ofrojë përgjigje: çfarë audience duan të kapin politikanët nëpërmjet internetit? Do të ekzaminojë dhe do të fokusohet tek dy liderët kryesore politikë në Shqipëri (ish-kryeministri dhe ish-kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha dhe ish-lideri i opozitës dhe kryeministri i zgjedhur Edi Rama) që nga koha kur ata janë bërë pjesë e medias sociale, e Facebook dhe Twitter respektivisht. Në të njëjtën kohë, ky punim do të japë një panoramë mbi efektet e medias sociale në audience dhe në politikë, por dhe tek lidhja midis tyre. Derisa interneti dhe media sociale janë një platformë ku çdokush është i lirë të shprehet, si po ndikon ky realitet te politikanët dhe sjelljet e tyre politike? Këto platforma lejojnë më shumë kontakte me të zgjedhurit, por në fakt a po rritet llogaridhënia e tyre? Interneti dhe media sociale ofrojnë më shumë mundësi dhe transparencë, por a po ndikon kjo në pushtetin dhe politikëbërjen? Kjo lloj marrëdhënie do të analizohet në këtë punim për të kuptuar ndryshimet në audiencën politike ose të votuesit.

Hyrje

Ritja dhe fuqizimi i medias sociale ka ngritur shumë pyetje në mes të akademikëve për të kuptuar efektin e medias së re në politikë dhe në audience. Kur radioja filloi të operojë në fillim të viteve '930, akademikë si

¹ Erald Kapri vijon studimet Mastër në Universitetin Westminster në Londër me bursë të qeverisë britanike Chevening (2012-2013). Është diplomuar në Universitetin e Tiranës për Gazetari dhe ka punuar për disa vite si reporter i politikës në gazetat “Metropol”, “Standard” dhe “Panorama”. Ka drejtuar zyrën e shtypit në Bashkinë e Tiranës në vitin 2011-2012 si dhe ka punuar në ekipin e fushatës së Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha në vitin 2011 dhe të Partisë Demokratike në vitin 2013, pranë konsulentëve të huaj. Gjatë studimeve në Londër është trajnuar në Institutin Reuters në Oxford, BBC dhe në Institutin Universitar European në Firence të Italisë.

Paul Lazarsfeld zhvilluan një studim për zgjedhjet presidenciale në SHBA në vitin 1940 për të kuptuar efektin e medias. Ajo që ata zbuluan ishte komunikimi me dy nivele që influençoi akademikët e komunikimit për më shumë se gjysmë shekulli. Në fakt, media nuk kishte atë efekt që ata mendonin. E njëjta pyetje shtrohet në ditët e sotme për median sociale. Sa efekt ka media sociale në audiencë? Është i njohur fakti se media tradicionale si gazeta, radioja dhe televizioni ndryshuan politikën përgjithnjë. Në të njëjtën kohë media sociale është duke ndikuar në ndryshimin e mënyrës së të bërit politikë dhe kjo për të kapur një audiencë të caktuar. Të tjerë akademikë ngrenë pyetje në lidhje me demokracinë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. A po bëhet shoqëria më e mirë në sajë të mediave sociale?

Kjo është më se e vërtetë edhe për vendet në zhvillim dhe në ato ku interneti nuk është i shpërndarë në të gjithë shoqërinë. Shqipëria është në pritje për të marrë statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Europian. Kjo do të thotë që brenda një periudhe kohore 6 deri në 8 vite (në varësi) mund të bëhet anëtare e Bashkimit Europian. Por pavarësisht kësaj, vendi është në prag të një beteje të fortë politike për pushtet mes dy partive të mëdha. Në qershor do të mbahen zgjedhjet e përgjithshme dhe të dy liderët kryesorë e kanë zhvendosur fushatën e tyre në median sociale. Katër vite më parë, fushata ishte e gjitha ndryshe. Të dy liderët kënduan me këngëtarë *pop* të famshëm vetëm për të pasur pak më shumë vota. Tashmë ata nuk e bëjnë më një gjë të tillë, por debatojnë nëpërmjet medias sociale. Lideri i opozitës përdor më shumë Twitter-in, ndërsa ai i maxhorancës përdor Facebook-un.

Në mesin e fushatës elektorale dhe vetëm dy javë larg ditës së votimeve u bë një sondazh në lidhje me pëlqimin e materialit të hedhur nga liderët e dy partive kryesore, PD dhe PS, respektivisht Sali Berisha dhe Edi Rama në rrjetet sociale. Në gazetën Mapo të datës 10 qershor 2012 u publikuan të dhënat e qendrës Abacus Research. Këto të dhëna nxjerrin materialet që kanë më shumë pëlqime, komente apo shpërndarje nga anëtarët e faqeve. Të dhënat tregojnë diçka krejtësisht ndryshe. Nëse kryeministri Sali Berisha, p.sh., në 5 materialet me më shumë aktivitet, kishte më shumë aktivitet nga pëlqyesit e tij, kreu i opozitës kishte materialin më me shumë aktivitet. Nëse Berisha kishte më shumë pëlqime për takimin me këngëtarën Elhaida Dani, kreu i opozitës kishte një koment për golin e kombëtares së futbollit. Sipas “Mapo-s”, për disa orë me radhë postimi i kryeministrit për takimin me Elhaida Danin mbante vendin e parë me (8119 pëlqime /166 komente /211 ndarje) dhe ky vend në renditjen e postimeve më të pëlqyera u fitua vetëm vonë në mbrëmje nga fotoja e shpërndarë e Ramës me diçiturën “çasti i golit” që mblodhi rreth orës 23.00 (8986 pëlqime /371 komente / 267 ndarje). Një e dhënë tjetër interesante sipas matjes së këtij projekti, tregon se aktiviteti i fushatës, duke pasur në qendër premtimet ndryshe, kishin më pak aktivitet nga pëlqyesit.

Nëse shikojmë faqen zyrtare në Facebook të kryeministrit në ikje, Sali Berisha, ai ka arritur një numër rekord prej 540 mijë pëlqyesish (deri në qershor 2012). Nga të dhënat e publikuara në Facebook, vetëm në një javë janë rreth 2.4 milionë shqiptarë që lexojnë aktivitetin e Berishës në Facebook. Ata shohin rregullisht

postimet, bëjnë komente apo lënë ndonjë shenjë tjetër. Nga ana tjetër, faqja zyrtare e kreut të opozitës ka një numër më të vogël pëlqyesish, 340 mijë, edhe pse ajo është hapur dy vite më parë për zgjedhjet lokale të 8 majit në vitin 2011, e për më tepër, më pak se 10 për qind e pëlqyesve janë aktivë në faqen e tij. Kryeministri Berisha ka më shumë pëlqyes dhe aktivitet në tërësi në rrjetet sociale, por Rama arriti një rekord për materialin më të pëlqyer gjatë fushatës edhe pse me numër më të vogël pëlqyesish. Në këtë pikë, mund të arrihen dy konkluzione: së pari, materiali i hedhur nga kreu i opozitës ishte më i mirë, ose anëtarët e faqes së tij, edhe pse më të pakët në numër, ishin aktivë më të shumtë në faqe se të kryeministrit Berisha.

Po ta hedhim shikimin prapa, në fushatën për zgjedhjet lokale të 2011 për Bashkinë e Tiranës, mund të thuhet padyshim se fitoi kandidati i cili zhvilloi një fushatë më të mirë online. Analistët politikë e cilësuan si “fushata e Facebook-ut” dhe të dy partitë e mëdha shpenzuan mjaft kohë për të shpërndarë mesazhin e tyre përmes Facebook-ut. Në fund, fitoi kandidati i cili pati më shumë mbështetje në Facebook. Sic shprehet dhe Couldry, “*Tashmë ka individë të rinj në politikë, jo më vetëm lider karizmatikë apo komentues politikë me impakt të gjerë (gazetarë), apo anëtarë të heshtur partie, por individë pa një domethënie apo autoritet politik të cilët papritur ndryshojnë statusin duke u bërë aktorë domethënës falë aktivizimit online*” (2012, f.121).

Keto shembuj mbi politikën shqiptare tregojnë se interneti luan një rol të rëndësishëm në aktivizim, por sërish kjo nuk do të thotë se vendi është më mirë sesa ishte apo mund të bëhet më mirë. Arena politike është dypolare, me akuza të forta mes dy partive kryesore. Kjo lloj beteje politike për pushtet harron qytetarët si dhe mundësinë për një integrim real për në Bashkimin Europian.

Pse përdoret media sociale?

Përdorimin e medias sociale është një trend tashmë në politikë e veçanërisht në fushatë elektorale. E njëjta situatë ka ndodhur edhe me median tradicionale që kemi sot (ardhja e radios apo televizionit). Roli që luajtën radioja apo televizioni në jetën politike ka qenë e gjithanshme. Mund të përmendim përdorimin e radios nga presidenti amerikan, Roosevelt, në fushatën e vitin 1932 apo debatin televiziv mes kandidatëve presidenciale Kenedi e Nikson në fillim të viteve 1960-të.

Në fakt, ka mjaft arsye pse përdoret media sociale. Kjo media është një mjet i mirë për të mbajtur lart moralin dhe motivimin e mbështetësve politikë. Ata mund t'i arrish në kohë reale, mund të marrësh mendimet e tyre. Nuk të garanton fitoren, por tregon sesa e mbështetur është një kauzë e caktuar. Në rastin shqiptar, kjo është edhe më esenciale për të kapur audiencën e të rinjve në një kohë kur 40 për qind e popullsisë është poshtë moshës 26 vjeç. Zgjedhjet lokale të vitit 2011 e treguan këtë fakt. Por, sërish nuk ka asnjë kërkim që tregon se postimet në median sociale kanë një impakt real mbi votuesit.

Në të njëjtën kohë, është e vërtetë se njerëzit e angazhuar politikisht mund të anëtarësojnë në faqet online të kandidatëve në median sociale si në Facebook apo Twitter. Pavarësisht se më pak të angazhuarit nuk e bëjnë një gjë të tillë, ata sërish shikojnë dhe ndjekin mesazhet politike kur miqtë e tyre i ripostojnë, pëlqejnë apo komentojnë ato. Ky koncept ka ngjashmëri me modelin e komunikimit me dy modele dhe që i referohet impaktit që liderët e opinionin kanë mbi njerëz të tjerë.

Roli më i rëndësishëm dhe shënjeshtë që media sociale ka në lidhje me politiken është përqendrimi i mesazhit. Të përdorësh median sociale është më fleksible dhe më e thjeshtë të menaxhosh përmbajtjen, që do të thotë se grupi që punon për mirëmbajtjen e faqes mundet që më lehtësi dhe në kohë reale të hedhë lajm të çdo lloji natyre, edhe nga telefonat mobile ose nga pajisje të tjera. Gjithnjë politikanët dëshirojnë të hedhin një mesazh i cili transmetohet në media e në audiencë ashtu siç ata e dëshirojnë. Tashmë, me median sociale ata mund të vendosin çfarë të dëshirojnë dhe media ta transmetojnë atë thatë, pa interpretim. Kjo është një lloj ndryshe marrëdhënie nga ajo që kemi pasur me median tradicionale me konferencat e përhershme të shtypit dhe ku llogaridhënia mund të bëhet drejtpërdrejtë me gazetarët përballë. Së fundmi në Shqipëri, kur koalicioni qeveritar u nda, kryeministri preferoi të konfirmojnë lajmin jo me një deklaratë për shtyp apo me një konferencë për shtyp, por zgjodhi Facebook-un.

Nga ana tjetër, lideri i opozitës ka demonstruar preference e tij për të dhene konferenca shtypi në Twitter. Media merr mesazhin dhe e raporton atë, madje edhe me pamje gati të filmuara nga zyra e shtypit e opozitës duke treguar liderin pranë një kompjuteri. Këto pamje mund të shihen bruto në YouTube, kjo pasi ato mund të shkarkohen lehtësisht nga mediet vizive.

Ky realitet i ri ka sjellë dhe ndryshime strukturore: partitë politike janë kthyer në një dhomë lajmesh dhe me një staf të zgjeruar. Për të pasur një faqe të mirë në median sociale ajo duhet të përditësohet me material dhe me përmbajtje të cilësisë të lartë si video, foto, konferenca, tekst, etj. Kjo do të thotë se ky staf i gjerë, por edhe përgatitja e materialit kushton duke i bërë fushatat edhe më të shtrenjta. Por kush paguan për këto fushata? Kjo bëhet edhe më dramatike pasi lufta politike nuk është më vetëm për vota, por vlen edhe një *Tweet*, *Like* apo shpërndarje në Facebook (*Share*).

Procesi i komunikimit ka ndryshuar nëse e krahasojmë me vitet e hershme të studimeve në komunikim. Përdorimi i medias ishte një faktor i rëndësishëm nga diktaturat në Europë dhe përtej saj, por në ditët e sotme censura është më e përshtatshme. Më herët, për të kuptuar efektin e medias do të duhej të kuptoje *“semiotikën sociale të një situatë komunikimi të dhënë dhe gjithashtu të pranoje potencialin e deshifrimit të mesazhit në mënyrë të ndryshme e cila gjithnjë ekziston; pluralitetin e kuptimeve të cilat mund të përfshijnë të gjithë diversitetin e grupeve dhe të individëve të cilët përbëjnë audiencën e saj, dhe shumëllojshmërinë e përgjigjeve që kjo mund të provokojë”* (McNair, 2011: f. 161). Por media sociale është një ekosistem qartësisht më i larmishëm dhe kompleks, i themeluar mbi marrëdhëniet, pasionet dhe nga dëshira për të qenë në kontakt të vazhdueshëm, (Waddington 2012).

Implikimet

Ky peizazh i ri është përqaftuar nga shumë studiues si një mënyrë të re për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë dhe në vendimmarrje. Ata që përkrahin këtë qasje dhe interpretim pozitiv të mediave të reja besojnë se mjedisi i ri do të rrisë pjesëmarrjen dhe debatin në shoqëri. Sipas Sara Bentivegna *“ky argument vlen për qytetarët e thjeshtë të cilëve u ka munguar hapësira në mediet tradicionale për të shprehur vetveten, por gjithashtu edhe mundësia që të jepet më shumë informacion. Kjo legjitimon mundësinë e shpikjes së formave të reja të komunitetit, edhe pse virtuale, brenda një sfere publike, ku qytetarët mund të debatojnë për tema të rëndësishme politike”* (2002: f. 51).

Akademikët e komunikimit politik nënvizojnë ndryshimet që po ndodhin. Për Aeron Davis, ka një magnitudë prej efektit të komunikimit të matur, por kjo nuk do të thotë se forca apo mundësi të fuqishme kundërbalancuese po vijnë. *“Zgjerimi i internet-politikës mund të sjellë përmirësimin e angazhimit demokratik dhe llogaridhënien në qendër, por, ende nuk ka gjasa për të ofruar një zgjidhje për modelet më të gjera të mosangazhimit publik nga politika institucionale”* (2010: fq 98). Nga ana tjetër, Davis mendon se mediet e reja ndryshuan përgjithmonë mediet tradicionale, por së dyti, *“ajo është duke kontribuar në përjashtimin politik të “rrjeteve jashtë kursit” që ekzistojnë në politikën tradicionale apo offline”*, (ibid, f. 109).

Ka disa efekte pozitive për qytetarët në mënyrë që ata të kenë qasje më të mirë për t'u angazhuar në politikë dhe për çështje të tjera të rëndësishme në shoqëri. Teknologjia mund të ndihmojë që të ketë demokraci më të mirë përmes mundësive të vetorganizimit e të rrisin zërin e tyre. Sipas Papacharissi, interneti ka ulur koston e komunikimit dhe e bërë atë më të lehtë për të arritur nga të tjerët duke përdorur këtë platformë. Për më shumë, ai vë në dukje se jo të gjithë akademikët bien dakord mbi idenë se interneti po bën një punë të mirë. *“Shumë akademikë e akuzojnë internetin se lehtëson përçarjen, fragmentimin e publikut nëpërmjet krijimit praktik të komuniteteve homogjene në komunitetet, një fenomen i quajtur dhoma jehonë. Interneti mund të jetë i dëmshëm për demokracinë për shkak të rolit që mund të luajë për të përçarë, izoluar dhe në inkurajimin e enklavave nëpërmjet filtrimit të të dyjave, asaj që shkruhet e çfarë lexohet”*, (2009: f. 125).

Por për të shkuar përtej kësaj dhe të mendosh për të ardhmen është me të vërtetë e vështirë. Shumë akademikë nuk kanë një mendim të detajuar se sa larg ne po shkojmë me mediet sociale dhe me internetin në përgjithësi. Në librin e tij të famshëm mbi politikën e tij dhe internetin, Chadwick përshkruan implikimin e internetit në shumë aspekte të shoqërinë, por ai ende nuk jep një përgjigje të qartë. *“Çfarë mban e ardhmja mbi internet-politikën? Kjo është një pyetje me risk sepse e keqja më e vogël është se ka një huq të çuditshëm për të sfiduar edhe parashikimet më të besueshme”* (2006: f. 317).

Pavarësisht se shkollarët argumentojnë ndikimin e internetit, përgjithësisht është e pranuar ideja se interneti dhe mediet sociale kanë lehtësuar pjesëmarrjen në politikë.

Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit bëjnë të mundur që veprimet të jenë më të lehta, në kohë reale dhe më shumë gjithëpërfshirëse. Votuesit mund të jetë më aktivë në qoftë se ata duan, edhe pse ndikimi i veprimit të tij është i panjohur.

Edhe me këto ndryshime të rëndësishme që kanë ndodhur, mjaft elemente në shoqëri e ndoshta më të rëndësishmet, nuk po ndryshojnë. Një ndër to është pushteti, balanca e fuqisë. Sa e kanë ndryshuar balancën e pushtetit në shoqëri interneti dhe media sociale në një kohë kur shumë studiues vënë në dukje se ne jemi duke lënë pas kohën post-industrialiste? Nëse po, ku është ky ndryshim? Sipas Wim Van De Donk *“çdo kah politik, i brendshëm e i jashtëm, mund t’i përdorin këto mundësi të reja të teknologjive të komunikimit (TIK), balanca e pushtetit dhe e strukturës ekzistuese politike nuk ka të ngjarë të ndryshojë. Hulumtimet tregojnë se njerëzit të cilët janë politikisht aktivë në web janë tashmë “politikisht mbetës”, (2004: fq, 123).*

Në lidhje me këtë situatë, një akademik i njohur në komunikim dhe në sociologji, Manuel Castells, është tepër kritik pasi kjo mënyrë e re komunikimi po sjell disa shpenzime të tilla si; qytetarët po paguajnë fushata elektorale gjithnjë e më të shtrenjta. Sipas tij, *“korrupsioni politik bëhet fakt sistematik në moshën e politikës së informacionit”, (Castells, 2000, f. 13).*

Pas zgjedhjeve presidenciale në SHBA në vitin 2012, revista “Time” publikoi një artikull të gjatë duke nënvizuar se *“në politikë, koha e të dhënave të mëdha ka ardhur”*. Ditën e zgjedhjeve Presidenti Obama luante basketboll pa shprehur asnjë lloj frike për humbje dhe siguri se do të fitonte. Gjatë asaj fushate, Obama mblodhi më shumë se një miliard dollarë që ishte një shumë rekord parash. Pse Obama ishte kaq i sigurt në fitoren e tij dhe si mundi të mblidhte 1 miliard dollarë në një kohë krize? Sipas revistës “Time”, e cila zhvilloi një investigim prej 4 muajsh, para dhe pas zgjedhjeve, përgjigjja është: Të dhënat. Në fakt duket e frikshme, edhe për vetë SHBA-në, mënyra sesi u përdorën të dhënat e qytetarëve për fushatën elektorale. *“Ata (stafi i Obamës) rankuan çdo emër sipas një përlllogaritje të bërë nga vetë stafi, me prioritetet e fushatës. Rreth 75 për qind e faktorëve vendimtarë kishin të bënin me faktorë parësorë si moshë, seksi, raca, vendi i banimit si dhe historia e votës. Të dhëna konsumi mbi votuesit ndihmuan për të krijuar një tablo. “Ne mund të parashikojmë se cilët njerëz do të jepnin para për fushatën”, një anëtar i stafit i cituar nga revista”. (Time Magazine, 11 Korrik 2012).* Për më tej, gazetarët e “Time-s” analizuar rolin që luajtën të dhënat në vendimmarrje të cilat krijuan mundësinë për një mandat të dytë presidencial e që do të jetë një nga temat që pritet të studiohet më shumë për zgjedhjet e vitit 2012. Përdorimi i të dhënave është i frikshëm sepse asnjëherë nuk mund ta kuptosh se sa shumë ato po përdoren. Kjo ngre çështje mjaft thelbësore mbi mënyrën dhe sa duhet të përdoren të dhënat duke ditur se je në limitin e thyerjes së ligjit, sigurisë e të jetës private të qytetarëve. Sa për “Waddington” (2012), tani të gjithë janë duke u përpjekur për të gjetur të dhëna sa më shumë që munden, sepse askush nuk mund të fitojë pa gjetur informacione për çdo person të vetëm. *Ndërsa numri i pakët dhënave ishte sfida e shekullit të 20-të, e ashtuquajtura “të dhënat e mëdha” është sfida dhe mundësi e 21-të, (ibid. f. 221).*

Kritikët e medias sociale

Disa studiues sugjerojnë se kjo nuk është hera e parë që kemi të njëjtat pyetje dhe dyshime për median sociale. Edhe kur dolën mediet e tjera si gazeta, radioja apo televizioni pyetjet dhe dyshimet ishin të njëjta. *Kjo nuk është hera e parë në historinë moderne që një këndvështrim i tillë vjen para nesh, kur një medium të ri nis të përdoret. Shpërndarja e energjisë elektrike, telegrafi, telefoni, radio, televizioni, VCR dhe kablllo, të gjitha prej tyre ishin dikur media me një potencial demokratik të cilat mendoheshin se do të përfundojnë luftërat dhe diktaturat, Van Dijk (2012; f.109).* Gjithashtu ka disa kufizime të tjera. Sipas Van Dijk, interneti mund të përdoret nga të gjithë, por kjo nuk do të thotë se çdokush mund të dëgjohet ose ajo është i barabartë. Ai vë në dukje se regjimet diktatoriale mund ta përdorin për qëllime të ndryshme për të mbikëqyrur opozitën. Ka përvoja që tregojnë se interneti është shumë i mirë për të krijuar populizëm. Shumë shtete despotike në Afrikë dhe në Europë janë duke përdorur internetin vetëm për propagandë dhe kanë krijuar kushtet që ato qeveri të paraqesin një demokraci ndryshe, një model tjetër.

Sipas Beckett-it (2001), mund të ketë efekt negativ pasi *media sociale është e mirë për të ndryshuar qeveritë, por jo shumë e mirë për të përmirësuar qeverisjen*. Për më tepër, Beckett vuri në dukje se mediet sociale nuk janë gjithmonë të efektshme pasi *mediet sociale nuk krijojnë revolucioneve (ekonomia, politika, dhe historia e bëjnë)”. Ajo është vetëm një katalizator dhe një kanal. E pra, ajo sigurisht nuk e bëri në Bahrein. Përkundër të gjitha kushteve shfaqen të jenë në vend, mediet sociale nuk bëjnë dallimin.*

Ndërkohë, interneti është shumë i kufizuar dhe pajisjet digjitale nuk janë të shpërndara në të gjithë popullatën dhe ka qasje që shumë nuk mund të jenë të interesuar. Për më tej, interneti, në përgjithësi, ka rrezikun e selektivitetit dhe të përjashtimit për njerëzit të cilët nuk kanë akses ose mundësi. Mosca (2010) f. 16. Në këtë kontekst, për David Gauntlett (2007), kjo nuk është diçka e re apo një revolucion: *“Për të parë kreativitetin si brez e kontekste të reja si dhe çfarë përfaqëson, aplikimin e tyre, është në rregull, por kjo nuk duket se tregon ndonjë gjë të re në shoqëri. Kjo aftësi është kultivuar përmes evolucionit, por edhe kulturës” (Gauntlett, 2007, f. 224).*

Janë dy argumente kryesore kundër idesë se mediet sociale mund të bëjnë një ndryshim në politikën kombëtare. I pari është se mjetet janë të paefektshme, dhe e dyta është se ato prodhojnë të njëjtin dëm, ndoshta edhe më shumë për demokratizimin e shoqërive, sepse qeveritë represive janë duke i përdorur ato edhe më mirë për të shtypur disidentët. Shirky (2011). Ndërkohë Sonia Livingstone (2002) vë në dukje se mediet e reja ngrenë edhe *pyetje të reja dhe kërkon koncepte të reja analitike, ndërsa autorët në këtë pjesë preferojnë të analizojnë aktivitetet njerëzore brenda kornizave të mirëkrijuara, duke marrë pyetjet e tyre duke filluar fëmijëria, demokracia, komuniteti e kështu me radhë (Livingstone 2002, f. 19).* James Everett Katz (2008, f. 225) sugjeron se teknologjia ka gjithmonë dy anë dhe për sa i përket mediave sociale mund të përkufizohet si e dobishme dhe e mirë, por jo vetëm për të motivuar, por edhe për të demoralizuar.

Një sferë e re publike?

Koncepti klasik i 'sferës publike' vjen nga Jürgen Habermas. Me këtë koncept, Habermas (1974) i referohej një vendi ku anëtarët e komunitetit, në mënyrë kolektive, mund formojnë opinionin publik në një mjedis larg qeverisë ose ekonomisë. (f.350-353). Ky koncept duket sikur funksionon për sa i përket krijimit të një komuniteti në dhe nëpërmjet mediave sociale, por kjo nuk është ajo që Habermas do të donte dhe komuniteti të cilit ai i referohet kërkon komunikim të mirë politik, kërkon pjesëmarrjen e aktorëve politikë, mediave dhe publikut.

Sipas Kees Brants dhe Katrin Voltmer (2011), mediat sociale sollën shumë optimizëm në lidhje me arritjen e një demokracie më të mirë. Megjithatë, ende ka shumë pikëpyetje dhe shumë prej pritshmërive sa i takon rolit të tyre në demokraci nuk janë përbushur ende. Për autorët e cituar më sipër, "*Bukuria e hapësirave të tilla qëndron në faktin se ata që marrin pjesë në to nuk janë atje për të bërë politikë, edhe kur politika del në vend të parë; ata nuk duhet të besojnë se debatet politike vlerësohen në këto hapësira, duke u dhënë mundësinë të shmangin, në një mënyrë a një tjetër, konotacionet negative që janë të lidhura zakonisht me të folurin e politikave konvencionale në ditët e sotme*" (f. 262).

Por, në anën tjetër, ndoshta ne kemi një sistem të ri komunikimi që Manuel Castells (2009) e quan "vetë-mass komunikim" (në anglisht "Self-Mass communication"). Për Castells komunikimi është "mass" sepse mund të arrijë një audiencë masive dhe është "vetë" sepse prodhimi i mesazhit vetëgjenerohet ose sepse informacioni mund të vetëkrijohet. Mund të themi se kemi të bëjmë me komunikim- nga të gjithë tek të gjithë (në anglisht "*Many-to-many communication*"), në kohë reale ose të zgjedhur dhe me mundësinë e vetëtransmetimit, në varësi të qëllimit dhe karakteristikave të praktikës së komunikimit" (f.55).

Një prej pikave të forta të kësaj praktike është se të jep më shumë mundësi për të debatuar dhe për të qenë pjesë e këtij debati. Për më tepër, është shumë e kuptueshme dhe, më e rëndësishmja, nuk është e kushtueshme. Sidoqoftë është me vlerë të evidentojmë edhe pika të dobëta: cilësia e diskutimeve dhe ndikimi ose impakti i ulët. Vërtet, si mund të bësh debat cilësor me 140 karaktere në Twitter? Në përgjithësi, si një platformë, interneti është i kufizuar. Sikundër pohon Castells: "*Ky potencial për autonomi është formuar, kontrolluar dhe cunguar nga numri i madh i mbylljeve të mediave të formateve të ndryshme si dhe i korporatave të mëdha mediatike në rrjetin botëror*" (Castells, 2010, f.135).

Konkluzione

Me mediat sociale dhe internetin në përgjithësi, nuk po ndodh diçka e pazakontë, as në politikë as në shoqëri, vetëm se agjentë të ndryshëm po përdorin një mjet të ri për të arritur objektivat e tyre politike. Në qoftë se 4 vjet më parë udhëheqësit

shqiptarë të politikës duhej të këndonin me yje të muzikës *pop* duke u bërë pjesë e kulturës komerciale, sot ata bëjnë pothuaj të njëjtën gjë duke hedhur në median sociale fotografi, video, shakara etj. David Gauntlett vë në dukje se kultura është duke shkuar drejt "*të bërit dhe të publikuarit*" e cila mund të lulëzojë në këtë shekull. Por, ende, pyetjet vazhdojnë të shqetësojnë teoricienë politikë dhe shkencëtarë socialë – sa rol luajnë mediat e reja në vende të ndryshme dhe në cilat vende kanë ndikim më të madh?

Është e vërtetë se mediat e reja, si mjet dhe platformë e lirë mund të kenë ndikim, duke i ndihmuar individët në dhënien e kompetencave të reja, të afta t'i fuqizojnë në të bërit politikë, shumë thjeshtë: duke marrë një foto ose një video me një telefon celular dhe ngarkimin e imazhit ose të videos në YouTube. Megjithatë, media sociale nuk mund të ndihmojë në situatat me rrezik të lartë ose për të qeverisur një vend në mënyrë më të mirë. Fuqia dhe pushteti nuk po ndryshojnë gjithashtu. Pranvera arabe ka treguar se nuk ishte media sociale ajo që nxorri njerëzit në rrugë, por situata politike dhe ekonomike i detyroi të dalin e të protestojnë.

Ndërkohë mund të pohojmë se media sociale është një mundësi më shumë për t'u angazhuar politikisht, sikundër jemi të ndërgjegjshëm për rastet e keqpërdorimit ose propagandimit nëpërmjet saj, ashtu siç ka bërë edhe media tradicionale. Në ditët e sotme mediat sociale dhe interneti janë pjesë e jetës së përditshme, por kjo nuk do të thotë se ajo është faktor për vendimmarrje në qeveri, ose për ndryshim politikash. Mund të thuhet se "*ne jetojmë në kohë konfuze, siç është shpesh rasti në periudhat e tranzicionit historik midis formave të ndryshme të shoqërisë*" (Castells 2010: f. 17).

Bibliografia

- A Davis (2010) *Political Communication and Social Theory*, Routledge.
Beckett, C. (2001) *Social media – why it's useless for democratic politics. Some caveats to political cyber-optimism*, <http://t.co/PcBhdadZ> (Accessed 23 April 2013).
Bentivegna, Sara (2002) *Handbook of new media*, Edited by Leah Lievrouw and Sonia Livingstone, Sage publications.
Brants, Kees and Voltmer, Katrin (2011) *Political communication in postmodern democracy challenging the primacy of politics*, Basingstoke: Palgrave Macmillan.
Chadwick, A. (2006) *Internet Politics: States, Citizens, and New Communication Technologies*. Oxford University Press, New York and Oxford.
Castells, M. (2000). *The Information Age: Economy, Society and Culture, Volume I: The Rise of the Information Society, Second Edition*. Blackwell Publishing.
Castells, Manuel. (2009) *Communication Power*, Oxford University Press.
Castells, Manuel. (2010). "*Preface to the 2010 Edition of Rise of the Network Society*" in *The Information Age: Economy, Society and Culture, Volume I: The Rise of*

- the Information Society. Blackwell Publishing.
- Couldry, Nick (2012) *Media, Society, World: Social Theory and Digital Media Practice*, Cambridge: Polity.
- Gauntlett, David (2007) *Creative explorations new approaches to identities and audience*, London : Routledge.
- Gladwell, Malcolm quoted by Rita Safranek (2012) *The Emerging Role of Social Media in Political and Regime Change, "Twitter Revolution" Critics* http://www.csa.com/discoveryguides/social_media/review4.php (Assessed 23 April 2013).
- Jürgen Habermas, "The Public Sphere," 1974, printed in *The Information Society Reader*, (New York: Routledge, 2004).
- Katz, James Everett (2008) *Handbook of Mobile Communication Studies*, Massachusetts Institute of Technology.
- Karaj, Vladimir Fushata në Facebook, ja çfarë pëlqehet nga Berisha dhe Rama, Gazeta MAPO, (Assessed 11.06.2012) <http://mapo.al/2013/06/10/fushata-ne-facebook-ja-çfare-pelqehet-nga-berisha-dhe-rama>
- Megenta, Abiye (2011) *Can it tweet its way to democracy? "The promise of participatory media in Africa."* Oxford: Reuters Institute for the Study of Journalism. (http://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/fileadmin/documents/Publications/Working_Papers/Participatory_Media_in_Africa.pdf) (Açessed 23 April 2013).
- Mosca, Lorenzo (2010) *From the Streets to the Net? The Political Use of the Internet by 20 Social Movements*, The International Journal of E-Politics, 1(1): <http://www.igi-global.com/Bookstore/TitleDetails.aspx?TitleId=1147&DetailsType=FreeSampleCopy> (Açessed 23 April 2013).
- McNair, Brian (2011) *An introduction to political communication*, London : Routledge.
- Time Magazine, *Inside the secret world of the data crunchers who helped Obama win*, <http://swampland.time.com/2012/11/07/inside-the-secret-world-of-quants-and-data-crunchers-who-helped-obama-win/> (Accessed 23 April 2013).
- Livingstone, Sonia (2002) *Handbook of new media, Edited by Leah Lievrouw and Sonia Livingstone*, Sage publications.
- Papacharissi, Zizi (2009) *Journalism and citizenship new agendas in communication*, London: Routledge.
- Shirky, Clay. "The Political Power of Social Media: Technology, the Public Sphere, and Political Change." *Foreign Affairs* 90.1 (2011): 28-I. ProQuest. Web. 16 Feb. 2012.
- Van Dijk, Jan (2012) *The Network Society, 3rd edition*, London : Sage.
- Van de Donk, Wim (2004) *Cyberprotest new media, citizens, and social movements*, London; New York : Routledge.
- Waddington, Stephen (2012) *Share this social media handbook for PR professionals*, Chartered Institute of Public Relations, Chichester: John Wiley & Sons Ltd.

Recensa

Prof. Dr. Aleksandër DHIMA*

**Recensë e monografisë së dr. Nebi Bardhoshit:
"Gurtë e kufinit", Tiranë: UET Press, 2011**

Studimi i dr. Nebi Bardhoshit është frut i një pune të gjatë studimore që zë fill me ekspeditat e shumta të karakterit etnografik/ etnologjik në terren (2002-2007), vijon me rikonceptimin e *kulturës së pronësisë* në aspektin antropologjik ligjor, ballafaquar kjo me traditën zakonore shqiptare dhe me kornizat ligjore të kohës së sotme. Veçanti parësore të studimit përbëjnë shfrytëzimi pothuajse tërësor i dokumentacionit arkivor vendës, referencave bibliografike mbi marrëdhëniet pronësore në realitetin shqiptar dhe i një literature të pasur mbi modelet dhe mbi përvojat bashkëkohore në trajtimin e problematikës së *të drejtës së pronësisë* në Shqipëri.

Siç e pohon vetë autori në *Parathënie*, në Shqipëri ka pak studime lidhur me *të drejtën kanunore* në tërësi (Sh. Gjeçovi; Rr. Zojzi; S. Pupovci; M. Tirta; I. Elezi), ndërkohë që s'kemi asnjë studim për *pronën* në vështrim antropologjiko-ligjor. Hulumtimi dhe ndriçimi i këtyre dy shtyllave të rëndësishme të *kontrollit* dhe *kohezionit social*, në evolucionin e tyre kohor, përbën një ndihmesë të rëndësishme për institucionalizimin e një prirjeje të re të studimeve antropologjike social-kulturore në vendin tonë.

Tema e shtjelluar në monografi ka rëndësi në pikëpamje të njëjësimit të metodës së kërkimit në shkallë ndërrajonale dhe, në një aspekt më të përgjithshëm, në rrafsh kombëtar. Subjekt i studimit të marrëdhënieve pronësore është krahina e Hasit. Kjo trevë e të njëjtit entitet kulturor- në bazë të të dhënave burimore etnografike- është e ndarë në dy pjesë administrative politike qysh prej fillimit të shek. XX (rrethi i Hasit në territorin e sotëm të Shqipërisë dhe Hasi i Zhurit në ish- territorin e Jugosllavisë/ përkatësisht

* Lektor i lëndëve të *Antropologjisë social-kulturore* në UET.

në Republikën e Kosovës mbas vitit 1999). Pavarësisht se të dyja pjesët kanë pasur historikisht regjime të ndryshme ligjore (shtetërore dhe pronësore) në kohët e vona, të diktuar nga forma e regjimit politik, *e drejta kanunore* në tërësi dhe ajo mbi *pronën* në veçanti duhet të kenë qenë të njëjta në të dyja anët e kufirit, ashtu si për shumicën dërmuese të trevave shqiptare. Këtë hamendje empirike, autori e ka vërtetuar me argumente të qenësishme shkencore. Një gjetje origjinale e tij lidhet me strukturën e punimit. Shtyllat, në të cilat mbështetet studimi, janë: *e drejta kanunore mbi pronësinë* dhe *strukturimi social* që lidhet me të dhe imponon një impakt të anasjelltë. Në plotësim të kësaj strukture vjen edhe këndvështrimi i marrëdhënieve pronësore në kontekstin e *së drejtës shtetërore*.

Vepra e dr. Nebi Bardhoshit, ashtu si çdo studim serioz i kësaj natyre, çelet me kapitullin teorik mbi metodën e mbledhjes dhe trajtimit të materialit. Në aspektin metodologjik, puna hulumtuese e dr. Bardhoshit mbështetet në dy shtylla që ngërthejnë në vetvete një optikë të re në të gjykuarit e dukurive me karakter shoqëror, duke i dhënë rëndësi të posaçme kthimit të grupit në pjesë të subjektit antropologjik:

- *Vëzhgimi me pjesëmarrje*, iniciuar nga B. Malinowski, përbën standardin kryesor për kërkimet antropologjike moderne, sepse ai mbështetet te *funksionalizimi i kulturës* (në rastin konkret: *kulturës pronësore*). Falë tij krijohet familjariteti proverbial i antropologut me grupet e targetuara dhe, nga ana tjetër-praktikat e tyre zakonore ose ligjore mund të njihen, siç ka ndodhur në rastin konkret, nëpërmjet përfshirjes intensive të kërkuesit në njerëzit e studiuar në mjedisin e tyre natyror. Falë këtij lloji të kërkimit, autori ka realizuar me sukses intervista informale, plotësimin e pyetësorëve mbi lidhjet farefisnore, strukturën familjare, arsyet e (mos)zbatimit të ligjit për (ri)shpërndarjen e pronës, gjithashtu një analizë të thelluar të dokumenteve personale, vetanalizave verbale dhe historive narrative; më tej, vendimtare në suksesin e kësaj ndërmarrjeje ka qenë pjesëmarrja aktive e autorit në jetën e grupit dhe në diskutimet kolektive mbi format dhe praktikatat e ndërmjetësimit si dhe në vjeljen e detajeve mbi normat zakonore lokale.

- *Antropologjia në shtëpi* është një tjetër qasje, relativisht e re në praktikën e studimeve antropologjike, të cilën autori e ka zbatuar me sukses, duke kapërcyer *impas*-in që mund të shkaktonte studimi i kulturës “tënde” dhe jo i “tjetrit”, duke e zhvendosur vëmendjen- siç shprehej dikur F. Boas “*tek e kaluara nisur nga e tashmja e lëvizshme*”. Në ndihmë të zbatimit të kësaj metode pune vjen prejardhja hasjane e autorit dhe kjo është një përparësi jo e vogël, po të marrim me mend se sa vështirësi mund t’i ishin dashur të përballonte një studiuesi tjetër për mbledhjen e informacioneve paraprake mbi shtrirjen e krahinës, të folmen e saj, vendosjen e një dialogu intim dhe të besueshëm me komunitetin (sipas traditës vendëse) etj. Nga ana tjetër, autori- gjatë ekspeditave të tij në terren- ka tejkaluar me sukses edhe

një farë doze subjektivizmi që mund të zërë vend në raste të tilla, kur studiuesi vjen nga e njëjta krahinë, duke i kushtuar vëmendje edhe *nivELIT tjetër*, përtej asaj që “thuhet”, por që mund të mos ketë ndodhur realisht; për këtë, autori ka ngulur këmbë vazhdimisht në verifikimin *in situ* të praktikave të reja që karakterizohen nga një qëndrueshmëri e brishtë dhe që ndikojnë në ridimensionimin e anëve të veçanta të jetës sociale, përfshirë edhe qëndrimin aktual ndaj *së drejtës kanunore* në tërësi.

Një përparësi tjetër e veprës qëndron në faktin se e gjithë “veshja” metodike dhe metodologjike mbështetet në përvojën e autorëve klasikë dhe bashkëkohorë më në zë në fushat e *antropologjisë social-kulturore* (B. Malinowski; C. Geertz; Ch.M. Hann) dhe *antropologjisë së ligjit* (M. Gluckman; A.E. Hoebel; L. Pospisil; S.F. Moore; W. Twining etj).

Një syth mjaft domethënës në kapitullin e parë lidhet me trajtimin e *së drejtës* në këndvështrim antropologjik, çka do të përbënte një përligjje teorike të domosdoshme jo vetëm për studimin në fjalë, por edhe për studimet e ardhshme në vend në fushën e *antropologjisë së ligjit*. Në bazë të kësaj prirjeje qëndron *funksioni* që ka *e drejta* në shoqëri. Studiuesit e ligjit e kanë konsideruar këtë qasje si të lidhur me tri sfida kryesore: kërkesën për zgjidhje më të mira ligjore ndaj problemeve sociale aktuale; nevojën për t’u mbështetur në përfundime shkakësore si dhe me domosdojnë për të marrë parasysh kontekstin kulturor, ekonomik, politik dhe social, në kuadër të të cilit ekzistojnë dhe veprojnë institucionet e ligjit. Koncepti i “funksionit të ligjit” do të mundësonte dallimin midis funksioneve të paracaktuara dhe pasojave konkrete të tyre në institucionet ligjore. Duke mbajtur parasysh këtë paradigmë të rëndësishme, autori ka analizuar me vëmendje në punim raportin (marrëdhënien) e *së drejtës kanunore* me të drejtën shtetërore.

Kapitujt në vazhdim përbëjnë korpusin kryesor të veprës, ku trajtohen aspekte etnografike të *së drejtës kanunore* në Has: terminologjia juridike tradicionale dhe kuptimet e saj; normat juridike, morale dhe religjioze, si pjesë përbërëse të një sistemi shtrëngues kryesisht për marrëdhëniet sociale më të rëndësishme në kontekstin (sub)kulturor përkatës (si *prona* ose *martesa*); figura e autoritetit ligjor në kuadër të këtij institucioni dhe *analogjia*, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën e të menduarit, për ta ruajtur traditën, por edhe për ta ndryshuar atë. Kapitulli 3 i kreut të parë “*Hasi në një vështrim të përgjithshëm*” mund të vendosej përpara kapitullit 2 “*Mbi të drejtën kanunore në Has*”, sepse lexuesi do t’i kuptonte më mirë institucionet e *së drejtës kanunore* në rrafsh lokal duke mësuar paraprakisht se Hasi, si pjesë e krahinës së madhe etno-kulturore të Dukagjinit, ka ruajtur relativisht mirë memorien sociale mbi të drejtën kanunore.

Kreu i dytë i kushtohet binomit *pronë/familje*, që trajtohen në *antropologjinë e ligjit* si dy entitete organikisht të ndërvarura, nga mënyrat e bashkëveprimit

të të cilave në kontekste historiko-kulturore të caktuara përcaktohet forma dhe fryma (përmbajtja) e *së drejtës pronësore*. Struktura sociale e familjes shërben si një model *par excellence* për të interpretuar institucionet e shoqërisë, ndër të tjera edhe institucionin e *pronësisë*, sepse familja është strukturuar sipas sistemit të vlerave dhe normave që mbrohen nga ligji/ më herët nga Kanuni (në rastin shqiptar). Edhe vetë “zhvendosjet” e mundshme në fitimin e *pronësisë* dhe në ndarjen e saj kushtëzohen- në radhë të parë- nga treguesit e jetës familjare si prejardhja dhe trashëgimia, marrëdhëniet shoqërore brenda familjes dhe ndarja e punës midis anëtarëve të saj, ndarja e familjes, përdorimi i pronës së paluajtshme (tokës, në rastin konkret) etj. Nisur nga analiza e hollësishme që u bën autori këtyre treguesve si dhe nga përshkrimi i shkëlqyer narrativ i institucioneve “të vogla” të karakterit simbolik dhe besimtar (si pirja e kafesë, e falmja, mbathja, beja), që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në *të drejtën kanunore*, unë mund të pohoj pa mëdyshje se dr. Nebi Bardhoshi është tashmë ndër etnologët më të spikatur të kohës së sotme në vend.

Me rëndësi për perspektivën e marrëdhënieve pronësore në Shqipëri është trajtimi në një syth të posaçëm i *së drejtës së pronës mes Kanunit dhe ligjit shtetëror*, ku spikat analiza e dy prej formave më radikale të ndërhyrjes shtetërore në jetën social-kulturore: *kolonializmi*, i shprehur në formën tipike në pjesën e Hasit të Kosovës, që kishte për bazë legjitimuese interesin politik të shtetit jugosllav dhe *kolektivizimi*, që preku në thelb jetën ekonomike të shoqërisë rurale shqiptare, për shkak të së cilës *e drejta kanunore* e humbi legjitimitetin në jetën publike të vendit.

Kreu i tretë i kushtohet *lidhjeve sociale dhe pronës* në fshat, si “njësi sociale gjysmë-autonome”. Në këtë kuadër, *strukturimi social* i fshatit shihet si faktori përcaktues i *pronësisë mbi tokën*. Nëpërmjet një analize të thelluar, autori trajton mënyrat e krijimit dhe format e *pronës së përbashkët*, ndarjen e saj dhe krijimin e bashkëpronësive të reja, që pasqyrojnë një shndërrim të thellë konceptual rreth *pronësisë*. Sythi etnografik mbi “kufirin e pronës”, prej nga vjen edhe titulli i veprës, rreket të shpjegojë filozofinë morale, religjioze dhe juridike të popullit që sendërtohet në *të drejtën kanunore*; njëkohësisht, ai përbën “gurin e provës” për të garantuar vijimësinë e marrëdhënieve sociale të *pronësisë*.

Monografia përfundon me një analizë përmbyllëse mbi *kulturën e pronësisë* midis dy sistemeve ligjore (kanunor dhe shtetëror) në një krahinë kufitare, siç është ajo e Hasit. Duke u nisur nga paradigma e A. Hoebel-it që “marrëdhëniet sociale janë të tilla [pra sociale], sepse ato- midis të tjerash- përvijojnë marrëdhëniet pronësore”, duket e përligjur sfida që i ka vënë vetes autori për të analizuar faktet sesi janë përjetuar dhe ç’rol kanë luajtur në jetën e banorëve të krahinës dinamikat kohore të sistemeve ligjore dhe, pse jo, edhe të sistemeve politike. Unë personalisht do të vlerësoja përfundimin e autorit

që “historia e marrëdhënieve sociale në tërësi, sidomos e atyre të *pronësisë*, ndryshon nga ajo që paraqitet në nivelin *makro*, konkretisht në ligjin shtetëror, dhe asaj në planin lokal [*mikro*]”. Në këtë pikë, autori i kundërvihet me të drejtë idesë se “ligji shtetëror është i përparuar (madje bashkëkohor), ndërsa ligji zakonor është shprehje e së kaluarës dhe, në tërësi, i prapambetur”. Kjo rrethanë e nxit autorin t’i drejtohet një teorie të re mbi “vijimësinë e *së drejtës kanunore*”, falë faktit se kjo formë e *së drejtës* duket se ka fituar tashmë edhe një cilësi shtesë, atë të të vlerësuarit si *kulturë juridike tradicionale* (ndoshta në rrafsh kombëtar).

Kjo teori e re sfiduese duket se mund të përligjet nga fakti që forca zbatuese *relative* e ligjit shtetëror dhe mbijetesa *reale* e *së drejtës kanunore* janë shprehje e një *dualizmi ligjor* funksional: *ligji shtetëror mbi pronën* ka tipare të mirëfillta të një *ligji autoritar*, sipas konceptit të L. Pospisil, sepse ai nuk përputhet domosdoshmërisht me mendësitë “e vjetra” juridike që vazhdojnë të jenë të pranishme në shoqërinë shqiptare ku mbijetojnë në një masë të caktuar (kryesisht në zonat fshatare, jo vetëm në krahinën e Hasit). Në “luftën” midis *së drejtës kanunore* dhe *së drejtës shtetërore* mbas viteve ’90 të shek. XX, del- sipas studimeve të thelluara të dr. Nebi Bardhoshit- të ketë fituar e para, sepse institucionet shtetërore njohin sot e kësaj dite (qoftë edhe heshturazi) efektet e *së drejtës kanunore*, pa pasur fuqi të plotë institucionale për t’iu kundërvënë hapur asaj. Këto janë mesazhe me impakt konkret në modelimin e marrëdhënieve pronësore në Shqipërinë e së ardhmes. Njëherazi, ato tregojnë vlerën e pazëvendësueshme të studimeve të mirëfillta shkencore në sferën e *antropologjisë së ligjit* për zgjidhjen e pyetjes: pse ligji (shtetëror) për (ri) shpërndarjen e tokës na rezulton i pazbatueshëm plotësisht/ drejtësisht në kushtet konkrete.

Nëpërmjet dokumentimit shumëpërmasor të fazave të njëpasnjëshme të *së drejtës pronësore* në Has, autori ka identifikuar elemente të një shoqërie progresive që **ka realizuar kode, por edhe që synon vazhdimisht ndryshimin dhe përmirësimin e tyre. Shoqëri të tilla karakterizohen nga mobiliteti (lëvizshmëria) drejt shoqërisë së hapur, ku të drejtat vetjake dhe ato të pronësisë zhvendosen nga kornizat familjare dhe të fshatit në hapësira më të gjera publike e shoqërore; vetëm në shoqëri të tilla mund të aktivizohen me sukses mekanizmat e ndryshimeve ligjore për përshtatjen e ligjit me interesat e shoqërisë. Nga ana tjetër, kjo nënkupton edhe ndërgjegjësimin e instancave vendimmarrëse për vëmendje maksimale ndaj traditës kur vjen fjala për akte normative që mund të ndikojnë në kohezionin social të shoqërisë shqiptare.**

Krahas interesit të mirëfillt shkencor, libri i drejtohet një rrethi të gjerë lexuesish, nga specialistët e *së drejtës civile* e asaj të *krahasuar* deri te lexuesi i thjeshtë (jo vetëm hasjan!), i cili do të gjejë aty të vërteta historike mbi trashëgiminë kulturore juridike në trevat shqiptare.

Së fundi, dëshiroj ta falënderoj për zemërsisht autorin për këtë vepër të re që na takon të gjithëve ta vlerësojmë. Ajo është shkruar me përgjegjësi shkencore dhe intelektuale, me idenë për të ndriçuar në mënyrën më të mirë të mundshme aspekte të rëndësishme të *së drejtës në kuadrin e marrëdhënieve pronësore në realitetin shqiptar. Kjo vepër do të zërë një vend të merituar në fondin ende modest të antropologjisë social-kulturore shqiptare.*

Recensa _____

_____ *PhD. Odeta BARBULLUSHI* _____

Recensë e librit të Shkëlzen Maliqit (2012) "*Shembja e Jugosllavisë, Kosova dhe rrëfime të tjera*", Tiranë: UET Press

Ky është një libër pak i veçantë në llojin e tij: ai nuk është libër akademik në kuptimin rigoroz të fjalës dhe as mirëfilli publicistik. Si i tillë, ai nuk është i detyruar të ndjekë ato rregulla dhe parime të rrepta shkencore që ne njohim në fushat tonë të studimit. Por në të njëjtën kohë, nuk është as një vepër publicistike në kuptimin e parë të fjalës: siç e dimë, në veprat publicistike autori synon që të bindë lexuesin ose dëgjuesin që interpretimi të cilin jep ai është më i sakti dhe më legjitimi, dhe këtë autori e bën jo vetëm nëpërmjet argumentimit logjik, por dhe nëpërmjet tërheqjes emocionale dhe stilit letrar. Në këtë sens, libri i Maliqit nuk i përket asnjërës: ai është një biografi personale dhe kombëtare e prodhuar nëpërmjet një dialogu 218 faqesh, të shtrirë në 4 vite kohë, mes viteve 2007 -2011. Ky është po aq një libër i Shkëlzen Maliqit sa është dhe një libër mbi Shkëlzen Maliqin. Libri është organizuar në 8 kapituj, të cilët janë të kombinuar sipas temave politike, si shembull, "Pse dështoi rezistenca paqësore" e kapitullit të fundit, ose sipas etapave/periudhave historike si vitet 60-të, revolucioni dhe protestat e vitit 1968, vitet 70-të, vitet 80-të, etj. Për mua, kapitujt më të preferuar janë kapitulli i parë, "Hyrja" dhe kapitulli i dytë 2 "Vitet 60-të".

Kapitulli i parë ose *Hyrja* na tregon procesin e lindjes së "publicistit" ose të intelektualit publik. Ky udhëtim i Maliqit nga një punonjës 35-vjeçar i Fakultetit Filologjik në Universitetin e Beogradit, i interesuar në estetikën bizantine dhe në filozofi, në një pozicion të mirë social e simbolik- duke qenë se i ati kishte qenë Ministër Rendi në Kosovë- në një akuzues të sistemit të ri nacionalist që po lindte pikërisht në Beograd, është një udhëtim i zbulimit të vetvetes. Te një intelektual ose studiues tjetër të të njëjtit brez në Europën Perëndimore a përtej Atlantikut, ky moment vetëzbulimi, ose i zbulimit të "intelektualit publik" mund të mos vinte kurrë: por ishte urgjenca dhe goditja që solli vetë shembja graduale e një regjimi

dhe zëvendësimi i një ideologjie me një ideologji përjashtuese dhe kërcënuese për shqiptarët, si ajo e nacionalizmit serb, e cila shkundi melankolinë, ngurrimin dhe egoizmin krejt të përligjur në kushte të tjera të studiuesit, dhe forcoi te Maliqu zërin e protestës.

Kapitulli i dytë, mund të quhej më mirë dhe kapitulli i formimit të Shkëlzen Malikut si individ. Në këtë kapitull vend të rëndësishëm zënë marrëdhëniet me babanë, titullar i rëndësishëm në sistemin komunist, me fisin dhe me familjen e cila ruante ende tipare të jetës tradicionale të familjeve të mëdha nga Prizreni, por që vetë Maliqu shkruan se e “kishte kapur trendin e kohës, ishte rreshtuar me fituesit (pas Luftës së Dytë Botërore) dhe këta fitues ofronin një të ardhme më të mire (f. 38), marrëdhëniet me qytetin/qytetet-Prishtinën dhe Prizrenin, si dhe me Zotin. Ky kapitull në shumë aspekte sipas meje i përngjason librit “Stambolli” të Orhan Pamuk, ku autori na tregon procesin e krijimit të identitetit të tij nëpërmjet marrëdhënies me qytetin dhe etapave dhe ndryshimeve historike që kalon ai. Për shembull, këtu shohim dallimet mes Prizrenit dhe Prishtinës, dallimet mes qytetit me politikë më të ideologjizuar siç është Prishtina dhe Prizrenit që ruan ende tiparet e një “life-world” po të përdorim termin e Jurgen Habermas-it, domethënë e një hemisfere humane kulturore e të pakolonizuar ende nga sistemi politik.

Një prej temave që përshkon këtë kapitull, por dhe të tjerët vijues është kapërcimi i kufijve ideorë (për shembull, në marrëdhëniet e Malikut me të atin, një person shumë parimor dhe komunist i ndershtëm siç na e portretizon Maliqu), atyre kulturorë dhe gjeografikë (për shembull, në pyetjet që bën Maliqu qysh i vogël, kur nuk kupton pse i ati i thotë që nuk ka Zot, kur hallat e gjyshit i luten Allahut), apo në kalimin nga Prizreni provincial në Prishtinë e më pas në metropolin e konfederatës, në Beograd.

Disa prej pyetjeve kyçe që ngre libri janë pyetje që lidhen me eksperiencat vetjake dhe të komunitetit të tij politik e profesional, familjes e të afërme si, për shembull, nga erdhi nacionalizmi në ish-Jugosllavi; si lindi, fillimet e tij dhe përse mori këtë formë dhe këto përmasa; përse politika paqësore e Prishtinës dështoi; si u kalua nga konfederata në shtetin e Kosovës dhe si u përjetua ky ndryshim nga një brez intelektualësh të edukuar si qytetarë jugosllavë. Por duhet të kemi parasysh që ky nuk është një libër rreth nacionalizmit, rreth Kosovës ose rreth të qenit shqiptar. Ky është një libër që, siç e thotë edhe vetë titulli jep një tablo rreth shembjes së Jugosllavisë: kështu që është një libër i cili tregon rreth atij ndryshimi dramatik, social e politik që në mënyrë të pashmangshme reflektohet dhe në jetën individuale - dhe aq më tepër tek individë të ndjeshëm politikisht-siç na e paraqitet autori-ashtu si është ndryshimi i një sistemi politik dhe zëvendësimi i tij me një sistem tjetër.

Një prej kontributeve të librit është që ai është prezantim i mirë edhe i skenës intelektuale e kritike të Kosovës, por dhe më gjerë në harkun e tri dekadave. E vërteta është që ne intelektualët dhe studiuesit në Shqipëri i njohim ende pak

intelektualët publikë, studiuesit dhe aq më pak dhe rezistencën e shqiptarëve të Kosovës, në të gjithë dimensionet e saj dhe me gjithë kompleksitetin e saj. Toni i Shkëlzen Malikut është faktual dhe reflektiv dhe aspak difensiv apo etno-centrik: Me shumë ftohtësi, Maliqu na jep tablonë e vakët intelektualisht dhe rezistencën ende të dobët dhe të paartikulluar qartë të udhëheqjes dhe intelektualëve shqiptarë në fillimin e viteve 80-të në Prishtinë. Po ashtu, ai pohon sesi individualisht, ashtu dhe kolektivisht, shqiptarët e Kosovës nuk përbënin ende atë masë kritike që të parashikonin dhe t’i bënin ballë me argumente jonacionaliste revanshizmit nacionalist serb.

Librin e përshkruan tejprtej një sinqeritet dhe kthjelltësi që brezat e rinj ia kanë zakonisht zili brezit më të vjetër, kur ky i fundit ka guximin intelektual dhe ndërgjegjësimin e mjaftueshëm për ta parë të kaluarën në sy dhe për të nxjerrë mësim prej saj.

Maliqu nuk është apologjistik për të kaluarën e tij të majtë dhe as për bindjet e tij te sistemi titist: Ai pohon pjesëmarrjen si një ndër organizatorët në protestat e vitit 1968 në kampusin e universitetit të Beogradit, ku sipas përshkrimit të tij, studentët dëgjonin këngë partizane italiane “Bela Ciao” ashtu dhe Beatles, dhe kundërshtonin fort drejtimin ri “devijues” të Jugosllavisë, që dukej se po dilte nga rruga e komunizmit të pastër.

Po ashtu, kompleksiteti, larmia dhe situatat deri diku dhe ato që sot mund të na duken paradoksale, por që në kontekstin e tyre ishin aspak të habitshme për vetë ato që i jetuan, na jepen me shumë zhdërvjelltësi letrare po aq sa dhe me një ton të hapur: për shembull, në vitet 80-të ishte një situatë paradoksale që një shqiptar nga Kosova po ruante njërin nga institucionet serbe, që jo zyrtarisht njihej si çerdhja e nacionalizmit serb, prej rreziqeve krejtësisht të stisura shqiptare. Në këtë sens, një tjetër kontribut i vyer i këtij libri është që na jep një tablo plot dritëhije dhe me shumë nuanca, e jo bardh e zi, të një identiteti të tij si vetjak, si intelektual i majtë që mundohet përherë t’i rezistojë dogmave, qofshin këto ideologjike, fetare apo të tjera. Po ashtu, në këtë libër na jepet dhe një tablo plot ngjyra e një brezi të tërë intelektualësh të rritur si jugosllavë.

Pse dhe nga kush duhet lexuar

Tridhjetë vjet pas botimit të letrës së Malikut, drejtuar intelektualit serb, Pavle Ivic, rreth entonacionalizmit shqiptar, ne dimë ende shumë pak rreth zhvillimeve politike në Kosovë në tri dekadat e fundit. Librat akademikë që ekzistojnë nuk arrijnë përherë të kenë një audiencë jashtë qarqeve akademike; po ashtu ata shpesh bien në grackat e ideologjizimit nacional, pra dhe në grackat e të shkruarit si “shqiptar”, si “të majtë” si “të djathtë”, etj. Ky libër, edhe për vetë zhanrin në të cilin është shkruar mundohet t’i rezistojë këtyre. Duke mos qenë teorik dhe pa

u munduar të teorizojë ose mbianalizojë eksperiencat jetësore, ky libër mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë raportin e përditshëm të individit me sistemin politik. Ne këtë sens, për studentët e lëvizjeve politike ky është një libër që nuk duhet shpërfillur.

Po ashtu, libri mund t'u shërbejë dhe studiuesve të historisë bashkëkohore të Ballkanit; libri ka pasazhe të tëra mbi dallimet mes qyteteve dhe fshatrave shqiptare të Kosovës e republikave të tjera jugosllave gjatë komunizmit. Libri mund të shërbejë edhe për studentët e nacionalizmit dhe të konflikteve, të sociologjisë për rolin e intelektualit publik në zhvillimet politike e sociale. Kjo është sot një çështje më e rëndësishme se kurrë, kur roli i intelektualit publik dhe i kritikut social kanë ndryshuar rrënjësisht, ashtu si ka ndryshuar dhe sfera publike.

Recensa

Dokt. Klodiana TURHANI

Recensë e librit të Michel Foucault (1976) "*Historia e Seksualitetit, Vullneti për Dije*", përkthyer nga Orges Hazizi, Tiranë: UET Press, 2011

Librin i Michel Foucault (Mishel Fuko) *Historia e seksualitetit I: Vullneti për dije*, shkruar në vitin 1976, ka ardhur në shqip nga Orges Hazizi dhe është botuar nga UET Press në 2011. Fokusi kryesor i kësaj vepre të ndërtuar me shumë kujdes, është të na sjellë debatin mbi analizimin e pushtetit, duke thënë se, pushteti është një "Janus", pra që merr fytyra jo vetëm të ndryshme, por dhe krejt të kundërta. Me këtë kuptojmë, që nuk është një instancë ndalesash apo tabush, por prodhon, rikrijon ndalesa të tjera duke iu përshtatur konteksteve. Kreshëria për analizimin e këtij libri shtohet kur marrëdhënia e krijuar prej pushtetit kërkohet të qëmtohet duke marrë si indikator social historinë e seksualitetit. Ky indikator ka qenë në fakt kryesori dhe për Zigmund Frojd-in, por në pikëpamje të ndryshme. Prandaj mendoj se është një detyrim për të analizuar dhe për të lexuar qasjen Fukoldiane, nga një psikologe klinike, qoftë dhe në rastin kur vetë Fuko ka qenë herë-herë shumë e rreptë me psikanalizën dhe psikologjinë. Mëtimi dhe ftesa e autorit është për të parë shoqërinë moderne si shoqëri perverse dhe kjo, jo si shmangie e sundimit të puritanizmit Viktorian e as si kundërpërgjigje ndaj hipokrizisë së tij; por që shoqëria moderne është realisht perverse dhe e drejtpërdrejtë shkruan Fuko. Prandaj, në këtë paraqitje të shkurtër do të vihen në pah dy lexime që mund t'i bëhen këtij libri, njëri si studiues i shoqërisë në të cilën jetojmë (asaj moderne) dhe së dyti si një perspektivë e shkurtër për ata që merren apo dëshirojnë të merren me psikologjinë klinike si profesion.

1. Pushteti dhe kapaciteti për të klasifikuar sjelljet njerëzore

Sipas Mishel Foucault, si ai shprehet në këtë libër, kemi kriminalizim të shumë

sjelljeve dhe për rrjedhojë shtim të dënimeve mbi persione të vogla dhe një perceptim të çrregullimeve seksuale si sëmundje mendore. Gjatë dhe mbas periudhës Viktoriane (shek. XIX-XX), pra në shoqërinë moderne, kemi krijimin e normave të rrepta mbi zhvillimin seksual, kontrole pedagogjike me kura mjekësore, etiketim të sjelljes njerëzore nga mjekët, si dhe krijimin e një tipi seksualiteti që kërkohet të jetë i dobishëm dhe politikisht konservator. Për të përmendur dy shembuj, çrregullimet seksuale si fetishizmi, zoophilia etj, kthehen apo klasifikohen në të paligjshme. Moderniteti krijon atë që për Fukonë është dispozitivi i seksualitetit, i cili zbeh dispozitivin fisnor, por nuk e zhbën domosdoshmërisht dhe krejtësisht atë. Ndryshe nga dispozitivi fisnor që si qëllim riprodhimin, vë re Fuko, "... dispozitivi i seksualiteti ka si synim jo vetëm riprodhimin, por shumëfishimin, shpërhapjen, ripërtëritjen, kolonializmin, shpikjen, depërtimin gjithnjë e më të hollë të trupave, kontrollin gjithnjë e më global të popullsisë...". Më tej vijon "Bërthama nistore e zanafillës së tij qenë praktikë pendestare dhe pas ato të shqyrtimit të ndërjegjes dhe direktimit shpirtëror: mirëpo, siç e cekëm dhe më lart, gjyqi i pendësës përqendrohej te seksi për sa kohë ky ishte, para së gjithash, mishërim marrëdhëniesh fisnore. Pyetjet e shtruar fillimisht kishin të bënin me llojin e lejuar ose të ndaluar të marrëdhënieve mishtore... më pas, pak nga pak, me ardhjen e pastoriales së re – dhe zbulimin e saj nëpër seminare, kolegje dhe kuvende murgjërë – u kalua nga problematika "mishtore, domethënë tek ajo e trupit, e ndijimeve, e natyrës së kënaqësisë, e hoveve më të fshehta të epshit, e zgjimeve më të holla të kërshërisë dhe pëlqimit. Pikërisht nga ky çast fillon të lindë "seksualiteti", si pasojë e një teknike pushteti e cila fillimisht ishte përqendruar rreth fushës fisnore". Kjo perspektivë hap shumë mundësi për debate për transformime sociale dhe kulturore, të një natyre më rrënjësore sesa ajo e ofruar nëpër formave të tjera periodizuese.

Një rrafsh tjetër shumë provokues për imagjinatën e hulumtuesit të dijeve humane është raporti në mes pushtetit dhe rrëfimit edhe dijes në tërësi: "Njësoj si dashuria më e brishtë, edhe gjakësori i pushteteve ka nevojë për rrëfimin. Njeriu, në Perëndim, u bë kafshë e punës rrëfyese: Një ndër to na shfaqet në ditët tona njeriu rrëfyës i jetës intime. Nëpërmjet analizës së Fuko-së, ky njeri na vjen i shpalosur palë - palë nga folës të ndryshëm, që dikur ishin të parëndësishëm si ligjërues, por të cilët tani marrin fjalën dhe *rrëfihen* duke treguar hapur natyrën e tyre si, për shembull, emisioni Big Brother ose plot foltore të tjera në të cilat rrëfimi i intimitetit kthehet në normë, ndërsa e kundërta shfaqet si inferiore. Hipokrizia në këtë rast qëndron që kjo sjellje bëhet në emër të lirisë, ndërkohë s'do shumë mend për të kuptuar se jemi në një sistem tjetër të disiplinimit të seksualitetit dhe të imtimes që dikur ishte e parrëfyeshme. Mbetet për t'u analizuar se kujt po i rrëfëhet ai apo ajo, subjekti dhe individ që rrëfen intimitetin e tij apo të saj. Për më tepër, kush është tjetri imagjinar, audienca imagjinare dhe si është ndërtuar ajo? Për Fuko-në ka rëndësi që jemi para një rishqyrtimi të *seksualitetit*

normal dhe daljes në pah të *seksualiteteve periferike* të cilat dënohen më pak dhe janë zhvendosur për trajtim nga pedagogët dhe terapeutët. Fuko, nuk kënaqet të konstatojë historinë e njerëzimit apo të llojeve të pushteteve në mënyrë historiciste, por ai përpiket ta sjellë nëpërmjet metodës së gjeanalogjisë, një hulumtim mbi mendësitë e koncepteve dhe kuptimit kontekstual që kanë pasur për individin dhe si është pozicionuar ai me instancat e pushtetit.

Për Fukonë, ritualet për ta kthyer seksualitetin në tabu e kanë bërë atë objekt akoma më të përfolur. Thënë ndryshe, tabuja flet më shumë edhe kur mendohet se është lënë në heshtje. Por fakti për ta institucionalizuar tabunë, bënë që ajo të përfshijë një armatë të madhe aktorësh, që çon akoma më shumë në përfoljen e saj, duke krijuar një copëzim midis ligjërimit publik dhe atij privat. Janë ritualet, apo rolet që marrin institucionet si kisha, shteti, ligjet, politika dhe profesionet si mjeku, juristi, politikani, psikologu të cilët i dhanë legjitimitet vetes të jenë ata "zotritë", "ekspertët" që kanë përgjigje dhe kontroll mbi mendjen, trupin e tjetrit. Sa më intime, e errët, e pafolur të jetë problematika aq më shumë autoritet, epërsi dhe legjitimitet do të fitojë "eksperti" për të transmetuar një dije gjithëshpjeguese dhe që eskludon subjektin. Ekspertët kanë një dije, por dhe një përgjigje mbi pyetjet që ka njeriu mbi legjitimitimin e seksuales, intimes, identifikimit gjinor, vetvetes. Por, ky është një debat që është shumë aktual në fushën e psikologjisë klinike dhe të psikopatologjisë ku, Roland Gori përpiket të sjellë një këndvështrim kritik mbi "psikologjizmin"/ "shkencërizimin" e dijes e cila prodhon përgjigje për gjithçka dhe që çon në një instrumentalizim të dijes psikologjike nga "ekspertët". Gjithashtu, aktuale për kontekstin shqiptar, kur flitet për rastin e Nazmie Vishës ose për rastin e shumëpërfolur të Griseldës, ku psikologjia që kreu ekspertizën psikologjike rrëfen në Revistën "Psikologjia" takimin me subjektin.

Pra, në librin që kemi në diskutim, autori dëshiron të trajtojë një gjeanologji të pushtetit mbi seksualitetin. Seksualiteti është një nyje e lidhjeve sociale. Kjo e ndihmon të analizojë marrëdhëniet që krijohen midis pushtetit-dijes dhe kënaqësisë si elemente bazë për seksualitetin njerëzor. Tema e seksualiteti paraqitet te Fuko, jo si një ligjëratë mbi organizimin fiziologjik të trupit, as si një studim i sjelljes seksuale, por si një zgjatim për të analizuar pushtetin. Sipas Fuko-së, duke filluar nga shekulli XVIII, kemi investime të pushtetit në ligjërimet dhe praktikë e « mjekësisë sociale » në aspekte kyçe të jetës njerëzore, si shëndeti, ushqimi, seksualiteti etj. Seksualiteti është vetëm një nga fushat e aplikimit të « biopushtetit ». Në libër shprehet teza se seksualiteti serviret nga pushteti si një "lojë mbi të vërtetën" dhe me këtë Fuko, kupton se ne, shoqëria moderne, jemi një civilizim që u kërkon njerëzve të thonë të vërtetën mbi seksualitetin, që të dëshmojnë, të rrëfejnë vërtetësinë e tyre dhe jo seksualitetin si një zgjedhje të njeriut.

Fuko, vë në pah sesi praktikë fetare e përdorin "rrëfimin" si një teknikë për të penetruar sa më thellë në psikikën e individit. Ai shkruan se "Predikimi ekziston

sepse në të thuhet diçka seksuale “. Projekti i një historie të seksualitetit sillet për të hulumtuar mënyrat, sesi praktikat dhe ligjërimi fetar, shkencor, moralist, politik, ose ekonomik kanë kontribuar ta bëjnë seksualitetin jo vetëm instrument të krijimit të subjektivitetit, por edhe të instancave të pushtetit. Fuko, e dallon qartë seksin nga seksualiteti. Ai shkruan se “kur u fol si ligjërim për seksualitetin për herë të parë nuk u fol për seksin, por për trupin, organet seksuale, kënaqësitë, lidhjet martesore, marrëdhëniet ndërpersonale”. Të gjitha këto cilësi emërtojnë atë që ai e quan *dispositivi seksual* dhe se në një moment të caktuar u shfaq ideja mbi seksin. Problematika e seksualitetit është e ndarë në dy lloje etike: 1. *Aphrodisia* që përshkruan kënaqësinë, dëshirën, dhe aktin që i përkiste kohës greko-romane (trajtohet në librin 2 *Përdorimi i Kënaqësive*) dhe “chair” mishërimi që i jep rëndësi më shumë kënaqësisë sesa dëshirës ku ai i referohet periudhës të krishtërimit. Ai shkruan se “*morali i krishterë nuk funksionon mbi përzgjedhjen, por mbi bindjen jo mbi “aphrodisiac”, por mbi mish/ “chair”*”.

Seksualiteti për shumë kohë është menduar si një fushë e mbingarkuar nga ndalimet dhe censura. Familja borgjeze proklamonte se vetëm për seks nuk flitet, por e praktikojmë vetëm në rrethana të rezervuara. Kjo sipërmarrje frustuese i vete për shtat ideologjisë kapitaliste e cila i refuzon trupit, i cili kërkon kënaqësi dhe i jep rëndësi maksimalizimit të energjive për punë. Në një moment të dytë ai shpjegon pse kemi nxitje për të treguar. Pse seksi parashtrohet si diçka që duhet thënë dhe sesi kjo vjen qysh nga shekulli XVII. Sipas tij, kemi një grup institucionesh duke nisur nga feja, mjekësia, psikiatria, shteti me politikat mbi lindshmërinë, institucionet pedagogjike të obseduar për sa i përket sjelljeve “polymorphe”¹ që supozojnë një seksualitet infantil. Ai e përmbledh idenë e tij në këto terma: « *Seksi për kulturën tonë nuk është diçka që bëhet, por që flitet.* » Pyetjen që ngre është çfarë mund të bëjmë me seksin tonë? Ose më mirë me atë pjesë të seksualitetit që është ndryshe nga thjesht një funksion riprodhimi? Shumë civilizime mendojnë se u janë përgjigjur kësaj pyetje: duke e parë si një instrument ose duke i thënë rëndësi “kënaqësisë” duke e parë si “art-erotique”. Specialiteti i Perëndimit, sipas Fuko-së, ishte ta bënte seksualitetin më shumë vendin e ushtrimit të një dëshire së vërtetë të subjektivitetit? Kjo mund të shprehet më qartë me formulën për shembull: “Më thuaj mua si dhe çfarë dëshiron, të të them se cili je!”. I tillë është dispozitivi seksual i botës Perëndimore. Në pjesën e dytë, *Scientia Sexualis*. s Fuko sugjeron se nuk është më në lojë një trup e as shkalla e intensitetit të kënaqësisë, por subjekti dhe e vërteta mbi dëshirën e tij.

Në pjesën e fundit *Shpërndarja e perversitetëve*, Fuko flet për forma të

¹ Koncepti “polymorphe” nga vetë etimologjia e fjalës, vjen nga greqishtja që kupton “poly”-disa, “morphe”-forma. Koncept i përdorur nga Sigmund Frojd në librin “Tri teori mbi seksualitetin” shkruajtur në 1905, ku ai ka si shqetësim të shpjegojë se te fëmija kemi një “seksualitet infantil” i cili gjatë zhvillimit psikik kalon nga një pozicionim “biseksual” në një identifikim gjinor të ripozicionuar (femër/ mashkull) në adoleshencë.

shumëtrajtshme të seksualitetit. Ai shkruan se e kërkojmë seksualitetin gjithandej dhe e vendosim edhe aty ku nuk mund të qëndrojmë. Kodet juridike e inkuadronin seksualitetin vetëm te çiftet e martuara. Rreth tyre parashtroheshin ndalesat, rregullat etj. Ndërkohë, për sa i përket formave jo të pranueshme të seksualitetit (zoophile, sodomie, nekrophilie, etj.) nuk kishin të bënim me denoncimin e deviancave si raport i një norme, por dënohej si shkelje që thyenin kodin. Seksi kishte marrë natyrë juridike. Në shekullin XIX, kemi inkuadrim juridik të seksualitetit tek të marrët, te fëmija, te kriminelet, kurse çifti i martuar ka më shumë sjellje të rezervuar. Kemi një kriminalizim të ri të seksualitetit. Ligji mundëson kontroll të sjelljes sepse shihej rrezik ngado. Kemi shtim të dënimeve mbi perversione të vogla. Kur ligji bie ndërhyrjet pedagogjike dhe terapeutike fillojnë të kenë më shumë hapësirë. Kemi medikalizimin e seksualiteteve të pazakonta, analizimin e sjelljeve të çiftit, llojin e marrëdhënieve, kemi emërtimin sjellje të ligjshme dhe të paligjshme. Seksualiteti nuk trajtohet më nga gjykatësit, por fjala i kalon mjekut, psikiatrit, psikologut. Kemi rishqyrtim të seksualitetit normal dhe daljen në pah të seksualiteteve periferike të cilat dënohen më pak dhe janë zhvendosur për trajtim nga pedagogët dhe terapeutet. Kemi etiketime të shumëfishta të seksualitetit, si për shembull, seksualitet për sa i përket fiksimeve në shije apo objekte të veçanta (fetishizimi), seksualitet në marrëdhënien që formohet midis: mjek-pacient, nxënës-mësues, fëmijë- prind. Kjo sjellje paranoiake e cila e sheh rrezikun te dadoja, te mësuesi, te mjeku, tek anëtarët e familjes vjen pikërisht te popullarizimi i një seksualiteti, që e gjejmë kudo, që s’ka limite si prodhim i një ligjërimi që rreziku është i kudogjendur të cilin e prodhon moderniteti sot, për të legjitimuar format e kontrollit.

II. Leximi i Foucault-it në/për lentet e psikologjisë klinike: dy fjalë

Mishel Fuko është një filozof i cili gjatë gjithë jetës së tij nuk resht së treguari historinë mbi të përjashtuarit, të marrët, të marginalizuarit, për subjekte tabu si mendimin e subjektivitetit mbi kënaqësinë, mishërimin, dëshirat, por edhe mbi vdekjen, burgjet dhe luftërat. E në gjithë këtë ato ai sheh shenjat kryesore të lojës së pushtetit. Ai cilësohet si poststrukturalist i cili diti të risjellë në një formë origjinale idetë e veta, ose thënë më ndryshe si ai vetë e parashtroi një herë “si dhe në ç’masë është e mundur të mendosh ndryshe në vend që ta legjitimosh atë që tashmë dihet” (1992). Ai ndërtoi dhe shkoi në shtigje të tjera të reflektimit, por duke iu referuar dhe replikuar me autor si Levi Straus, Derrida etj. Sot, flasim për rrymë mendimi “foukolian” sepse mendimi i tij pati impakt te shumë studiues në shkencat sociale mbi mënyrën sesi ai e analizoi “biopushtetin” duke bërë një arkieologji të konceptit. Se çfarë solli të re në vend që të legjitimonte atë që dihej, vështirë është të thuhet

kaq lehtë, por së paku ai synonte të denonconte lidhjet e pushteteve okultike, të provokonte rezistencën, t'iu mundësonte zërave të shtypur të ekzistonin dhe të vlerësoheshin si dije joperiferike, të prodhonte dije të vërteta që të kundërshtonin format qeverisëse dominuese, të mundësonte lindjen e subjektiviteteve të reja, të përkufizonte liritë njerëzore dhe mundësitë për të vepruar, të vinte në pah historinë e sistemeve të dijes, të pushtetit dhe të subjektivitetit, e në fund të tregonte se asgjë nuk është fatale.

Tani po i kthehem pak pozicionimit tim teorik dhe etik. Me të drejtë kushdo që e njeh sado pak punën e këtij autori do të shtronte pyetjen: Pse një psikologe klinike na fton ta lexojmë kritikun e psikologjisë dhe veçanërisht psikanalizës. Mishel Fuko është një filozof i cili fillimet e tij akademike i filloi si lektor i psikologjisë ku ndër të tjera ai ka qenë specializuar në psikopatologji dhe në psikologji eksperimentale. Së dyti, ai ishte i interesuar të kuptonte çfarë kuptojmë me normale dhe patologjike në shoqëri duke përdorur si objekt studimi ligjërimin psikiatrik i cili merret me të sëmurin mendor, me të *marrin*. Kjo pikënisje nuk u venit asnjëherë si perspektivë në mendjen e tij, aty qëndruan ndoshta dhe origjina e pyetjeve kryesore. Këto ishin disa prej arsyeve, që zgjodha për të reflektuar rreth veprës së këtij autori, pyetje dhe shqetësimet që janë përdorur si një pikënisje në një kontribut të botuar po në revistën "Polis" (10/2011) që kishte si fokus teknikat në shkencat sociale dhe ku unë kam sjellë një shkrim kritik për sa i përket mënyrave sesi përdoren teknikat mjekësore gjatë ndjekjes së shtatzënisë dhe instrumentalizimin me ndërhyrjen cezariene. Janë këto teknika që krijojnë kontekstin në të cilin mjeku obstetrik-gjinekolog neglizhon etikën profesionale dhe keqpërdor besimin që pacienti i jep "mendimit të ekspertit". Ky është një shembull i thjeshtë për të treguar se analitika e Fuko-së është mjaft provokuese për këdo që rrëmon në lëmejt e shkencave sociale.

Fuko kur hulumton në teks mbi format e trajtimit që i kanë bërë seksualitetit shton se psikanaliza sipas Frojdit ka efekte normalizuese duke i dhënë një pushtet rolit të psikanalistit apo psikologut si e vetmja instancë ku ai mund të thotë çfarë mendon dhe se nuk do të paragjykohe mbi të. Më vonë është shprehur gjerë e gjatë për pushtetin pastoral që si qëllim kryesor ka vendosjen e rendit apo krijimin e rendit në vend të kaosit, dhe se ky pushtet krijon "veten" dhe "tjetrin". Kjo është një premisë shumë provokuese, eksplorimi me anë të saj mund të na mundësojë të shohim shumë realitete të krijuara nga disiplinat humanitare si "pushtete pastorale". Por, si bashkëkrijuese e Rrethit "Lakanian" në Tiranë nuk mund të rri pa shtuar se Foucault ka të drejtë për mënyrën sesi e rendit argumentin, sepse shqetësimi i tij është shoqëria dhe jo mirëqenia e një individ që mund të vijë nga seancat psikologjike me një psikanalist apo psikolog klinik. Si Fuko apo psikanalisti postfrojdian, Jacques Lacan, kanë pasur si fokus në punën e tyre, në forma të ndryshme, një etikë mbi subjektiven. Lacani duke u përpjekur që ta dallojë psikanalizën nga ligjërimi mjekësor dhe psikologjik dhe Foucault nëpërmjet metodës së « arkeologjisë së dijes » dhe "gjenealogjinë së pushtetit" të kuptojë

humanen. Veç faktit që psikologjia është parë si një pushtet pastoral, për Fukonë ka dhe një tjetër këndvështrim kritik mbi mënyrën sesi dija mbi psikologjinë e njeriut është instrumentalizuar për të sjellë një ligjërim faktues mjeko-ligjor. Ato janë përdorur nga pushteti për të legjitimuar aktet e tyre nëpërmjet ekspertizave mjeko-ligjore duke e sjellë faktin si të vërtetë. Psikologët janë të vetëdijshëm, ose së paku duhet të jenë të vetëdijshëm, për mekanizmat perversë që shpalosin institucione të ndryshëm duke u përpjekur të ndërtojnë një etikë profesionale dhe ajo që e bën të veçantë si fushë është se psikologu është i vetëdijshëm mbi teknikat kontrolluese të pushtetit që dominojnë njeriun, prandaj i jep rëndësi vetanalizimit për të analizuar pacientin në një hapë të dytë.

III. Konkluzion

Në përfundim, Fuko na flet për një seksualitet i cili është bërë objekt i punës së ekspertëve, i cili etiketohet, emërtohet, por nuk jetohet. Ligjërimi institucional i "ekspertëve" prodhon seksualitete të shumëfishta perverse të fëmija, në raport si formohen marrëdhëniet me tjetrin, marrëdhëniet me objektin ku sipas kohës dhe kontekstit u etiketuan. Institucionalizimi i praktikave fetare, shkencore, moraliste, politike, apo ekonomike e kanë kthyer seksualitetin si seli për të performuar pushtetin e tyre ndër të tjera. Foucault refuzon të pranojë se kemi një seksualitet të censuruar si rezultat i një pushteti represiv. Ai sugjeron që pushteti nuk është një instancë ndalesash, por prodhimi të të ndaluarash shumëformëshe që prek marrëdhënien e subjektit me tjetrin. Seksualiteti sipas Fuko-së nuk duhet të shihet vetëm si funksion riprodhimi, por me shumë funksione: *shumëfishimin, shpërhapjen, ripërtëritjen, kolonializmin, shpikjen, depërtimin gjithnjë e më të hollë të trupave, kontrollin gjithnjë e më global të popullsisë*. Ky dispozitiv nuk është domodoshmërisht asgjësues dhe zëvendësues, ai është trualli ku luhet loja e pushtetit, pa nevojë për qendër dhe periferi. Një pushtet jorepresiv dhe ndalues, por një pushtet me natyrë krijuese subjektivitetesh dhe të vërtetash, një pushtet në raport imtim me dijen dhe anasjelltas. Seksualiteti për Fukonë nuk është në kundërshti me pushtetin ku ky i fundit mundohet ta bëjë atë zap, as realitet i nëndheshëm, por duhet parë krejt ndryshe, dhe për ta mbyllur prapë me vetë fjalët e Fuko-së, seksualiteti është [... një rrjet i madh në sipërfaqe ku acarimi i trupave, intensifikimi i kënaqësive, nxitjet për ligjërime, grumbullimi i dijeve dhe përforsimi i dyanshëm i kontroleve dhe qëndresave vargëzon me njëri-tjetrin në përputhje me strategji të veçanta dijeshe dhe pushteti".

ABSTRACTS

Dialogue and Critique as a Means of Emancipation: what we can learn from Popper and Habermas

Fatos Tarifa and Tonin Gjuraj

While Popper's and Habermas' philosophies are often considered to be in irreconcilable conflict, essentially over issues in social science methodology and on political ideology, there are however elements that point to not only problems of mutual concern, but also to a number of shared values and assumptions, such as the value of freedom of speech and communication, which is central to both of them. For Popper, a key requirement of the open society is the freedom to criticize political and intellectual authority, while Habermas demonstrates the importance of open, undistorted communication. The main normative convergence of their thought can be found in Popper's sketch of the "open society" and Habermas's concept of an "ideal speech situation". Both philosophers advocate a public sphere characterized by free dialogue and criticism set within a democratic context, although they use significantly different ways of argument to establish them. This paper aims to delineate the importance of Popper's and Habermas' ideas on the role that free and undistorted public debate could play for the emancipation of Albania's intellectually acrimonious society.

Cultural Globalization and Global Communications

Aleksandër Dhima

This paper aims to reassess the present cultural *globalization's* challenges such as: ideological culture of *consumerism*, transnational cultural exchange and the *relativism* of ethno-cultural identities, in correlation with the *global communication*

that are a result of implementation of latest technology, and pluralism of media products. Based on empirical facts on the effects of *globalism* in the Albanian media environment, the author presents some of the main challenges that the Albanian society will face in the near future, connected with substantive vectors of the *global media* and their actual exposure in the native one.

Obstacles and Challenges in communicative processes between agents of different subcultures

Roland Lami

During the last two decades, we have witnessed a rural exodus and a significant demographic concentration in some of the major cities of Albania. Of course, this social mobility drives the creation of a multicultural reality in these cities, but without being able to avoid conflicts between individuals or groups belonging to different sub-cultures. In these social spaces, cultural identities do not fade, but instead they are already developed in a society of interaction, differences and communication. These subjects exhibit the willingness to socialize, to participate in the same actions, to belong to the same group as the host community. And yet, at the same time, they are differentiated, discriminated and excluded. From this perspective, this paper analyzes several variables that prevent the normal development of interactive processes between groups with different cultural identity.

Social Exclusion in the marginalized neighborhoods in Kukes

Rifat Demalija

The concept of social exclusion is relatively new in Albania, in both areas, academic and political, while the phenomenon of exclusion itself for certain social groups is present and scattered throughout the society.

In this article, we try to analyse *social exclusion* as a sociological phenomenon which goes through the following stages: *poverty* as the main element which social exclusion is identified; *participation and inclusiveness* as a tool to influence policy and establishing effective access to real actors in community life; ending with *demographic movement*, arguing the fact that it has influenced *the coexistence and stereotypes* as a barrier for the integration of excluded people. Building on insights from fieldwork, we reinforce the hypothesis that social exclusion is influenced by economic, political and cultural factors.

The way disadvantaged suburban neighbourhoods are structured in Kukes, depends on the chaotic development of the transition, on the one side, and the typical style of communist system, on the other. Demographic movement in Albania after 1992 is associated with lack of proper infrastructure, but acceptable for new comers, and the lack of social services affecting directly social exclusion. Addressing the issue of social exclusion in disadvantaged neighbourhoods is a complex problem and inseparable from central and local institutions, as well for the society in general, and therefore the results of this article will be addressed exactly to the actors in the region targeted as the object of the study.

Policy approaches for the marginalized groups: The limitations of public discourse on 'street children'

Blerjana Bino

The research project addresses the complex phenomenon of "street children" in the Albanian contemporary society and polity with a particular focus on discourse and policy approaches for inclusive education. "Street children" face multifaceted deprivation, social, economic, cultural and political exclusion, negative public perceptions and as such are placed at the outer margins of the mainstream society. The research project analyses the conceptual framework on "street children" as embedded in the intervention programs of governmental and non-governmental organizations for inclusive education. Through a qualitative methodology of document analysis, in-depth interviews and critical discourse analysis, the research project explores the ways in which the conceptual framework and discourse on "street children" impacts policy approaches for inclusive education. The research demonstrates that the discourse on "street children" in the public sphere (re) produces and reinforces already existing aspects of social deprivation, marginalization

and discrimination of these children and their families. The research shows that there are limited efforts to elaborate the concept of “street children” and that there is confusion in policy regarding the use of the term. In addition, “street children” are seen either as victims of socio-economic hardship and endangered by their presence in the spaces of the “street” or as a possible threat to the rest of the society, i.e. the street criminalises children. The research shows two main policy approaches: (i) correctional or repressive-oriented policy approach that conceives “street children” as a danger to public order whose features differentiate from mainstream childhood and as such invites intervention programmes that tend to “normalise” children as in the case of the National Strategy for Improving the Living Conditions of Roma community; (ii) protective or rehabilitative policy approaches, i.e. emphasising children needs and aiming at protecting and re-integrating them in family and mainstream society as demonstrated in the National Strategy for Children. Recent intervention programmes from non-governmental organisations draw from the conceptualisation of children as social actors and attempt to include children in research and development of intervention programmes. The research suggests that there is a need to link research on the socialisation processes, identity construction and resilience of “street children” in the spaces of the street based on their dynamic lifestyles and perspectives with policy development. This entails a deconstruction of the limits of discourse on “street children” and an in-depth and critical analysis of the concept of “street children” in policy development as well as a conceptualisation of children based on their rights.

Travel of neo-liberal theories in the area of urban development in post-socialist countries: The case of Albania

Marsela Mele and Entela Shehu

The neo-liberal discourse has dominated policy analysis in post socialist cities. Said's (1983) “travel theory” opens up a crucial research agenda, which establishes the displacements of ideas in different cultural or national sites as an important aspect of the production of knowledge. Drawing from Said's “travel theory” Smith (2006) suggests that theories of transition have travelled at different paces in different post socialist countries. This principle can be applied to the situation in Albania, which continues to defy a straightforward translation of Western urban theory to an understanding of the local context. Albania provides a good example of two aspects of “travelling urban theory”: (1) the transfer of “good practice” models of urban governance and (2) the application

of Anglo-American urban theories to knowledge of changing spaces of governance and suburban development in the Tirana city region. Focusing on the analysis of suburban development in the Tirana city region, this paper examines in what ways can, or should, “travelling urban theory” be grounded in the evolving complexities and contradictions of urban life in the Tirana city region. Specifically it considers the relevance of urban theories developed by British and American scholars of urban development for transitional urban economies. Enacting the transfer of theory from one context to another represented a challenge for the first author, who is an Albanian scholar doing PhD research in the UK, but also for the second one who saw its implementation on the ground. While some theoretical concepts were helpful in contextualizing the situation in Albania, we propose that western theory does not “fit” well within the context of understanding processes of suburban development in Tirana. We examine two contexts where travelling urban theory collided with local knowledge on the ground and consequently led to a modification of conceptual themes. These were, respectively, (a) knowledge of local livelihood strategies and (b) local property knowledge.

The “desire of the Other” as an indicator to read psychological suffering and mutations in contemporary social relations

Klodiana Turhani

Through the concept of the “desire of the Other” we will try to explore how parenting processes reveals in the case of a woman who becomes a mother. To understand the Other's desire as a concept must first analyze the function of the Other in Freudian and Lacanian more generally in psychoanalytic terms. Start from the paradigm, that one of the functions of the Other is imaginary representations that the subject have as reference. The Other interfere on the subject or, the other is viewed as a place where the subject speaks and addresses his complaint. After all, without the Other has no meanings.

Concrete case to be presented will focus on the case study of a woman interviewed before and after pregnancy. The desire of the mother to have a baby boy goes so far as the mother denies the achievements of science by questioning the results of “gynecology echography”. The mother has been told after having gynecology echography that her baby is a boy. Faced with dilemmas created by

the Desire of the Other to have a boy and her position as mother she chooses to deny the truth offered by the technology and in place of it she choose to use another system that can give her hope to have a baby according to Other Desire – a boy and to give to her baby birth

The question of this study is that we have a fundamental change in social discourse regarding how the woman construct and expresses her willingness/desire and creates parenting confronting and living within the context of plurality of ideologies and system of values. Giving a birth to female child which does not consist with what is desired by the Other, brings confusion and denial to the mother. As the wife of man, the mother, refuses to accept child sexuality during pregnancy and wants to sacrifice herself to achieve the desire. As a mother, she lives in ambiguity, she wants to have this child with no condition on sexuality of the baby, but /and she likes to fulfill the Desire of the Other at the same time.

Key words: The big Other, social discourse, clinical fact, women, motherhood, subjectivity, technology.

Down with corruption! May Neo-liberalism live long! The international anti-corruption campaign in Albania 1998-2005

Blendi Kajsii

During the period 1998-2005 international organizations, Albanian civil society groups and the Albanian Government implemented a multidimensional anti-corruption program in Albania. This program ranged from anti-corruption awareness campaigns that sought to educate the general public about the dangers of corruption to specific policies that sought to reduce corruption levels in the Albanian governance. After an intensive and multidimensional ear that lasted for almost eight years corruption levels in Albania did not change substantially. On the contrary, some phenomena such as state capture, increased during the 1998 – 2005 period. In order to explain this paradox I argue that the anti-corruption campaign in Albania served to institute the neoliberal order in the country. Thus,

while unsuccessful in lowering corruption levels it succeeded in strengthening the neoliberal order in Albania. Corruption served as a threat against which the neoliberal order could be legitimized.

The level of satisfaction of Albanians in relation to democracy: The impact of leadership and trust in institutions

Marsela Dauti

This study focuses on citizen satisfaction with democracy in Albania. Utilizing data from the World Values Survey of Albania (2002), this study examines the impact that satisfaction with the work of high-level officials and confidence in social and political institutions have on satisfaction with democracy, controlling for the effects of financial security, education, and geography. Results indicated that individuals who were satisfied with democracy were more likely to be satisfied with the work of high-level officials and had a high level of confidence in social and political institutions. Satisfaction with the work of high-level officials had the greatest impact on the likelihood of Albanians to be satisfied with democracy. These findings add value to the existing debates on democracy and governance in Albania, showing that satisfaction with state leadership and confidence in social and political institutions matter to citizen satisfaction with democracy.

Social Media, Audience and Politics: What type of Audience do politicians target through social media?

Erald Kapri

This essay will examine the role of social media in politics and it will provide answers; what audience want to reach politicians through the internet. It will examine and focus on two Albanian leaders of Albania (the former Prime Minister and leader

of the Democratic Party, Sali Berisha and the former leader of opposition and incoming Prime Minister Edi Rama) since the time they joined social media, Facebook and Twitter respectively. Meanwhile, the essay will provide an overview on effect of social media in audience and politic and relations between them. Since internet and social media are a platform when everyone is free to express, how is this affecting politicians and their political attitude? These platforms allow having more contact with elected representatives but is accountability growing? Internet and social media provide more evidence and transparency but is this effecting power and policy-making? These relations will be analysed in order to understand changing on political audience or voters.